

**Strategjia e Zhvillimit Rural**

**per**

**Shqiperine**

**Mbeshtetje per rritje ekonomike dhe zhvillim te qendrueshem**

**Nentor 2002**

Pergatitur nga Departamenti i Zhvillimeve te  
Qendrueshme Sociale dhe Mjedisore per Evropen dhe Azine Qendrore, Banka Boterore  
Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit, Shqiperi

Perkthyer nga Sofi Noti

## Permbajtja e Lendes

<b>Permbledhje Ekzekutive .....</b>	<b>i</b>
<b>1. Hyrje .....</b>	<b>1</b>
<b>2. Vleresimi i situates aktuale te zhvillimit rural .....</b>	<b>3</b>
2.1 Dekada e fundit-Zhvillime dhe frenime .....	3
A. Zhvillimi ekonomik dhe reformat .....	3
B. Varferia rurale .....	4
C. Sektori bujqesor .....	6
D. Struktura ne ndryshim e bujqesise .....	8
E. Ndryshimet rajonale .....	12
F. Te ardhurat nga ferma .....	14
G. Ekonomia rurale jobujqesore .....	15
H. Migracioni dhe dergesat .....	16
I. Mbeshtetja ekonomike dhe sherbimet e sektorit publik .....	19
J. Mjedisi dhe burimet natyrore .....	20
2.2 Gjendja dhe zhvillimi aktual - Kuadri strukturor .....	24
A. Kuadri i nxiteseve – Mjedisi makroekonomik .....	24
B. Kuadri i politikave rurale .....	27
C. Reformat institucionale dhe iniciativat .....	31
D. Klima e biznesit – Zhvillimi i sektorit privat .....	36
E. Procesi i privatizimit te tokes .....	39
2.3 Situata dhe zhvillimi aktual- Sherbimet rurale.....	41
A. Infrastruktura rurale .....	41
B. Sherbimet mbeshtetjen rurale.....	45
C. Marketingu dhe agro-perpunimi.....	56
D. Financat rurale.....	61
<b>3. Nje pershkrim i Strategjise rurale – Elementet esenciale per mbeshtetjen e rritjes ekonomike dhe zhvillimit te qendrueshem.....</b>	<b>66</b>
3.1 Nje kuader makroekonomik i stabilizuar .....	68
3.2 Decentralizimi dhe roli i zhvillimit me baze komuniteti .....	69
3.3 Permiresimi i klimes se biznesit.....	71
3.4 Infrastruktura rurale .....	73
3.5 Tregjet e tokes.....	76
3.6 Sherbimet mbeshtetese rurale .....	79
3.7 Zhvillimi rural jobujqesor .....	84
3.8 Manaxhimi i qendrueshem i burimeve.....	87

<b>4. Korniza e nje Strategjie Rurale – Zonat kryesore per nderhyrjet e Bankes Boterore .....</b>	<b>90</b>
A. Te vijojte theksi mbi reformat ne aspektin e politikave dhe programet specifike per mbeshtetjen e zhvillimin te sektorit privat .....	90
B. Rritja e kapaciteteve institucionale ne kushtet e nje klime decentralizimi ne te gjitha nivelet .....	91
C. Te vijojte vemendje ne zhvillimin e tregjeve te tokes .....	92
D. Fuqizimi i sherbimeve rurale perfshire kerkimin dhe ekstensionin, sherbimet veterinare dhe ato te mbareshtimit, marketingun dhe agro-perpunimin .....	94
E. Mbeshtetja per rritjen e disponueshmerise se sherbimeve financiare ne zonat rurale .....	96
F. Rritja e investimeve ne rehabilitimin e infrastruktures dhe permiresimi i menaxhimit te infrastruktures rurale .....	98
G. Hartimi i programeve specifike qe synojne zhvillimin e ekonomise rurale jobujqesore, me nje fokus ne zonat rurale, ku potencialet bujqesore jane te kufizuara .....	100
H. Rritja e vemendjes ne menaxhimin e qendrushem te burimeve .....	101

#### **Tabela**

Tabela 1. Varferia sipas burimit kryesor te te ardhurave familjare .....	4
Tabela 2. Ritmet e rritjes ne ekonomie e pergjithshme dhe sektorin bujqesor .....	7
Tabela 3. Siperfaqja, prodhimi dhe rendimenti i dritherave .....	9
Tabela 4. Struktura bujqesore ne te kater zonat .....	13
Tabela 5. Ndryshimet ne te ardhurat nga ferma .....	15
Tabela 6. Drejtimet me te rendesishme te perdorimit te dergesave .....	18
Tabela 7. Kategorite kryesore te Tregetimit te Mallrave .....	25
Tabela 8. Prodhimi agro-industrial i produkteve te perpunuara blegtorale .....	52
Tabela 9. Eksportet, importet kryesore dhe destinacioni kryesor .....	57
Tabela 10. Zhvillimi dhe agro-perpunimi .....	61
Tabela 11. Pozicioni i Shoqatave te Kursim-Kredise .....	65

#### **Kuti**

Kutia 1. Lidhjet midis BE dhe Shqiperise ne dekadën e fundit .....	27
Kutia 2. Kater iniciativat kryesore me te mprehta .....	32
Kutia 3. Lidhjet midis sherbimeve te varfera te ujit dhe varferise rurale .....	42
Kutia 4. Shqiperia: Marketingu i qumeshtit te varferve .....	53
Kutia 5. Vendi i shitjes dhe blerjes se produkteve .....	58
Kutia 6. Eksperienca e fituar – Eksperienca nga vendet e ECA-s .....	67
Kutia 7. Ceshtjet kryesore per klimen e investimeve direkte te huaja .....	73

#### **Anekse**

Aneksi I. Baza e burimeve natyrore ne Shqiperi .....	104
Aneksi II. Pakti i Stabilitetit .....	108
Aneksi III. Tabela reference nga teksti .....	109
Aneksi IV. Te dhena mbi popullsine .....	120

## Shkurtime dhe Akronime

AFADA	Shoqata shqiptare e tregtareve te plehrave kimike dhe agro-biznesit
AGM	Agjencia Globale e Mjedisit
AKM	Agjencia Kombetare e Mjedisit
ARUH	Agjencia Rurale e Ujit dhe Higjenes
BE	Bashkimi European
BKT	Banka Kombetare Tregtare
CARDS	Asistenca e Komunitetit per Rindertim, Demokratizim dhe Stabilizim
DBR	Drejtori i Bujqesise se Rrethit
DENA	Shoqata Kombetare e e Sipermarresve te Bulmetit
DPP	Drejtoria e Pergjithshme e Pyjeve
DPPK	Drejtoria e Pergjithshme e Pyjeve dhe Kullotave
EBRD	Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim
ERJB	Ekonomia Rurale Jobujqesore
F&M	Funksionim dhe Mirembajtje
FEFAD	Federata per Financimin e Zhvillimin e Ndermarrjeve
FFR	Fondi i Financimit Rural
FFZM	Fondi i Financimit te Zonave Malore
FKF	Fondet e Kredise ne Fshat
FZSHH	Fondi i Zhvillimit Shqiptar
GDP	Produkti i Brendshem Bruto
GIF	Grupet e Interesave te Fermereve
GPRS	Strategjia e Rritjes Ekonomike dhe Uljes se Varferise
IFDC	Qendra Nderkombetare e Zhvillimit te Plehrave
IMB	Instituti i Mbrojtjes se Bimeve
KSHA	Keshilli Shqiptar i Agro-Biznesit
KSHA	Kuadri i Shpenzimeve Afat-mesme
MBU	Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit
MM	Memorandumi i Mirekuptimit
MM	Ministria e Mjedisit
MPL	Ministria e Pushtetit Lokal
MPPT	Ministria e Puneve Publike dhe Transportit
MT	Ministria e Transporteve
NA	Nderzimi Artificial
NJMPM	Njesia e Manaxhimit te Projekteve te Mjedisit
NRU	Njesia e Rregullimit te Ujit
NUR	Ndermarrja e Ujit ne Rreth
OBT	Organizata Boterore e Tregtise
OJQ	Organizata Joqeveritare
OSBE	Organizata per Siguri dhe Bashkepunim ne Europe
PKSHE	Programi Kombetar Shqiptar i Ekstensionit
PRSC	Kredia per Strategjine e Uljes se Varferise
QKKBE	Qendra Kombetare e Kerkimit Bujqesor dhe Ekstensionit
QRKB	Qendrat Rajonale per Keshillimin Bujqesor
QRKE	Qendrat Rajonale te Kerkimit dhe Ekstensionit
SHH	Shoqatat e Hortikultures
SHKK	Shoqatat e Kursim Kredise
SHPU	Shoqatat e Perdoriesve te Ujit

SHVU	Shoqata e Vajrave Ushqimore
SME	Ndermarrjet e Vogla dhe te Mesme
SRPP	Sistemi i Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme
TVSH	Taksa mbi Vleren e Shtuar
USD	Dollari Amerikan
VNM	Vleresimi i Ndikimit te Mjedisit

## Falënderime

Autorët e këtij raporti dëshirojnë të falenderojnë një sërë bashkëpunëtorësh për mbështetjen dhe kontributin e tyre. Ky raport është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Bankës Botërore dhe Ministrisë shqiptare të Bujqësisë dhe Ushqimit për përkufizimin e mëtejshëm të strategjisë rurale gjatë këtyre dy vjetëve të fundit. Organizata e DFID-it ka dhënë kontributin e saj në pjesën ku flitet për zhvillimin rural jo-fermer. Kolegët që kontribuan në mënyrë direkte në këtë raport për pjesën e Bankës janë: Frauke Jungbluth (drejtuese projekti, ekonomiste agrare), David Lugg (specialist agrar), Ibrahim Hackaj (specialist agrar), Roy Southworth (ekonomist agrar), Ivan Ford (specialist për tokat), Graham Owen (financim rural), Gerhard Dieterle (burimet natyrore), Arben Bakllamaja (ujë dhe infrastrukturë), Tjaart Schillhorn-Van Veen (specialist për blegtorinë dhe veterinarinë), Philippe Lepere (specialist veteriner), Christoph Pusch (infrastrukturë), Sarah Leigh Hammill (redaktoi dhe përpunoi tekstin).

Raportit i erdhën në ndihmë diskutimet e frutshme me Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit. Dëshirojmë të falenderojmë në veçanti Prof. Dr. Vjollca Ibro, Zëvendës Ministre e Bujqësisë, z. Arben Molla, Drejtor i Zyrës së Programeve Bujqësore dhe Zhvillimit Rural, znj. Tatjana Dishnica, Drejtore e Drejtorisë së Shkencës dhe Shërbimeve Këshillimore, z. Irfan Tarelli, Drejtor i Drejtorisë së Ekstensionit, z. Serri Allushi, Drejtor i Drejtorisë së Statistikës dhe Informacionit, z. Bardhyl Qilimi, Drejtor i Departamentit të Tokës dhe kolegë të tjerë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministrisë së Mjedisit. Gjithashtu, dëshirojmë të falenderojmë zotërinjte Shkelzen Marku, Ylli Bicoku dhe Claude Freeman për informacionin dhe diskutimet me vlerë. Po ashtu, dëshirojmë të falenderojmë edhe shumë bashkëpunëtorë të tjerë, të cilët dhanë kontributin e tyre për pjesë të ndryshme të këtij raporti.

Për këtë raport u zhvilluan një sërë takimesh konsultative në Shqipëri. Autorët e raportit dëshirojnë të falenderojnë z. Michael Hoffman të Qendrës “Carter” në Shqipëri dhe gjithë stafin e tij për organizimin e takimeve dhe sigurimin e një pjesëmarrjeje të gjerë të grupeve të ndryshme të palëve të interesuara. Diskutimet e gjalla dhe mendimet e vjela në këto diskutime kontribuan në mënyrë të ndjeshme në lidhje me problemet e ngritura nga ky raport. Gjithashtu raporti pasqyron interesimin e madh dhe dëshirën e këtyre grupeve për ta çuar më tej zhvillimin në zonat rurale në Shqipëri. Ne dëshirojmë të shprehim mirënjohjen dhe falënderimet tona për të gjithë pjesëmarrësit.

Ky raport është shqyrtuar nga një numër kolegësh në Bankën Botërore. Autorët e raportit dëshirojnë të falenderojnë në veçanti për ndihmesën dhe komentet z/znj. Laura Tuck, Marjory-Ann Bromhead, Kathryn Funk, Roy Southworth, Ibrahim Hackaj, si edhe z. David Steeds dhe znj. Arntraud Hartman. Drejtore e Sektorit është znj. Laura Tuck dhe Drejtor për Shqipërinë është z. Christiaan J. Poortman.





## **Strategjia Rurale per Shqiperine – Mbeshtetje per Rritje Ekonomike dhe Zhvillim te Qendrueshem**

### **Permbledhje Ekzekutive**

1. Shqiperia eshte nje vend relativisht i vogel, me relief te theksuar malor dhe me nje popullsi prej rreth 3.4 milion banoresh. Vetem 24 perqind e tokes se saj klasifikohet si toke bujqesore, 36 perqind jane pyje dhe 15 perqind kullota. Ende, bujqesia perben bazen e te ardhurave per pjesen me te madhe te popullsisë dhe sherben si nje burim punesimi. Popullsia rurale vleresohet te perbeje rreth 54 perqind te popullsisë totale, ndersa me shume se 60 perqind e fuqise punetore punon ne bujqesi dhe fusha te lidhura me te.
2. Shqiperia ka pershkuar nje rruge te gjate qe nga faza e tranzicionit drejt ekonomise se tregut ne vitin 1991. Kushtet fillestare ne Shqiperi nuk ishin te favorshme per te perballuar nje tranzicion te tille, nese ato krahasohen me vendet e tjera te Europes Lindore dhe Qendrore. Reformat thelbesore, te cilat perfshinin privatizimin dhe shperndarjen e tokes, si dhe liberalizimin e tregut dhe te cmimeve, ndihmuan ne rritjen e prodhimit rural. Investime te rendesishme ne rehabilitimin e infrastruktures, e vecanerisht ate te infrastruktures ujtesë ndikuan ne pershpejtimin e zhvillimit. Por Shqiperia arriti te ndryshonte shume shpejt, duke zbatuar ne menyre shume strikte ndryshime makro-ekonomike, duke privatizuar token dhe ndermarrjet shteterore.
3. Nje kuader i pergjithshem makro-ekonomik si dhe reforma thelbesore me karakter politik dhe institucional ndihmuan qe ta pershpejtonin kete tranzicion, i cili rezultoi ne rritje te prodhimit dhe te te ardhurave qe prej vitit 1992. Sektori rural jorentabel i dominuar nga ferma te medha shteterore apo kolektive dhe ndermarrjet bujqesore, u shnderrua ne nje sektor rural i karakterizuar nga mijera ferma te vogla me baze familje. Megjithese fermat ishin jashtezakonisht te vogla dhe te copezuara, ato regjistruan nje rritje te prodhimit pasi pronaret e fermave te reja punuan intensivisht per te permiresuar rendimentin e tyre.
4. Pavaresisht nga te gjitha zhvillimet pozitive, varferia eshte ende e qendrueshme dhe godet me ashper zonat rurale. Pothuaj nje ne cdo tre shqiptare mund te konsiderohet i varfer dhe kater ne cdo pese te varfer, jetojne ne zonat rurale. Pabarazia ne nivelin e te ardhurave eshte e larte referuar standardeve rajonale, dhe varferia eshte me e larte ne familjet me nje nivel te ulet shkollimi dhe me shume femije. Shume familje, vecanerisht ne zonat rurale, nuk kane akses ne infrastrukturen baze, perfshire edukimin baze dhe sherbimet shendetesore.
5. Ky dokument do t'i sherbeje perpjekjeve ne vazhdim per te intensifikuar zhvillimin dhe reduktuar varferine ne zonat rurale. Ai siguron nje trajtim te gjithanshem te situates aktuale ne zonat rurale dhe zhvillimeve gjate dekadës se fundit, merr ne shqyrtim mundesite ekzistuese dhe identifikon komponentet themelore te zhvillimit rural dhe reduktimit te varferise<sup>1</sup>. Ai sugjeron veprime per perballimin e problemeve, identifikon prioritete aty ku eshte e mundur dhe rekomandon fushat e angazhimit te Bankes Boterore per te ardhmen.
6. Strategjite per hapësiren rurale duhet te shkojne pertej permiresimit te rendimentit bujqesor. Ndersa bujqesia vazhdon te luaje nje rol kryesor ne zonat rurale ne drejtim te sigurimit

---

<sup>1</sup> Kontributet per kete document vijne nga nje game e gjere individesh dhe institucionesh. Per pergatitjen e saj, u hartuan raporte te ndryshme informuese. Keto raporte u perdoren bashkarisht me Qeverine dhe mbeshteten direct punen e Ministrise se Bujqesise ne hartimin e Strategjise per Rritjen Ekonomike dhe Reduktimin e Varferise. Tavolina te rumbullaketa u zhvilluan se bashku me Qeverine dhe shoqerine civile, per te diskutuar probleme dhe mundesi ekzistuese ne zonat rurale te Shqiperise, dhe gjetjet e tyre jane te perfshira ne kete dokument.

te te ardhurave dhe mundesive per punesim, shume faktore te tjere nderlidhes duhet te merren ne konsiderate ne menyre qe te realizohen ndryshime strukturore, te permiresohet infrastruktura sociale dhe te rriten te ardhurat. Ndersa diskutimet rreth ketij dokumenti shkojne pertej ceshtjeve bujqesore, ne menyre qe te arrihet nje panorame sa me e plote e sektorit rural, ende ka ceshtje qe mbeten te patrajtuara. Keto ceshtje jane arsimi, shendetesia dhe mbrojtja sociale ne zonet rurale. Perjashtimi tyre nuk nenkupton se ato jane me pak te rendesishme per zhvillimin rural. Nje pune e metejshme eshte planifikuar per formulimin e strategjive dhe veprimeve qe do te adresonin faktoret frenues te ketyre ceshtjeve ne zonat rurale.

7. Permiresimet ne aspektin e nje strategjie mund te kishin nje efekt pozitiv, por gjithsesi vetem permiresimet ne nje numer aspektesh mund ta ndryshojne situaten ne teresi. Nje strategji rurale per Shqiperine duhet te kete si objektiva qendrore elementet e meposhtem: (a) rritja e vazhdueshme e te ardhurave; (b) reduktim i varferise rurale; dhe (c) menaxhimi i qendrueshem i burimeve natyrore, perfshire pyjet, kullotat dhe ujin. Implementimi i nje strategjie te tille per Shqiperine domosdoshmerisht do te perfshije aksione intensive ne sektore te ndryshem dhe nje numer agjencish te ndryshme qeveritare te niveleve te ndryshme, si dhe do te kerkoje nje fokus te forte mbi masat mbeshtetese te cilat mundesojne uljen e varferise ne zonat rurale, dhe gjithashtu edhe nje veshtrim mbi strategjite potenciale te ndryshme rajonale te zhvillimit. Nje strategji e sukseshme rurale do te kerkoje nje baze te qendrueshme te nje stabiliteti te vazhdueshem makro-ekonomik, karakterizuar nga inflacioni i ulet, nje stabilitet te monedhes vendase, reduktimi i deficiteve fiskale, dhe stabilitet te jashtem te konsoliduar. Mbi kete themel sugjerohen te ngrihen tete fusha baze qe do te formojne berthamen e strategjise:

- Mbeshtetje e metejshme e reformave te politikave per te krijuar nje mjedsi politik favorizues per zhvillimin ne zonat rurale.
- Theks i vazhdueshem mbi regjistrimin e tokes dhe zhvillimin e tregjeve te tokes.
- Rritja e vemendjes mbi ndertimin e kapaciteteve gjate dhe pas procesit te decentralizimit (a) ne nivelin lokal per te fuqizuar strukturat zyrtare te sapokrijuara dhe (b) ne nivelin kombetar per te fuqizuar institucionet qendrore (ministrite).
- Rritja e perfshirjes ne iniciativat komunitare qe synojne permiresimin e infrastruktures rurale, perfshire ujitjen, furnizimin me uje, menaxhimin e tokes per kullote dhe rruget rurale.
- Fuqizimi i metejshem i sherbimeve mbeshtetese rurale me fokus qendror ne sherbimet mbeshtetese bujqesore dhe sigurine ushqimore, por pa perjashtuar aktivitetet te orientuara drejt sektorit jobujqesor.
- Arritja e sukseseve ne sektorin e finances rurale dhe shtrirja e sherbimeve si dhe e iniciativave ekzistuese te mikrokredise, dhe te nxitet shtrirja e rrjetit bankar ne zonat rurale.
- Hartimi i opsioneve per mbeshtetjen e zhvillimit rural me drejtim jobujqesor, ne funksion te krijimit te mundesive per punesim dhe sigurimit te te ardhurave ne zonat rurale, dhe te aftesohen njerezit te jene me te pergatitur per te mbeshtetur vetveten ngado.
- Fuqizimi i perfshirjes ne menaxhimin e burimeve natyrore si ne nivel hartimi politikash ashtu dhe drejperdrejt nepermjet aktiviteteve te projekteve me nje synim te qarte.

### **Varferia Rurale dhe Diferencat Rajonale**

8. Varferia. Varferia ne Shqiperi ka karakteristika te ndryshme, por predominon ne zonat rurale. Varferia ne Shqiperi ka shume dimensione si: (a) niveli i ulet apo shume i ulet i te ardhurave te te varferve; (b) rreziku i larte nga semundjet dhe mungesa e sherbimeve te pershtatshme shendetesore; (c) analfabetizmi dhe niveli i ulet i shkollimit; dhe (d) aksesit i kufizuar ne institucionet vendim-marrese qeveritare. Nje e treta e shqiptareve mund te

konsiderohet e varfer, ndersa gjysma e tyre jetojne ne varferi ekstreme. Vdekshmeria foshnjore dhe vdekshmeria tek femijet nen moshen pese vjec, eshte relativisht e larte, krahasuar me ato te vendeve te tjera ne rajon, dhe pothuaj nje ne cdo shtate femije nen moshen pese vjec, eshte i kequshqyer. Analfabetizmi eshte rritur; dhe tre te katertat e familjeve te varfera perjetojne probleme sociale akute te njerit lloj apo tjetrit.

9. Mundesia e te jetuarit ne varferi rritet paralel me rritjen e madhesis se familjes. Nivelet e varferise jane relativisht te larta ne ato grupe, per te cilat bujqesia eshte burimi kryesor i te ardhurave. Kjo perforcohet nga fakti qe rreth 50% e te varferve jane fermere, 20% jane pensioniste dhe 10% jane te punesuar ne sektorin jobujqesor. Sipas LSMS ne 1998, me shume se gjysma e familjeve, ne te cilat kryefamiljari ishte i papune, ishte nen nivelin e varferise. Njerezit e punesuar kane nje mundesi me te vogel per te hyre ne kategorine e te varferve, nese ato jetojne ne zonat urbane (5.3%), ne krahasim me ato rurale (32.6%). Nje ne cdo gjashte familje jeton me me pak se 1US\$ ne dite dhe pothuaj nje ne cdo dy familje, jeton me me pak se 2US\$ ne dite.

10. **Dimensionin rajonal.** Varferia ka edhe nje dimension rajonal. Rajonet e Kukesit dhe Dibres, ne rajonin malor verior, dhe Elbasani, ne rajonin qendror, mund te konsiderohen si me te varferat. Familjet ne Tirane, Durres dhe Vlore, ne ultesiren bregdetare, jane mesatarisht ne nje nivel me te mire. Niveli shume i ulet i shperndarjes se tokes se punueshme per fryme ne zonat rurale, konsiderohet si nje nga shkaqet kryesore te varferise ne zonat rurale. Duke mos patur mjete te tjera jetese, pervec tokes bujqesore, pjesa me e madhe e familjeve ne rrethet e Dibres, Kukesit, Tropojes, Shkodres, Mirdites dhe Matit, mbesheten kryesisht ne te ardhurat dhe produktet e fermes se tyre.

11. **Diferencat rajonale.** Diferencat rajonale ne lidhje me burimet, pozicionin gjeografik, infrastrukturen, klimen, etj., duhet te merren ne konsiderate kur merren vendime strategjike per buxhetin, permiresimet ne infrastrukture dhe zhvillimin e sherbimeve. Rajonet e Shqiperise ndryshojne ne menyre te konsiderueshme ne drejtim te klimes, terrenit dhe aksesit ne sherbimet dhe tregjet rurale, si dhe zhvillimin e infrastruktures. Zonat e uleta me potenciale me te larta te prodhimit bujqesor, zonat e ndermjetme dhe ato te larta, te gjitha jane te dallueshme. Keto diferenca rajonale, vecanerisht per zonat me te largeta si ato verilindore, japin ndikimin e tyre ne cfaredolloj rruge zhvillimi qe vendi mund te zgjedhe. Keto diferenca duhet gjithashtu te ndikojne edhe ne vendimet mbi rruget sesi mund te ndihmohen nepermjet programeve te ndryshme, zona specifike. Nuk ekziston asnje metodologji qe do t'i pershtatej njelloj te gjitha rajoneve. E ndersa perpjekjet per zhvillim mund te japin rezultate pozitive per disa rajone, por per disa te tjera, nuk do te ishte e mundur qe ato te rimekembnin ekonomine, dhe njerezve te tyre do t'u sherbente me shume nese ata te pajisur me mire me sherbime arsimore dhe ne gjendje te mire shendetesore te kerkonin mundesi sigurimi te ardhurash gjetke. Kjo, vlen ne vecanti per zonat e largeta ne verilindje, ku mundesite per gjenerim te ardhurash duken shume te pashpresa. Qeveria duhet te vazhdoje te zhvilloje nje vizion strategjik rajonal, i cili lejon nje perdorim me te orientuar te burimeve per aktivitete prioritare ne zona te vecanta. Kjo nuk do te thote se disa zona do te perjashtohen nga mbeshetja, por ajo sugjeron qe llojet e nderhyrjes mund te ndryshojne. Per shembull, ndersa eshte e nevojshme per te siguruar sherbimet baze ne infrastrukture ne te gjitha vendin, permiresime te metejshme te rrjetit te rrugëve duhet te perqendrohen ne zonat me potenciale me te medha rritjeje si ato bregdetare dhe zonat jugore te vendit.

12. Dergesat nga emigracioni luajne nje rol te rendesishem ne ekonomine shqiptare. Dergesat vleresohen te zene rreth 18 per qind te GDP ne Shqiperi dhe te perbejne 30-50 perqind te te ardhurave te ekonomive private ne zonat rurale. Keshtu, dergesat jane nje nga strategjite kryesore te perballimit te jeteses, megjithese parate qe vijne nga emigracioni perdoren edhe per te filluar ndonje aktivitet ekonomik. Megjithë perfitimet ekonomike qe rrjedhin nga dergesat e

emigranteve, migrimi i brendshem dhe emigracioni shoqerohen me kosto te larta sociale. Megjithese levizjet me te medha ndodhin ne periudha me pak se gjashte muaj, shpesh mungon deshira per t'u kthyer ne zonat rurale, edhe nese mjedisiurban mund te mos ofroje permiresim te kushteve te jeteses se migrantit. Pozicioni gjeografik i fshatrave dhe qyteteve ne Shqiperi, shpesh percakton dhe drejtimin e emigrimit te nje individi. Rreth 400,000 shqiptare jane larguar nga vendi i tyre ne dekadën e fundit. Ky emigrim shpjegon dhe humbjen e pjeses me te madhe te forces aktive te punes, pasi pergjithesisht e largon prodhuesin kryesor nga ekonomia e tij private. Kjo prek me tej ato kategori qe jane me te pambrojturat si femijet, te moshuarit dhe grate, te cilat shpesh iu duhet qe te ristrukturojne sistemet e tyre mbeshtetese.

13. Megjithë keto impakte potenciale negative, nje strategji rurale per Shqiperine nuk duhet te synojne bllokimin e levizjes se migranteve nga zonat rurale. Vemendja duhet perqendruar ne permiresimin e sherbimeve rurale dhe mundesive per ata qe zgjedhin per te qendruar, e duke garantuar per ata qe largohen jane te arsimuar dhe shendet te mire, rruge te mira per te udhetuar; largim nga vendi me minimumin e veshtiresive dhe lehtesira ne dergimin e parave te kursyera. Kjo kerkon nje dialog politik me shtetet fqinje, i cili mund te lehtesohet nepermjet nje perfshirjeje me konkrete te Shqiperise ne marreveshjet rajonale si dhe ne KE.

### **Ku qendron Shqiperia sot?**

14. Shqiperia ka bere hapa te konsiderueshme pergjate dhjete viteve te kaluara per te lene pas trashegimine e regjimit te vjeter dhe per te hyre ne rrugen e zhvillimit ekonomik. Shqiperia e filloi tranzicionin drejt ekonomise se tregut ne 1991. Tranzicioni fillestar ishte jashtezakonisht kaotik dhe rezultoi ne nje permbyasje te menjehershme ekonomike me nje renie te prodhimit pothuajse sa gjysma e vitit 1989 dhe me nivele therese te inflacionit. Ne pergjigje te kesaj suate, Qeveria u fut ne procesin e nje stabilizimi te plote makro-ekonomik dhe programeve per ndryshime strukturore ne 1993, te cilat rezultuan ne nje rritje te dukshme dhe te gjithanshme ekonomike. Ne tre vitet ne vijim, ekonomia u rrit ne rreth 9 per qind ne vit dhe inflacioni ra ndjeshem. Kjo ishte kryesisht rrjedhoje e shperndarjes se gjere te kontrollit mbi cmimet dhe tregun, privatizimin dhe shperndarjen e tokes dhe privatizimin e ndermarrjeve te vogla dhe te mesme bujqesore. Kjo rimekembje u intensifikua nga dergesat e nje numri te madh shqiptarësh, te cilet ishin larguar nga vendi.

15. Shume kriza dhe trauma u shfaqen gjate dekadës se fundit. Renia e skemave piramidale ne 1997 coi ne renien e qeverise, duke sjelle turbullira civile dhe shmangie te menjehershme nga aktivitetet ekonomike dhe sociale. Konflikti ne Kosove, i shoqeruar nga nje dyndje massive e refugjateve ne 1999, krijoi nje krize te re e cila ne pikun e saj, rezultoi ne nje rritje te popullsisë ne masen prej 14 perqind. Si pasoje e zgjedhjes se nje qeverie te re ne 1997, u rivendos nje kuader i mire makro-ekonomik i cili eshte permiresuar dhe me tej. Qeveria u angazhua per te reduktuar deficitin buxhetor nepermjet rritjes se te ardhurave nga taksat dhe kufizimit te shpenzimeve. Përvec kesaj, nje politike monetare teper strikte ka ulur inflacionin dhe ka kontribuar ne qendrueshmerine e monedhes vendase. E gjithë kjo rezultoi ne pershpjetime dhe ritmeve te rritjes se GDP. Disa ndryshime te bera kohet e fundit nga Qeveria, mund te conin ne nje suate me te brishte politike.

16. Sektori bujqesor vazhdon te luaje nje rol te rendesishem ne ekonomi, duke siguruar 53 perqind ne GDP (apo me shume se nje e treta). Si fillim, sektori perjetoi ritme te shpejta rritjeje, te cilat aktualisht jane rreth nivelit 5 % ne vit. Rritja dhe rimekembja e shpejte ne fazen e hershme te tranzicionit u be e mundur si rezultat i aftesisë se fermereve per te pranuar ne menyre te menjehershme ndryshimet qe solli privatizimi, duke modifikuar strukturen e tyre te prodhimit. Megjithate prodhimi ka gjetur vend edhe ne shpenzimet e qendrueshme afatgjata. Prodhimi

vazhdon, por gjithsesi me nje perdorim te kufizuar te farerave me cilesi te permiresuar, pleherave dhe inputeve te tjera.

17. Pavaresisht nga reformat e lavderueshme qe jane kryer, nje numer jo i vogel problemesh kane mbetur pa u zgjidhur, pa u prekur nga reformat qe jane zbatuar deri me sot ose qe jane lene menjane nga zhvillimi ekonomik ne teresi i vendit. Disa prej tyre do te ishin mosrespektimi plote i ligjeve te aprovuara, shfaqja e korrupsionit, i cili minon reformat dhe mungesa e transparences, paaftesia e zonave rurale dhe te largeta per t'u pershtatur me nje mjedis ne ndryshim, duke shkaktuar nje rritje ne disnivelet e prosperitetit.

18. Dekada e fundit solli edhe disa impakte serioze ne gjendjen e mjedisit dhe burimeve natyrore. Problemet kryesore perfshijne: (a) shpyllezimi i pakontrolluar, (b) rritja e konsiderueshme e gjese se gjalle dhe per pasoje mbishfrytezimi i tokes per kullote, (c) erozioni dhe degradimi i tokes si pasoje prodhimit bujqesor ne toka marxhinale, vecanerisht ne toka kodrinore dhe malore; (d) humbja e siperfaqeve te tokes pjellore si pasoje e urbanizimit pa kriter, (e) shfrytezimi pa kriter i burimeve detare te peshkimit, dhe (f) ndotja e burimeve ujore dhe kurrizeve ujendares si dhe permytjet.

19. Shqiperia e zhvilloi tregtine me ritme te shpejta gjate periudhes se tranzicionit. Megjithate, ajo vazhdon te kete nje deficit te renduar tregtar, i cili eshte shmangur pjeserisht nga flukset e dergesave te emigracionit. Kategoria me e rendesishme e eksporteve jane produktet e nje pune intensive si tekstilet dhe kepucet, ne shumicen e rasteve duke nenkontraktuar per firmat e huaja. Prodhimet bujqesore perbejne vetem rreth 9 perqind te eksporteve totale. Investimet e huaja te drejtperdrejta ne Shqiperi deri tani kane qene te kufizuara. Mjedisi i pergjithshem i pasigurt, i shoqeruar me infrastrukture te dobet dhe procedura te gjata dhe te veshtira, pengon investimet e metejshme. Ka shume pak industri qe mund te ndikonte ne nje zhvillim me baze me te gjere, vecanerisht ne zonat rurale. Ndermarrjet rurale perfaqesohen nga ndertimet e dores se dyte, sherbimet e vogla dhe tregtia e vogel. Industria e ndertimit eshte nje nga sektoret qe po zgjerohet me shpejt, si rezultat i kerkesave ne rritje per ndermarrje te vogla dhe te mesme dhe nevojave per strehim. Zhvillimi i nje industrie agro-perpunuese konkurruese do te jete esenciale per zhvillimin rural. Pa kete industri, bujqesia do te kufizohet ne rradhe te pare ne drejtim te permbushjes se kerkeses se brendshme per prodhime te fresketa dhe avantazhet prodhuese per produkte me cilesi te larte dhe me pune intensive nuk do te viheshin ne shfrytezim. Krijimi i nje mjedisi qe nxit zhvillimin e kesaj industrie, por edhe te tjerave ne zonat rurale, duhet te arrihet ne vitet qe do te vijne.

20. Ne pergjithesi, megjithe arritjet impresionuese, ende mbeten shume probleme qe lidhen me prodhimin bujqesor dhe ekonomine rurale ne Shqiperi. Me nje GDP per fryme prej 1,130US\$, Shqiperia mbetet nje nga vendet me te varfera ne Europe. Sistemet prodhuese jane primitive, rendimentet te uleta, fermat shume te vogla dhe te copezuara per te qene te sukseshme, infrastruktura eshte e varfer dhe sektori privat ende nuk e ka mbushur vakumin e lene nga strukturat e vjetra shtetore te perpunimit dhe tregtimit. Shume pak perpjekje jane bere pertej sektorit bujqesor dhe orientimit drejt aktiviteteve me karakter jobujqesor ne zonat rurale, e per pasoje nje numer i konsiderueshem njerezish mbeten ne varferi ekstreme. Megjithe qe shume ndryshime te ndodhura deri me sot kane qene te dukshme, ato perfaqesojne vetem fillimin e nje procesi transformimi.

21. Shqiperia ka disa avantazhe per zhvillimin e bujqesise se saj. Disa prej tyre do te ishin (a) nje pozicion i favorshem gjeografik krahasuar me BE, vecanerisht me Italine dhe Greqine, (b) nivel krahasimisht te ulet te pagave, (c) popullsi rurale relativisht te arsimuar, pjesa dermuese e se ciles ka punuar ne vende te tjera europiane per periudha te caktuara kohore, (d) aftesia e

fermereve shqiptare per t'iu pershtatur rrethanave te ndryshuara, dhe (e) toke pjellore dhe klime e favorshme ne disa prej rajoneve. Bazuar ne keto avantazhe, mundesite me te medha per zhvillim ne sektorin bujqesor do te ekzistonin ne prodhimin e kulturave qe shiten me cmime me favorizuese, blegtorise, perpunimit dhe disa tregjeve bujqesore te favorshme.

22. Rendesia relative e blegtorise eshte rritur gradualisht, duke kontribuar me gjysmen e vleres totale te prodhimit bujqesor. Mbareshtimi i gjese se gjalle eshte i rendesishem per te gjithë vendin, por ai ka rendesi me te madhe vecanerisht per rajonet malore te jugut, megjithese rendimenti ne pergjithesi eshte i ulet. Aktualisht, me shume se 30 per qind e tokes perdoret per kullota dhe me shume se 60 per qind e popullsise merren me kullotjen dhe mbareshtimin e gjese se gjalle, kryesisht te deleve dhe dhive. Prodhimi blegtoral gjendet ne nivele te uleta dhe kjo i pershtetet struktures prodhuese te ekonomive te vogla private qe mbizoteron ne Shqiperi, ndersa sherben edhe si nje garanci e rendesishme sociale. Prodhimi eshte i destinuar kryesisht per konsum familjar, ndersa pjesa e tepert del ne tregun lokal ose cohet per perpunim. Gjeja e gjalle sherben edhe si nje mjet transporti dhe perdoret per perгатitjen e tokes.

### **Reformat institucionale po ndryshojne mjedisin e politikave dhe do te ndikojne ne sektorin rural**

23. Kater reforma institucionale baze jane aktualisht ne proces, te cilat do te ndikojne ne sektorin rural: Strategjia per Zhvillim Ekonomik dhe Social, Programi i Buxhetit Afat-mesem, Procesi i Decentralizimit dhe Reforma ne Administraten Publike. Reformat jane me objektiv te percaktuar qarte dhe nese implementohen sic duhet, do te sillnin nje ndikim teper pozitiv ne zhvillimin e zonave rurale. Ato e fuqizojne pushtetin vendor me te gjitha kompetencat per t'u perfshire ne menyre me te drejtperdrejte ne shperndarjen e buxheteve dhe vendimmarrjes, ato mbeshtesin reformat brenda Ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit dhe bejne qe ajo te funksionojë ne menyre me eficiente dhe me kapacitet me te larte, si dhe lejojne nje diskutim me pjesemarrje me te gjere mbi shperndarjen ne teresi te burimeve shteterore. E ndersa reformat kane filluar kudo, ato vijne e ngadalesohen ne fazen aktuale te implementimit, pasi shpesh iu mungojne plane veprimi te detajuara dhe tregues monitorimi. Nje pune voluminoze e pret Shqiperine per te vene ne zbatim keto reforma shume te admirueshme dhe do te duhet ende shume kohe deri sa perfitetim e tyre te ndihen nga popullsia rurale.

24. Procesi i Strategjise per Zhvillim Ekonomik dhe Social. Procesi filloi ne vitin 2000 si nje pjese e dialogut qeveritar me partneret e saj per zhvillim, kryesisht FMN dhe Banka Boterore. Parimet themelore te kesaj strategjie jane: (a) vemendje primare si ne drejtim te objektivave afat-gjata te zhvillimit ne Shqiperi ashtu dhe integrimin europian, (b) prioritizimi i veprimeve politike mbi bazen e nje analize te strategjise, (c) konsiderimi i strategjise si dinamike dhe evolutive ne pergjigje te rrethanave ne ndryshim; dhe (d) perpjekjet harmonike per te siguruar pronesi "shqiptare" mbi kete strategji. Ky parim i fundit u garantua nepermjet nje procesi te gjere konsultativ me shoqerine civile, pushtetin vendor, komunitetin e biznesit dhe partneret per zhvillim.

25. P.B.A. Nje proces i reformes buxhetore ka qene prezent ne Shqiperi ne dy vitet e fundit, duke bere adoptimin e kuadrit te shpenzimeve afat-mesme. Pritet qe P.B.A. te vazhdoje te permiresoje disiplinen fiskale dhe ndihmoje ne percaktimin e prioritarizimit te shpenzimeve publike. Qeveria aktualisht po ndermerr ciklin e dyte te planifikimit te shpenzimeve afat-mesme, i pari mbulonte periudhen 2001-2003. P.B.A perfshin nje rishikim te shpenzimeve te Ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit. Mbetet te shihet sesa efektive do te jene ndryshimet e parashikuara ne shperndarjen e buxhetit dhe nese cikli i planifikimit te shpenzimeve afat-mesme sherben si nje

instrument i pershtashem dhe i mjaftueshem per te garantuar fondet publike ne funksion te aktiviteteve qe synojne zhvillimin rural.

26. Decentralizimi. Ndersa nje strategji ambicioze decentralizimi po zbatohet qe nga viti 2000, sfida e qeverise do te jete sinkronizimi i strukturave institucionale me strukturat e reja lokale dhe percaktimi i qarte i kompetencave te pushtetit qendror dhe atij lokal. Strategjia e decentralizimit synon transferimin e nje numri te konsiderueshem pergjegjesish nga qeveria qendrore drejt pushtetit vendor, duke i dhene mundesine komunitetit per nje angazhim me te fuqishem ne akordimin dhe shfrytezimin e fondeve. E rendesishme eshte qe te forcohen kapacitetet ne nivelin lokal, garantohet aktivizim me energjik dhe identifikohen sherbimet per te cilat decentralizimi nuk do te ishte i pershtatshem.

27. Reforma ne administraten publike. Permiresimi i administrates publike do te jete nje fushe tjeter kyce e reformes me rekomandime per Ministrine e Bujqesise. Kalimi i punonjesve te kesaj ministrie ne nepunes civile do te jete i rendesishem per te siguruar me shume qendrueshmeri dhe siguri te stafit dhe per te terhequr staf te nje cilesie te larte. Pergjate dy viteve qe do te vijojne, do te rishikohen pergjegjesite dhe kompetencat perbrenda ministrise si dhe do te behet nje vleresim i kapaciteteve. Shpresohet qe sistemi te behet me eficient dhe me pak i influencuar politikisht. Ndersa pagat do te rriten ne procesin e reformes, ato mund te mos jene aq konkruese sa per te terhequr personel te kualifikuar ne sherbimin civil.

28. Nga ana tjeter, rruga drejt integritit European dhe Rajonal, do te ndikojte ne reformat ne fushen e politikave dhe ato institucionale. Pozicioni gjeografik i Shqiperise ka meritat e tij per integrimin e saj ne rrjetin e gjere te Europes Juglindore. Avantazhe dhe disavantazhe shoqerone kete integrim si dhe angazhimin e Paktin e Stabilitetit. Afrimi me BE ofron avantazhe ne drejtim te hapësirave tregtare, mundesive per punesim dhe investitoreve potenciale. Afersia me Italine dhe Greqine dhe portet si ai i Duresit, sigurojne rruge tregtie, prej te cilave mund te perfitoje i gjithe Ballkani. Pakti i Stabilitetit per Europen Jug-lindore ofron mundesi per Shqiperine qe te hyje ne marreveshje rajonale tregtare dhe te perfitoje mbeshetje shtese. Megjithate, do te ishte shume e domosdoshme qe Shqiperia te ndertoje nje program per kerkesat e saj ndaj Paktit te Stabilitetit, ne menyre qe investimet te drejtohen aty ku ato nevojiten me shume. Disavantazhet e ketij afrimi, reflektohen ne numrin e produkteve qe importohen ne Shqiperi nga tregu i BE, te cilat nxjerrin jashte loje produktet lokale si dhe ne paaftesine e prodhimit vendas per te konkuruar me keto importe. Nje peraftrim i shpejte me standartet e BE, mbart rrezikun qe financimi te orientohet drejt arritjes se standarteve te cilesise se larte, te cilat as nuk mund te jene nje prioritet per Shqiperine ne keto momente, dhe per me te teper nuk ekzistojne as kapacitetet per t'i arritur keto standarte, dhe per pasoje ekziston edhe rreziku potencial per te nxitur korrupsionin. Ekziston nje boshllek i madh ndermjet mjeteve ekzistuese te prodhimit dhe standarteve te cilesise te drejtuara nga BE, i cili nevojitet te mbushet perpara investimit ne ndermarrje perpunuese qe permbushin standartet e BE. Diskutimet e metejshme per asocim, mbartin riskun qe nevojat me themelore si infrastruktura rurale, te cilat konsiderohen si prioritete ne kete strategji, te neglizhohen.

## **Cfare duhet bere qe te nxitet zhvillimi rural?**

### **I. Reforma ne sektorin e politikave**

29. **Kuadri makro-ekonomik.** Masat per stabilizimin e kuadrit makro-ekonomik kane gene kyce ne procesin e rimekembjes ne Shqiperi, por gjithsesi nje fokus i vazhdueshem ne drejtim te ruajtjes se ketij stabiliteti, do te ishte i nevojshem, ne menyre qe te sigurohet rritje dhe zhvillim ne vazhdimesi ne sektorin rural. Treguesit e inflacionit jane planifikuar te mbahen ne kuoten 2- 4

per qind, nepermjet kontrollit ofertes se parase nga Banka e Shqiperise, administrimit te kursit te kembimit dhe kontrollit te deficitit buxhetor, si dhe nepermjet shfrytezimit me efektiv te instrumentave te tregut per te implementuar politiken monetare. Administrimi fiskal duhet perqendruar ne reduktimin e deficitit buxhetor duke: (a) rritur te ardhurat nepermjet nje administrimit fiskal te; permiresuar dhe zgjerimit te bazes se taksimit; (b) permiresuar kontrollin mbi shpenzimet dhe (c) permiresuar planifikimin dhe parashikimin buxhetor. Permiresimet ne ekonomine e jashtme do te fokusohen ne nje reduktim gradual te deficitit aktual, ndersa ruhen rezerva monetare ne nje sasi te barabarte me ate te vleres se kater muajve import. Masat per nxitjen e eksportit dhe zevendesimin e importit, duhen sinkronizuar me perpjekjet ne vazhdimesi per finalizimin si te marreveshjeve tregtare dypaleshe ashtu dhe atyre shumepaleshe.

30. Qeveria duhet te vazhdoje implementimin e masave kyce ne kuader te reformave qe kane filluar ne vitet e fundit. Keto masa perfshijne: (a) perfundimin e privatizimit dhe ristrukturimit te ndermarrjeve, (b) privatizimin e bankave, (c) permiresimin e kuadrit rregullator per sektorin financiar, (d) permiresimin e qeverisjes dhe transparences, dhe (e) forcimin e sistemit ligjor dhe juridik. Vazhdimi i nje programi reformash ambicioze do te jete kyc per permiresimin ne teresi te klimes se zhvillimit, rritjes dhe investimeve, vecanerisht per investimet e huaja. Shqiperia duhet te krijojte mundesi per punesim duke shmangur pengesat per aktivitetin privat te vogel. Reformat institucionale duhet te luajne nje rol dominues per kapercimin si te kapaciteteve te dobeta institucionale dhe mungesen e ndjenjes se pergjegjesise dhe transparences ne administraten publike.

## **II. Politikat rurale dhe Agjencite rurale – Ngritja e kapaciteteve**

31. Sot roli primar i Ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit eshte te vendose dhe rregulloje nje kuader politikash dhe ligjesh qe mundeson bujqesine te operoje ne menyre eficente dhe te suksesshme ne Shqiperi si dhe te siguroje ofrimin e sherbimeve per fermeret e vegjel te sapo krijuar. Qe prej reformave, Ministria ka siguruar nje numer sherbimesh mbeshtetese si ato te ekstensionit, kerkimit shkencor, blegtorise dhe kontrollit te semundjeve te kafsheve dhe mbrojtjes se bimeve. Keto reforma rezultuan ne nje numer te madh stafi te disponueshem ne nivel rrethi. Megjithate, stafi qe punon per keto sherbime eshte i vogel ne numer dhe nje pjese te tij i mungon kualifikimi i nevojshem, e per pasoje cilesia le per te deshruar. Sherbimet duhet te perkufizohen ne me shume burime dhe te sigurohet me teper trajnim. Kerkesat per sherbimin publik kane ndryshuar, ndersa stafi shpesh mbetet po ai, i bllokuar diku midis strukturave te vjetra dhe atyre te reja me pergjegjesi ende te pacaktuara qarte. Do te ishte jashtezakonisht e rendesishme terheqja e fuqise punetore te kualifikuar drejt sherbimeve qeveritare si dhe percaktimi i fushave te pergjegjesise sipas kerkesave ne ndryshim te nje sektori rural privat ne funksionim. Reformat dhe strategjite e permendura me lart jane nje fillim i mire per kete zhvillim; e megjithate eshte e nevojshme qe te behen perpjekje te metejshme per ta bere Ministrine me te orientuar drejt klienteve. Pa dyshim, nje hap i pare i rendesishem do te ishte kalimi drejt nje sherbimi civil qe i ben postet e tij te punes me terheqese dhe te sigurta. Keto kohet e fundit, Ministria ka krijuar nje departament te ri per zhvillimin rural, i cili do te fuqizoje rolin e Ministrise ne programin e pergjithshem te zhvillimit rural.

32. Eshte thelbesore qe te rishikohen pergjegjesite e Ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit dhe te Ministrise se Pushtetit Vendor, ne vecanti ato qe lidhen me procesin e decentralizimit. Decentralizimi ne zonat rurale ndikon ne bujqesi, burimet natyrore, aktivitetet jobujqesore si dhe infrastrukture. Deri tani, rolet e niveleve te ndryshme qeveritare nuk jane te pacaktuara qarte, vecanerisht ato qe lidhen me menaxhimin e fondeve dhe pergjegjesite per shpenzimin e tyre. Nje numer pergjegjesish duhet te mbeten ne nivelin qendror, si politikeberja, legjislacioni, marreveshjet tregtare, akordimet e buxheteve, mbledhja e te dhenave, sherbimet veterinare



publike dhe kontrolli mbi standartet e cilesise. Edhe nivelet bashkiake dhe lokale duhet te kene role dhe pergjegjesi te percaktuara qarte. Sfidat konsistojne ne bashkerendimin e struktures se Ministrive me ate te pushtetit vendor si dhe te behet nje ndarje racionale e pergjegjesive ndermjet pushtetit qendror dhe atij lokal.

33. Te shumta do te jene tiparet me rendesi themelore per nje proces decentralizimi te suksesshem. Se pari, kompetencat dhe detyrat e reja te pushtetit vendor duhet te lidhen me autoritetin vendim-marres si dhe me pergjegjesine. Ndersa ligji e parashikon kete rol te dyfishte, eshte e nevojshme qe kjo te pasqyrohet ne akte nenligjore, duke e angazhuar pushtetin vendor ne hartimin e tyre. Se dyti, pushteti qendror dhe vendor duhet te bashkepunojne ngushtesisht ne fusha ku ka pergjegjesi te perbashketa, sic mund te ishte rasti per furnizimin me uje te pijshem apo kanalet ujtes. Gjithashtu, eshte e rendesishme qe financimi t'i pershtatet detyrave qe duhet te permbushen nga struktura te ndryshme qeveritare. Kalimi nga burimet qendrore te te ardhurave ne ato lokale, do te kerkoje kohe dhe nevoja per financime, te cilat duhet te sigurohen gjate periudhes se tranzicionit. Jane identifikuar tre funksione te buxhetit: (a) nje funksion ekskluziv, plotesisht i mbuluar me taksat dhe detyrimet lokale; (b) funksione te perbashketa te financuara si grante te kushtezuara nga qeveria qendrore; dhe (c) funksione te deleguara, te financuara plotesisht nga transferimet e fondeve nga qeveria qendrore. Percaktimi i nje afati kohor per procesin e transferimit te pergjegjesive do te jete kyc per suksesin te decentralizimit. Kapacitetet mbeten te dobeta si ne nivelet lokale ashtu dhe ne ato qendrore. Per kete arsye, eshte e rendesishme qe te rriten kapacitetet ne te gjitha nivelet, vecanerisht ne nivelin lokal, dhe te behet nje shperndarje racionale e pergjegjesive.

34. Prioritetet kryesore te ndertimit te kapaciteteve dhe decentralizimit jane:

- Modernizimi i sherbimeve mbeshtetese dhe trainimi per stafin e nivelit lokal dhe sherbime me te orientuara nga klienti, nepermjet ristrukturimit te bazes nxitese (me baze komuniteti);
- Thithja e stafit te kualifikuar brenda sherbimit civil, duke rritur sigurine e vendit te punes dhe duke aplikuar paketa terheqese pagash;
- Percaktimi i pergjegjesive te pushtetit lokal ne procesin e decentralizimit;
- Perfundimi i pergatitjes se akteve nenligjore, te cilat percaktojne qarte pergjegjesite e niveleve te ndryshme te qeverisjes, kompetencat e tyre vendim-marrese dhe transferimin e fondeve; dhe
- Perpunimi i profileve per punesim dhe nevojat per trainim te bazuar ne kete identifikim.

### III. Reforma e Tokes

35. Shqiperia ndoshta ka shkuar me tej se cdo vend tjetër ne rajon per te zbatuar nje reforme sa me te plote te tokes, si nje parakusht per zhvillimin e tregjeve te tokes. Si rezultat i kesaj reforme, peisazhi rural eshte transformuar ne menyre drastike qe prej vitit 1990, me te gjitha fermat kolektive te shperbera dhe afersisht 98 perqind te tokes bujqesore (546,000 ha) te shperndare per ekonomite e vogla private. Kjo reforme ka transformuar fermen nga nje strukture te kolektivizuar dhe te komanduar, ne nje sektor plotesisht privat me ekonomi te vogla private dhe parcela te vogla dhe te fragmentuara qe prodhojne si per konsum familjar ashtu edhe per treg. Toka per kullota dhe pyjet nuk kane qene ne pjesen me te madhe pjese a procesit te privatizimit. Vetem se fundmi, pronesia shteterore eshte transferuar ne komunitete dhe persona private.

36. Elementet kyce te reformes se tokes perfshijne (a) zhvillimin e nje kuadri te plote ligjor dhe rregullator per administrimin e tokes dhe zhvillimin e tregut te saj; (b) vendosjen e sistemit te

regjistrimit te pasurive te paluajtshme ne funksion te percaktimit real te titujve te pronese dhe regjistrimit te saj; dhe (c) nje program i plote i mbeshetur nga donatoret per te siguruar regjistrimin e pare te pronareve te rinj te tokes. Pothuajse 29 ligje dhe rregullore ne lidhje me administrimin e pronese te paluajtshme jane aprovuar ne Shqiperi. Legjislacioni aktualisht ne fuqi ofron nje kuader te pershtatshem ligjor dhe rregullator mbeshtetes per funksionimin e tregut te tokes. Nuk ekzistojne barrierat themelore ligjore qe te pengojne transaksionet e tokes si psh. blerja, shitja, qiradhenia, dhurimi apo trashegimia. Sistemi i regjistrimit te pasurive te paluajtshme operon me 36 zyra neper te gjithe vendin. Nje proces sistematik i regjistrimit per here te pare eshte ne vazhdim. Rreth 55 perqind e tokes rurale te shperndare ose rreth 1.6 milion copeza te tokes rurale jane studiuar, vendosur ne harte, titulluar dhe regjistruar.

37. Pavaresisht progresit pozitiv te bere nga qeveria ne drejtim te intesifikimit te nje reforme efektive dhe largpamese, ekzistojne nje numer ceshtjesh qe kercenojne me ngadalesimin e zhvillimit te tregut te tokes. Per pjesen me te madhe te pronareve te rinj te tokes, eshte hera e pare qe ata zoterojne toke ose ndonje prone tjeter te paluajtshme, dhe per rrjedhoje ata nuk jane aq te zellshem per ta shitur ate. Per me teper, ata e kane perfituar token gratis, dhe duke qene qe nuk zbatohet nje sistem taksimi per token, presioni per ta shfrytezuar, shitur apo dhene me qira token eshte i vogel. Ceshtje te tjera qe mund te pengojne zhvillimin e tregjeve perfshijne : (a) procesi i paperfunduar i regjistrimit; (b) proceset e biznesit ne zyrat e regjistrimit; (c) struktura e tarifave perfshire ato te noterimit dhe regjistrimit; (d) kerkesat per venien ne dijeni te familjeve; (e) mungesa e njohurive dhe e kuptimit te konceptit te drejtave dhe pergjegjesive mbi pronen private; dhe (f) pretendimet e hershme per pronesi.

38. Regjistrimi. Pavaresisht se eshte bere nje progres i kenaqshem ne regjistrimin rishtazi, nje numer i konsiderueshem parcelash mbeten ende te paregjistruara dhe nese i referohemi kalendarit aktual, do te duhen me shume se dy vjet qe procesi i regjistrimit te perfundoje. Mundesia e respektimit te ketij kalendari eshte ne pikepyetje, pasi potencialisht mbeten 25 perqind me shume parcela qe duhet te regjistrohen, referuar parashikimit fillestar. Per me teper, pronat ne perdorim, te cilat duhet te regjistrohen jane kryesisht gjysme-urbane dhe urbane, zona ne te cilat paqartesia ne lidhje me kthimin e tokes dhe politikat kompensuese po shkaktojne vonesa ne vendosjen e titujve te qarte mbi token dhe sipërfaqet qe perbejne interes per turizmin, ku pronesia mbi token eshte ende e pazgjidhur.

39. Aktualisht, nuk ekziston nje takse pronese rurale ne Shqiperi. Taksat e pronese do te siguronin nje burim te ardhurash per te mbeshetur administrimin e sistemit te menaxhimit te pronese dhe do te sherbenin si nje shtyese per ta lene token te papunuar. Implementimi i nje takse modeste mbi pronen per te gjitha llojet e pronave, mund te lejonte qeverine qe te ulte ne menyre te ndjeshme taksen per transferimin e pronese dhe per ta bere ate me te arsyeshme per te kryer transaksione.

40. Kompensimi. Prosesi i privatizimit te tokes bujqesore i filluar ne 1991, nuk lejon kthimin e tokes atyre qe e kishin ne pronesi perpara shtetezimit te saj ne 1945. Por ligji lejon kompensimin e njerezve, te cilet mund te ngrene pretendime legjitime mbi token qe nga epoka para-komuniste. Kjo skeme eshte pare si nje nga rruget me pragmatiste per te trajtuar pretendimet e hershme. Qeveria ende nuk ka zbatuar procedurat per kompesimin me para te njerezve me pretendime te hershme per token bujqesore, si dhe nje numer i konsiderueshem kerkesash gjenden te bllokuara ne sistemin gjyqesor. Perfshirja e gjykatave ne kete proces e ka komplikuar edhe me tej ate, pasi gjykatat kane permbysur apo modifikuar vendimet qe lidhen me privatizimin, duke shkaktuar keshtu me shume konflikte ndermjet njerezve ne fshatrat ku ka mosmarreshje te pazgjidhura.

41. Gjithashtu, ne disa zona te Shqiperise, iniciativat lokale per privatizim paraprine procesin zyrtar te privatizimit te tokes. Vendimi per te mos lejuar kthimin e tokes rurale nuk eshte i zbatueshem per token urbane. Mijera kerkesa rivalizuese ne zonat urbane vazhdojne te mbeten te bllokuara ne gjykata si dhe te ngadalesojne regjistrimin dhe njohjen e titujve urbane. Keto praktika diferencuese per token rurale dhe urbane perbejne nje problem per sigurine e titujve ne zonat rurale, te cilat rrethojne qendrat kryesore urbane ku toka eshte duke u riklasifikuar shume shpejt si urbane. Keto probleme po cojne ne nje pasiguri te madhe per pronesine mbi token si dhe po shtojne rreziqet e investimit me token dhe/ose perdorimit te tokes per te siguruar transakcionet financiare.

42. Tregjet e tokes. Madhesia mesatare e vogel e fermes dhe shkalla e larte e copezimit te saj. Ekzistojne shembuj te shumte ku fermeret kerkojne te konsolidojne dhe zmadhojne feramat e tyre nepermjet mekanizmeve te ndryshem, shpesh nepermjet kembimeve informale apo qiradhenies se tokes. Nje rritje e numrit te transakcioneve, kryesisht atyre formale, aktualisht po kufizohet nga problemet qe rrjedhin prej sistemit ekzistues te regjistrimit. Aktivitetet per konsolidimin e tokes duhet te jene transakcione te bazuara ne treg. Nuk rekomandohet asnje metode e drejtperdrejte nxitese apo frenuese. Eshte shume e rendesishme te lehtesohet funksionimi i tregut te tokes nepermjet procedurave me te thjeshta ne bashkimin e tokes, te cilat jane me pak te kushtueshme dhe kerkojne me pak kohe.

43. Zhvillimi i metejshem i politikave te tokes dhe institucioneve qe lidhen me ceshtjen e tokes, duhet te fokusohet ne aktivitetet e meposhtme:

- Perfundimi i procesit te regjistrimit sa me shpejt qe te jete e mundur dhe sigurimi i financimeve shtese te sigurta nga donatoret, nese boshlleku financiar vazhdon te ekzistoj;
- Rishikimi i legjislacionit, rregulloreve dhe procedurave ekzistuese te regjistrimit te pasurive te paluajtshme, me synim reduktimin e kohes dhe kostove te kryerjes se transakcioneve;
- Rishikimi dhe amendimi i legjislacionit dhe procedurave qe kane te bejne me njoftimin e familjes ne funksion te thjeshtimit te procesit dhe kufizimit te llojeve te transakcioneve qe kerkojne njoftimin e familjareve;
- Ndertimi dhe venia ne zbatim e nje mekanizmi per kompensimin e qytetareve me pretendime legjitime te hershme dhe eliminimi i pasigurise se titujve si rezultat i konflikteve te pazgjidhura ;
- Zhvillimi i nje fushate publike sensibilizuese per qytetaret ne lidhje me te drejtat dhe pergjegjesite qe shoqerojne pronesine mbi pronen ; dhe
- Pergatitja per zbatimin e nje sistemi te taksimit per pronen me tarifa modeste, te cilat te behen efektive sapo qe te perfundoje regjistrimi i pare. Pergatitjet duhet te perfshijne zhvillimin e kapaciteteve per te bere vleresimin e prones.

#### **IV. Infrastruktura Rurale**

44. Infrastruktura mund te konsiderohet si nje nga faktoret me te rendesishem per zhvillimin rural. Ajo i sherben shume qellimeve, si permiresimit te kushteve te jeteses, krijimit te aksesit ne treg, permiresimit te prodhimit bujqesor, terheqjes se investimeve. Prania e rrugeve, ujit, energjise elektrike dhe ne disa zona, e sistemit te ujitjes do te perbeje bazen. Mungesa e kesaj baze per infrastrukturen shpesh permendet nga banoret e zonave te thella si prej faktoreve me te pafavorshem. Por, ekzistojne shume nevoja te tjera qe lidhen me infrastrukturen, si sherbimi shendetesor dhe arsimor, te cilet jane te nje rendesie te jashtezakonshme, por qe nuk trajtohen ne kete dokument.

45. Ne planin e pergjithshem, mungesat ne infrastrukture jane shume te medha ne zonat rurale. Nga ana tjeter, ekzistojne pabarazi persa i takon aksesit per sherbime midis zonave malore, kodrinore dhe atyre te uleta. Infrastruktura rurale eshte me e zhvilluar ne zonat fushore, me pak e zhvilluar ne zonat kodrinore dhe shume pak e zhvilluar ne zonat malore. Kushtet shume te varfere te jeteses dhe te sherbimeve ne infrastrukture ne zonat malore kane imponuar levizjet masive drejt ultesirave bregdetare dhe qendrave te medha urbane. Kjo levizje ka rritur presionin per sherbime infrastrukturore ne zonen e ulet bregdetare dhe qendrat urbane si dhe e ka ulur me ritme te shpejta ate ne fshatrat me popullsi te vogel. Ky rreth vicioz e ben te veshtire vendosjen e nje ekuilibri ndermjet kerkeses se larte dhe nevojës per sherbime ne infrastrukture per pjesen me te populluar te zones se ulet dhe nevojave njelloj te rendesishme ne infrastrukture qe kane zonat me te thella apo rajonet me dendesi me te vogel popullimi. Arritja e nje ekuilibri te tille do jete shume domethenese per zhvillimin e Shqipërisë ne vitet qe do te vijne. Perfshirja dhe pjesemarrja ne rritje e komunitetit ne ndertimin dhe rehabilitimin e infrastruktures ne nivelin lokal, do te jete shume e rendesishme ne kete proces.

46. Uji dhe Higjiena. Pervec sa me lart, zonat rurale perballen me probleme serioze te furnizimit me uje dhe higjienes. Permiresimi i sistemit te furnizimit me uje dhe higjienes perben nje nga faktoret kyç per permiresimin e kushteve shendetesore ne zonat rurale. Problemet me kryesore jane: (a) degradimi i rrjetit fizik, (b) mbikonsumimi si rezultat i perdorimit te ujit te pijshem per bujqesine, (c) mungesa e kontrollit mbi konsumin faktik perfshire cmimin e ulet te ujit dhe nivelin e ulet te faturimit, (d) institucione jo te konsoliduara qe merren me furnizimin me uje, dhe (e) mungesa e nje strategjie per te permiresuar sherbimet. Permiresimet ne zonat rurale lidhen ngushtesisht me procesin e decentralizimit, i cili e kalon pergjegjesine e furnizimit me uje tek pushteti vendor. Eshte pergatitur nje strategji per furnizimin me uje dhe higjienen ne zonat rurale, e cila synon te ndryshoje menyren sesi furnizimi me uje realizohet nga Qeveria. Roli i qeverise duhet te jete te mbeshtete kuadrin e ri institucional dhe te siguroje kuadrin rregullator te nevojshem qe garanton pjesemarrjen e organizatave komunitare ne menaxhimin dhe vendim-marrjen ne lidhje me furnizimin me uje te pijshem.

47. Ujitja dhe Kullimi. Rehabilitimi i sistemeve te ujitjes dhe kullimit duhet te vazhdoje edhe ne vitet ne vazhdim. Shoqatat e perdoruesve te ujit (SH.P.U.) provuan te ishin mekanizma te pershtashem per te menaxhuar infrastrukturen ujtese dhe shperndarjen e ujit ne nivelin lokal dhe permiresuan ne menyre te konsiderueshme aksesin ne dhe menaxhimin e burimeve ujore ne nivelet lokale. Bazuar ne keto suksese, duhet qe t'i kushtohet me shume vemendje ndertimit te kapaciteteve te strukturave qe koordinojne dhe lehtesojne funksionimin e kanaleve te medha, ndersa ruhet koncepti i menaxhimit te sistemit nga perdoruesit. Pervec kesaj, fermeret duhet te perfitojne me shume keshillim ne lidhje me perdorimin eficient te ujit per ujitje dhe menaxhimin e permiresuar te burimeve si dhe administrimin e qendrueshem.

48. Rruget rurale. Rrjeti i rrugeve rurale eshte jashtezakonisht i varfer dhe ne kushte shume te keqija. Rreth 50 perqind e rrugeve rurale mund te konsiderohen pothuajse si te pakalueshme. Pjesa me e madhe e rrugeve jane neglizhuar dhe nuk jane mirembajtur gjate kesaj dekade. Ndersa nje numer rruges jane permiresuar me asistencen e donatoreve gjate viteve te fundit, dhe pjesa me e madhe e punes per ndertimin dhe rehabilitimin e rrugeve rurale eshte decentralizuar ne nivel komuniteti, kushtet nuk duket te jene te permiresuara ne menyre te ndjeshme ne shume nga zonat e largeta. Edhe per rruget e reja, shume pak eshte investuar per mirembajtje, si rezultat i mungesave ne fonde dhe mungeses se kapaciteteve dhe organizimit. Permiresimi i rrjetit te rrugeve rurale eshte teper esencial per zhvillimin ekonomik te zonave rurale. Rrjeti i rrugeve i lejon njerezve per te patur akses per informacion dhe tregje, si dhe ne sherbimin arsimor dhe shendetesor, por gjithashtu ben te mundur edhe levizjen e lire te njerezve aty ku ka me shume

shanse per te siguruar te ardhura jetese. Rruget e kalueshme lehtesojne kryerjen e sherbimeve sociale dhe eshte nje parakusht qe investoret te investojne ne zonat rurale.

49. Faktoret kryesore te lidhur me permiresimin e rrugeve rurale do te ishin (a) nje strukture organizative me efektive, e cila te pergjigjej per sistemin e rrugeve, (b) sigurimi i kuotave te mjaftueshme te financimit kryesisht per mirembajtje, dhe (c) procedura te qarta dhe transparente funksionimi dhe rekrutimi te stafit. Pjesemarrja e komunitetit ne ndertimin dhe mirembajtjen e rrugeve rurale duhet te rritet edhe me shume. Ajo ka provuar te jete kyce per nje sistem te qendrueshem rruges ne zonat rurale. Eshte e rendesishme qe gjate procesit te decentralizimit, financimet te konvergjojne me pergjegjesite per ndertim dhe mirembajtje rruges.

50. Elektriciteti. Aksesi per furnizim me energji eshte nje faktor tjetër i rendesishem. Problemet ne vijimesi qe lidhen me furnizimin dhe shperndarjen e energjise vazhdojne te pengojne zhvillimin, vecanerisht zhvillimin e bizneseve dhe industrive rurale. Rrjeti i furnizimit me energji ka nje shtrirje te gjere, por gjithsesi pjesa me e madhe e zonave rurale marrin energji vetem per disa ore ne dite si pasoje e nderprerjeve te energjise apo problemeve ne furnizim. Me shume se 90 perqind e energjise ne Shqiperi sigurohet nga hidrocentralet. Megjithate, thatesirat e ketyre tre viteve te fundit e kane ulur ndjeshem nivelin e ujerave, duke arritur kuoten me te ulet te 30 viteve te fundit. Nuk ka as mirembajtje, as shtrirje apo permiresim te rrjetit energjetik. Koorporata Energjetike Shqiptare (KESH) nuk eshte ne gjendje te perballoje importimin e gjithë sasise se energjise qe nevojitet per te kompensuar burimet e brendshme, si rezultat i veshtiresive financiare te shkaktuara nga shfrytezimi jo i ligjshem i energjise, arketimet e dobeta te faturave dhe cmimet e aplikuara nen koston e energjise se importuar. Asistenca per KESH ne aspektin e menaxhimit dhe dhenia e fondeve shtese nga qeveria per te importuar energji, e kane permiresuar disi situaten. Megjithate, nderprerjet mbeten ende te shpeshta dhe zonat rurale furnizohen me me pak energji sesa ato urbane.

51. Permiresimi i furnizimit me energji ne zonat rurale eshte domosdoshmeri. Mungesa e energjise shpesh permendet si nje nga faktoret kryesore qe pengon zhvillimin e biznesit. Ajo veshtireson gjithashtu edhe funksionimin dhe zgjerimin e sherbimeve sociale. Per ta permiresuar situaten eshte e nevojshme qe prioritetet te perfshijne (a) permiresimin e furnizimit me energji nepermjet investimeve te metejshme ne centralet e prodhimit te energjise ose rritjes se sasise se importit, (b) nje funksionim me eficient dhe me pak i kushtueshem i KESH, (c) nivele me te mira te arketimit te faturave te energjise dhe inspektim mbi rastet e shfrytezimit te paligjshem te energjise, dhe (d) venia ne shfrytezim e burimeve alternative te energjise dhe plane te vecanta veprimi per zonat rurale. Eshte e nevojshme qe te merren ne konsiderate rruge te reja te sigurimit te energjise, meqenese duhet shume kohe per ta prodhuar ate. Per kete qellim, duhet te studiohen me tej burimet alternative te energjise se pershtatshme per zonat rurale.

## V. Sherbimet mbeshtetese rurale

52. Kerkimi shkencor bujqesor. Ekziston nje hapësire e konsiderueshme per nje eficience me te larte te operacioneve kerkimore-shkencore, permes nje programi me te pershtatshem kerkimi, permiresim te bashkepunimit ndermjet institucioneve te mbetura dhe nje percaktim te qarte te prioriteteve qe lidhen me kerkimin shkencor, te cilat pasqyrojne nevojat per zhvillim te Shqiperise. Qeveria duhet te mendoje per sistemet e financimit te kerkimit shkencor me orientim nga nevojat, duke perfshire edhe sistemet konkurruese. Eshte me se e nevojshme qe te reduktohet numri i institucioneve kerkimore dhe te konsolidohen ato qe mbeten ne nje qender kombetare me nje numer te kufizuar degesh. Disa prej atyre qe duhet te mbeten do te ishin instituti i misrit, foragjereve, grurit, frutikultures dhe blegtorise. Financimi duhet te behet bazuar ne mbulimin e kostove per zhvillimin e farerave mbareshtuese ndersa kerkimi shkencor specifik ne linje me

prioritetet qeveritare, duhet te financohet nga publiku. Prodhimi i embrioneve, farerave dhe vaksinave duhet te transferohet ne sektorin privat. Vemendja kryesore e punes kerkimore duhet te perqendrohet ne pershtatjen dhe futjen e teknologjive qe mund te sigurojne kosto te ulet, zgjidhje efektive te problemeve te fermerëve.

53. Sherbimi i ekstensionit ne bujqesi. Sherbimi aktual i ekstensionit ne Shqiperi eshte nen varesine e Ministrise se Bujqesise. Programe te ndryshme kane mbeshtetur kete sherbim gjate dekadese se fundit, te fokusuara ne trainim, asistence teknike, rregullime ne transport dhe aktivite demonstruese. Sherbimet e ekstensionit jane te pranishme ne te gjitha rrethet. Nje dokument politik qe synon ristrukturimin e sherbimit te ekstensionit eshte aprovuar se fundmi nga qeveria. Ai synon rritjen e lidhjeve te sherbimit me sektorin privat dhe krijimin e qendrave keshillimore private me synimin per te arritur vete-qendrueshmerine. Roli kryesor i Ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit ne kete aspekt, duhet te jete mbeshtetje ne vazhdimesi per zhvillimin e nje sistemi informacioni te larmishem. Sherbimet keshillimore per fermeret e medhenj me orientim tregun, duhet t'i lihen sektorit privat, perfshire shoqatat e fermerëve, prodhuesve, tregtaret, furnizuesit e inpueteve dhe burime te tjera informacioni. MBU duhet te mbeshtese plotesisht keto zhvillime nepermjet trainimeve te perbashketa dhe shperndarjen e materialeve qe permbajne informacion te perftuar nga kerkimi ne ferme dhe demonstrimet praktike. Performanca e Qendrave Rajonale te Keshillimit Bujqesor, te cilat kane lindur si struktura te sektorit publik, te planifikuara per t'u privatizuar plotesisht per nje periudhe pesevjecare, duhet te monitorohet dhe vleresohet me kujdes, me synimin e shtrirjes se tyre ne te ardhmen ne zona te tjera ne varesi te performances dhe efektivitetit.

54. Sherbimi publik i ekstensionit ne MBU duhet te perqendrohet ne nje mase te madhe tek fermeret e vegjel dhe te mesem, vecanerisht atyre me orientim nga tregu. Ky lloj kendveshtrimi kerkon (a) nje vemendje ne rritje per zhvillimin e materialeve cilesore ne kuader te sherbimeve te ekstensionit, perfshire masmedian dhe produksionet me video; (b) permiresimin e kapaciteteve per sherbim keshillimor lokal; (c) nje fokus ne vazhdimesi ne grupet e interesuara te fermerëve, perfshire grupet ekzistuese dhe shoqatat private te fermerëve; (d) permiresimin e lidhjeve ndermjet zyrave te sherbimit te ekstensionit dhe institucioneve te kerkimit shkencor nepermjet programeve kerkimore ne ferme dhe pjesemarrjes ne programe te komunitetit; (e) vazhdimi i programeve te trainimit mbi teknologjine e dobishme per fermeret e vegjel perfshire edhe menaxhimin financiar te fermes; dhe (f) sigurimi i informacionit mbi tregun. Nje instrument tjetër ne ndihme te ekstensionit dhe punes kerkimore, skemat konkurruese te grantit, te cilat jane provuar si te suksesshme ne shume vende, po eksperimentohen aktualisht edhe ne Shqiperi. Te ndertuara mbi bazen e kerkeses, keto skema po sigurojne nje sherbim ekstensionit, i cili paguhet nga klienti dhe garanton zgjidhje lokale.

55. Sherbimi veterinar. Sherbimi veterinar eshte i ndare ne dy seksione. i pari qe merret me kontrollin dhe zhdukjen e semundjeve me rrezik per shendetin publik. Keto sherbime kryhen nen programin e MBU megjithese mund te kontraktohet edhe me veterinere private per kryerjen e tyre. Seksioni i dyte trajton semundjet e tjera qe nuk perbejne rrezik per shendetin publik, dhe ku trajtimi i te cilave behet me pelqimin e poseduesit te gjese se gjalle. Keto sherbime kryhen edhe nga veterinere private. Per te nxitur zhvillimin e metejshe me sistemit privat veterinar, eshte e nevojshme dhe e justifikueshme qe te shtrihet me tej skema e perdorur nga Fondacioni per Blegtorine, i cili ne fillim ka qene pjese e Fondit Shqiptar te Zhvillimit, mbeshtetur nga Banka Boterore. Te gjitha kafshet e nje fshati trajtohen per nje numer semundjesh ne nje periudhe dyvjecare, ku fermeret paguajne 50 perqind te shpenzimeve vitin e pare dhe 70 perqind ne vitin e dyte. Ne vitet ne vijim, fermeret do te paguajne koston totale te trajtimeve te ndryshme. Kjo skeme ka rezultuar ne nje prodhimtari te larte te kafsheve, si rezultat i rritjes se numrit te fermerëve qe e trajtojne bagetene e tyre kunder semundjeve si dhe i ngritjes se klinikave private

veterinare te suksesshme ne nivel fshati. Sherbimet e mbareshtimit kryhen se pari nga sektori privat, me fare te siguruar nga institutet e kerkimit-shkencor dhe nga kafshe te futura per here te pare ne kuader te projekteve te ndryshme. Ne perspektiven afat-gjate, detyrat kryesore te qeverise duhet te jene menaxhimi dhe monitorimi e jo aq mbareshtimi i demave per prodhim te fares riprodhuese.

56. Mbrojtja e bimeve. Ne ditet e sotme, ekzistojne shume tregtare dhe magazina private qe ofrojne materiale per mbrojtjen e bimeve. Ne kuadrin e pergjithshem, aplikimi i mbrojtjes se bimeve eshte ne nje shkalle shume te ulet ne Shqiperi. Funkcionet kontrolluese dhe rregullatore, si venia ne karantine e bimeve dhe regjistrimi i pesticideve jane pergjegjesi e Sherbimit per Mbrojtjen e Bimeve. Ky rol perfshin regjistrimin e kimikateve, licencimin e shitjeve dhe inspektimin e ambienteve te shitjes dhe kushtet e magazinimit te kimikateve. E ndersa rregulloret jane te pranueshme, zbatimi i tyre eshte ne nje nivel shume te ulet. Ekzistojne shqetesime ne lidhje me (a) cilesine e keshillave qe jepen nga tregtaret, (b) informacionin i kufizuar mbi alternativat per perdorimin e pesticideve dhe perdorimin e sigurt te pesticideve, dhe (c) fuqizimin i rregullave te magazinimit dhe atyre per depozitimin e sigurt te pesticideve te skaduar. Per pasoje, eshte e nevojshme qe te permiresohet dhe imponohet zbatimi i sistemit kontrollues dhe rregullator per mbrojtjen e perdoruesve dhe konsumatoreve bazuar ne rritjen e kapaciteteve: (a) testimi dhe verifikimi i cilesise se produkteve te importuara ose te prodhuara ne vend per kontrollin e demtuesve; (b) te inspektoje mjetet e magazinimit dhe shperndarjes dhe (c) te analizoje produktet bujqesore dhe ujin nga pikepamja e ndotjes nga pesticidet apo edhe mbetje te tjera. Duke qene se eshte shume e mundshme qe perdorimi i pesticideve te rritet me rritjen e bujqesise, fuqizimi i ketyre rregullave behet po aq i rendesishem sa edhe shperndarja e me shume informacioni per fermeret mbi metodat e prodhimit te integruar dhe organik. Funkcione te tjera te rendesishme te sektorit publik mbi sherbimet e mbrojtjes se bimeve perfshin inspektimin e kufijve dhe karantinen e bimeve per te kontrolluar materialet e infektuara te sjella nga importi, monitorimin dhe diagnostikimin e demtuesve dhe semundjeve dhe keshillimit mbi metoda me te pershtatshme te kontrollit qe perfshijne parandalimin dhe manaxhimin e integruar te demtuesve.

57. Agro-industria dhe marketingu. Vetem nje pjese e vogel e prodhimit vendas perpunohet ne Shqiperi nga nje industri agro-perpunuese, e cila ze vetem 8 perqind te GDP dhe puneson 5 perqind te fuqise punetore ne nivel kombetar. Aktualisht, ekzistojne rreth 200 agro-ndermarrje, te cilat operojne me investime te medha ne prodhimin e pijeve freskuese, perpunimin e vajit te ullirit, qumeshtit dhe mishit. Zhvillimi i potencialeve agro-perpunuese do te kete rol vendimtar per permiresimin e metejshe me bujqesise dhe zonave rurale. Industria agro-perpunuese sherben si nje instrument kryesor dhe i qendrueshem per prodhimin bujqesor si dhe ofron mundesi per punesim ne zonat rurale. Marketingu i produkteve te perpunuara dhe te nje cilesie te larte do te rrishte mundesine qe Shqiperia te konkuroje ne tregjet europiane dhe te gjeje hapësira tregtare. Prodhimi organik me siguri do te arrije qe te zoteroje nje segment ne treg. Megjithate, para se Shqiperia te arrije suksese ne gjetjen e tregjeve te reja, duhet te permiresohet dhe te mbahet e qendrueshme cilesia e produkteve; e per pasoje edhe standartet e cilesise duhen te percaktohen dhe te imponohen per zbatim. Pjesa me e madhe e fabrikave perpunuese jane te vogla, dhe impakti i tyre ne marketing, zakonisht paraqitet shume i lokalizuar. Ekspansioni pengohet nga mungesa e kapitalit, ekspertizes, dhe kosto e larte e grumbullimit te produkteve. Zhvillimi i metejshe me i industrise agro-perpunuese do te jete vendimtar per nje lidhje te permiresuar te fermereve me tregjet dhe nje rritje te vleres se produkteve lokale. Marketingu kryhet nga disa tregtare private dhe nepermjet tregjeve lokale. Fuqia negociuese e fermereve eshte e vogel si pasoje e mungeses se informacionit mbi cmimet dhe mundesite e kufizuara per shitje. Tregje te vogla ekzistojne neper te gjitha vendin, shpesh shume te nevojshem, po ashtu dhe nje numer tregjesh te shumices dhe pakices. Do te jete e rendesishme qe te permiresohet infrastruktura e tregjeve, per te funksionuar ne menyre me eficiente, si dhe te garantohet mirembajtja e tregjeve.

58. Zhvillimi i agro-perpunimit duhet te vazhdoje duke u orientuar drejt investimeve private, ne vend te investimeve te sektorit publik, dhe nuk duhet te kete asnje perpjekje per te rimekembur thertoret shtetore aspak rentabel, fabrikat e perpunimit te qumeshtit dhe paketimit te mishit. Ne disa raste, si p.sh. ne zonat rurale, bashkia ose pushteti vendor mund te investonte ne ndertimin e thertoreve dhe magazinave frigoriferike, duke i dhene ato me qira bazuar ne parimin e mbulimit te koston. Nje investim i tille per sektorin publik do te permiresonte higjiene, reduktonte humbjet dhe ulte rrezikun e semundjeve te mbartura nga kafshet. Detyrat kryesore te qeverise do te jene vendosja e rregulloreve transparente dhe te zbatueshme pas konsultimeve te gjera me aktoret ne kete sektor. Investime te metejshme ne aspektin e sigurise ushqimore jane te garantuara, por eshte e nevojshme qe ato te planifikohen me kujdes ne menyre qe te mos pengojne aksesin gjithsesi te kufizuar rural dhe urban ne produktet bujqesore.

59. Shqiperia ka mundesi per te eksploruar disa hapësira tregtare bujqesore, si bimet mjekesore, produktet e ullirit, mjalti, produkte te tjera te bletes, djathera dhe mish i tymosur. Megjithate, keto tregje duhet te arrihen te zoterohen ne menyre te qendrueshme. Vecanerisht per bimet mjekesore, zhvillimi duhet te orientohet drejt kultivimit te tyre, sesa grumbullimit te tyre ne gjendje te eger, gjë qe rrezikon konsumin e burimeve natyrore. Perpunimi i ketyre barerave ne Shqiperi do ta shtonte vleren e tyre. Qeveria mund te mbeshtese kuadrin rregullator dhe mundesite per eksportim per keto produkte, si dhe te permiresoje shtrirjen e tyre ne kuader te ekstensionit bujqesor. Gjithsesi, funksionimi do te jete teresisht mbi baza private dhe do te mbetet nje hapësire tregtare me leverdi vetem per nje numer te vogel fermeresh, te cilet do te ngrene biznesin e tyre ne kete drejtim.

## **VI. Financimi Rural**

60. Mungesa e vazhdueshme e financimeve per investime ne sektorin rural, perben nje pengese themelore per zhvillimin rural ne Shqiperi. Te shumte jane faktoret qe mund te identifikohen si frenues per zhvillimin e tregjeve financiare rurale, disa prej te cileve jane (a) koston e larta te transakcioneve dhe risqet e medha qe mbart financimi rural, (b) informacioni jo i plote mbi klientet potenciale dhe mundesite per huadhenie ne zonat rurale, dhe (c) nje kuader i varfer ligjor dhe institucional per transakcione te sigurta. Keto pengesa i kane mbajtur bankat komerciale te instaluar ne qendrat urbane dhe fokusimin e tyre ne financimin urban, duke ngadalesuar keshtu, zhvillimin e sherbimeve financiare dhe agjenteve financiare.

61. Pavaresisht progresit te ngadalte ne zhvillimin e sherbimeve financiare rurale, disa tendenca inkurajuese kane filluar te shfaqen. Shume iniciativa te financuara nga Banka Boterore, IFAD, IFC dhe disa organizata joqeveritare kane hedhur bazat per shtrirjen e nje sistemi te qendrueshem te financimit rural. Iniciativat e hershme te huadhenies per fermeret dhe sipermarres te tjere rurale nepermjet fondeve te kredise se fshatit, po kompletohen tani me perpjekje te perqendruara per te zhvilluar nje sistem kombetar te shoqatave te kursim kredise, i cili do te mundesoje depozitimin e kursimeve apo edhe sherbimet e huadhenies. SH.K.K.-te jane institucione financiare formale, funksionimi i te cilave rregullohet nga legjislacioni per kursim-kredite, i kaluar se fundmi ne parlament dhe qe i ben ato subjekt kontrolli nga Banka e Shqiperise. Progresi i deritanishem ne zhvillimin e SH.K.K.-ve dhe F.K.F-ve ka rezultuar ne nje rrjet kombetar te institucioneve financiare rurale, i cili synon ne ofrimin e sherbimeve financiare per pjesen rurale te Shqiperise. Gjate tre viteve te ardhshme, fusha e mbulimit te popullsise rurale nepermjet sherbimeve te tilla do te zgjerohet, por numri i ekonomive bujqesore rurale qe do te kene akses ne kredi, ende do te jete me pak se 10% ne total.

62. Presioni per nje perhapje me te shpejte te ketyre programeve kerkon nje reagim pozitiv, po te kihet parasysh fakti qe mungesa e financimeve rurale eshte nje nga pengesat prioritare per



nje zhvillim rural. Nje fenomen i perhapur dhe i perseritur me iniciativat e financimit rural ne te gjithë boten e zhvilluar, do te ishte shtrirja shume e shpejte e programeve te vogla por te suksesshme, shpesh me ritme me te shpejta sesa ato te zhvillimit te kapaciteteve institucionale dhe njerezore, te nevojshme per t'i vene ne funksionim keto programe. Rezultatet e nje shtrirjeje kaq te shpejte mund te cojne ne degradimin e cilesise se portofolit, gje qe rrezikon qendrueshmerine e agjenteve financiare. Megjithë kete, zhvillime te metejshme ne drejtim te aksesit per sherbime financiare rurale, do te ishin te rendesishme per zhvillimin e zonave rurale.

63. Paralel me zhvillimin e nje sistemi kombetar te institucioneve te mikro-kredise, inkurajuese duket qe te jene edhe disa sinjale te vogla qe tregojne se sektori bankar tregtar po fillon te shtrihet pertej bazeve se tij aktuale urbane. Kjo shtrirje ka ardhur ne pergjigje te zhvillimit te pergjithshem te tregjeve financiare shqiptare. Dege bankash po shfaqen ne zonat rurale. Kjo shtrirje sjell sherbime te reja financiare per popullsinë rurale, ben qe bankat te familiarizohen me shume me mundesite per huadhenie ne zonat rurale, dhe ndihmon komunitetin bujqesor, nese jo ne menyre te drejtperdrejte nepermjet kredive, te pakten nepermjet nje ndermjetesimi me cilesor financiar.

64. Mbeten shume hapa te tjera per t'u bere, ne menyre qe te intensifikohet zhvillimi i sektorit financiar:

- Kompletimi i kuadrit ligjor dhe rregullator eshte kyc per kete zhvillim– ku perfshihen ratifikimi i ligjit per falimentimin dhe perfundimi i procedurave rregulluese dhe mbikeqyrese per shoqatat e kursim-kredise.
- Perpjekje paralele nevojiten te behen per te fuqizuar kapacitetin implementues dhe zbatues, vecanerisht per Banken e Shqiperise.
- Mbeshtetje e metejshme per iniciativat e ardhshme ne sferen e mikro-kredise. Vemendja kryesore do te perqendrohet ne shtrirjen e menaxhueshme te programeve te mikro-kredise, transformimin e suksesshem te Fondit te Financimit Rural ne nje Union Kombetar Kredie, dhe mbeshtetje ne vazhdimet per qendrueshmerine e institucioneve te mikro-kredise, menjehere sapo te perfundojne financimet e huaja.
- Perpjekje te metejshme per te zgjeruar tregun, sic mund te ishte mbeshtetja per bankat komerciale qe te ngrene deget e tyre ne zonat rurale, ndoshta nepermjet subvencioneve per kostot e larta administrative dhe mbeshtetje ne drejtim te aplikimit ne rritje te transaksioneve te sigurta, perfshire procedura te permiresuara regjistrimi ne funksion te transaksioneve te sigurta.

## VII. Zhvillimi rural pertej sektorit bujqesor

65. Ekonomia rurale varet nga potencialet ne sektorin jobujqesor. Ndersa bujqesia do te vazhdoje te luaje nje rol dominant, vecanerisht per zenien me pune te fuqise punetore, do te jete e nevojshme te zhvillohen biznese te tjera ne menyre qe te permiresohen mundesite e sigurimit te te ardhurave ne zonat rurale dhe te ulet papunesia. Keshtu, zhvillimi i aktiviteteve me karakter jobujqesor do te jape ndikimin e vet ne flukset migratore dhe mjedisin e pergjithshem te biznesit ne te gjitha fushat, duke e bere lokalitetin me terheqes per sherbime te tjera, por edhe per vete njerezit. Zhvillimi aktual i sektorit jobujqesor eshte ne shkalle minimale dhe ka natyre informale. Ai kufizohet ne ndertimet e dores se dyte (te cilesise se ulet), sherbime te vogla teknike dhe personale. Vetem rreth 20 perqind e ketyre ndermarrjeve jane te shtrira ne zonat rurale. Pervec kesaj, gjate dekadës se fundit, ekonomia eshte rritur shume shpejt ne dhe perreth zonave kryesore te uleta urbane, ku perqendrimi i faktoreve te prodhimit ka mundesuar shlyerje me te mire dhe shpejte te investimit.

66. Dergesat mund të shërbejnë si një mjet tjetër për të investuar në zonat rurale. E ndërsa dergesat ndihmojnë të sigurojnë mundësi për të filluar një biznes, paralel me këtë është e nevojshme që të këtë një akses më të madh në drejtim të burimeve financiare për të filluar një biznes me orientim jobujqësor në zonat rurale, gjë që e nxit zhvillimin në këtë zonë. Qeveria duhet të marrë parasysh krijimin e lehtësirave si në aspektin e taksave, subvencione të kufizuara apo edhe të tjera për bizneset që i instalojnë aktivitetet e tyre në zonat rurale. Gjithashtu, është thelbësore që t'i kushtohet vëmendje edhe aktiviteteve për formim profesional, në funksion të përgatitjes së një fuqie punëtore me të kualifikuar në zonat rurale. Mungesa e mundësive të punësimit jashtë kuadrin të fermes, është një pengesë për një racionalizim të metejshëm të prodhimit bujqësor dhe të përfitimeve nga ekonomitë shkalë. Ka ndodhur një ulje e vazhdueshme në nivelin e kualifikimit të fuqisë punëtore rurale, si pasoje e fenomenit të plakjes, migrimit apo mungesës së arsimit dhe trainimit të të rinjve. Të marra së bashku, këta faktorë kanë kontribuar në krijimin e një situatë konstante papunësie në fshat.

67. Ndërsa bujqësia ka qenë e suksesshme në mbështetjen e sigurisë ushqimore, ajo ende mbetet në shumë zona të vendit, kryesisht e orientuar drejt prodhimit për konsum familjar, si rezultat i mungesës së nxitesave strukturore për të prodhuar ekstra, gjë që cilën ajo është gjendje ta bëjë. Prodhimi ekstra i kufizuar reflektohet edhe në nivelin e ulet të të ardhurave nga sektori bujqësor e për pasoje edhe kërkesës së ulet për mallra dhe shërbime vendi, gjë që do të kontribuonte në zhvillimin e mjedisit ku zhvillohet biznesi rural.

68. Nga ana tjetër, zhvillimi i ekonomisë rurale jobujqësore ka vuajtur nga një mungesë e theksuar e strukturimeve institucionale, të nevojshme për zhvillimin e tij. Një program ndërsëktorial i planifikuar për mbështetje dhe inkurajim të investimeve në funksion të zhvillimit të biznesit, me një fokus në ngritjen e kapaciteteve me potencialet ekonomike lokale, do të shërbente shumë në rregullimin e disniveleve aktuale strukturore. Teknologjia e informacionit mund të ndihmojë për të lidhur me shumë zonat e thella me tregjet, të cilat ato nuk do të ishin në gjendje t'i arrinin me mjete tradicionale. Skema konkurruese financimi grant mund të mbështesnin një program me të gjere rural dhe të përmbushnin dy kritere të rëndësishme – të menaxhohen në nivel lokal dhe të imponoheshin nga mjedisi lokal. Për të nxitur zhvillimin e bizneseve rurale me karakter jobujqësor, vëmendje duhet t'i kushtohet aspekteve kyçe të mëposhtme:

- Ndertimi i kapaciteteve dhe mbështetja për sipërmarresit në hapësirat e tyre për prodhim dhe punësim;
- Aresimim dhe trajnim në drejtim të aftësive teknike dhe biznesit, dhe futja e teknologjive me kosto të ulët, të përshtatshme për të shfrytëzuar oportunitetet e identifikuar;
- Mbështetje për zhvillimin e mundësive për biznes dhe instrumentave të tregut për zonat rurale;
- Ndertimi i kapaciteteve institucionale në fushat e pushtetit vendor, organizatave të shoqërisë civile dhe shërbimeve financiare rurale; dhe
- Përmirësime në disiplinimin e prones, ambienteve institucionale dhe komerciale që pengojnë zhvillimin e biznesit.

### **VIII. Menaxhimi i Burimeve Natyrore**

69. Burimet natyrore në Shqipëri kanë degarduar në mënyrë drastike gjatë dekadës së fundit. Problemi i lindur në këtë drejtim do të ishin: (a) shpyllezimi i pakontrolluar dhe zjarret në zonat pyjore; (b) rritja e madhe në numrin e bagetive dhe për pasoje mbishfrytëzimi i kullotave, vecanerisht në zonat malore; (c) erozioni i tokës dhe degradimi si rezultat i prodhimit bujqësor në tokat kufitare, vecanerisht në zonat kodrinore dhe malore me reliev të thyer (d) humbja e tokës së

puneshme dhe pjellore nepermjet urbanizimit te shpejte te saj; (e) mbishfrytezimi i burimeve detare te peshkimit; dhe (f) ndotja e burimeve ujore dhe kurrizeve ujembledhese. Rrethet me nivele te larta te varferise prezantojne nivele te larta erozioni dhe shpyllezimi, duke treguar dhe lidhjen ndermjet varferise dhe degradimit te tokes. Shpyllezimi, gjithashtu ndikon ne rezervat ujore malore si dhe redukton dhe nivelet rrjedhese te lumenjve dhe rrit rrezikun e demeve te medha nga permbytjet gjate kohes se rreshjeve te shumta. Rritja e shpejte e numrit te gjese se gjalle ka cuar ne rritjen e stresit per ambjentin, pasi toka per kullote synon te mbi-shfrytezohet. Eshte llogaritur se 60 perqind e tokes bujqesore eshte e prekur nga erozioni i ashper i tokes, i cili ka ardhur si pasoje e shpyllezimit, praktikave te varfera bujqesore dhe mbishfrytezimit te tokes-kullote. Megjithatë ekzistojne shume pak te dhena mbi erozionin, eshte e qarte qe si rezultat i kushteve shume delikate te tokes, miliona tone toke pjellore humbet cdo vit, ndersa digat dhe pellgjet ujore zihen me rere shume shpejt.

70. Praktikave bujqesore intensive te se kaluares dhe aktivitetet e tanishme te nje ekonomie tregu ne tranzicion, te gjitha keto kane demtuar larmine e flores dhe reliefit. Disa nga impaktet me te padeshiruara perfshijne (a) humbjen e popullimeve dhe fragmentimin; (b) demtimi dhe degradimi i popullimeve dhe ekosistemeve; (c) c'rregullimi dhe keqtrajtimi i specieve te egra dhe (d) zhdukja e specieve dhe demtimi dhe erozioni i burimeve gjenetike. Ekzistojne nevoja te medha per ndertimin e kapaciteteve per monitorimin dhe kontrollin e biodiversitetit, fuqizimin e ligjeve, por me e rendesishmja krijimi i nje sensibiliteti ndaj mjedisit dhe i praktikave te pershtatshme mjedisore.

71. Tokat kane marre shume pak pleherim qe prej 1991, duke rezultuar ne nje shkaterrim te perberjes organike, nitrogjenit dhe potasiumit. Perverc degradimit te pjellorise se tokes, vihet re edhe nje renie e kapaciteteve ujembajtese dhe nje shfaqje me e shpeshte e barerave te keqija dhe eshte pikerisht nga ky neglizhim, qe shkaktohen dhe semundjet e bimeve. Perkeqesimi i gjendjes se pyjeve po ndodh per tre arsye kryesore: mbledhja e ekzagjeruar e drurit per ngrohje, mbishfrytezimi i tokes per kullote nga bagetia, dhe mbi-shfrytezimi i foragjereve. Pyjet me produktivitet te larte vuajne nga prerjet e paligjshme per dru komercial, te shoqeruara nga nje humbje e konsiderueshme e drurit cilesor. Permbytja eshte nje problem shqetesues ne rritje, vecanerisht ne pjesen veri-perendimore te Shqiperise, ku menaxhimi i burimeve ujore eshte i keq dhe infrastruktura kulluese po degradon. Siperfaqja totale e permbytur eshte me shume se 40,000 hektare. Nje lidhje rastesore ekziston gjithashtu ndermjet shpyllezimit, mbi-shfrytezimit te kullotave, erozionit, dhe permbytjesve, e cila shkaktohet nga mirembajtja qe le per te deshiruara e kanaleve kulluese dhe stacioneve te pompimit. Burimet detare te peshkimit dhe akuakultura menaxhohen ne menyre shume te keqe, por qe kane potenciale te mira ekonomike. Ujerat shqiptare po shfrytezohen per peshkim gjithnje e me shume, gje qe ushtron nje presion ne rritje per ta shitur peshkun jashte Shqiperise. Per pasoje, shenja te dukshme jane shfaqur nga mbishfrytezimi i burimeve detare te peshkimit ne zonat bregdetare.

72. Pyjet perbejne rreth 36 perqind te siperfaqes se pergjithshme te vendit dhe perfaqesojne nje baze shume te rendesishme te burimeve natyrore. Potencialet ekzistojne qe sektori te rrise kontributin e tij ne rimekembjen ekonomike, duke gjeneruar te ardhura nga shitja e lendes drusore, duke rritur punesimin rural, dhe duke sjelle perfitime per mjedisin. Menaxhimi me i mire i pyjeve duhet te perqendrohet ne tre objektivat qe vijojne: (a) permiresimi i siperfaqeve te degraduara pyjore dhe per kullota ne pronesi te shtetit dhe sensibilizimi per nje shfrytezim te qendrueshem te tyre; (b) nxitja e ruajtjes se ekosistemeve pyjore natyrore; dhe (c) intensifikimi i tranzicionit te pylltarise/sektorit te kullotave drejt nje ekonomie tregu, duke ndare funksionet komerciale nga ato rregullatore dhe krijimi i mekanizmeve per vete-financimin e aktiviteteteve tregtare. Keto hapa do te kerkojne reforma institucionale per administraten pyjore/kullotave perfshire krijimin e nje njesie te menaxhimit mjedisor te pylltarise dhe reforme ne fushen e politikave qe lidhen me kontrollin mbi prerjet ilegale ne pyje, si dhe reforma ne marketing dhe cmime. Theks i vecante

duhet te vihet drejt nje metode me pjesemarrje ne procesin e menaxhimit te pyjeve dhe kullotave shteterore nga komunitetet lokale.

73. Shqiperia ka nje larmi biologjike dhe relievi qe ben te mundur rritjen e nje game te gjere bimesh dhe speciesh shtazore. Vleresohen 3,200 lloje bimesh vaskulare dhe 756 specie vertebrare ne vend. Rreth 30 perqind e te gjitha flores europiane eshte e pranishme ne Shqiperi, ndersa pyjet e larte jane strehe per komunitete kafshesh te egra si ujq, arinj, macet e egra, dhite e egra dhe komunitetet e zogjve karakteristike te shoqeruar me pyje te virgjier. Shqiperia eshte nje urekalimi e rendesishme per migrimin e zogjve, lakuriqeve dhe insekteve. Rrezikohen te zhduken rreth 91 specie ne Shqiperi. Llojet kryesore te sistemeve dhe popullimeve te demtuara perfshijne dunat ranore, deltat e lumenjve, pyjet aluvionale, lagunat e brendshme, livadhet alpine, liqenet kontinentale dhe te ngrira si dhe pyjet gjethegjere dhe halore. Ndermarrja e hapave per te mbrojtur burimet natyrore do te jete domethenes per zhvillimin e ardhshem te sektorit bujqesor dhe rural. Aktualisht, Shqiperia ka pak toke bujqesore per fryme. Per te ruajtur qendrueshmerine e prodhimit bujqesor, qeveria duhet te : (a) vazhdoje te zhvilloje dhe implementoje politika qe synojne menaxhim me te mire te ujembledhesave nepermjet lehtesimit te menaxhimit ne nivel fshati te kullotave malore dhe pyjeve; (b) siguroje shfrytezim afat-gjate te qendrueshem te burimeve ujore midis kerkesave konkurruese; dhe (c) zhvilloje dhe implementoje politika te monitorimit dhe ruajtjes se burimeve detare dhe ujerave te brendshem. Permirosimi ne menaxhimin e ujembledhesave duhet te synoje transferimin gradual te drejtave te perdorimit te pyjeve dhe kullotave shteterore, tek komunitetet dhe fshatrat ne perspektiven afat-gjate, me synim mbeshtetjen e jeteses se ketyre komuniteteve. Duke siguruar te drejtat e perdorimit afat-gjate, nenkuptohet qe interesi i komuniteteve lokale ne menaxhimin e qendrueshem te ketyre burimeve pyjore dhe kullotave, do te rritet, duke kontribuar keshtu ne uljen e erozionit.

74. Burimet e ujerave te embla ne Shqiperi do te jene subjekt i kerkesave konkurruese ne rritje nga konsumi familjar, perdorimi industrial, prodhimi i energjise elektrike dhe ujitja ne bujqesi. Per te siguruar perdorimin racional te ujerave te fresketa te vendit dhe shfrytezimin e qendrueshem te burimeve detare dhe te ujerave te embla te peshkimit, duhet hartuar nje strategji per burimet ujore. Deri me sot, nuk ka ekzistuar asnje metode menaxhuese qe te percaktoje, dhe aq me pak te implementoje nje politike te qendrueshme, si dhe te theksoje rolin e institucioneve publike ne percaktimin dhe imponimin per zbatim te niveleve te shfrytezimit ujit dhe te peshkimit.

75. Veprime te rendesishme per te ardhmen do te perfshinin:

- Krijimi i mundesive te reja per gjenerim te ardhurash dhe akses ne treg per komunitetet e varfere rurale brenda kuadrit te menaxhimit te qendrueshem ne aspektin ekologjik, ekonomik dhe social, te pyjeve, kullotave, dhe kurrizeve ndarese ujore, perfshire aksesin ne teknologjite e informacionit;
- Rehabilitimi i integruar i pyjeve, kullotave dhe tokes se punueshme, te degraduara dhe eroduara, nepermjet menaxhimit te mikro-zonave ne tokat komunale;
- Normalizimi i biodiversitetit dhe mbrojtja e ambientit nepermjet konservimit te biodiversitetit, kryesisht ne zonat e mbrojtura, dhe ndergjegjesim rreth mbrojtjes se ambientit;
- Fuqizimi i kapaciteteve institucionale te menaxhimit te burimeve natyrore dhe agjencive te ambientit ne nivel qendror, rajonal dhe lokal, dhe sigurimi i mbeshtetjes per krijimin e nje kuadri koherent ligjor, politik dhe ekonomik per decentralizimin e menaxhimit te pyjeve dhe kullotave komunale.

## Konkluzione

76. Me siper u pershkruan sfidat dhe mundesite qe qendrojne perballe Shqiperise rurale. Jane identifikuar tete fusha themelore, ne te cilat progresi eshte shume i rendesishem per vitet e ardhshme ne menyre qe te ndihmohet zhvillimi, zgjidhen problemet e varferise dhe te menaxhimit te qendrueshem te burimeve natyrore ne zonat rurale. Percaktimi i prioriteteve brenda ketyre sektoreve mbetet i veshitire. Te gjithë perbejne perberesit kryesore te nje recete te suksesshme per zhvillimin rural ne Shqiperi. Ne mungese te qofte edhe njerës prej tyre, rezultati nuk do te ishte aq i kenaqshem dhe progresi mund te ishte i paqendrueshem.

77. Percaktimi i prioriteteve duhet te ndodhe ne dy nivele: niveli makro dhe mikro. Ne nivelin makro, permiresimi i mjedisit ligjor dhe politik do te jete thelbesor per cdo lloj hapi perpara drejt zhvillimit, por vecanerisht per terheqjen e investimeve ne zonat rurale. Qeverise do t'i duhet nje vizion i shendoshe dhe nje kapacitet per te perkthyer vizionin ne aksion. Ne nivelin mikro, sherbimet rurale mbeshtetese jane kyce per zgjidhjen e nje numri problemesh njekohesisht. Megjithate, sukcesi do te varet ne menyre te konsiderueshme nga cilesia e sherbimeve, e cila ne fund te fundit lidhet me kapacitetin e individeve dhe organizatave te perfshira, dhe aftesive dhe mundesive te tyre per te ndryshuar dhe zhvilluar.

78. Zhvillimi rural eshte pergjegjesi e nje numri institucionesh qeveritare dhe jo-qeveritare. Procesi i zbatimit te strategjise per zhvillim ekonomik dhe social dhe Programi i buxhetit afat-mesem, perfaqesojne nje platforme ne te cilen institucionet mund te kembejne mendime dhe bien dakort mbi hapat e metejshe per arritjen e synimit perbashket per zhvillim rural. Kjo platforme duhet te perdoren me me shume vendosmeri dhe nuk duhet te mbetet ne nivelin e pergjithshem makro. Ajo duhet te permbaje detaje te mjaftueshme qe lejojne personat pergjegjes ne institucione te ndryshme per t'i perkthyer keto synime ne veprime konkrete. Kjo gje behet edhe me e rendesishme ne nje mjedis te decentralizuar. Ne te njejten kohe, Qeveria do te duhet te percaktoje tregues me te mire monitorimi, qe lejojne analize te impakteve te veprimeve te ndryshme dhe te nxitet rishikimi i tyre aty ku eshte e nevojshme.

79. Zhvillimi rural ne kuptimin e gjere, duhet te mbetet nje prioritet per angazhimet e BB ne vitet qe do te vijne. Banka mund te mbeshtese zhvillimet esenciale nepermjet portofolit te projekteve te saj te ardhshme, programeve CAS dhe PRSC, si dhe me nje pune te metejshe analitike. Aktivitetet e Bankes ne drejtim te zhvillimit rural, do te fokusohen ne faktoret kryesore qe jane marre ne shqyrtim ne kete dokument.

80. Perberesit jane ne recete per te konsoliduar rritjen dhe nxitur zhvillimin e qendrueshem ne zonat rurale te Shqiperise. Sfida do te jete si te perfshihen zonat rurale ne programin e zhvillimit te pergjithshem dhe te identifikohen personat e afte brenda qeverise dhe shoqerise civile, qe te mund te vene ne levizje kete program. Per te patur sukses rendesi kane alokimet dhe kapacitetet e njerezve te perfshire ne te gjitha nivelet.



## Matrica e Strategjise Rurale

Matrica e Strategjise bazohet ne veprimet e propozuara nga SKZHES e Qeverise. Gjithashtu, ajo trajton statusin aktual dhe nxjerr ne pah instrumentat e propozuar per mbeshtetje nga Banka.

Objektivi	Statusi aktual/Diagnostikimi	Veprimi i propozuar	Institucioni Pergjegjes	Instrum t e Mbesht nga Ba
<b>Zhvillimi i sektorit privat</b>				
Promovimi i ndermarrjeve private dhe permiresimi i sigurise ne tregje.	Hyrja ne treg eshte relativisht e hapur, megjithate mungesa e hyrjes ne skemat e kreditimit kufizon ne shkalle te konsiderueshme investimet; kjo behet me komplekse nga infrastruktura e dobet dhe vecanerisht rruget rurale dhe elektriciteti Rreth 75% e GDP gjenerohet nga sektori privat. Kudri eshte i favorshem, megjithate pengesat jane: mungesa e mbrojtjes nga korrupsioni, burokracia dhe sistemi juridik	<p><b>Lehtesimi i procedurave per hyrje ne aktivite biznesi nepermjet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Reformimit te institucioneve per nxjerrjen e licensave dhe lejeve per aktivite ndertimi;</li> <li>Rritja e transparences se autoriteteve ne administrimin e taksave dhe doganes, nepermjet publikimit te urdherave dhe udhezimeve si dhe krijimit te zyres se informacionit per publikun.</li> </ul> <p><b>Inkurajimi i rritjes se kreditimit dhe permiresimi i kushteve per financimin e siper marrjes private nepermjet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Permiresimit te transparences dhe informacionit te tregut;</li> <li>Konsolidimit te legjislacionit per kolateralin dhe zbatimin i ligjit</li> <li>Permiresimit te legjislacionit tregetar, sidomos duke sjelle ne fuqi ligjin mbi falimentin.</li> <li>Zhvillimit te nje sistemi efektiv juridik;</li> <li>Mbeshtetjes se mekanizmave institucionale qe do te lehtesojne asistencen teknike dhe procesin e kreditimit</li> </ul>	<p>Ministria e Ekonomise (ME)</p> <p>Ministria e Financave (MEF)</p> <p>Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit</p>	<p>PRSC</p> <p>FIAS</p> <p>ASP</p>

		per bizneset.		
Mbeshtetje per zhvillimin e ndermarrjeve te vogla dhe te mesme, nxitja e investimeve te huaja dhe eksporteve.	Iniciativat kryesore per zhvillimin e zonave rurale. Rritja pritet te vije kryesisht nepermjet ndermarrjeve te sektorit bujqesor dhe jo-bujqesor.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Miratimit te ligjit mbi SME-te;</li> <li>• Permiresimit te kudrit ligjor mbi zhvillimin dhe forcimin e aktivitetit te skemave te mikro-kredise;</li> <li>• Permiresimit te nje sistemi te dhenash per lehtesimin e marrjes se vendimeve nga investitore te huaj</li> <li>• Promovimit te produkteve rurale me mundesi eksportimi;</li> <li>• Vleresimit dhe rishikimit te legjislacionit me qellim krijimin e lehtesirave per eksportet.</li> </ul>	Ministria e Ekonomise  Banka e Shqiperise	Mikro-PRSC Projekt Peshkin ASP FIAS Puna sektoria
<b>Reforma e tokes</b>				
Krijimi i tregjeve funksionale dhe te sigurta te tokes	Toka bujqesore u eshte shperndare zoteruesve private, qe coi ne me shume se 460.000 fermere (pronare) te vegjel – pyjet dhe kullotat u mbajten nga shteti. Dhenia me qera e kullotave per nje periudhe afatgjate eshte akoma ne shqyrtim. Regjistrimi i pare akoma i pakompletuar (rreth 2000 nga 3000 zona kadastrale te kompletuara) Zvarritje ne regjistrimin e ndryshimeve te pronesive ne toka per arsye te kostove te larta dhe perpjekjeve te shumta.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxitjes se zhvillimit te tregut te tokes dhe konsolidimit te prones.</li> <li>• Kryerjes se plote e regjistrimit te tokes,, pyjeve dhe kullotave dhe publikimi ityre.</li> <li>• Krijimit te zyrave per administrimin e tokes ne te gjitha bashkite.</li> <li>• Permiresimit dhe konsolidimi i sherbimit kadastral dhe plotesimi i dokumentacioneve per katese te pronesive private.</li> <li>• Zgjidhjes se problemit te pronesise dhe kompesimi i ish-pronareve.</li> <li>• Zhvillimit te nje sistemi te decentralizuar per dhenien me qera te kullotave publike.</li> </ul>	Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit  Zyrat qendrore dhe te Rrethit per regjistrimin	ASP  Projekt Pyjeve
<b>Parashikimi Sherbimeve Rurale</b>				
Mbeshtetja per rritjen e prodhimit bujqesor dhe blegtoral.	Rritmet aktuale te rritjes dhe zhvillimit kane qene mjaft pozitive, rritja konstante prej 3,5 deri ne 4%-pavaresisht se parcela	<i>Permiresimi i aksesit dhe cilesise se sherbimeve ne bujqesi dhe blegtori:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Implementimi i granteve me baze konkurimi per futjen e teknologjive te reja ne prodhim; Ristrukturimi dhe</li> </ul>	Ministria e Bujqesise dhe	



	<p>te vogla, migrimi, mungesa e aksesit ne treg, infrastruktura dhe tregje financiare te dobeta pengojne rritjen e metejshme.</p> <p>Rritje e larte eshte a rritur ne procesin e privatizimit (reforma e tokes, privatizimi i agro-industrise dhe inputeve, pa kontroll cmimesh dhe kufizime tregetimi; megjithate, kjo faze e pare e rritjes paraqitet e pamjaftueshme per arsye te financimit disponibel te kufizuar per aktivitete ne zonat rurale, infrastruktura e e dobet duke perfshire rruget rurale dhe elektricitetin, dhe ujitjen – parcela te vogla te copetuara; sektori privat duhet te mbushe akoma boshllekin e shkaktuar nga ndermarrjet shteterore te perpunimit dhe te marketingut; sherbime bujqesore akoma te varfera.</p>	<p>konsolidimi i institucioneve per kontrollin dhe certifikimin e farave dhe fidanave; Vazhdimesia dhe zgjerimi i projekteve per permiresimin e masave profilaktike veterinare dhe shendetit te kafsheve; Konsolidimi i sherbimeve fito-sanitare dhe ato te mbrojtjes se kulturave bujqesore; kufizimi gradual i rolit te sektorit shteteror lidhur me cilesine kontrollit dhe perdorimit te sigurt.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Forcimi i sherbimeve te keshillimit dhe vendosja e tij ne te gjitha zonat e vendit; Mbeshtetja dhe zhvillimi i nje sektori privat efektiv te keshillimit; Ristrukturimi i institucioneve kerkimore ne bujqesi; Ngritja e Qendres Kombetare te Kerkimit Bujqesor dhe Sherbimit te Keshillimit Bujqesor;</li> </ul> <p><i>Rritja e aksesit ne sherbimet financiare dhe te kreditimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e aksesit ne burimet financiare dhe te kredise per investime ne sektoret prioritare te bujqesise (sera, rritja e frutave, vreshta) dhe ne blegtori;</li> <li>• Zhvillimi i kooperativave te kredise nepermjet krijimit te shoqatave te kursim-kredise.</li> </ul>	<p>Ushqimit</p> <p>Ministria e Financave</p> <p>Ministria e Bashkepunimit Ekonomik dhe Tregetise</p>	<p>ASP</p> <p>Ujitja Rruget</p> <p>Mikro</p>
<p>Rritja e nivelit te perpunimit te prodhimeve bujqesore dhe blegtorale.</p>	<p>Rreth 90% e mbi 300 ndermarrjeve jane privatizuar, megjithese sektori privat nuk ka zevendesuar akoma sektorin shteteror, vetem 2% e bizneseve merren me agro-perpunim, shpesh perpunimi realizohet nepermjet lendeve te para te importuara, per arsye te sasise</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbeshtetja e trajnimeve mbi sigurine dhe kontrollin e cilesise se ushqimeve, duke perfshire sherbimet e laboratorit per certifikimin e cilesise dhe standartizimin e sigurt.</li> <li>• Sigurimi i trajnimeve ne manaxhimin e biznesit.</li> <li>• Permiresimi i aksesit ne skemat e kredise.</li> <li>• Inkurajimi i joint ventures.</li> <li>• Sigurimi i produkteve te qendrueshme nepermjet permiresimit te aksesit ne tregje</li> </ul>	<p>Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit</p>	<p>ASP</p> <p>Mikro</p>

	disponibel te kufizuar ne vend.	permiresimit te aksesit ne tregje.		
Rritja e nivelit te veteqeverisjes se organizatave lokale	Niveli bujqesor ne shkalle rrethi ka nje fare autonomie ne bujqesi, megjithate, nuk ka te ardhura te taksave lokale, per rrjedhoje ka varesi nga buxheti qendror-komuniteti lokal ka shume pak kontribut ne programin bujqesor.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Implementimi i planit te decentralizimit.</li> <li>• Rritja e kapaciteteve nepermjet trajnimit si per pergatitjen e politikave rajonale te zhvillimit ashtu edhe shpermdarjes se sherbimeve publike;</li> <li>• Promovimi i perfshirjes se komunitetit ne veteqeverisje.</li> </ul>	Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit Ministria e Bashkepunimit Ekonomik dhe Tregetise Pusheteti Lokal	
<b>Infrastruktura Rurale</b>				
Rehabilitimi dhe rikonstruksioni i sistemit te ujitjes	Shoqatat e Perdoruesve te Ujit po operojne me sukses te luhatur, jo te gjithë i manaxhojne burimet e tyre dhe grumbullojne tarifat e perdorimit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e investimeve per rehabilitimin e sistemeve te ujitjes dhe kullimit;</li> <li>• Vazhdimesia dhe zgjerimi i projekteve te rehabilitimit per skemat e vogla te ujitjes vecanerisht ne zonat malore;</li> <li>• Vazhdimesia e mbeshtetjes per krijimin e Shoqatave dhe Federatave te Perdoruesve te Ujit.</li> <li>• Trajnimi i SHPU-ve dhe Federatave per permiresimin e organizatave dhe per rritjen e aftesive manaxheriale. Permiresimi i manaxhimit te burimeve ujore, nepermjet transferimit te manaxhimit te puneve ujore tek Shoqatat e perdoruesve te ujit.</li> </ul>	Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit  Bordet e kullimit	Projekti Ujitjes
Permiresimi i infrastruktures se ujerave te bardha e te zeza dhe transportit rural	Mungesa e aksesit ne sistemin e ujit te pijshem dhe ujrave te zeza ndikon mjaft cilesine e jeteses ne zonat rurale, gjithsesi, mungesa e rrugeve te mira rurale dhe elektricitetit jane pengesa serioze per investime ne keto zona.	<i>Permiresimi i aksesit dhe cilesise ujrave te bardha dhe te zeza:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Miratimi i strategjise se sistemit te furnizimit me uje te pijshem dhe sistemit te ujrave te zeza ne zonat rurale.</li> <li>• Krijimi i Agjensise se Ujit dhe te Higjenes per zonat rurale;</li> <li>• Ndertimi i sistemeve te furnizimit me uje dhe te ujrave te zeza ne zonat me kritike rurale per te plotesuar nevojat per uje te pijshem dhe permiresimin e sherbimeve ujore ne keto zona;</li> <li>• Inkurajimi i pjesemarrjes se komunitetit ne projektet e furnizimit me uje dhe permiresimi i rrjetit te ujrave te</li> </ul>	Departamenti i Rrugeve  Autoriteti Kombetar i	

		<p>zeza;</p> <p><b>Rehabilitimi dhe permiresimi i rrugeve kryesore, furnizimit me energji elektrike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rehabilitimi i rrugeve kryesore qe lidhin qendrat bashkiake me qytetet dhe komunat me te aferta (pune ndertimore ne 920 projekte rrugeshe ne zonat rurale apo rreth 1800 km rruge);</li> <li>• Riorganizimi dhe permiresimi i mirembajtjes se rrjetit te rrugeve dytesore dhe tretesore;</li> <li>• Permiresimi i rrjetit te furnizimit me energji elektrike per popullsine rurale, kryesisht nepermjet permiresimit te eficiences se veprimit.</li> </ul>	<p>Energjetikes</p> <p>Ministria e Puneve Publike</p> <p>Pushteti lokal</p> <p>Ministria e Shendetesise</p>	
<p>Permiresimi i kushteve dhe nivelit te marketingut per produktet bujqesore ne tregjet lokale dhe te huaja.</p>	<p>Rreth 80% e tregut dominohet nga importet, duke bere prezente nje konkurrence mjaft te forte ndaj produkteve lokale, tregjet ekzistojne, megjithate ata shpesh jane ngritur ne menyre informale dhe nuk mirembahen.</p> <p>Fermeret shpesh nuk kane akses ne treg, per arsye te sasive te kufizuara qe ata prodhojne dhe mungeses se afersise se tregjeve me prodhimin e tyre.</p> <p>Tregjet jane dominuar nga tregetaret e vegjel dhe te medhenj dhe mungon informacioni mbi cmimet, vecanerisht per fermeret, duke dobesuar pozicionin e tyre ne treg.</p> <p>Produktet, shpesh nuk prodhohen</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i tregjeve te vogla per shitjen me shumice te frutave dhe perimeve;</li> <li>• Permiresimi i organizimit te tregjeve te produkteve dhe perfshija e perfituesve ne menaxhimin e tyre;</li> <li>• Krjimi i strukturave per grumbullimin dhe shperndarjen e informacionit ne tregje per te ndihmuar fermeret.</li> </ul> <p><i>Permiresimi i standarteve dhe kontrolli i cilesise se produktit:</i></p> <p>Forcimi i kontrollit veterinar ne pikat kufitare;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Harmonizimi i legjislacionit mbi produktet ushqimore me legjislacionin e BE;</li> <li>• Identifikimi i mundesive per rritjen e konkurrences se produkteve ushqimore ne tregjet e brendshme dhe te jashtme;</li> <li>• Permiresimi i legjislacionit dhe procedurave administrative lidhur me eksportet dhe cilesine e ushqimit;</li> <li>• Favorizimi i investimeve te huaja;</li> <li>• Kerkimi i asistences per permiresimin e cilesise, etiketimin, paketimin, informacionin e tregut mbi</li> </ul>	<p>Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit</p> <p>Ministria e Bashkepunimit Ekonomik dhe Tregtise</p> <p>Pushteti lokal</p>	<p>ASP</p>

	me nje orientim drejt tregjeve – shpesh tregjet furnizohen me te njejtin produkt duke cuar ne uljen e cmimeve.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• produktet e perpunuara;</li> <li>• Rehabilitimit i plote dhe furnizimi me pajisje i laboratoreve rajonale te kontrollit te ushqimit.</li> </ul>		
<b>Zhvillimi Rural per Ndermarrjet Jo-bujqesore</b>				
Nxitja e punesimit dhe te ardhurave nga aktivitetet jobujqesore ne zonat rurale	<p>Pjesa me e madhe e ndermarrjeve jo-bujqesore ka nje strukture te vogel dhe tregeton pak. Rreth 30-40% e te ardhurave vijne nga bujqesia, keshtu qe ka nje varesi te theksuar ne parate e derguara jashte dhe migrimit te perkohshem</p> <p>ShKK-te fondet e kredise se fshatit dhe institucione te tjera financiare do te jene te rendesishme per zhvillimin e metejshem te aktiviteteteve rurale jo-ferme. Gjithashtu, te ardhurat nga migrimi kontribuojne ne investime te vogla ne zonat rurale</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbeshtetja e krijimit te mikro-ndermarrjeve nepermjet projekteve mikro-financiare dhe mbeshtetjes me asistence keshillimore.</li> <li>• Rritja e mundesive te punesimit nepermjet programit te puneve publike;</li> <li>• Forcimi dhe zgjerimi i kooperativave te kredise nepermjet krijimit te shoqatave te Kursim-kredise;</li> <li>• Promovimi i aktiviteteteve per agro-turizem, grumbullimin dhe perpunimin e barerave mjekesore, artizanate etj.</li> <li>• Promovimi i aktiviteteteve trajnuese profesionale</li> </ul>	<p>Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit</p> <p>Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale</p> <p>Pushteti lokal</p>	<p>Mikrokr</p> <p>ASP</p> <p>Puna sektorial</p> <p>PRSC</p>
<b>Manaxhimi i Burimeve Natyrore</b>				
Mbrojtja dhe permiresimi i perdorimit te burimeve natyrore	<p>Presioni ne burimet natyrore nepermjet mbishfrytezimit te kullotimit, prerjes e drureve pyjore ne menyre ilegale, problemeve te erozionit, mbishfrytezim i peshkimit, shtimi i problemeve te permbytjeve, ndotja e lumenjve dhe perrenjve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Forcimi i strukturave te menaxhimit te mjedisit ne nivel kombetar dhe lokal;</li> <li>• Transferimi i pyjeve dhe kullotave ne pronesi apo per perdorim komunitetit;</li> <li>• Futja e metodes se menaxhimit te perbashket te burimeve ujore detare nga komuniteti rural nepermjet Shoqates se Peshkataveve.</li> <li>• Forcimi i kapaciteteve per manaxhimin e burimeve natyrore</li> <li>• Permiresimi i organeve pergjegjese per manaxhimin dhe kontrollin e perdorimit te pyjeve dhe kullotave;</li> </ul>	<p>Ministria e Mjedisit</p> <p>Ministria e Bujqesise</p> <p>Drejtoria e Pergjithshme e Pyjeve dhe</p>	<p>Projekti Pyjeve</p> <p>Projekti Peshkim</p>

		<ul style="list-style-type: none"><li>• Ristrukturimi i shërbimeve pyjore për të lehtësuar përdorimin e qendrueshëm të pyjeve dhe kullotave;</li><li>• Krjimi i kuadrit ligjor institucional për menaxhimin dhe përdorimin e burimeve ujore për peshkim;</li><li>• Rehabilitimi dhe mbrojtja e burimeve natyrore nëpërmjet pyllëzimit dhe ndërtimit të digave malore;</li><li>• Rehabilitimi i kullimit për të eliminuar përmytjet në zonat veri-perëndimore.</li></ul>	Kullotave  Qeveria Lokale	Agjencia Globale Mjedisit do të ndertohe
--	--	---	---------------------------------	--



## **Shqiperia: Strategjia e Zhvillimit Rural -**

### **Mbeshtetje per Rritje Ekonomike dhe Zhvillim te Qendrueshem**

#### **Hyrje**

1. Qeveria Shqiptare ka pergatitur nje strategji ambicioze per rritjen ekonomike dhe reduktimin e varferise si nje element kyc i perpjekjeve te saj per t'i dhene fund tranzicionit te ekonomise, per te nxitur nje zhvillim te shpejte dhe me baze te gjere si dhe per te reduktuar varferine. Suksesi i strategjise varet ne nje shkalle te konsiderueshme nga c'ka do te ndodhe ne vitet e ardhshme ne zonen rurale te Shqiperise. Shqiperia rurale popullohet nga mbi 58% e popullsisë totale, prodhon me shume se nje te terten e prodhimit te pergjithshem bruto (GDP), dhe kontribuon ne shkalle te konsiderueshme ne te ardhurat e eksportit. Ajo ka perfituar gjithashtu edhe nga nje rritje shume e ndjeshme e te ardhurave prej prodhimit si dhe te ardhurat nga zonat rurale qe nga fillimi i periudhes se tranzicionit. Megjithate kete rritje, per fat te keq shume zona rurale ne Shqiperi mbeten ne varferi te thelle si dhe jane subjekt i nje funksionimi te kufizuar dhe te varfer te infrastruktures dhe sherbimeve baze. Qeveria eshte shume e ndergjegjshme qe Strategjia e saj per Zhvillim Ekonomike dhe Social qe ne thelbin e saj eshte konceptuar per te adresuar barrierat kryesore qe pengojne rritjen, zhvillimin dhe zbutjen e varferise ne zonat rurale.

2. Ky dokument synon te kontribuojne ne nje dialog rreth asaj se cfare mund te permbaje nje strategji e fokusuar drejt zhvillimit rural dhe reduktimit te varferise. Objektivat e saj jane: (a) te beje nje trajtim te plote te problemeve dhe mundesive me te cilat perballen popullata rurale; (b) analizoje zhvillimet dhe politikat aktuale qe ndikojne ne ekonomine rurale; (c) te sugjeroje veprimet e duhura per kapercimin e problemeve qe lidhen me zhvillimin rural, reduktimin e varferise dhe rritjen e qendrueshme te burimeve; (d) identifikojte fushat e asistences se ardhshme te B.B. ne sektorin rural.

3. Ky dokument do te argumentojte qe nje strategji rurale nuk mund te fokusohet vetem ne performancen e permiresuar te bujqesise. Sasia e tokes se punueshme ne raport me popullsinë eshte e vogel, ndersa fermat qe kane lindur nga privatizimi i fermave shtetore dhe kooperativave jane shpesh aq te vogla dhe te copezuara, saqe veshtire qe te perballojne nevojat themelore te popullates. Keshtu, ndersa ky dokument do te analizoje mundesine e rritjes se rendimentit bujqesor, paralelisht ai do te shohe edhe drejt burimeve te tjera qe ndikojne ne rritjen rurale dhe punesimin. Mbi te gjitha, ai do te sugjeroje qe garantimi i sherbimeve rurale baze sic jane sherbimi shendetesor, arsimimi, dhe transporti, do te lehtesojne levizshmerine e vazhdueshme te fuqise punetore drejt zonave me kerkese te larte per te<sup>2</sup>.

4. Studimi zbulon gjithashtu edhe diversitetin qe karakterizon Shqiperine rurale ne drejtim te klimes, gjeografise dhe bazes se burimeve. Ai propozon qe cdo perpjekje per te formuluar nje strategji rurale, duhet t'a marre ne konsiderate nje gje te tille, si dhe faktin qe strategjia duhet te jete aq fleksibel sa te mundesojte per zgjidhje lokale sipas rrethanave specifike. Keshtu, ky diversitet kerkon nje kendveshtrim rajonal te programeve per zhvillim.

5. Gjate analizimit te nderhyrjeve te mundshme ne mbeshtetje te implementimit te nje strategjie rurale, studimi ve theksin tek rendesia e perfshirjes se komunitetit ne aktivitetet e zhvillimit. Shqiperia ka grumbulluar eksperience te konsiderueshme ne drejtim te iniciativave me baze komuniteti, vecanerisht ne rehabilitimin e infrastruktures rurale. Metodrat me baze komuniteti jane zhvilluar me tej ne drejtim te rehabilitimit te infrastruktures ujites, si dhe jane

---

<sup>2</sup> Megjithese ceshtjet e prekura nga ky dokument shkojne pertej atyre bujqesore, ne menyre qe te perftohet nje pamje me e gjere e sektorit rural, ka edhe ceshtje qe mbeten te patrajtuara. Keto ceshtje lidhen me arsimin, shendetesine dhe mbrojtjen sociale ne zonen rurale. Perjashtimi tyre nuk nenkupton aspak qe ato jane me pak te rendesishme per zhvillimin rural. Formulimi i strategjive per keto ceshtje kerkon hapesire e vet dhe kalon pertej qellimit te ketij dokumenti. Eshte planifikuar nje pune e metejshme per formulimin e strategjive dhe veprimeve qe trajtojne problematiken ne keto fusha per zonen rurale.

duke u shtrire me ritme të shpejta edhe në fusha të tjera, përfshirë skemat me baze komuniteti të kreditimit, skema e granteve konkurruese dhe iniciativat e menaxhimit të pyjeve.

6. Në funksion të plotësimit të metodës me baze komuniteti është përqendrimi në rritje të vëmendjes nga ana e qeverisë në drejtim të procesit të decentralizimit të vendim-marrjes dhe transferimit të përgjegjësive nga autoritetet qendrore tek administrata lokale. Kjo iniciativë u ndërmor kohët e fundit me aprovimin e ligjit për decentralizimin. Një sfida me të cilën përballë qeveria shqiptare dhe një fushë prioritare për mbështetjen e donatoreve, do të jetë ngritja e kapaciteteve të pushtetit lokal në drejtim të kryerjes së shërbimeve komunitare baze. Në të njëjtën kohë, qeveria po ndërmerr një reformë të plotë të shërbimit civil, e cila fokusohet në një përcaktim me të mirë të rolit të ministrive sektoriale, duke përshtatur nivelet dhe aftësitë e personelit me rolet e rishikuara, dhe duke prezantuar përmirësime në drejtim të kompensimit, për të tërhequr apo mbajtur staf të motivuar dhe të aftë. Pasojat e këtyre reformave në shërbimet rurale do t'i nështrohen një analize të veçantë.

7. Dokumenti është i organizuar si vijon. Seksioni tjetër merr në shqyrtim situatën aktuale në zonën rurale të Shqipërisë si në drejtim të performancës së ekonomisë rurale ashtu edhe të ndryshimit të kornizave të prodhimit. Ai fillon me një vlerësim të zhvillimeve dhe frenimeve gjatë dekadës së fundit, duke hedhur vështrimin në politikën themelore dhe klimën institucionale si dhe duke përshkruar reformat që kanë ndihmuar në nxitjen e ndryshimeve dhe rritjes në zonën rurale të Shqipërisë. Ai vijon me një diskutim mbi situatën aktuale në kuadrin struktural dhe aksesin në shërbimet rurale. Seksioni i tretë merr në analizë sfidat dhe mundësitë e perspektivës për Shqipërinë rurale si dhe diskuton në mënyrë të detajuar elementet që përbejnë bazën për një strategji rurale në Shqipëri- elementet e saj kryesore. Seksioni i katërt ben përpyetje t'i bashkojë këta elemente në një deklaratë të një strategjie koherente si dhe analizon fushat e mundshme për mbështetje nga B.B. në drejtim të implementimit të kësaj strategjie. Ai mbyllet me një matricë të strategjisë e cila rrjedh nga dokumenti i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik dhe Social si dhe ve në dukje veprimet me të rëndësishme që ndihmojnë zhvillimin rural.

Vlerësimi i situatës aktuale të zhvillimit rural

## **2.1 DEKADA E FUNDIT- ZHVILLIMET DHE FRENIMET**

### **Zhvillimi Ekonomik dhe Reformat**

8. Shqipëria, me një popullsi prej rreth 3.1 milion banorë, e filloi kalimin drejt ekonomisë së tregut në vitin 1991, pas disa vitesh rënie ekonomike. Në fillim tranzicioni ishte kaotik dhe rezultoi në një degradim të menjëhershëm ekonomik. Në 1992, vetëm pas një viti në tranzicion, prodhimi kishte rënë në gjysmën e niveleve të shënuara në vitin 1989 ndërsa inflacioni ishte rritur në 250%. Një zi buke e mundshme mezi arriti të shmangej gjatë kësaj periudhe, kryesisht nëpërmjet programeve nderkombëtare të emergjencës ushqimore.

9. Në përgjigje të këtij fillimi kaotik, në fillim të 1993, qeveria filloi zhvillimin e programeve që synonin stabilitet makro-ekonomik dhe rregullime strukturore, të cilat rezultuan në një rritje ekonomike të ndjeshme. Nga 1993 në 1996, ekonomia u rrit 9% çdo vit ndërsa inflacioni ra në shifra teke, në sajë të liberalizimit të gjere të çmimeve dhe kontrollit mbi tregjet, shpërndarjes së shpejtë të tokës bujqësore, dhe privatizimit të ndërmarrjeve bujqësore, tregtare dhe të vogla. Rimekembja u ndihmua edhe nga dërgesat e shumë njerezve, të cilët ishin larguar nga vendi i tyre. Megjithatë, progresi nuk ishte i njëjtit në të gjithë sektorët, ku reformat në sektorin bankar dhe fuqizimin e nevojshëm të kapaciteteve institucionale dhe administrative kishin mbetur prapa.

10. Në vitin 1996, problemet ekonomike dhe politike, filluan të përvijohen. Rritja e shpejtë u frenua pjesërisht nga skemat piramidale të paqëndrueshme, ashtu si edhe nga politika shumë liberale fiskale e imponuar nga zgjedhjet. Inflacioni u rrit tre herë dhe reformat strukturore u ndërprenë. Skemat piramidale rënë në 1997, duke provokuar një krizë sociale dhe ekonomike, e



cila e coi vendin në prag të luftës civile dhe në ndërprerje të aktivitetëve ekonomike. Performanca makro-ekonomike u prish ndjeshëm, me një GDP të rene në 7% ndërsa inflacioni u ngrit në 30%. Dergesat nga jashtë shtetit u ulen, ndihmat e huaja u ndërprehen, tregtia ndërkombëtare u ngadalesua dhe monedha shqiptare u zhvleftësua 40% brenda pak muajsh.

11. Por me zgjedhjen e një qeverie të re në mesin e vitit 1997, ekonomia shqiptare u rikthye në rrugën e rritjes ekonomike dhe reformave. Me asistencën e donatorëve, qeveria formuloi një program rimekembjeje me synim përmirësimin e qeverisjes, forcimin e institucioneve dhe politikave ekonomike, privatizimin e bankave tregtare dhe ri-startimin e ekonomisë. Stabiliteti ekonomik u rikthye shpejt, me ritme të rritjes së GDP në 8% në vitin 1998, 7,3% në 1999, dhe rreth 7% aktualisht. Politika fiskale e kujdesshme e uli inflacionin në më pak se 1% për vitin 1999 dhe rreth 2% në vitin 2000. Ndërsa në vitin 2001, GDP për frymë arriti deri në 1,130 USD. Këto arritje ndodhën pavarësisht krizës kosovare dhe fluksit të madh të refugjatëve në fillim të 1999. Në kulmin e krizës, numri i refugjatëve shënoi 450,000, duke e rritur popullsinë në masën 14%.

### Varferia Rurale

12. Pavarësisht këtyre arritjeve pozitive, varferia mbetet një fenomen i zakonshëm dhe mbizotërues kryesisht në zonat rurale. Varferia ka shumë dimensione si: (a) niveli i ulët apo shumë i ulët i të ardhurave; (b) shkalla e lartë e rrezikimit të shëndetit dhe mungesa e shërbimeve të përshtatshme shëndetësore; (c) analfabetizmi apo shkalla e ulët e arsimimit; (d) aksesit i kufizuar në institucionet qeveritare vendim-marrëse. Pothuajse, një në tre shqiptarë, mund të konsiderohet i varfër dhe këta në çdo pesë persona të varfër, jetojnë në zonat rurale. Pabarazia në nivelin e të ardhurave (0,43 Gini) është e lartë, referuar standarteve rajonale dhe varferia është më e lartë në familjet me një nivel të ulët arsimimi dhe me një numër të madh femijesh. Shumë familjeve, kryesisht në zonat rurale, u mungon aksesit në infrastrukturën bazë, përfshirë shkollimin bazë dhe shërbimet shëndetësore. Vdekshmëria foshnjore si dhe niveli i vdekshmërisë tek femijet nën moshën 5 vjeç janë relativisht të larta nëse krahasohen me ato të vendeve të tjera të rajonit dhe pothuajse një në çdo shtatë femije nën moshën 5 vjeçare është i kequshqyer. Analfabetizimi është rritur dhe tre të katërtat e familjeve të varfëra përballen me probleme sociale të mëprehta.

13. Mundësia e të jetuarit në varfëri rritet paralelisht me madhësinë e familjes. Nivelet e varferisë janë relativisht të larta në grupet, për të cilat bujqësia është i vetmi burim i të ardhurave. Kjo përforcohet me shumë nga fakti që gati gjysma e të varfërve merret me aktivitete bujqësore, 20% janë pensioniste dhe 10% janë të punësuar në sektorin jobujqësor. Sipas LSMS në vitin 1998, me shumë se gjysma e familjeve, ku kryefamiljari është i papunë, janë në nivelin e varferisë. Njerezit e punësuar janë më pak të rrezikuar të futen në kategorinë e të varfërve nëse jetojnë në zonat urbane (5,3%) sesa ata që jetojnë në zonat rurale (32,6%). Një në çdo gjashtë familje jeton me më pak se 1 USD në ditë dhe pothuajse një në çdo dy familje jeton me më pak se 2 USD në ditë. Tabela 1 tregon përhapjen e varferisë sipas burimit kryesor të të ardhurave.

**Tabela 1. Varferia sipas burimit kryesor të të ardhurave**

	Te varfer	Jo te varfer	Totali
Te punësuar në sektorin jobujqësor	10.31	40.03	32.63
Te punësuar në bujqësi	48.38	23.96	30.04
Pensioniste (përfshirë të paafet)	21.05	26.27	24.97
Pagese papunësie	4.42	1.04	1.88
Te tjere	15.84	8.71	10.48

*Burimi: Strategjia per Zhvillimin Ekonomik dhe Social*

14. **Diferencat rajonale.** Varferia ka nje dimension rajonal. Rajonet e Kukesit, Dibres dhe Elbasanit mund te konsiderohen si me te varferat. Familjet ne Tirane, Durres dhe Vlore kane mesatarisht, tregues me te larte, pak a shume tri here me te larte se ne prefekturat e varfera. Sasia shume e vogel e tokes se punueshme e shperndare per fryme ne zonat rurale, konsiderohet si nje nga shkaqet kryesore te varferise ne keto zona. Papunesia e fshehur eshte karakteristike per zonat rurale. Papunesia e fshehur dhe punesimi jo i plote, jane pasoje e sasise se ulet te tokes se punueshme per fryme te popullates dhe nivelit te ulet te aktiviteteve ekonomike dhe jobujqesore ne zonat rurale. Duke mos patur mjete te tjera jetese, pervec tokes bujqesore, pjesa me e madhe e familjeve ne rrethet e Dibres, Kukesit, Tropojes, Shkodres, Mirdites dhe Matit, mbeshteten kryesisht ne te ardhurat dhe produktet e fermave te tyre.

15. Paaftesia per te siguruar te ardhura nepermjet punesimit eshte nje nga shkaqet kryesore te varferise ne zonat urbane. Megjithese papunesia ka rene nga 27% qe ishte ne 1992 ne 16.8% ne 2000 (statistika zyrtare), ajo vazhdon te mbetet ne nivele te larta, sidomos papunesia afatgjate. Referuar te dhenave ekzistuese, papunesia ndodhet mbi nivelin mesatar ne qytetet e Beratit, Elbasanit, Kurbinit, Shkodres, Permetit dhe Kucoves. Pjese te konsiderueshme te fuqise punetore ne zonat e Kamzes dhe Paskuqanit te rrethit te Tiranës, dhe zonen e Katundit te Ri te rrethit Durres, jane te papune dhe jetojne kryesisht me pune te perkohshme, si pjese e ekonomise informale. Vecanerisht, papunesia prek grup-moshat nga 16-34 vjec, per arsye se kjo grup-moshe nuk ka eksperience apo aftesi profesionale. Nivelet me te larta te kesaj grup-moshe regjistruhen ne rrethet e Vlores (86%), Matit (82%), qytetin e Tiranës (66%), Pukes (65%), dhe Shkodres (63%).

16. Nje vleresim i varferise ne aspektin cilesor merr ne analize 10 rrethe ne vitin 2001<sup>3</sup>. Sipas ketij studimi, rrethet e vendit mund te klasifikohen ne tre grupe: te varfera, mesatarisht dhe relativisht te pasura. Si rrethe te varfera identifikohen Kukesi, Laci dhe Gramshi. Ne keto rrethe ka me shume familje te varfera, per arsye te ekzistences se pak mundesive per punesim dhe sigurim te ardhurash. Pervec kesaj, pak njerez nga keto rrethe kane mundur te emigrojne, duke kufizuar keshtu aksesin per dergesa. Grupi i dyte perfshin rrethet e Vlores, Mallakastres, Tiranës, Shkodres dhe Mirdites, me mundesi per te siguruar te ardhura prej nje apo dy burimeve. Tirana, e cila i perket ketij grupi, perben nje rreth te vecante per shume arsye, perfshire faktin qe ajo eshte kryeqyteti i vendit, ka me shume mundesi per te terhequr investimet e huaja, dhe eshte epiqendra e migracionit. Keto karakteristika e bejne Tiranen nje rreth shume me teper heterogjen si nga pikepamja ekonomike ashtu dhe nga ajo sociale, ne raport me rrethet e tjera. Grupi i trete perfshin rrethet qe kane me pak familje te varfera dhe shume te varfera, si Korca dhe Saranda. Keto rrethe kane nje ekonomi me te larmishme, kane tre ose kater burime per punesim dhe sigurim te ardhurash, si dhe dergesa me te medha nga emigracioni.

17. Diferencat rajonale ne drejtim te burimeve, vendndodhjes, infrastruktures, klimes, etj., duhet te merren ne konsiderate gjate marrjes se vendimeve strategjike ne lidhje me shperndarjen e buxhetit, permiresimet ne infrastrukture dhe zhvillimin e sherbimeve. Rajonet ne Shqiperi dallojne kryesisht nga pikepamja e klimes, relievit dhe aksesit ne sherbimet dhe tregjet rurale si dhe zhvillimit te infrastruktures. Zonat e uleta me potencialet me te larta te prodhimit bujqesor, rajonet gjysme dhe plotesisht malore dallojne nga njeri-tjetri. Keto diferenca rajonale, vecanerisht per zonat me te largeta si ato veri-lindore te vendit, do te mbartin impaktin e tyre ne cfaredolloj rruge zhvillimi qe vendi mund te zgjedhe. Keto dallime duhet gjithashtu te ndikojne ne vendimet per format sesi zona te vecanta mund te mbeshteten nepermjet programeve te ndryshme. Nuk ekziston asnje metode qe te mund t'i pershtatet ne menyre perfekte te gjitha rajoneve. Ndersa disa perpjekje per zhvillim mund te japin rezultat pozitiv per disa nga zonat, per

<sup>3</sup> Vleresim i varferise ne aspektin cilesor per 10 rrethe te vendit. Aktualisht eshte duke u pergatitur nje studim i LSMS. LSMS pritet te siguroje informacione te metejshme rreth dimensioneve te varferise ne zonat rurale. Rezultate paraprake priten ne vjeshten e 2002.

disa të tjera, mund të mos jete e mundur që ato të rigjallerojnë ekonomine, dhe njëzë të këtyre zonave mund t'u shërbeje me mirë nëse ata kanë shkollimin dhe shëndetin të kërkojnë mundësi sigurimi të ardhurash gjetke. Kjo, është vecanerisht e vlefshme për zonat e largëta në veri-lindje të vendit, ku mundësitë për sigurim të ardhurash janë shumë të pakëta. Qeveria duhet të vazhdojë të zhvillojë një vizion strategjik rajonal, i cili të mundësojë një shfrytëzim më të orientuar të burimeve drejt aktiviteteve prioritare në zona të vecanta. Kjo nuk nënkupton që disa zona do të përjashtohen nga mbështetja, por kjo sugjeron që llojet e nderhyrjeve mund të ndryshojnë. P.sh., ndërsa është e nevojshme që të sigurohen shërbimet infrastrukturore baze në të gjithë vendin, përmirësime të metejshme në rrjetin rrugor mund të përqendrohen në zona me potenciale më të mëdha rritjeje siç janë zonat bregdetare si dhe ato jugore të vendit.

### **Sektori Bujqësor**

18. Bujqësia shqiptare ka pësuar ndryshime të mëdha gjatë tranzicionit.<sup>4</sup> Sistemi bujqësor shtetëror u përmbys, shumë ndërtesa dhe pajisje bujqësore, përfshirë dhe sistemet e ujitjes u braktisen ose u demtuan, sasia e inputeve ra në mënyrë dramatike, dhe sistemet e marketingut dhe të agro-industrisë i ndërprehen aktivitetet. Kështu, në vitin 1991, sektori pësoi një rënie të menjëhershme prej rreth 22% krahasuar me 1989, dhe u riu në një mundësi reale në vitin 1992.

19. Në përgjigje të këtij kolapsi të afert, u filluan një sërë reformash në fillim të periudhës së tranzicionit, të cilat mundësuan një rikthim të shpejtë të rritjes në sektorin bujqësor, ndryshe nga disa vende të tjera të Europës Qendrore dhe Lindore ku bujqësia vazhdon të pësonte rënie për vite me rradhë. Para se gjithash, qeveria filloi në vitin 1992, shpërndarjen e tokës bujqësore nga 550 ferma dhe kooperativa shtetërore tek fermeret, një proces, i cili u mbyll në vitin 1996. Kjo bëri të mundur krijimin e 460,000 fermereve private me ferma të vogla me një sipërfaqe mesatare prej 1 ha dhe shpesh të copezuara në shumë parcela. E gjithë baza blegtorale dhe asetet e tjera të shtetit dhe fermave kolektive, iu shpërndanë gjithashtu fermereve të rinj. Përveç kësaj, progres i rëndësishëm u shënuar edhe në privatizimin e ndërmarrjeve të agro-industrisë, dhe në ngritjen e një kuadri nxites larg çdo deformacioni, nëpërmjet liberalizimit të çmimeve dhe të tregut. Në 1993, sektori ishte rimekëmbur nga rënia e tij e ndjeshme, dhe në 1996, prodhimi bujqësor u rrit në 37% me shumë se nivelet e shënuara në 1989. Kjo këthese erdhi kryesisht si rezultat i veprimtimit të kalimit të tokës në duart e fermereve private dhe rritjes së produktivitetit në sektorin e blegtorisë.

20. Ritmet e shpejta të rritjes të shënuara në fillim, pësuan një rënie prej 10% në 1997, pjesërisht si pasojë e trazirave civile të këtij viti. Pavarësisht këtij fakti, duke filluar nga 1998, bujqësia pati ritme rritjeje prej 5% në vit. Ndryshimet në prodhimin bujqësor gjatë periudhës së tranzicionit janë pasqyruar në Tabelën 2.

21. Sektori bujqësor mbetet i një rëndësie më të madhe për ekonomine e përgjithshme. Megjithatë ka patur një rënie të lehtë në vitet e fundit, si rezultat i një rimekëmbjeje në sektorin industrial dhe një rritjeje në atë të ndërtimit, kontributi relativ i bujqësisë në GDP është ende i lartë. Eksportet bujqësore dhe ato të ushqimeve kapen vlerën e 28.7 milionë USD në vitin 2000, dhe përfshinin kryesisht frutat, perimet, duhanin dhe produktet e peshkut. Eksportet blegtorale kapnin vlerën prej 1,4% të totalit në vitin 2000. Importet në produkte bujqësore dhe ushqimore

<sup>4</sup> Shqipëria ka një sipërfaqe totale prej 28 750 km<sup>2</sup>, prej të cilat 699 000 ha klasifikohen si tokë bujqësore (24% e sipërfaqes totale), 1,027,000 ha si pyje (36%) dhe 466 000 ha kullota (15%). Pjesa e mbetur prej 25% klasifikohet si tjetër, duke përfshirë zonat urbane, rreth 135, 000 ha liqene dhe lumenj, dhe token shkëmbore e malore të pashfrytëzuara. Shqipëria mund të ndahet në tre zona kryesore agro-ekologjike. Zona e ulet përbehet nga ultësira bregdetare përgjatë Detit Adriatik dhe është zona me produktivitet më të lartë bujqësor në vend. Këtu ekzistojnë mundësi për ujitje si dhe kultivohet një game e gjërë kulturash bujqësore. Ato më shtrirë me të madhe, zonat kodrinore janë të mbjella kryesisht me dru frutore, ullinj dhe vreshta. Zona malore përfshin luginat e largëta dhe alpet, të cilat kanë dimër shumë të ashpër. Kulturat bujqësore mund të rriten nëpër luginat, ndërsa zonat më të larta janë kryesisht pyje dhe kullota. Në përgjithësi, cilesia e kullotave është e varfër dhe fenomeni i mbi-shfrytëzimit të tyre është i përhapur. Referohuni në aneksin 1 për një përshkrim të bazës së burimeve natyrore.

jane me te medha se eksportet, duke regjistruar nje vlere prej 226,6 milione USD ne vitin 2002, dhe perbehen kryesisht nga produkte ushqimore te perpunuara.

**Tabela 2. Ritmet e rritjes se ekonomise totale dhe sektorit bujqesor (reale)**

Viti	Rritja e ekonomise totale	Vlera e produkteve bujqesore	Indeksi (1989=100)	% ndryshimit
1991	-28.0%		78	-17.4%
1992	-7.2%	71,602	92	17.10%
1993	9.6%	84,927	109	18.6%
1994	9.4%	91,985	118	8.3%
1995	8.9%	104,157	133	13.2%
1996	9.1%	107,224	137	2.9%
1997	-7.0%	95,634	122	-10.8%
1998	8.0%	99,027	127	3.5%
1999	7.3%	103,198	132	4.2%
2000	7.76%	95,220	Na	-7.7%
2001	7.28%	96,798	Na	1.7%

*Burimi:* Ritmet e rritjes nga Albania Economic Update, Mars 2002, Vlera e Produkteve Bujqesore nga Statistikat Bujqesore, MBU.

22. Megjithë arritjet impresionuese të deritanishme, ende ka shumë probleme që lidhen me bujqesinë shqiptare dhe jetën rurale. Sistemet e prodhimit mbeten ato tradicionale, rendimenti i ulët, shumë ferma janë të teper të vogla dhe të copezuara për të qenë të qëndrueshme, infrastruktura fizike është e varfër, dhe aktiviteti i sektorit privat duhet të plotësojë boshllëkun e krijuar nga agjencitë e mbyllura shtetërore të agro-industrisë dhe marketingut. Mbi të gjitha, një e treta e popullatës rurale jeton ende në varfëri ekstreme. I njëjti shqetësim qëndron edhe për degradimin e madh mjedisor. Kështu, megjithëse mbreselënëse, ndryshimet e ndodhura deri më sot janë vetëm fillimi i procesit të transformimit.

### Struktura në Ndryshim e Bujqesisë

23. **Ndryshimet në prodhim.** Bujqësia në Shqipëri aktualisht dominohet nga fermerët e vegjël, të cilët prodhojnë si për konsum familjar ashtu edhe për treg, ku tregtojnë tregtare private, agro-perpunues dhe furnizues inputesh. Rimekembja e shpejtë në fillim të tranzicionit, ndodhi pasi këta fermerë e pershtatën prodhimin bujqësor me situatën lokale. Në fillim, fermerët synuan të prodhonin sasinë e nevojshme të drithit, kulturave kryesore bujqësore, për konsum individual, dhe mbështeteshin në blegtori dhe/ose perimet për të siguruar të ardhura të kufizuara në kesh. Kulturat bujqësore prodhoheshin në kushtet e një përdorimi të kufizuar të farërave të përmirësuar, pleherave dhe inputeve të tjera, megjithëse së fundi ka patur një përmirësim në situatën e furnizimit me inpute, pasi tregtarët private kanë levizur për t'ua mbushur këtë boshllëk.

24. Siperfaqja e kultivuar me grurë ka ndryshuar gjatë periudhës së tranzicionit (Tabela 3). Në fillim, siperfaqja e mbjelle me grurë pothuajse u pergjysmua nga 200,000 ha në 1985-89 në 103,000 ha në 1992, si rezultat i rënies së fermave kolektive. Në vijim, zona e grurit arriti kulmin prej 170,000 ha në 1994, pasi fermerët e rinj private u perpoqën të prodhonin për qëllime ekzistence. Megjithatë, që prej 1994, ka pasur një rënie konstante të sasisë së grurit të mbjelle në rreth 110,000 ha aktualisht, duke qenë se fermerët i kanë përqendruar burimet e tyre në aktivitete të tjera. Kjo rënie ka ndodhur vecanerisht në zonat kodrinore dhe malore, ku gruri kultivohej në

toke të papershtatshme për të përmbushur synimet kombëtare për vetëqëndrueshmeri. Rendimentet mesatare tani janë të ngjashme me ato të arritura përpara reformave, pjesërisht për faktin që tashme gruri kultivohet në toka më të mira. Aktualisht, Shqipëria përmbush 40 deri në 50% të nevojave për grurë prej 700, 000 tone.

25. Prodhimi i misrit ka ndjekur të njëjtin model. Rendimentet e misrit rënë në mënyrë të menjehershme si pasojë e reformave, si shkak i mungesës së farërave dhe inpueteve të tjera, por që kanë shënuar se fundmi një përmirësim të qëndrueshem si rezultat i rikthimit të pjesës së kapacitetit prodhues të farërave hibride si dhe përmirësimit të games së inpueteve në treg.

26. Prodhimi i kulturave industriale duke përfshirë panxharsheqerin, lulediellin, sojen, pambukun dhe duhanin ka rënë në mënyrë drastike, si rezultat i mbylljes së agjencive shtetërore të përpunimit dhe marketingut. Këto pesë kultura janë kultivuar në një sipërfaqe mesatarisht prej 81,000 ha në fermat shtetërore dhe kolektive në periudhën nga 1985-89, dhe më në më pak se 10,000 ha në fermat private në vitin 2000.

27. Sipërfaqet e mbjella me patate dhe fasule kanë mbetur konstante në rreth 12,000 dhe 22,000 ha respektivisht, pjesërisht sepse këto kultura kërkojnë zona të vecanta agro-klimatike. Megjithatë, prodhimi i patates përfundimisht u dyfishua nga rreth 87,000 t në 1985-90 në 160,000 t në 1999-2000, si rezultat i rritjes së sasive të farës së përmirësuar të patates dhe inpueteve. Gjithashtu, ka patur edhe një shtim të sipërfaqes dhe prodhimit të perimeve, veçanërisht në rajonet e ulëta me akses të kënaqshëm në tregjet e zonave urbane. Perimet sot rriten në një sipërfaqe mbi 30,000 ha.

28. Ka patur një rritje edhe në prodhimin e bimeve foragjere për ushqimin e blegtorisë në të gjitha rajonet e vendit. Bimet foragjere sot rriten në rreth 165,000 ha kundrejt 130,000 ha të regjistruar përpara reformave. Megjithatë shifrat për jonxhen nuk janë mbledhur në vecanti, sot ajo vlerësohet si kultura më shumë e përhapur në Shqipëri, duke zënë më shumë se 100,000 ha. Mbi të gjitha, prodhimi i foragjereve në tokë të punueshme vlerësohet të jetë rritur në mënyrë të vazhdueshme nga rreth 3 milion ton që shënonte mesatarisht në periudhën 1985-89 në 4,8 milion ton në vitin 2000, që do të thotë një rritje prej 60%.

**Tabela 3. Siperfaqja, prodhimi dhe rendimenti i dritherave**

<b>Kultura</b>	<b>1985-90</b>	<b>1992</b>	<b>1993</b>	<b>1994</b>	<b>1995</b>	<b>1996</b>	<b>1997</b>	<b>1998</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>
<i>Grure t</i>										
Siperfaq (‘000 ha)	200	103	155	170	141	125	136	141	109	112
Prodhimi (‘000 t)	606	252	464	420	405	271	388	395	272	341
Rendimenti (t/ha)	3.01	2.44	3.00	2.48	2.87	2.17	2.85	2.80	2.49	3.05
<i>Maize</i>										
Siperfaq (‘000 ha)	72	63	73	75	69	66	61	57	55	53
Prodhimi (‘000 t)	283	156	176	193	216	214	195	189	206	206
Rendimenti (t/ha)	3.80	2.49	2.30	2.45	3.00	2.96	2.92	3.34	3.71	3.58
<i>Other a/perkthei</i>										
Siperfaq (‘000 ha)	12	10	20	18	17	14	15	13	14	13
Prodhimi (‘000 t)	17	12	25	33	24	19	19	19	20	19
<i>Total Cerealsperkthei</i>										
Siperfaq (‘000 ha)	283	176	248	263	227	205	212	211	178	178
Prodhimi (‘000 t)	896	420	665	646	645	504	603	603	498	566

*Burimi:* MBU

*A/ perfshin tersheren, elbin, thekren dhe orizin (te kultivuara perpara 1990)*

29. Nje ndryshim tjetër i rendesishem ka qene edhe ulja e konsiderueshme e intensitetit të mbjelljeve. Perpara vitit 1990, pothuajse e gjithë siperfaqja e tokës bujqesore prej rreth 700,000 ha ishte e mbjelle me kultura fushe apo peme frutore. Megjithate, sot vetem 77% e tokës bujqesore është e mbjelle; ne vitin 2000, p.sh. Rreth 160,000 ha u lane te pambjella ose djerre, apo edhe u braktisen per t’u kthyer me pas ne kullota. Shkaqet kryesore kishin te benin me cilesine e ulet te kesaj toke, mungesen e sherbimeve ujtesore dhe largesine nga fshati.

30. Rendesia relative e prodhimit blegtoral është rritur gradualisht qe prej reformave, me nje kontribut ne vleren e prodhimit te rritur nga 42% qe ishte ne 1992 ne 50% ne 1999. (Aneksi III, Tabela1). Prodhimi blegtoral pershtatet mire me sistemin e fermave te vogla dhe ka nje funksion te rendesishem per mbrojtjen sociale. Ekonomite private synojne kryesisht te prodhojne aq qumesht dhe mish sa te plotesojne nevojat e tyre per konsum, dhe te mbetet nje pjese tjetër suplementare, e cila shitet ku te mundet ne tregjet lokale apo ne fabrikat e vogla te perpunimit, te cilat shtohen dita dites. Karakteri i vogel i prodhimit blegtoral ilustruhet me shifrat e dala nga nje vezhgm<sup>5</sup> ne sektorin bujqesor te realizuar ne gusht 1998, i cili raporton qe rreth 302,000 ekonomi fshatare kishin ne pronesi nje ose dy lope, vetem 5,350 me shume sesa dy, dhe vetem 70 prej tyre zoteronin me shume se dhjete. Gjeja e gjalle sherben gjithashtu edhe per nevoja transporti per njerezit dhe mallrat, dhe shpesh perdoret edhe per pergatitjen e tokës. Te tjere faktore qe shpjegojne kete rritje jane toka e lire e pershtatshme per foragjere; mundesia per te rritur numrin e gjese se gjalle pa shpenzime te larta; fuqia punetore e lire per t’u perkujdesur per gjene e gjalle; aftesia per te siguruar te ardhura te rregullta nga produktet blegtorale; dhe kerkesa ne rritje per produktet blegtorale.

<sup>5</sup> Vezhgm i pergjithshem mbi ekonomite bujqesore, qershor 1998, INSTAT 2000.

31. Numri i gjese se gjalle qe u rrit ne menyre te konsiderueshme ne periudhen nga 1992 deri ne 1995, ra papritur gjate turbullirave civile ne 1997 dhe me tej u rrit perseri qe prej 1998. (Aneksi III, Tabela 2). Gjedhet perbejne sot 4% dhe delet rreth 22% me shume sesa shifra e regjistruar ne 1989. Pervec kesaj, lopet zene 60% te gjedheve, kundrejt vetem 40% qe ishte ne 1989, duke reflektuar nje rritje te rendesise se prodhimit te qumeshtit dhe nje mbeshtetje me te madhe ne sistemet e prodhimit te bazuar tek forageret. Edhe eficenca e prodhimit eshte permiresuar, si provohet nga rendimentet e qumeshtit te cilat jane rritur nga 1,500 kg/per lope ne 1992 ne 1,800 kg/per lope ne 2000. Ne planin e pergjithshem, nga 1989 deri ne 2000, shifrat e prodhimit te qumeshtit dhe mishit jane rritur me 80% dhe 33% respektivisht, prodhimi i vezeve me shume se dy here, dhe prodhimi i mjaltit u rrit me shume se dhjete here.

32. Prodhimi i frutave ra menjehere pas shkaterrimit te sistemit te fermave kolektive, si pasoje e braktisjes se pemishteve, prerjes se drureve per ngrohje, dhe te riaftesimit te tokes nga ana e fermereve private per ta mbjelle me kultura fushë. Prodhimi u pengua edhe nga shkaterrimi i sistemit shteteror te marketingut. Ne 1992, numri total i pemeve frutore perfshire ullinjte dhe agrumet, ra ne menyre dramatike ne rreth 35% te shifres se regjistruar ne 1990. (Aneksi III, Tabela 3). Siperfaqja e mbjelle me vreshta ra ne 40% te asaj qe ekzistonte ne 1990. Megjithate, interesi ne rehabilitimin e prodhimit te pemeve frutore, vecanerisht molleve, ka ardhur duke u rrizgjuar. Edhe prodhimi i ullirit eshte rritur disi, gje qe mund t'i atribuohet pjeserisht ringritjes gjate koheve te fundit te fabrikave te perpunimit te vajit te ullirit, te cilat tashme jane te privatizuara. Gjithashtu, ka nje interes te konsiderueshem ne rritjen e prodhimit te pjergullave, dhe ne fakt vihet re nje rritje e vogel e siperfaqes se mbjelle dhe nje rritje akoma me e madhe ne prodhim si rezultat i menaxhimit me te mire te tokes ne funksion te dhenies se rendimenteve me te larta. Ne te kundert, prodhimi i agrumeve ka vazhduar te bjere, pjeserisht pasi nuk ka mundur te konkuroje me cilesine me te larte te frutave qe vijne nga Italia dhe Graqia.

33. **Ndryshimet ne furnizimin me inpute.** Perpara reformave, Shqiperia ishte pothuajse e veteqendrueshme ne prodhimin e pleherave me permbajtje nitrogjeni, ndersa superfosfati prodhohej nga guri i importuar i fosfatit. Sasia mesatare e perdorur nga 1985 deri ne 1990 ishte rreth 350,000 t te pleherave me permbajtje ureje, nitrati i amoniumit, superfosfati dhe potasi, mesatarisht 140 deri 150 kg per ha te tokes se punuar, te ndara respektivisht ne 72% per nitratin, 25% P<sub>2</sub>O<sub>5</sub> dhe 3% K<sub>2</sub>O. Pas reformave, prodhimi i pleherave dhe importet rane ne menyre drastike, me nje sasi ne renie deri ne 75,000 t ne 1992. Qe nga kjo kohe, perdorimi i plehrave eshte rritur ne menyre progresive duke arritur deri ne 130,000 t ne vitin 2000, fale ne rradhe te pare, importeve te realizuara nga sektori privat. Ka patur gjithashtu edhe nje kalim ne plehera si fosfati i diamonimumit (DAP), megjithese nje sasi e vogel e plehut te potasit perdoret. (Aneksi III, Tabela 4)<sup>6</sup>.

34. Edhe perdorimi i kimikateve bujqesore ra menjehere pas reformave. Aktualisht sasia e perdorshme eshte shume e ulet, me materiale per mbrojtjen e bimeve te ofruara nga sektori privat, kryesisht nepermjet nje numri te konsiderueshem magazinash per furnizimin e inputeve ne nivel rrethi. Pervec kesaj, sistemi i prodhimit te farerave u shkaterrua ne fillim te periudhes se tranzicionit, ku pjesa me e madhe e fermereve mbeshteteshin tek farat e prodhura vete, shpesh te nje cilesie te ulet, me shkalle te ulet mbirjeje, si dhe probleme semundjesh dhe barerash te keqija. Pavaresisht ketij fakti, industria shqiptare e farerave eshte rritur ne menyre te konsiderueshme gjate viteve te fundit si rezultat i aktivitetit te sektorit privat, perfshire edhe zgjerimin e prodhimit te fidanave qe japin kultura me vlere te larte si p.sh. vreshti, pemtoret, importimin e farerave

<sup>6</sup> Sot nga 130,000 t plehrash, sasia ushqyese qe perdoret eshte mesatarisht rreth 32,000 t, ose ndoshta rreth 80 kg/ha ne nje siperfaqe prej 400,000 ha. Megjithese jonxha rritet ne nje siperfaqe te konsiderueshme (e cila ne thelb e shton sasine e N ne toke), ndersa plehu organik eshte duke u bere me i rendesishem, kjo shifer tregon se degradimi i tokes eshte nje problem i vazhdueshem (kjo duket qarte edhe nga gjendja e kulturave ne disa zona). Ne planin e pergjithshem, eshte e mundshme qe prodhimi vjetor i kulturave bujqesore te kufizohet ne zona pjellore me te favorshme, jonxha do te vazhdoje te rritet me prioritet, toka jopjellore do te vazhdoje te braktiset per kultivim dhe/ose do te kaloje per perdorim kullotje. Pavaresisht sa me lart, kerkesa per plehera ka nje tendence per t'u rritur me tej.

hibride te perimeve me nje cilesi te larte, si dhe rritjen e prodhimit te farerave te grurit, misrit, jonxhes dhe patates brenda Shqiperise.

35. Perpara reformave kishte rreth 10,500 traktore ne Shqiperi, numer qe perfshinte si traktoret dhe buldozeret me rrota, me nje mesatare prej 66ha te tokes se punueshme per traktor. Makinat u futen per perdorim ne fermat e medha dhe shume prej tyre nuk i pershtaten strukturese aktuale te parcelave te vogla te copezuara. Pavec kesaj, pothuaj 80% e traktoreve dhe me shume se gjysma e kombajnave ne vitin 1990 ishin mbi 10 vjecare. Gjate viteve te fundit, jane importuar disa traktore te rinj dhe te perdorur, nderkohe qe nje pjese e makinerive te vjetra, perfshire pjesen derrmuese te buldozereve me rrota, kane dale nga perdorimi. Numri total i traktoreve tani eshte rreth 7,200, qe do te thote nje traktor per 97ha te tokes se punueshme. Gjithsesi, shume prej tyre nuk jane ne gjendje te mire pune, apo nuk jane te disponueshem kur dhe ku duhet. Per kete arsye parmenda dhe kultivimi me dore kane zevendesuar traktoret, vecanerisht ne zonat kodrinore dhe malore. Aktualisht, 58% e fermereve e pergatisin token e tyre ne menyre mekanike, 21% me kafshe pune dhe 21% me dore<sup>7</sup>. Te tjera makineri bujqesore jane me pakice, megjithese disa pajisje si kositeset, te perdorura kryesisht per prodhimin e jonxhes, dhe makinat mbjellese, jane shtuar ne menyre te konsiderueshme gjate viteve te fundit, kryesisht prej importeve te sektorit privat. (Aneksi III, Tabela 5).

### **Ndryshimet Rajonale**

36. Sic edhe mund te pritej, ekzistojne diferenca rajonale thelbesore ne strukturen e bujqesise. Keto diferenca pasqyrojne ndryshime ne klime, terren, akses ne sherbimet bujqesore dhe inpute, zhvillimin e tregjeve si dhe niveleve te ndryshme te zhvillimit te infrastruktures. Per te zbuluar keto diferenca, rrethet jane grupuar ne kater rajone te medha, te cilat perfaqesojne zona agro-ekologjike te ndryshme<sup>8</sup>:

- *Rajonin e ulet*, i cili perfshin Durresin, Fierin, Kavajen, Kucoven, Lacin, Lezhen, Lushnjen dhe Peqinin. Keto rrethe ndodhen kryesisht ne ultesiren bregdetare;
- *Rajoni i ndermjetem*, i cili perfshin Beratn, Delvinen, Elbasanin, Krujen, Mallakastren, Saranden, Shkodren, Tiranen dhe Vloren. Keto rrethe perfshijne gjithashtu, disa zona brenda ultesires bregdetare, por edhe disa zona kodrinore dhe malore;
- *Rajoni malor jugor*, qe perbehet nga rrethe malore, te ndodhura ne pjesen jugore te Shqiperise. Rrethet e perfshira ne kete rajon jane Devolli, Korca, Kolonja, Permeti, Pogradeci, Tepelena dhe Gjirokastra. Keto rrethe jane ne pjesen me te madhe kodrinore dhe malore, megjithese ato perfshijne disa zona bujqesore te rendesishme si p.sh. pellgu i Korces;
- *Rajoni malor verior dhe qendror*, i perbere nga Bulqiza, Dibra, Gramshi, Hasi, Kukesi, Librazhdi, Malesi e Madhe, Mat, Mirdite, Puke, Skrapar dhe Tropoje. Keto rrethe jane ne pjesen derrmuese malore, pa siperfaqe bujqesore ekstensive.

37. Te kater rajonet reflektojne nje shkallezim nga zonat e uleta ne ato malore, dhe karakteristikat e tyre permblidhen ne Tabelen 4. Sic mund te mendohej, rezulton me pak toke bujqesore dhe me shume kullota dhe pyje ne rajonet me malore. Gjithashtu, ekonomite bujqesore kane tendence per te qene me te vogla ne rajonet me malore, megjithese fermeret kane akses ne siperfaqen e tokes kullote dhe pyjore per qellime kullotjeje. Sistemet e kultivimit ndryshojne midis rajoneve, megjithese tendenca me e dukshme eshte perqindja e larte e tokes bujqesore te pambjelle ne rajonet me malore. Pjesa me madhe e kesaj toke-shpesh e pjerret, shkembore dhe jopjellore- ka qene e kultivuar gjate regjimit te meparshem. Nje pjese e saj tani perdoret vetem per qellime kullotjeje. Druret frutore rriten ne te gjitha rajonet, lloji i te cilave varet nga

<sup>7</sup> Te dhena nga Vezhgimi ne Sektorin Bujqesor, 1998.

<sup>8</sup> Te kater grupimet me baze rrethesh nuk korrespondojne ekzaktesisht me zonat egro-ekologjike, pasi shume rrethe i perkasin me shume se nje zone.



pershtatshmeria klimaterike, megjithese ato jane vecanerisht te rendesishme ne zonen e ndermjetme ku ullinjte, rrushi dhe shume dru te tjera frutore rriten gjeresisht.

38. Perdorimi i inpueteve ne zonat malore eshte me i ulet se ne ato fushore, me perdorim me te paket te pleherave kimike, me pak vaditje, me pak traktore ne dispozicion dhe me shume vartesi nga puna me dore dhe kafshet e punes per pergatitjen e tokes dhe praktika te tjera kultivimi. Keto ndryshime reflektohen ne rendimentet e uleta te kulturave dhe prodhimin e ulet, perfshire kulturat foragjere, ne keto rajone me pak te favorizuara.

39. Gjedhet jane nje pjese e rendesishme e ekonomise bujqesore ne te gjitha rajonet, megjithese numri dhe prodhimi rezultojne te jene me te uleta ne zonat malore, per arsye pjeserisht te prodhimit te kufizuar te foragjereve cilesore. Anasjelltas, prodhimi i deleve dhe dhive eshte pergjithesisht me i rendesishem ne zonat kodrinore dhe malore sesa ne ato te uleta, si rezultat i mundesise per te kullotur, pavaresisht faktit qe kopete duken te jene me te vogla ne zonat malore sesa ne ato kodrinore. Megjithate vemendjen me te madhe ne aktivitetet e blegtorise ne zonat kodrinore dhe malore, ne raport me ato te uleta, prodhimi i mishit dhe qumeshtit per ekonomi ka nje tendence per te qene relativisht i ulet si pasoje e kushteve te keqija te burimeve publike te kullotjes si dhe te prodhimit te kufizuar te foragjereve cilesore ne toke te punueshme. Megjithate, rendesia e blegtorise per zonat me te pafavorshme, nuk duhet te nenvleftesohet.

40. Dallimet e medha midis zonave agro-ekologjike ne Shqiperi kane cuar edhe ne rruge te ndryshme zhvillimi. Rruget e zhvillimit ne te ardhmen kane te ngjare te vazhdojne te jene te ndryshme dhe cdo strategji zhvillimi qe te hartohet duhet te marre ne konsiderate kushtet specifike natyrore. Shpesh investimet dhe zhvillimi fokusohen ne zonat urbane apo gjysme-urbane me dendesi te madhe te popullsise, te cilat jane lehtesisht te arritshme, me shume produktive, dhe me te perparuara ne drejtim te zhvillimit te tyre. Zonave me te largeta, me me pak formula te gatshme per zhvillim, shpesh u mungojne nivelet e duhura te mbeshtetjes. Si rezultat, keto zona mbeten prapa, me ritme te ngadalta apo edhe negative zhvillimi.

Tabela 4. Struktura bujqesore ne te kater zonat (2000)

Struktura	Shqiperi a	Zonat e uleta	Te mesme	Malore Jugore	Malore verior dhe qendrore
<i>Struktura e tokes</i>					
Sip. totale e tokes (ha)	2,874,80	328,969	895,560	659,458	990,813
% e sip. me pyje dhe kullota	0	19%	43%	56%	66%
% e tokes bujq.	51%	61%	26%	21%	13%
	24%				
STRUKT. MBJELLJES					
Sip. totale e tokes bujq. (ha)	699,293	201,989	229,221	136,734	131,349
% e kulturave pemore	17%	13%	25%	13%	15%
% e kultures se dritherave	26%	29%	23%	26%	24%
% e kulturave foragjere	24%	28%	25%	19%	19%
% e kulturave te tjera	11%	16%	10%	9%	7%
% e kulturave te pambjella	23%	14%	16%	34%	36%
<i>Ekonomite Bujq.</i>					
Numri total		120,197	123,542	62,237	122,306
Sip. totale e ekon. bujq. ha	466,670	159,886	117,941	68,441	61,900
Sip. /ekonomi (ha)	457,581	1,33	0,95	1.10	0,51
	0,98				
<i>Perdorimi i inputeve</i>					
Sip. e ujitur (% e tokes bujq.)	45%	68%	44%	27%	31%
Perdorimi i pleherave (kg/ha)	185	275	158	80	111
Traktore ne dispozicion (ha/traktor)	97	74	125	127	133
<i>Pergatitja e tokes (% e fermerëve)</i>		91%	61%	64%	16%
Mekanike	58%	3%	15%	21%	49%
Kafshe pune	21%	7%	24%	15%	35%
Manuale (me dore)	21%				
<b>Prodhimi i kulturave dhe rendimenti</b>					
	3.1	3.4	3.3	2.5	2.4
	3.6	3.9	4.5	2.3	3.3
Rendimenti i grurit (t/ha)	3.6				
Rendimenti i misrit (t/ha)		1,705	1,260	1,324	748
Prodhimi i dritherave (kg per ferme)	1,212	33	24	18	19
	28	17.4	10.4	7.5	3.7
Rendimenti i foragjereve (t/ha)	9.6				
		10.6	8.3	4.5	6.1
Prodhimi i foragjereve (t/per ferme)	7.1	18.8	14.6	12.4	13.8
Rrush (t/ha)	15.5				
Fruta (kg/peme)		1.7	1.9	1.5	1.6
<b>Numri i gjese se gjalle dhe prodhimi</b>					
	1.6				
		2,130	1,862	1,538	1,113
Gjedhe (no./ferme)	1,609	2.3	8.7	12.8	7.3
Rendimenti i qumeshtit (kg/lope)	6.5				
		2,536	2,368	2,029	1,328
Dele dhe Dhi (no/ferme)	2,031	237	259	223	216
Prodhimi i qumeshtit	241				

(kg/ferme)a/ Prodhimi i mishit (kg/ferme) b/					
--	--	--	--	--	--

*Burimi:* Statistika të Ministrisë së Bujqësisë, 2000

a/ prej të gjithë gjese së gjalle; b/ pësja e gjalle, prej të gjithë gjese së gjalle

### Te ardhurat nga ferma

41. Te ardhurat nga ferma janë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme që me fillimin e reformave. Tabela 5 tregon që fermerët kanë qenë në gjendje të përfitojnë nga mundësitë për të rishpërndarë burimet dhe modifikuar strukturën e fermës në kuadër të reformave. Faktoret që kanë ndikuar përfshijnë zhvillimet në sektorin privat të furnizimit me inxhinieri, marketingut dhe përpunimit; rehabilitimin e disa sistemeve të ujërave; përmirësimet e kujdesit veterinar; dhe përmirësimin e sistemit të ekstensionit. Pavarësisht, te ardhurat nga sektori bujqësor mbeten ende të ulëta<sup>9</sup> dhe zakonisht përbejnë vetëm një pjesë të vogël të te ardhurave totale të familjeve rurale. Fermerët e ekonomive të vogla dhe sipërmarrës të tjerë rurale në Shqipëri, ende ballafaqohen me një sërë faktorësh pengues për zhvillimin e biznesit të tyre, dhe shumë prej tyre u mungon informacioni dhe njohuritë e nevojshme për të përmirësuar prodhimtarinë e tyre, për të bërë me të larmishëm prodhimin dhe për të shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga tregu. Fitimet e para pas reformave u pasuan nga ritme me të ngadalshme rritjeje si pasojë e një numri faktorësh si: kufizimet në treg; degradimi i vazhdueshëm i infrastrukurës ujëtare në zonat, të cilat nuk përfshihen në projekte të ndryshme të ujërave; aksesit i kufizuar në kredinë rurale nga ana e fermerëve, agro-përpunuesve dhe tregtarëve si dhe bizneseve të tjera të vogla rurale; dhe cilesia e ujit dhe farërave dhe fidaneve.

**Tabela 5. Ndryshimet në te ardhurat nga ferma (1994-1998)**

	1994	1995	1996	1998
Te ardhurat bruto në kesh (L/familje)	12,700	23,400	38,900	57,800
Te ardhurat bruto në kesh (USD/ferme)	134	252	374	401
Te ardhurat në kesh nga blegjoria (%)	73	85	79	73
Sipërfaqja e kultivuar ('000 ha)	394	390	353	353

*Burimi:* Faza III e Programit Kombëtar të Ekstensionit, Raport Vlerësimi, Korrik 2000, marrë nga Raportet Vjetore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

### Ekonomia Rurale jobujqësore

42. Menjeherë pas rënies së qeverisë komuniste në 1991, pjesa më e madhe e ndermarrjeve rurale të financuara dhe të operuara nga shteti u mbyllën, dhe ekonomia rurale jobujqësore pothuajse u shkatërrua. Në fokus kryesor ishin ndermarrjet agro-përpunuese dhe sektori i minierave. Gjate dekadës së fundit, niveli i punësimit ra në mënyrë dramatike nga 38,000 në vetëm 4,800 të punësuar në sektorin e minierave; dhe nga 24,000 në 7,500 në industrinë e naftës. Keto ndermarrje nuk ishin konkurrencë në mjedisin e ri të ekonomisë së tregut, dhe aftësia thithëse

<sup>9</sup> Familjet vlerësojnë që atyre u nevojiten të ardhura minimale prej 31,000 Lek në muaj për të bërë një jetesë të thjeshtë, ndërsa te ardhurat mesatare mujore të deklaruara janë 17,000 Lek. (Raporti mbi Zhvillimin Njerezor në Shqipëri 2000).

ndaj investitoreve u ul si rezultat i veshtiresive ne rehabilitimin e infrastruktures fizike dhe i mjeteve te nevojshme per rigjenerimin e tyre nga pikepamja e fitimit.

43. Ne vijim te ngjarjeve te vitit 1991, prioritet i qeverise se re u be arritja e sigurimit te ushqimit brenda vendit, dhe perpjekjet e saj te hershme u perqendruan per reforma ne drejtim te privatizimit dhe rishperndarjes se tokes bujqesore - si nje hap fillestar i nevojshem dhe qe sjell rentabilitet te shpejte. Gjithsesi, qeveria vazhdoi t'i jepte prioritet zhvillimit bujqesor per dekadene qe do te vijonte, duke lene shume pak burime ne dispozicion te ekonomise rurale jobujqesore. Keshtu, sektori i bujqesise arriti nje periudhe stabiliteti te rritjes gjate viteve '90, ndersa ekonomia rurale jobujqesore mbeti realisht ne vend pas renies se saj te menjehershme.

44. Aktualisht, ekonomia rurale jobujqesore kufizohet ne ndertimet e vogla, sherbime te vogla teknike dhe profesionale si dhe tregtine e vogel<sup>10</sup>. Punedhensit ne sektorin e sherbimeve zakonisht perfaqesohen nga biznese familjare, te cilat jane te vogla dhe me pak mundesi per hapje vendesh pune. Pervec kesaj, puna ka tendence te jete e rastesishme, me nderprerje dhe me pagese te ulet. Ato pak vende pune qe krijohen duken qe te krijojne pak mundesi ose aspak ne drejtim te mesimit te aftesive te reja, duke e disavantazhuar edhe me tej fuqine punetore rurale pothuajse te paformuar. Nga ana tjeter, ekonomia rurale jobujqesore siguron vetem mallrat dhe sherbimet baze te jeteses, dhe mbeshtetet me shume ne kode lidhjesh fafesisnore dhe tradicionale te reciprocitetit nderpersonal sesa ne praktikate moderne kontraktuale. Ekonomise rurale jobujqesore i mungojne investimet dhe iniciativa e nevojshme, te cilat sot jane te orientuara drejt zonave te uleta urbane dhe gjysme-urbane, aty ku jane shfaqur ritmet me te shpejta te rritjes gjate viteve '90. Kjo ka cuar ne nje migrim ne shkalle te gjere nga zonat rurale, kryesisht te anetareve meshkuj me aktive te familjes, te cilet terhiqen per punesim ne zonat urbane dhe jashte shtetit. Per pasoje, popullsia rurale po dominohet ne menyre progresive nga grate, te moshuarit dhe te paformuarit nga ana profesionale, duke e ngushtuar ne menyre te konsiderueshme bazen e burimeve njerzore per zhvillimin e Ekonomise Rurale Jobujqesore.

45. Ekonomia Rurale Jobujqesore ne Shqiperi ka vuajtur gjithashtu edhe nga mungesa e rregullimeve institucionale te nevojshme per zhvillim. Vihen re boshlleqe te medha institucionale ne arsim dhe trajnimin per aftesi teknike dhe drejtimin e biznesit, aksesit ne sherbimet financiare, koordinimit me pushtetin lokal dhe organizatat e shoqerise civile; dhe dekretimin, perhapjen dhe venien ne funksionim te nje organi i cili te kerkoje respektimin e ligjit tregtar. Fuqia punetore rezulton me nje ulje te vazhdueshme te aftesive, si pasoje e migracionit, moshimit dhe mungeses se arsimit dhe formimit profesional te te rinjve<sup>11</sup>.

### **Migracioni dhe dergesat**

46. Shqiperia eshte nje vend ne levizje<sup>12</sup>. Migracioni ne Shqiperi shfaqet i brendshem dhe i jashtem<sup>13</sup>. Migracioni i jashtem eshte pergjegjes per humbjen e fuqise punetore me aktive te

<sup>10</sup> Tregtia e vogel eshte e perhapur pasi ka nje fitim te shpejte, kapitali fillestar i vogel mund te aktivizohet brenda familjes, si dhe nevojiten pak aftesi. Tregtia raportohet per rreth 52% te numrit total te ndermarrjeve dhe ka nje tendence te forte qe ato te jene jeteshkurtra. Vetem rreth 20% te ndermarrjeve jane te lokalizuara ne zonat rurale, megjithe faktin qe rreth 55% e popullates banon aty. Psh., Prefektura e Tiranes, me nje popullsi 1,6 here me shume sesa ajo e Dibres dhe Kukesis, raporton per gjashtefishin e ndermarrjeve; 134 here me shume te vleres se sektorit te ndertimit dhe dhjetefish numrin e abonenteve telefonike.

<sup>11</sup> Ritmet e regjistrimit ne shkolle, vecanerisht per femijet e zonave rurale, kane pesuar renie qe prej vitit 1990. Renia reflekton shkaterrimin e cilesise se mesimdhencies, rendesine ne turrje te formimit profesional dhe teknik, si dhe shpenzimet ne rritje per ndjekjen e shkolles. Te dhenat e Ministrise se Aresimit tregojne qe vetem 44% e femijeve ndjekin shkolle, 17% e tyre e braktisin aresimin e detyrueshem cdo vit dhe vetem 4% e ndjekin shkolle rregullisht. Ri-formimi i te rriturve eshte joekzistent.

<sup>12</sup> Referohu Aneksit IV per informacion mbi zhvillimin e popullsis gjate viteve te fundit ne zonat urbane dhe rurale.

<sup>13</sup> Vleresohet qe ne tete vitet e fundit, rreth 350,000 - 400,000 njerz kane levizur drejt zones se Tiranes dhe 700,000 ha toke bujqesore eshte uzurpuar nga ndertimet urbane. Levizja e popullsis nga zonat malore, kryesisht nga zonat

vendit, por nga ana tjeter ai sjell edhe flukse te konsiderueshme dergesash. Migracioni i brendshem po ndikon ne shperndarjen e popullsise dhe po prek shoqerine ne shume menyra. Migracioni drejt zonave urbane po e shton popullsine e ketyre zonave dhe po privon zonat rurale nga forca e tyre e punes, shpesh duke lene vetem femijet dhe te moshuarit pas. Ekziston migracioni afat-shkurter, afat-gjate dhe permanent, megjithese ne te shumten e rasteve migracioni brenda Shqiperise ndodh per periudha me pak se gjashte muaj.

47. Ekzistojne shume dimensione te ketyre modeleve migratore- nga zonat rurale neper qytete, drejtimi gjeografik, dhe nga jashte. Brenda secilit prej ketyre dimensioneve, ekzistojne disa modele te qendrueshme. Migrantet tentojne te braktisin zonat rurale per te shkuar neper fshatra ose qytete brenda Shqiperise. Gjeografikisht, verioet zhvendosen drejt jugut ne qytetet kryesore shqiptare apo ne perendim drejt Italise. Nje pjese e verioreve zhvendosen perkohesisht drejt jugut te Shqiperise perpara se te emigrojne ne Greqi. Jugoret zbresin me ne jug drejt Greqise apo drejt perendimit ne qytetet kryesore bregdetare te Shqiperise, ndersa disa te tjere kalojne ne Itali. Keto modele migracioni si dhe numri i perfshire ne to tregojne qe Shqiperia eshte nje vend ne levizje.

48. **Migrimi i jashtem.** Ndryshimet politike dhe shkaterrimet ekonomike ne fillim te viteve '90 cuan ne flukset e para te emigracionit. Migrimi ishte shpesh rruga e vetme per te plotesuar nevojat themelore te familjes. Qe prej asaj kohe, numri i shqiptareve qe braktisnin vendin e tyre eshte rritur vazhdimisht. Te dhenat zyrtare tregojne qe rreth 265,000 njerez emigruan jashte gjate dekadese se fundit. Megjithate, vleresimet jozyrtare flasin per dyfishin e kesaj shifre. Pergjithesisht, destinacionet me te preferuara jane Greqia, me pas Italia, Franca, Gjermania dhe Zvicra.

49. Migrantet jane ne shumicen e tyre meshkuj, zakonisht nga mosha 14 deri ne 40 vjec<sup>14</sup>. Ekzistojne disa dallime esenciale midis atyre qe deshirojne te migrojne dhe atyre qe ne fakt migrojne. Duke patur nje rrjet miqsh dhe te afermish ne qytetin e destinacionit, kjo te ndihmon ne marrjen e vizave dhe gjetjen e vendit te punes. Gjithashtu, ata qe zoterojne me shume para fizike kane me shume mundesi per t'ia dale me sukses, pasi migracioni eshte i kushtueshem.

50. Te marresh vize eshte bere shume e veshtire dhe e komplikuar. Nje vize afat-shkurter per ne Greqi kushton sa nje ose dy muaj page e fituar ne kete vend. Emigracioni ilegal eshte me pak i kushtueshem, por mbart rrezik. Ende, migracioni jashte konsiderohet si nje nga mekanizmat me te rendesishem perballues. Vleresimi cilesor i varferise thekson se 39% migrojne si rezultat i papunesise, 20% per mungese te ardhurash te mjaftueshme, 16% migrojne per te siguruar nje te ardhme me te mire per femijet e tyre dhe 26% si pasoje e pasigurise ekonomike.

51. **Migrimi i brendshem.** Shqiptaret po migrojne nga zonat e largeta dhe rurale drejt atyre urbane. Gjate dekadese se fundit, popullsia rurale eshte ulur ne 13% dhe banoret e zonave me te largeta jane zhvendosur drejt qendrave urbane si Tirana, Korca, Vlora dhe Shkodra. Pjesa me e madhe e migranteve te brendshem vijne nga vendbanime te vogla dhe relativisht te largeta, te cilat jane ndikuar negativisht nga zhvillimet politike dhe ekonomike, duke cuar keshtu ne mungese sigurie. Shpesh gjendja e tyre nuk permiresohet edhe aq neper qytete, por ka shume pak motivim per t'u kthyer ne zonat e tyre rurale.

52. Migrantet e vendosur ne zonat urbane shpesh nuk regjistrohen dhe per pasoje nuk kane te drejte ndaj asnje lloji perfitimi. Duke qene se ata nuk zoterojne tituj toke, nuk konsiderohen rezidente. Keshtu, shume migrante e fillojne jetesen e tyre urbane ne varferi te plote. Shpesh, pjesa dermuese e burimeve te tyre financiare jane shpenzuar gjate udhetimit, ndersa mundesite per punesim ne zonat urbane duket qe te jene shume te kufizuara.

---

verilindore, ka qene teper akut, por ende ka nje tendence levizjeje brenda zonave te uleta, nga qytetet e vogla drejt atyre te medha.

<sup>14</sup> Sipas vleresimit cilesor te varferise, burrat mbi 40 vjec shpesh nuk mund apo nuk deshirojne te perballen me kushtet e veshtira gjate udhetimit neper Shqiperi apo pertej kufijve.

53. **Dergesat.** Per shume shqiptare, dergesat nga jashte kane qene dhe vazhdojne te jene nje mjet i rendesishem per te plotesuar nevojat e tyre per ushqim dhe nevoja te tjera baze per konsum. Dergesat perfaqesojne rreth 20% te GDP, jane pothuajse dyfishi i te ardhurave nga kembimet me valute te eksporteve, pothuajse katerfishi i vleres se investimeve direkte dhe afersisht 60% me shume sesa te ardhurat e realizuara nga prodhimi industrial<sup>15</sup>. Nje vezhgim mbi te ardhurat familjare ne rrethet e Fierit, Korces, Shkodres dhe Tiranës konstaton qe bujqesia ze 37% te te ardhurave te pergjithshme, dergesat 31% dhe biznesi me karakter jobujqesor vetem 16%<sup>16</sup>. Nje familje tipike rurale ne veri-lindje te Shqiperise, rajoni me i varfer ne Shqiperi, siguron 8% te te ardhurave nga aktivitetet bujqesore, 21% nga blegtoaria, 1% nga perpunimi dhe 67% nga burime jashte fermes, kryesisht dergesat. Ne nivel familjeje, te fituarit dhe sigurimi i dergesave nepermjet migracionit, shihet shpesh si nje menyre per te plotesuar nevojat per konsum, ose per te investuar ne permiresimin e kushteve te banimit, arsimimit apo inputeve te fermes. (Tabela 6).

**Tabela 6. Drejtimet me te rendesishme te perdorimit te dergesave (%)**

Perdorimi	I pare	I dyte	I trete
Per plotesuar nevojat per konsum familjar	43,3	20.6	10.7
Per te permiresuar kushtet e banimit	37,8	41.8	11.8
Per te paguar per shkollimin e femijeve	0.5	2.6	2.1
Per te paguar per inputet e fermes	3.5	23.2	21.4
Per te zgjeruar apo permiresuar aktivitetin bujqesor	3.9	4.1	12.3
Per te filluar apo permiresuar aktivitete familjare private me karakter jobujqesor	1.0	1.6	4.8
Per te plotesuar nevoja te papritura familjare	0	4.6	13.4
Per te bere investime te tjera	4.5	2.1	15.0
Te tjera	5.5	6.7	8.6

*Burimi:* Studim, BE Phare ACE Program, 2001

54. **Problemet dhe mundesite.** Megjithese migrimi eshte nje mekanizem i rendesishem perballues, ai mund coje ne lindjen e shume problemeve. Ndarja e familjeve si pasoje e migrimit, i sjell te gjitha familjes shume stres, dhe eshte i rende vecanerisht per te moshuarit, te cilet shpesh humbasin mbeshtetjen sociale. Familjet pa meshkuj jane te pambrojtura dhe kane me pak anetare per te perballuar te njejtin volum pune. Edhe cilesia e mesimdhenies preket, pasi mesuesit e kualifikuar shpesh emigrojne. Kjo ndodh edhe ne profesionet e tjera. Gjate dekadës se fundit, Shqiperia eshte perballur me nje eksod te njerezve te saj me te arsimuar.

55. Ndersa per pjesen derrmuese te njerezve, migrimi eshte mjeti me efektiv per ta nxjerre familjen nga varferia, shume prej tyre i perdorin parate e fituara jashte per te krijuar nje baze sesi te jetojne ne vendin e tyre. Migrimi ndihmon per te grumbulluar kursimet, te cilat mund te investohen ne disa forma aktivitetesh ekonomike, kryesisht ndermarrje me nje person apo me baze familje. Shpesh parate shperbejne si baze fillestare financiare per te ngritur nje mikro-ndermarrje, apo perdoret per te blere pajisje ne menyre qe te permiresohet produktiviteti i aktiviteteve ekzistuese. Prandaj, investimet e emigranteve qe rikthehen ne atdhe jane ne dobi te ekonomise shqiptare. Megjithate, mund te thuhet se nje pjese e madhe e ketyre perfitimeve shkojne per zonat urbane.

56. Per aq kohe sa njerezit nuk do te jene ne gjendje te ndertojne jeten e tyre ne Shqiperi, ata do te vazhdojne te punojne gjetke, pavaresisht nga pengesat qe ata mund te hasin. Me shume sesa te nderpriten flukset migratore, eshte me e preferueshme qe ne rradhe te pare te gjenden zgjidhje ne lidhje me shkaqet e migrimit. Gjithashtu, eshte e nevojshme te lehtesohet udhetime dhe te

<sup>15</sup> Raporti i Zhvillimit Njerezor ne Shqiperi 2000, PNUD.

<sup>16</sup> Vleresim social per Projektin e Sherbimeve Bujqesore ne Shqiperi.

shmangen rreziqet me qellim qe njerezit te levizin lirisht dhe me kosto te ulet. Eshte evidente qe migrimi ka dy aspekte, te cilat duhet te balancohen me njera-tjetren, perpara se te arrihet ne konkluzione ne lidhje me masat qe duhen marre ne te ardhmen. Migrimi do te vazhdoje te luaje nje rol te rendesishem ne shoqeri dhe ekonomine e Shqiperise ne perspektiven afat-gjate. Masat, te cilat do te mbeshtesin zonat rurale nuk do ta nderpresin migrimin, por gjithsesi ato mund ta ngadalesojne ate, t'i bejne migrantet me produktive dhe permiresojne produktivitetin e investimeve nga dergesat.

### **Mbeshtetja ekonomike dhe sherbimet ne sektorin publik**

57. Kalimi i tokes se fermave shtetore dhe kooperativave tek ekonomite individuale, beri te mundur qe familjet ta prodhonin vete bazen e tyre ushqimore, por meqenese reformat u implementuan perpara se institucionet e duhura te tregut te ngriheshin, vetem pak prodhim mbi ate qe nevojitej per konsum vetjak mund te tregtohej. Pervec kesaj, disa prej familjeve perfituan toke te nje cilesie shume te ulet, gje qe e kufizoi si mbiprodhimin dhe prodhimin per konsum vetjak. Gjithashtu, ndermarrjet shtetore u privatizuan perpara se te ngriheshin rritjet e sigurise sociale. Skemat qeveritare te pensioneve qe ekzistonin, nuk ishin te pershtatshme dhe shpesh nuk administroheshin drejt. Per pasoje, duke qene qe njerezit mbeteshin te papune apo me punesim te pamjaftueshem dhe nuk mund te siguronin nje jetese normale nepermjet tokes se tyre, ata filluan te mbeshteten ne mekanizma te ndryshme zgjidhjeje si p.sh. dergesat nga emigrantet anetare te familjeve te tyre. Ne te njejtën kohe, infrastruktura, sherbimi shendetesor, dhe sherbimet arsimore u perkeqesuan, dhe kapaciteti i varfer i qeverise cuan ne nje shtim te kemit me dhune.

58. **Mbrojtja sociale.** Rreth 42% te familjeve ne zonen e analizuar per vleresimin cilesor te varferise, merrnin nje lloj perfitimi nga skemat e mbrojtjes sociale - nje pension, pagese papunesie apo paaftesie. Megjithate, familjet, administratoret e asistences qeveritare dhe lideret politike te gjithë jane dakort qe asistenca ekonomike e dhene nepermjet ketyre mekanizmave, eshte shume e vogel per te ndihmuar shume; shpesh ajo nuk mjafton per te mbuluar shpenzimet mujore. Gjithsesi, ajo mundeson qe disa prej kategorise te shume te varferve te blejne miell dhe bejne buke, nje racion te konsiderueshem te dietes se tyre ditore.

59. **Arsimimi.** Sipas vleresimit, pjesa dermuese e shqiptareve besonin qe cilesia e mesimdhënies ka rene gjate dhjete viteve te fundit, se nivelet e arsimimit kane rene, dhe se po shfaqet analfabetizmi, vecanerisht ne zonat rurale dhe disa vendbanime te reja gjysme-urbane. Shume prinder, mesues, administratore shkollash dhe lidera politike kane theksuar qe cilesia e dobet e mesimdhënies dhe nivelet e uleta te ndjekjes se shkolles, jane shkaqet kryesore te ketij degradimi. Numri i te regjistruarve ka rene me ndjeshem ne zonat rurale, ne krahasim me ato urbane, me perjashtim te nivelit parashkollor. Vendbanimet gjysme-urbane, shpesh te banuara nga te varfer te ardhur nga zonat rurale, jane te paracaktuara qe te kene nje nivel regjistrimi poshte atij mesatar (Berryman 2000). Analizat tregojne gjithashtu qe cilesia e shkollave reflekton ne ritmet e regjistrimit, duke e ulur shkallen e frekuentimit te shkolles edhe me tej ne zonat rurale.

60. **Sherbimi shendetesor.** Cilesia e sherbimit shendetesor dhe aksesit per te ishin ceshtje te rendesishme per shqiptaret ne zonen e studiuar. Pothuajse rreth 80% u shprehen qe shendetit i tyre ishte nga niveli mesatar ne shume te mire, dyfishi u shprehen qe shendetit i anetareve te tyre te familjes ishte perkeqesuar qe prej 1990 dhe me pas ai ishte permiresuar. Rreth nje e treta e te intervistuarve ndjenin qe pamundesia per te perfituar perkujdes shendetesor per anetaret e tyre te familjes, perbente nje problem te madh ne jeten e tyre te perditshme. Mungesat ne personelin e kualifikuar shendetesor, pajisje dhe aksesit ne personelin mjekesor dhe ilace, ishin problemet me te evidentuara nga fokus-grupet dhe pjesemarrjesit e intervistuar. Per rrjedhoje, semundjet qe lidhen mungesen e kujdesit parandalues dhe higjenes, po shtohen, ashtu sikurse edhe ato qe lidhen me mungesen e ushqimit dhe ujit te pijshem. Shendetit dhe kushtet e kujdesit shendetesor jane me te keqija per ata qe qendrojnë ne nivelin e fundem social-ekonomik, per ata pa akses ne infrastrukturen baze si psh. sistemet e ujit, kanalizimeve, dhe ata qe ndodhen shume larg qyteteve.

### Mjedisi dhe burimet natyrore

61. Degradimi i burimeve natyrore në Shqipëri është një pengesë e rëndësishme afat-gjate për zhvillimin e sektorit. Problemet përfshijnë: (a) shpyllezimin e pakontrolluar; (b) numrin e madh të gjese se gjalle dhe për pasoje dhe mbishfrytezimin e kullotave, vecanerisht në zonat malore; (c) erozioni i tokës dhe degradimi nga prodhimi bujqësor në tokat jo të favorshme, kryesisht në zonat kodrinore dhe malore me reliev të thyer përpara rënies së regjimit të vjetër; (d) humbja e tokës pjellore nepermjet urbanizimit të shpejtë; (e) zvogëlimi i burimeve detare të peshkimit; (f) degradimi i burimeve ujore dhe pellgjeve ujore; dhe (g) ekspozimi në rritje ndaj demeve nga permbytjet.

62. Tokat kanë marrë shumë pak pleherim që prej 1991, duke çuar në një rënie të përmbajtjes organike, nitrogjen dhe potas, krahasuar me 20 vjet më parë. Mbjellja jo e pershtatshme, praktikat joeficiente të kultivimit si dhe praktikat e dobëta të konservimit të tokës kanë ndikuar në degradimin e saj. Përveç rënies së pjellorise së tokës, kjo e fundit po e humbet aftësinë për të mbajtur ujin, dhe po bëhet gjithnjë e më shumë e ekspozuar ndaj barerave të keqja dhe semundjeve të bimëve. Afërsisht 200,000 ha vlerësohen të jenë prekur në këto mënyra, pjesa më e madhe e të cilave ndodhet në zona bregdetare me potenciale të larta prodhuese. Një sasi e konsiderueshme e tokës kullote është kthyer në bujqësore duke rënë nga 700,000 ha që ishte në vitet '60 në rreth 400,000 në ditët e sotme, duke çuar në një reduktim të furnizimit me baze ushqimore për blegtorinë si dhe një rritje të tokës së punueshme marxhinale.

63. Edhe shkalla e erozionit të tokës është rritur, vecanerisht për tokat më pak pjellore si dhe në ato kodrinore dhe malore dhe shfaqet si: (a) erozion i sipërfaqes, (b) erozion i bregdetit, (c) erozion i shtratit të lumenjve, (d) në transportimin e zhavorrit, dhe (e) varferimi i pjellorise së tokës. Faktoret kryesorë që shkaktojnë erozionin janë të karakterit gjeo-klimatik<sup>17</sup> dhe njerezor<sup>18</sup>. Një studim i kryer nga Instituti i Kerkimeve të Tokës (IKT), vlerëson që humbja e sipërfaqes së tokës shkaktuar nga erozioni është nga 20 deri në 70 t për ha në vit dhe në disa raste edhe 100 t/ha/vit. Me shumë se 60 miliona ton lende e ngurte<sup>19</sup> merret nga lumenjtë çdo vit për t'u transportuar dhe shkarkuar në det. Njëzet përqind e tokës në Shqipëri është e predispozuar të gërryhet në një masë me shumë se 5t/ha/vit. Shtatëdhjetë përqind e territorit gërryhet në masën 30 t/ha/vit. Vetëm 10% e sipërfaqes së tokës është më pak e infektuar nga ky fenomen, që do të thotë se humbet më pak se 15t/ha/vit. Raporti i IKT tregon që degradimi dhe shkatërrimi janë edhe më shqetësues, pasi rreth 100,000 ha tokë bujqësore është aktualisht në proces shndërrimi në tokë të pakultivueshme, shkaktuar nga pjelloria e ulët dhe mungesa e pronarëve. Zonat më të prekura nga erozioni, nga pikepamja e mjedisit, identifikohen si më poshtë (Raporti Shtetëror për Mjedisin 97/98):

Zona A (Shkodra, Tropoja, Saranda, Gjirokastra) - 52 ton/ha/vit

Zona B (Berati, Tirana, Durrësi, Lushnja, Elbasani, Kruja) - 37ton/ha/vit

Zona C (Korca, Pogradeci, Kolonja, Devolli, Librazhdi, Dibra) - 15ton/ha/vit

64. Degradimi i pyjeve po ndodh për tri arsye kryesore. Së pari, pyjet e lisit po degradojnë kryesisht prej mbledhjes së ekzagjeruar të drurit për ngrohje, mbishfrytezimit për arsye kullotjeje, dhe shfrytezimit iracional të bimesise që përdoret për ushqim blegtorie. Dy problemet e fundit kanë ardhur si rezultat i rritjes së numrit të kafsheve ripertypese. Së dyti, pyjet me produktivitet më të lartë vuajnë nga një shfrytezim jo i ligjshëm për motive tregtie, e shoqëruar kjo edhe me një rënie të konsiderueshme të cilesise së drurit, vecanerisht që prej fillim viteve '90. Së treti, në vitet '60, shteti i asaj kohe i shndërroi pyjet në tokë bujqësore, pjesa dërrmuese e së cilës është sot jo produktive. Situata sot karakterizohet nga një shpyllezim me ritme të shpejta (apo shfrytezim) i

<sup>17</sup> Lartësia mbi nivelin e detit, terreni malor, reshjet në shpatat e zhveshura.

<sup>18</sup> Shpyllezimi, ujitja pa kriter, rënia e konsiderueshme e investimeve për të mirëmbajtur tokën bujqësore, zjarret neper kullota dhe pyje.

<sup>19</sup> 1,200,000 ton humus, 100,000 t kripera nitrati, 60,000 t kripera fosfori dhe 16,000 t kripera potasi.



lendes drusore cilesore dhe degradim ne potencialet prodhuese te pyjeve dhe ekosistemeve kullotore. Burimet pyjore kane pesuar nje renie te konsiderueshme gjate dhjete viteve te fundit si pasoje e kalimit te vendit ne ekonomine e tregut. Ne disa zona, siperfaqja e pergjithshme pyjore eshte zvogeluar ne mesatarisht 15% ne nje hark kohor pesevjecar, me shkalle te ndryshme zvogelimi ne varesi te llojeve te pyjeve. Ky degradim i burimeve, qe perfshin prerjen e pakontrolluar te pyjeve dhe shfrytezim iracional per kullota, eshte ne vecanti i pranishem ne zonat qe jane afer fshatrave dhe komuniteteve, duke e bere presionin e njerezve ndaj pyjeve, shkakun kryesor te perkeqesimit te tyre. Paralel me degradimin e pyjeve dhe kullotave, ka ndodhur edhe tkurrja ne mase te konsiderueshme e investimeve ne drejtim te menaxhimit te pyjeve pas mesit te viteve '80, per t'u nderprere praktikisht ne vitet '90 si rezultat i zvogelimit te burimeve te akorduara per administraten e pyjeve. Produktet pyjore jodrusore nga Shqiperia jane te mirenjohura per cilesine e tyre te larte. Kontratet me industrite farmaceutike ofrojne burime te konsiderueshme te ardhurash. Me shume se 7,400 tone produkte pyjore jodrusore me nje vlere prej 9.9 milione USD u eksportuan vetem ne vitin 2002.

65. Qe ne vitet e para te tranzicionit, sasi te konsiderueshme druri jane prere ne menyre ilegale. Aktivitete te tilla te paligjshme kane shkaktuar dhe vazhdojne te shkaktojne deme serioze ekonomike dhe mjedisore. Ne terma ekonomike, impakti i prerjeve te paligjshme ka cuar ne humbjen direkte te te ardhurave per shtetin, deformim te tregut pasi lenda drusore e prere ilegalisht shitet poshte cmimeve dysheme, si dhe humbje indirekte te te ardhurave, pasi jo e gjitha lenda drusore e nxjerre per shitje, arrin te shitet. Bazuar ne nivelin e vleresuar te konsumit qe eshte rreth 4.3 m per familje, jane konsumuar si lende djegese nga familjet rurale gjate vitit 2000, 1.6 milione m<sup>3</sup>. Rreth 12% e familjeve rurale e sigurojne lenden drusore pa paguar. Pjesa dermuese sigurohet nga prerjet e paligjshme, duke nxjerre konkluzionin qe gjate vitit 2000, me shume se 190,000 m lende drusore djegese eshte prere ilegalisht nga familjet rurale. Po ashtu, vleresohet qe me shume se 33,000 m dru eshte prere ilegalisht nga familjet rurale per nevoja ndertimi apo rindertimi te shtepive, dyqaneve dhe fermave te tyre. Bazuar ne volumin zyrtar te prerjeve te paligjshme per vitin 1999, (72,606m), demi i drejtperdrejte ekonomik si pasoje e mospagimit te tarifave te aplikueshme, kapte shifren 13.8 milione leke. Pavaresisht permiresimeve gjate pese viteve te fundit, gjendja mbetet serioze, pasi nje sasi e konsiderueshme druri perftohet me shume ilegalisht sesa legalisht. Humbjet per ekonomine jane te medha dhe te ardhurat e siguruara nuk jane per pasoje ne gjendje qe te mbulojne kostot per operacionet pyjore. Kerkohet vemendje e vazhdueshme, sidomos ne rrethet ku ka shenja te qarta te intensifikimit te prerjeve te paligjshme, si p.sh. Bulqiza, Skrapari, Pogradeci, Kukesi, Mati dhe Malesia e Madhe.

66. Permytjet perbejne gjithashtu nje problem ne rritje, sidomos ne zonen verilindore te Shqiperise, ku menaxhimi i rrjedhjeve ujore eshte shume i dobet dhe infrastruktura kulluese eshte ne perkeqesim. Siperfaqja e pergjithshme ne rrezik permytjeje eshte me shume se 40,000 ha. Ekziston nje lidhje rastesore ndermjet shpyllezimit, shfrytezimit pa kriter per kullota erozionit, dhe permytjeve, te cilat shtohen si rezultat i mirembajtjes se dobet te kanaleve kulluese dhe stacioneve te pompimit. Nje element tjetër qe i ka shtuar permytjet eshte edhe nderprerja e programit te kontrollit te lumenjve, i cili ne te shkuaren financohej nga publiku. Mbushja me rere e rezervuareve eshte nje rezultat tjetër i ketij erozioni dhe permytjeje, me nje impakt negativ ne potencialet hidroelektrike dhe ujitesë te Shqiperise.

67. Burimet e peshkimit ne ujerat e kripera dhe te embla menaxhohen shume dobet, por gjithsesi kane potenciale te mira ekonomike. Ujerat shqiptare gjithnje e me shume po shfrytezohen nga varka te huaja peshkimi, te licencuara dhe te palicencuara, si dhe nga flota vendase e peshkimit, te gjitha se bashku duke ushtruar nje presion ne rritje ne drejtim te zhvendosjes se tregut te peshkut jashte Shqiperise. Per pasoje, shenja te dukshme jane vene re ne drejtim te mbishfrytezimit te burimeve peshkore bregdetare ne zonat prane detit. Sasia e zenieve per njesi ka rene si dhe sasia e peshkut e zene nga peshkataret eshte zvogeluar. Megjithate, sektori i peshkimit ende ka mundesi te rendesishme ekonomike me nje potencial per eksporte te qendrueshme qe vleresohet rreth 30 milione USD ne vit. Shqiperia disponon shume pak

informacion shkencor te besueshem dhe kapacitete institucionale per te lehtesuar vleresimin e tregut te peshkut te fresket, si nje parakusht per menaxhim efektiv te ketij burimi. Gjithashtu, Shqiperise i mungon kapaciteti per te arritur rendimente te qendrueshme peshkimi.

68. Shqiperia ka ndertuar nje legjislacion te plote per Mbrojtjen e Mjedisit, qe perben edhe ligjin kryesor per menaxhimin e mjedisit<sup>20</sup>. Ligji parashikon qe mbrojtja e mjedisit perben nje parakusht per zhvillim te qendrueshem te shoqerise, si nje prioritet kombetar. Elemente te rendesishme strategjike jane parandalimi dhe reduktimi i ndotjeve; ruajtja e diversitetit biologjik; menaxhimi racional i burimeve natyrore dhe shmangia e mbi-shfrytezimit; rehabilitimi i siperfaqeve te demtuara si nga nderhyrjet njerezore ashtu edhe nga fatkeqesite natyrore; ruajtja e ekuilibreve ekologjike; dhe ruajtja apo permiresimi i standartit te te jetuarit. Ligji thekson gjithashtu, nevojen per nje vleresim te ndikimit mjedisor mbi te gjitha aktivitetet. Ne fillim, ishte Komiteti per Mbrojtjen e Mjedisit, brenda Ministrise se Shendetesise, ai qe ishte pergjegjes per zbatimin e ketij ligji, por pas nje amendimi te ligjit ne 1998, u krijua Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM), e cila me pas u ngrit ne nivelin e nje Ministrie Mjedisit ne vitin 2001<sup>21</sup>.

69. E ndersa behen rregullime ne kuader te implementimit te mbrojtjes se mjedisit, fuqizimi dhe zbatimi i legjislacionit ekzistues provon te jete shume i veshtire. Per pasoje, dhunimet e mjedisit si p.sh. peshkimi mbi kuotat e lejuara, prerjet e paligjshme dhe ndotja e ujit, shpesh nuk kontrollohen. Gjithashtu, mungojne norma per pergatitjen e vleresimeve te impaktit mjedisor, gje qe pengon pergatitjen dhe rishikimin e dokumentave te tille. Shqiperia ka rreth 15 OJQ mjedisore, te gjitha te krijuara pas viteve '90. Roli i tyre paresor eshte qe te nxisin ndergjegjesimin publik dhe pjesemarrjen ne mbrojtjen e natyres dhe biodiversitetit, dhe ne fakt ato kane ardhur duke i shtuar aktivitetet e tyre me mbeshtetjen kryesisht te donatoreve te huaj dhe nje numri donatoresh vendas. Zgjerimi gradual i aktiviteteve te tyre ka krijuar bazen per krijimin e nje Forumi te OJQ-ve te Mjedisit, per ta cuar me tej punen e tyre. Si konkluzion, levizja mjedisore mbetet ende e dobet dhe impakti i saj ne shoqeri dhe publik eshte i kufizuar.

## 2.2 GJENDJA DHE ZHVILLIMI AKTUAL- KUADRI STRUKTUROR

### Kuadri nxitës - Klima makro-ekonomike

70. Pas zgjedhjes se qeverise se re ne 1998, u ruajt nje kuader i mire makro-ekonomik. Qeveria u perpoq te reduktonte deficitin buxhetor nepermjet kufizimit te shpenzimeve dhe rritjes se te ardhurave prej taksave. Te ardhurat nga taksat ishin 17% e GDP ne vitin 2000, ndersa pritet te rriten ne 22.3% gjate 2001. Politika monetare e shtrenguar ka cuar ne uljen e inflacionit ne pothuajse 0%, dhe monedha vendase ka ardhur duke u forcuar qe prej 1998. Per pasoje, eshte kthyer rritja ekonomike, me ritme te rritjes se GDP nga 7 ne 8% qe prej 1998. (7.28% ne 2001).

71. Menaxhimi fiskal eshte perqendruar ne reduktimin e deficitit buxhetor nepermjet rritjes se te ardhurave, fale nje administrate te permiresuar fiskale dhe zgjerimit te bazes se taksimit, duke permiresuar kontrollin mbi shpenzimet, dhe duke shtuar planifikimet dhe parashikimet per buxhetin. Permiresimet ne pozicionin e jashtem te ekonomise do te fokusohen ne reduktimin gradual te deficitit ekzistues dhe ruajtjen e rezervave ne valute ne nje vlere ekuivalente me ate te kater muajve aktivitet importues.

72. Shqiperia ka bere nje progres te konsiderueshem ne aspektin e reformave ligjore qe mbeshtetin kuadrin makro-ekonomik. Ndermjet reformave me te spikatura, eshte privatizimi i tokes, te cilin qeveria e aplikoi ne fillim te periudhes se tranzicionit. Reforma e tokes ndihmoi

<sup>20</sup> Ligji per Mbrojtjen e Mjedisit (no. 7664, 21 Janar 1993), i cili mbulon pyjet dhe kullotat. Kerkohen vleresime te ndikimit te mjedisit dhe licencave per aktivitetet qe mund te kene nje ndikim te rendesishem mbi mjedisin.

<sup>21</sup> Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit ka ngritur nje Njese te Menaxhimit te Mjedisit brenda Departamentit te Pyjeve, per te trajtuar ceshtje qe dalin ne pah nga Projekti i Pyjeve i financuar nga B.B. Ne te ardhmen, kjo njese mund te behet nje njese e vecante mjedisit brenda Ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit.

per te pershpjtuar rritjen e pergjithshme, bazuar, pjeserisht ne perfitimet nga rritja e prodhimit, si rezultat i numrit te madh te ekonomive private.

73. Shqiperia ka shenuar ritme te shpejta te zhvillimit te tregtise gjate periudhes se tranzicionit. Vlera totale e eskporteve u rrit nga 70 milion USD ne 1992, ne 275 milion USD ne 1999, ndersa importet u rriten nga 541 milione USD ne 1.12 miliarde USD gjate se njejtës periudhe. Deficiti tregtar eshte eliminuar pjeserisht nga dergesat qe vijne nga 300,000 shqiptare qe punojne jashte. Vendet e BE jane parneret kryesore tregtare, sidomos Italia dhe Greqia, te cilat zene 83% te eskporteve dhe sigurojne 65% te importeve. Struktura e tregtise ka ndryshuar ne menyre radikale si rezultat i liberalizimit te politikës tregtare, qe perfshin edhe anulimin e kuotave te importit. Kategoria me e rendesishme e eksporteve jane produktet qe realizohen prej nje pune intensive si p.sh. prodhimet tekstile dhe kepucet, duke reflektuar edhe avantazhin e dukshem qe Shqiperia mbart ne drejtim te kostos se lire te fuqise punetore. Rreth 2/3 e eksporteve jane rieksperte. Firmat shqiptare, te cilat veprojne si nen-kontraktuese per firmat e huaja, kryesisht perendimore, importojne lenden e pare dhe eksportojne me pas produktin e perfunduar. Produktet bujqesore ne kuptimin me te gjere, perfshire ato ushqimore, pijet, duhanin dhe prodhimet nga perimet, perbejne rreth 10% te vleres totale te eksporteve. Megjithate, eshte nje konkluzion i pergjithshem qe eksportet e produkteve bujqesore mund te ishin me te rendesishme, vecanerisht eksportimi i frutave dhe perimeve qe piqen heret, vajit cilesor te ullirit, vererave dhe produkteve te tjera te rrushit, si dhe bimeve mjekesore, me kusht qe te permiresohet paketimi dhe marketingu. Barrierat per tregtine ekzistojne me disa vende fqinje si Kroacia, megjithese se fundi jane hequr kufizime nga BE. Kategorite kryesore te tregtise jane permbledhur ne Tabelen 7.

74. Nje nga synimet me afat-gjata te Shqiperise eshte anetaresimi ne BE, ndersa nje objektivi strategjik i Ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit eshte harmonizimi i politikave bujqesore me ato te BE. Per te ndihmuar vendet e Europes Juglindore perfshire edhe Shqiperine, BE ka vendosur Marreveshjet per Asocim-Stabilizim, per t'i afruar keto vende gradualisht drejt ketyre strukturave europiane<sup>22</sup>. Ne menyre te vecante, po behen perpjekje per te reformuar Administraten e Doganave dhe zhvilluar nje kuader legjislativ ne nje linje me standartet e BE. Standartet dhe rregullat e cilesise ushqimore jane te rendesishme per te zhvilluar me tej eksportet.

**Tabela 7. Kategorite kryesore te tregtise se mallrave, 2000 (USD; fob)**

Kategoria	Eksportet	Importet	Bilanci
Tekstike dhe veshmbathje	177.7	128.5	
Produkte minerare	7.4	141.7	
Metale baze	21.5	83.8	
<b>Produkte ushqimore, pije alkolike dhe duhan</b>	13.7	97.6	
	12.1	90.7	
	4.4	148.0	
Produkte perimesh	<b>255.9 a/</b>	<b>1,079.5</b>	<b>-823.6</b>
Makineri dhe pajisje			
<b>Total</b>			

Burimi: *Banka e Shqiperise, Buletini per Tregtine me Jashte, ne EIU Country Profile 2002*

a/ Perfshin 183.3 milionUSD ri-eksporte.

75. Shqiperia eshte bere anetare Organizates Boterore te Tregtise (OBT) ne shtator 2000. Kjo mbart nje detyrim per te ruajtur nje politike te hapur tregtare dhe vendosur nivele tarifore te detyrueshme. Duke patur parasysh masen ne te cilen jane liberalizuar politikat tregtare dhe te

<sup>22</sup> Aneksi II pershkruan Paktin e Stabilitetit dhe rendesine e tij per Shqiperine.

vendosjes së cmimeve, anetaresimi në OBT me shumë do të konsolidojë reformat e mëparshme në fushën e politikave, sesa do të promovojë reforma të mëtejshme. Hyrja në OBT do të ndihmojë gjithashtu edhe në ligjerimin e politikës ekzistuese liberale të tregtisë dhe do të konsolidojë rezistencën kundër presioneve nga brenda Shqipërisë për të rritur mbrojtjen.

76. BE akordon koncesione tregtare për vendet jo-anetare, pasi promovimi i tregtisë me rajone të ndryshme rrit avantazhet ekonomike për të dy partneret. Në Shtator 2000, BE akordoi masa të vecanta për një tregti autonome, të cilat liberalizojnë me shumë se 95% të tregtisë së BE me vendet Ballkanike. Shqipëria përfiton prej këtyre preferencave tregtare.

77. Në 27 Qershor 2001, Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia dhe Republika Federale e Maqedonisë dhe Rumania, nënshkruan një Memorandum Mirekuptimi (MM) për Liberalizimin dhe Lehtësimin e Tregtisë. MM synon të rrisë volumin e tregtisë rajonale dhe ndërkombëtare, të përmirësojë kapacitetin rajonal për të tërhequr investime të huaja të drejtperdrejta dhe intensifikojë integrimin e rajonit në strukturat Europiane dhe ekonomine globale. Parimet e Memorandumit janë që të perfundohet nënshkrimi i një rrjeti marreveshjes dypalëshe për tregtinë e lirë gjatë 2002, dhe të liberalizohen të paktën 90% e tregtisë ndërmjet paleve, në një periudhë tranzitore prej gjashtë vjetësh. Marreveshjet do të përfshijnë edhe klauzola për liberalizimin në të ardhmen të shërbimeve dhe harmonizimin e legjislativës në fushën e doganave, fito-higjenes, vlerësimit të standarteve dhe përafrimit të tyre, konkurrencës, dhe pasurisë intelektuale.

### ***Bashkimi Europian në pozicionin e një fqinj***

78. Lidhja me Bashkimin Europian (BE) ka dy aspekte: BE është një donator kryesor për Shqipërinë, duke dhënë asistencë në fusha të ndryshme si dhe një fqinj gjigand dhe partner tregtar me ndikime të rëndësishme në migrim, tregjet e importeve dhe eksporteve dhe rregullat tregtare. Të dyja aspektet do të kenë një influencë të madhe për të ardhmen e Shqipërisë.

79. Asistenca e BE. Në periudhën ndërmjet 1991 deri 1999, BE ofroi asistencë të konsiderueshme financiare dhe teknike për pesë vende të Europës jug-lindore, asistencë e cila kapte vlerën 4.5 miliardë Euro, nga të cilat 1 miliardë për Shqipërinë. Qëllimi i përgjithshëm i asistencës së BE ishte të përmirësoheshin kushtet e jetesës së popullsisë. Objektiva të vecanta të BE janë: (a) t'a afronte Shqipërinë pranë standarteve dhe parimeve Europiane, dhe t'a përgatiste për një integrim gradual në strukturën e BE dhe kuadrin e Stabilizimit dhe Asocimit; (b) të ndihmonte autoritetet Shqiptare në konsolidimin e demokracisë dhe zbatimin e ligjit; (c) të lehtësonte transformimin ekonomik dhe social drejt një ekonomie eficiente tregu.

80. Pjesa e madhe e asistencës së BE është kanalizuar nëpërmjet programit BE-PHARE<sup>23</sup>. Në 10 maj, 2000, BE adoptoi një propozim për një program të asistencës për vendet e Ballkanit Perëndimor (CARDS)<sup>24</sup>. Ky program siguron asistencë për të gjithë rajonin mbi një bazë ligjore dhe vendosjen e procedurave uniforme. Objektivat kryesore janë mbështetja e pjesëmarrjes së vendeve përfituese në Procesin e Stabilizimit Asocimit (instrumenti kryesor i BE në rajon) si dhe arritja e bashkëpunimit të ngushtë rajonal<sup>25</sup>.

81. Asistenca e ardhshme e BE për Shqipërinë do të vazhdojë të përqendrohet në reformat në administratën publike dhe për shtetin e së drejtës, me synimin e qarte për të ndihmuar vendin në përmirësimin e kushteve të shtruar për Procesin e Stabilizimit dhe Asocimit. Përpjekje të konsiderueshme do të vazhdojnë në programet e infrastrukurës dhe të bashkëpunimit ndërkufitar

<sup>23</sup> Programi Phare u krijua në dhjetor 1989 sipas Rregullores së Këshillit (EEC) No. 3906/89 (OJ L 375, 23.12.1989) për të mbështetur procesin e reformave në Poloni dhe Hungari dhe prej aso kohe ai u zgjerua për Bullgarinë, Çekosllovakinë, Rumaninë, Shqipërinë, Estoninë, Letoninë, Lituaninë, Slloveninë, Bosnje-Hercegovinën dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

<sup>24</sup> Asistenca Komuniteti për Rindërtim, Demokratizim dhe Stabilizim.

<sup>25</sup> Asistenca do të sigurohet për (i) rindërtimin dhe stabilizimin e rajonit; (ii) mbështetje për demokraci, shtetin e së drejtës, të drejtat njerezore dhe minoritetet; (iii) zhvillim ekonomik dhe reforma të orientuara drejt ekonomisë së tregut; (iv) zhvillim i marrëdhënieve me të ngushta ndërmjet vendeve të BE si dhe atyre aplikuese.

(cross-border). Përveç kësaj, do të inkurajohen përpjekjet për demokratizim, shoqëri civile dhe zhvillim lokal. Komisioni Europian po fillon përgatitjen e Marrëveshjes së Asocim Stabilizimit me Shqipërinë.

82. BE është e angazhuar në shumë sektore të ekonomisë Shqiptare. P.sh. ajo siguron asistencë për fuqizimin e administratës publike dhe gjyqësorit, për përmirësimin e gjykatave, dhe për rritjen e profesionalizimit të shërbimit civil. Ajo ndihmon gjithashtu policinë dhe rendin publik duke ofruar keshillim, trainim dhe mjete logjistike, si dhe shërbimet doganore duke siguruar të ardhurat dhe përmirësuar menaxhimin e doganave. Ajo ofron asistencë edhe për Institutin Kombëtar të Statistikave si dhe mbështet zhvillimet në infrastrukture. BE përfshihet gjithashtu edhe në programet komunitare. Në sektorin bujqësor, ajo siguron mbështetje për hartën e tokës, zhvillimin e peshkimit, kontroll veterinar dhe keshillim në aspektin e politikave. Nga ana tjetër, BE angazhohet në programet e bashkëpunimit ndërkufitar, asistencën në fushën e aresimit, dhe demokracisë, të drejtave humane dhe asistencës humanitare.

83. Shqipëria do të lidhet gjithnjë e më shumë me tregjet e BE dhe ato rajonale. E ndërsa kjo do të jetë pozitive në parim, Shqipëria mund të mos jetë sot në gjendje për të vjelë të gjitha frutet që burojnë nga këto marrëveshje të gjera tregtie. Një nga arsyt është se ajo është në konkurrencë me vende fqinje si Maqedonia dhe Greqia, të cilat në vecanti në aspektin e produkteve bujqësore, janë më të përparura në sistemet e tyre të prodhimit, dhe mund të prodhojnë mallra me kosto më të ulët dhe/ose me çilesi më të lartë. Për rrjedhojë, Shqipëria duhet të konsolidojë prodhimin e saj dhe sektorin e përpunimit, paralel me gjetjen e tregjeve të pershtatshme si në rajon ashtu edhe dhe BE. Megjithatë, iniciativat ekzistuese për rajonizimin e regjimeve tregtare do të jenë padyshim të dobishme për Shqipërinë.

#### **Kutia 1. Marrëdhëniet ndërmjet BE dhe Shqipërisë në dekadën e fundit**

- 1992: Marrëveshja për Tregtine dhe Bashkëpunimin ndërmjet BE dhe Shqipërisë bëhet efektive per financim në kuadër të programit të BE.
- 1997: Metoda rajonale. Keshilli i Ministrave i BE vendos kushtet politike dhe ekonomike për zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe.
- 1999: BE propozon një Proces të Ri Asocimi dhe Stabilizimi (PAS) për pesë vende të Europës Juglindore, përfshirë Shqipërinë.
- 1999: Shqipëria përfiton nga Preferencat për Tregti Autonomë me BE.
- 2000: Zgjerimi i aksesit në përjashtimin nga taksat në tregun e BE, për produktet nga Shqipëria.
- 2000: Keshilli I Europës thekson që këto vende janë kandidatë potenciale për anëtarësim në BE.
- 2001: Viti i parë i programit të ri CARDS, i konceptuar në mënyrë të posaçme për vendet e Europës Juglindore.
- 2001: Komisioni konkludon që tashmë është e pershtatshme për të vijuar me Marrëveshjen e Asocim Stabilizimit me Shqipërinë dhe të prezantohen draft-direktivat për negociatat.

#### **Kuadri i politikave rurale**

84. Kuadri i politikave për sektorin bujqësor është relativisht pa deformacione, pa asnjë lloj kontrolli në cmime, subvencione të kufizuara dhe një politikë liberale tregtare. Reformat gjatë periudhës së tranzicionit përfshinin shpërndarjen e tokës bujqësore, gjese se gjalle dhe asetëve të tjera të fermave shtetërore dhe kolektive, dhe privatizimin e pjesës dermuese të ndërmarrjeve tregtare dhe agro-përpunuese. Për pasojë, sektori bujqësor dominohet sot nga sektori privat.

85. Regjimi tregtar dhe cmimet e produkteve u liberalizuan në fillim të procesit të reformave, duke i lënë cmimet të percaktoshin nga tregu. Liberalizimi i cmimeve të prodhimit dhe konsumit për të gjithë produktet ushqimore dhe bujqësore u perfundua në vitin 1996, kur cmimet

e grurit dhe bukes u ndryshuan. Përveç kesaj, subvencionet nga tarifatat e importit për grurin dhe miellin u ndërprehen në fillim të 1998. Për rrjedhojë, cmimet mesatare sot reflektojnë kërkesën dhe oferten dhe kanë mbetur shumë të qëndrueshme që prej 1997<sup>26</sup>.

86. Subvencionet janë kufizuar edhe për ujin që perdoret për qëllime vaditjeje. Këto subvencione u ndërprehen në vitin 2000, por disa prej tyre, këtu këtu të kufizuara, u ripërshpënë në buxhetin e 2001. Skemat e ujitjes aktualisht po kalojnë nga sisteme publike në private, me Shoqatat e Përdoruesve të Ujit (ShPU) dhe Federatat e ShPU, të cilat marrin gradualisht përgjegjësinë për shpërndarjen dhe mirëmbajtjen e ujit nga Ndermarjet e Ujit në rrethet (shih Paragrafin C).

87. Shqipëria nuk ka asnjë kufizim apo kuote për eksportet dhe importet. Përveç kesaj, tarifatat për importet janë thjeshtuar dhe ulur këtu kohët e fundit. Politika ekzistuese tregtare sot bazohet në tre tarifa baze për importet 5%, 10% dhe 15 % në varesi të llojit të produktit. Teorikisht, lenda e parë e papërpunuar përfshirë importet për kulturat bujqësore dhe gjene të gjalla, kanë një tatim prej 5%, materialet gjysmë të përpunuara tashmë 10%, dhe materialet plotësisht të përpunuara si produkte ushqimore, makineri bujqësore, plehëra dhe agro-kimikate janë subjekt i shkallës më të lartë të tatimit prej 18%. Në drejtim të eksporteve nuk ka as subvencione dhe as kufizime.

88. Politika e hapur tregtare që në një rritje të eksporteve, me eksport të produkteve bujqësore në rritje nga 23.3 milionë USD në vitin 1994 dhe me kulmin e tyre prej 35.7 milionë USD të regjistruar në 1996. Eksportet rënë në 1997, si pasojë e trazirave civile, dhe ende nuk i kanë kapur nivelet e 1996. Në fakt, eksportet bujqësore rënë lehtësisht nga 32.8 milionë USD në 1998 në 28.2 milionë në 1999, ndoshta si pasojë e krizës Kosovare dhe një nevojë në rritje për të ndihmuar një numër të konsiderueshëm refugjatësh që gjendeshin në Shqipëri. Eksportet kryesore bujqësore janë frutat, perimet dhe ullinjat (36% në 2000); dhe peshku dhe produktet e tjera të detit me guacka (19% në 2000). Eksportet në blegtori janë minimale dhe në vitin 2000, ato përbenin vetëm 1.4% të totalit. (Aneksi III, Tabela 8).

89. Importet e produkteve bujqësore dhe ushqimore janë shumë më të larta sesa eksportet, me vlerën 226.6 milionë USD, pothuajse tetëfishi i vlerës së eksporteve prej 28.7 milionë USD në vitin 2000. (Aneksi III, Tabela 9). Importet kryesore të produkteve bujqësore janë frutat dhe perimet (13% në vitin 2000); gruri dhe drithërat e tjera (11% në 2000); gjëja e gjallë dhe produktet blegtorale (9% në vitin 2000); plehërat (2.3% në vitin 2000); dhe produktet e përpunuara përfshirë sheqerin, miellin, dhe produktet e përfuara nga frutat dhe perimet (në vitin 2000, 10%, 11%, dhe 11% respektivisht). Këtu shifra flasin për disa mundësi në drejtim të rritjes së prodhimit vendas, vecanerisht për frutat, perimet dhe produktet blegtorale, nëse përmiresohet cilësia dhe paketimi. Gjithsesi, një rritje e prodhimit vendas për grurin dhe sheqerin, nuk ka të ngjarë të jetë financiarisht dhe ekonomikisht e qëndrueshme. Vlera e importeve u rrit ndjeshëm nga 1997 deri në 1998, ndoshta e ndikuar nga kriza kosovare, ndërsa sot nivelet duken të jenë të stabilizuara.

90. Politikën makro-ekonomike të shoqëruara me rritje ekonomike, e bene bujqësive t'i përgjigjej në mënyrë efektive reformes së tokës, privatizimit, dhe liberalizimit të cmimeve dhe tregjeve vendase gjatë fillimit periudhës së tranzicionit. Rritja e fuqishme ekonomike që në rritjen e kërkesës për produkte bujqësore, dhe stabiliteti ekonomik bëri që fermeret t'i vlerësonin më mirë ndryshimet në cmime dhe iu përshtatën më mirë vendim-marrjes në kushtet e ekonomisë së tregut. Si rrjedhojë, ritmet e rritjes së sektorit bujqësor, të cilat mesatarisht e kalonin masën 10% gjatë periudhës nga 1992-1996, shkuan paralel, dhe madje në disa raste i kapërcyen ritmet e rritjes së GDP në teresi. Për më tepër, duke qenë që bujqësia zinte më shumë se 50% të GDP, ajo ofronte një rrjet të vlefshëm të sigurisë sociale dhe një mjet për zbutjen e e shkallës së lartë të papunësisë, e cila rezultonte nga ristrukturimi ekonomik.

<sup>26</sup> Tendencat tek cmimet e prodhimit dhe pakicës për mallrat kryesore bujqësore pasqyrohen në Aneksin III, Tabela 6 dhe 7.

91. Ne 1997, rritja negative ne sektorin bujqësor reflektoi permbysjen e pergjithshme ekonomike te ketij viti. Megjithate, pas rikthimit te stabilitetit ne 1998, bujqesia ka perjetuar perseri nje periudhe rritjeje, e cila ka arritur ne 5% ne vit. Kjo shifer eshte me e vogel se rritja e pergjithshme e ekonomise prej rreth 7-8% dhe mund t'i atribuohet nje serie faktoresh. Ata perfshijne: (a) aksesin e kufizuar ne kredi dhe nivelet e larta te interesit; (b) infrastruktura e varfer ne zonat rurale perfshire rruget, energjine dhe sistemet e ujitjes te cilat ende nuk jane rehabilituar ne disa zona; (c) fermat shume te vogla dhe te copezuara per te siguruar nje nivel te aresyeshem te ardhurash; (d) kufizimet ne treg dhe (e) mundesite e kufizuara per punesim jashte fermes. Ne vecanti, mungesa e nje sektori financiar plotesisht te funksionueshem dhe sherbimeve rurale financiare, mund te konsiderohen si defekti kryesor ne programin e reformes deri me sot. Pervec kesaj, aktiviteti i sektorit privat ka ende per te mbushur boshllekun e lene prej ndermarrjeve te mbyllura shteterore te perpunimit dhe tregtimit. Eshte e mundur qe keto pengesa te vazhdojne te kufizojne rritjen e sektorit bujqësor ne perspektiven afatmesme.

92. **Roli ne ndryshim i qeverisjes.** Gjate regjimit te meparshem, e gjithë toka konsiderohej prone e shtetit dhe prodhimi bujqësor realizohej ne rreth 550 ferma shteterore dhe kooperativa bujqësore. Rreth 3,000 specialiste ishin te punesuar ne keto ferma ne agronomi, zooteknike, inxhinieri bujqësore si dhe ne sektore te tjere te bujqesise brenda kontekstit te nje sistemi te komanduar. Synimi primar ishte rritja ne maksimum e rendimenteve dhe e prodhimit sipas sistemit te menaxhimit te fermave te medha. Sistemi i kerkimit ne bujqesi, i cili perbehej nga 18 institute kerkimi, plus nje numer stacionesh rajonale qe lidheshin me to, siguronte informacion baze per specialistet. Sistemi i kerkimeve ishte gjithashtu pergjegjes per prodhimin e varieteteve bujqësore, farerave te gjese se gjalle, ilaceve veterinare si dhe kerkesave te tjera te fermave. Ne 1991, ekzistonin ende 342 kerkues si dhe nje total prej 4,654 punonjesh ne keto institucione.

93. Fermave shteterore dhe kolektive u sherbenin ndermarrjet shteterore te vendosura ne secilin nga 27 rrethet, perfshire edhe ndermarrjet pergjegjese per inputet bujqësore, stacionet e makinave, pergjegjese per sigurimin e pajisjeve per fermen, dhe ndermarrjet e ujit, pergjegjese per planifikimin, ndertimin, funksionimin dhe mirembajtjen e te gjitha skemave ujtese dhe kulluese. Kooperativat bujqësore paguanin per keto sherbime bazuar ne tarifate e vendosura nga shteti. Pervec kesaj, ndermarrje te specializuara grumbullonin, magazinonin dhe shperndanin produktet bujqësore, ndersa te tjera perpunonin qumeshtin, mishin, duhanin, pambukun, sheqerin, drithin, frutat dhe perimet. Kooperativat bujqësore ishin te detyruara te dorezonin te gjitha prodhimet e tyre tek keto ndermarrje ne kembim te cmimeve te vendosura nga shteti<sup>27</sup>. Fermat dhe ndermarrjet shteterore kishin marredhenie kontraktuale te percaktuara nga nje plan shteteror, i cili kishte statusin e ligjit. Per pasoje, shteti kishte pergjegjesine per te gjitha aspektet e prodhimit, menaxhimit, perpunimit dhe shperndarjes se produkteve bujqësore. Qe prej renies se ketij sistemi, roli i qeverise ka ndryshuar krejtesisht. Prodhimi sipas sistemit te fermes dhe funksionet e menaxhimit jane tashme ne duart e fermereve te vegjel private. Si rezultat, nje nga rolet kryesore te MBU eshte qe te siguroje sherbime per keta fermere, dhe te zhvilloje politika, rregulla dhe kuader ligjor bujqësor, ne menyre qe ato te funksionojne sukseshem.

94. **Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit.** MBU siguron sherbime ne ekstension, veprimtari kerkimore, kontroll te semundjeve tek kafshet dhe mbrojtjen e bimeve. Drejtorite e MBU mbulojne Bujqesine e Pergjithshme, Kulturat Bujqësore, Shkencen dhe Ekstensionin, Mbrojtjen e Bimeve, Mbareshtimin e Gjese se Gjalle, Drejtorite Veterinare dhe ato te Pyjeve, te cilat pervec funksioneve rregulluese dhe kontrolluese, sigurojne dhe pak ekspertize teknike. Megjithate, sot stafi i MBU eshte shume i kufizuar me rreth 147 veta ne te gjithë ministrine perfshire edhe te

<sup>27</sup> Keto ndermarrje perfshinin 38 qendra blerjeje per drithin me pajisje per bluarjen dhe magazinimin; 27 thertore dhe mjedise per paketimin e mishit; 32 fabrika per bulmetin, 11 fabrika per perpunimin e vajit te lulediellit dhe 27 per ate te ullirit; 31 fabrika per konservimin e fruta/perimeve; nje kombinat sheqeri; 21 kantina te veres; 2 fabrika te prodhimit te pambukut dhe fabrika per perpunimin e duhanit.

pakten 60 veta staf joteknik. Per pasoje, jo te gjitha drejtorite jane ne gjendje te sigurojne inpute te mjaftueshme teknike, si rezultat i kufizimeve ne personel dhe detyrave te tjera.

95. Ne nivel rrethi, nje total prej rreth 750 personash jane pergjegjes per shendetin veterinar, sherbimet e ekstensionit, mbrojtjen e bimeve, blegtorine, token, ushqimin, farerat, dhe mbledhjen e statistikave. Efektiviteti i personelit eshte i kufizuar si pasoje e mungeses se buxheteve operacionale dhe transportueseve. Ne nivel komune, ekziston rreth 248 personel ekstensionit nen drejtimin teknik te Sektorit te Ekstensionit, 143 specialiste te mbrojtjes se bimeve nen drejtimin teknik te Inspektoratit te Mbrojtjes se Bimeve dhe 184 specialiste veterinare nen drejtimin teknik te Inspektoratit Veterinar. Keshtu, jo te gjitha 315 komunat e Shqiperise jane te mbuluara ne secilen prej disiplinave. Pervец kesaj, nuk ekzistojne lidhje formale ndermjet stafit te disiplinave te ndryshme si ne nivel rrethi ashtu dhe ne ate te komunes. Lidhjet qe ekzistojne jane gjeresisht te bazuara ne njohje personale.

96. **Buxheti per bujqesine dhe ushqimin.** Si pasoje e ndryshimit te rolit te MBU dhe kufizimeve buxhetore te vendosura nga nevoja per te kufizuar shpenzimet publike dhe ruajtur inflacionin ne nivele te uleta, buxheti i brendshem per MBU ka mbetur i qendrueshem qe prej 1999 ne vlere leku dhe ka rene ne vlere dollari. Buxheti total per bujqesine dhe ushqimin ka mbetur ne rreth 4.25% te buxhetit te shtetit per periudhen nga 1996-2001. Po keshtu, buxheti total per bujqesine eshte i vogel ne krahasim me madhesine e sektorit. Ne 1999, shpenzimet totale te bujqesise perfaqesonin rreth 5.9% te vleres se pergjithshme te produkteve bujqesore, dhe shpenzimet e brendshme mbulonin vetem 2.6%. Shpenzimet dhe buxheti i MBU jane te permbledhura ne Aneksin III, Tabela 10.

97. **Institucionet e mjedisit.** Ministria e Mjedisit koordinon me shume ministri dhe institucione te tjera te cilat mbulojne aspekte te vecanta te menaxhimit mjedisor. Ajo ka pergjegjesine kryesore per kontrollin dhe parandalimin e ndotjes; politikat mjedisore, legjislacionin dhe rregullat; implementimin e strategjive dhe te projekteve; menaxhimin e zonave te mbrojtura dhe biodiversitetit, vleresimin e impaktit mjedisor; dhe informacion mbi mjedisin. Institucione te tjera kombetare kane pergjegjesi te rendesishme qe lidhen me mjedisin: (a) Komisioni i Perhershem per Shendetin dhe Mjedisin brenda Parlamentit eshte pergjegjes per ambientin; (b) Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit ka nje rol te rendesishem ne administrimin, mbrojtjen, studimin dhe inventarin e Biodiversitetit; (c) Drejtoria e Pergjithshme te Pyjeve dhe Kullotave (DPPK) nen ombrellen e Ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit, eshte pergjegjese per administrimin e zonave te mbrojtura, parqeve kombetare, kafsheve te egra dhe gjuetise per argetim; (d) Njesia e Menaxhimit te Projekteve per Mjedisin (Nj.M.P.M.) brenda Drejtorise se Pergjithshme te Pyjeve dhe Kullotave, eshte pergjegjese per monitorimin e implementimit te masave zbutese; dhe (e) Drejtoria e Peshkimit eshte pergjegjese per administrimin e burimeve te faunes ujore, dhe te ujit te embel ne zona ku ka peshkim dhe akuakulture. Zhvillimi i struktures institucionale dhe i kuadrit ligjor korrespondues eshte ne nje faze te hershme, dhe koordinimi eficient ndermjet institucioneve te ndryshme kombetare eshte i kufizuar.

### **Reformat dhe iniciativat institucionale**

98. Kater reforma te rendesishme institucionale jane momentalisht ne implementim, te cilat do te ndikojne ne sektorin rural. Reformat jane me synime te mire-percaktuara dhe nese implementohen sic duhet, do te ndikojne pozitivisht ne zhvillimin e zonave rurale. Ato fuqizojne qeverisjet lokale per t'u angazhuar me drejtperdrejt ne shperndarjen e buxhetit dhe vendim-marrje, ato mbeshtetin reformat brenda MBU dhe bejne qe ajo te funksionojne ne menyre me eficente dhe me nje kapacitet me te larte, dhe mundesojne nje diskutim me te gjere ne shperndarjen e pergjithshme te burimeve qeveritare. Megjithate, reforma te suksesshme kerkojne kohe dhe progresi mund te jete i ngadalshem. Ndersa keto reforma jane iniciuar ne nje kuader te gjere, ato ngadalesohen shume ne fazen aktuale te implementimit, shpesh duke ju munguar plane veprimi me te detajuara dhe indikatore monitorimi. Shume me teper pune qendron perpara



Shqiperise, ne menyre qe keto reforma te lavderueshme te shnderrohen ne veprime, dhe akoma me shume kohe do te kaloje derisa perfitimet prej tyre te prekin popullsine rurale.

### **Kutia 2: Kater iniciativa kryesore bashkerenduese**

Kater inisiativat kryesore nderlidhese qe do te influencojne ne zhvillimin e sektorit rural ne vitet ne vazhdim jane:

- *Strategjia per Zhvillimin Ekonomik dhe Social.* Kjo strategji synon ne futjen ne veprime qe do te reduktojne varferine ne menyre te ndjeshme. Meqenese varferia eshte predominuese ne zonat rurale dhe gjysme-urbane, ajo duhet te fokusohet ne permiresimet ne hapësirën rurale. Ajo ndihmon ne krijimin e nje klime perfshires, duke iu referuar insitucioneve qeveritare si dhe shoqerise civile.
- *Programi i Buxhetit Afatmesem.* Ai synon ne: (a) permiresimin e procesit te konsultimit per formulimin e politikave buxhetore strategjike; (b) permiresimin e vendim-marrjes ne lidhje me buxhetin; (c) krijimin e nje procesi buxhetimi gjithe-perfshires, duke e lidhur ate me inisiativa te tjera te rendesishme politike si Strategjia per Rritjen Ekonomike dhe Reduktimin e Varferise dhe strategjia e decentralizimit; dhe (d) permiresimi i transparences dhe pergjegjshmerise ne menaxhimin e shpenzimeve publike. Ky planifikim pritet te rrise buxhetin e akorduar brenda Ministrise se Bujqesise dhe te permiresoje transparencen ne perdorimin e buxhetit, ndersa monitorohen impaktet.
- *Strategjia e decentralizimit.* Kjo strategji propozon nje program ambicioz per decentralizimin e pergjegjesive qe lidhen me kryerjen e sherbimeve tek qeverisja lokale. Nese strategjia do te implementohet me sukses, ajo do te ndryshoje ne menyre te dukshme klimen e zhvillimit rural, nepermjet nxitjeve per autoritetet vendore ne drejtim te permiresimit te situatave ne zonat e tyre te pergjegjesise.
- *Programi i reformes ne administraten publike.* Qeveria ka filluar nje program te rendesishem te reformes ne administraten publike, i cili perfshin nje rishikim te pagave ne sektorin publik, reforma organizative, dhe ato te niveleve te stafit te sherbimit publik. Pritet qe programi te kontribuojte ne nje rritje te kapaciteteve dhe eficences se personelit. Sektori rural mund te perfitoje gjeresisht prej kapaciteteve te permiresuara te qeverise dhe keshtu, mund te kete nje impact me te fuqishem ne aktivite te tjera strategjike.

99. **Lufta kunder Varferise Rurale.** Per te arritur rritje te shpejte dhe te qendrueshme dhe per te perballuar varferine rurale, nevojiten veprime te bashkerenduara nga ana e qeverise, komuniteteve lokale dhe sektorit privat per te kapercyer nje numer sfidash dhe pengesash. Kjo perpjekje do te lehtesohet ne menyre te konsiderueshme prej perpjekjeve me baze te gjere te bera gjate dy viteve te fundit ne drejtim te zhvillimit te nje Strategjie te Zhvillimit Ekonomik dhe Reduktimit te Varferise Ekonomike. Se fundmi, Qeveria Shqiptare beri te njohur Strategjine per Zhvillimin Ekonomik dhe Social per periudhen 2002-2004 pas nje periudhe intensive prezantimesh dhe diskutimesh. Strategjia per Zhvillimin Ekonomik dhe Social synon te udheheqe zhvillimin e Shqiperise pergjate tri viteve te ardhshme.

100. Procesi i pergatitjes se strategjise filloi ne vitin 2000 si pjese e dialogut qeveritar me partneret e saj per zhvillim, vecanerisht FMN dhe BB. Ajo eshte nje produkt i perpjekjeve te koordinuara te qeverise qendrore, asaj vendore, shoqerise civile dhe sektorit privat, dhe u pergatit ne konsultime te ngushta me komunitetin e donatoreve. Parimet qe pershkojne kete strategji jane: (a) vemendje ne objektivat afatmesme per zhvillim te Shqiperise dhe integrimin europian, (b) percaktimi i prioriteteve ne lidhje me veprimet ne aspektin e politikave, bazuar ne analiza brenda strategjise, (c) pohimi i strategjise si dinamike e cila do te evoloje ne pergjigje te ndryshimit te rrethanave; dhe (d) perpjekje te koordinuara per te siguruar autoresine mbi strategjine<sup>28</sup>. U

<sup>28</sup> Pergatitja e Strategjise se Rritjen Ekonomike dhe Reduktimit e Varferise ishte pergjegjesi e :

zhvillua nje proces i gjere konsultimi me shoqerine civile, pushtetin vendor, komunitetin e biznesit dhe partneret per zhvillim, dhe pergatitja e strategjise u lehtesua si rezultat i perfshirjes se kosos se strategjise ne buxhetin e shtetit ne kontekstin e Kuadrit te Shpenzimeve Afatmesme.

101. Strategjia per Rritjen Ekonomike dhe Reduktimin e Varferise ka percaktuar keto synime specifike per tri vitet e ardhshme: (a) rritje ekonomike, (b) reduktimi i numrit te njerezve qe jetojne ne varferi, (c) permiresime ne sherbimet jetike te infrastruktures, vecanerisht ne zonat urbane dhe suburbane, (d) reduktimi i vdekshmerise foshnjore dhe te nenat si dhe niveleve te semundjeve, dhe (e) permiresime ne aresim, vecanerisht ne nivelin elementar. Ne kerkim te arrijtes se ketyre objektiveve, strategjia identifikon gjashte fusha prioritare per veprim publik perfshire shendetesine, arsimin, qeverisje te permiresuar, rritje ekonomike, mbeshtetje sociale dhe stabilitet makro-ekonomik. Strategjine e pershkron konstatimi qe varferia eshte ne pjesen dermuese nje fenomen rural dhe se vemendja ne keto gjashte fusha prioritare duhet te jete me e perqendruar ne zonat rurale.

102. Gjate pergatitjes se strategjise, grupi teknik sektorial per bujqesine, luajti nje rol thelbesor dhe konstruktiv. Ai ndihmoi per artikulin e veprimeve publike specifike qe synonin sektorin rural, me nje fokus ne zhvillimin e bujqesise dhe blegtorise, akses ne rritje ne infrastrukture dhe sherbime sociale te permiresuara, mbrojtja dhe menaxhimi me i mire i burimeve natyrore; dhe diversifikimi i ekonomise rurale. Po keshtu, strategjia njeh nevojten per te siguruar qendrueshmerine e veprimeve te saj per zhvillim nepermjet politikave mjedisore qe synojne: (a) ndalimin e degradimit te mjedisit, (b) rehabilitimin e zonave te ndotura; dhe (c) rritjen e shfrytezimit te qendrueshem te burimeve mjedisore<sup>29</sup>.

103. **Reforma e buxhetit** ne Shqiperi ka qene ne proces implementimi gjate dy viteve te fundit, me miratimin e nje kuadri shpenzimesh afatmesme si planifikim i buxhetit baze dhe instrument formulues. Objektivat e kuadrit jane fuqizimi i planifikimit buxhetor dhe arritja e nje shfrytezimi me efektiv te burimeve publike nepermjet:

- promovimit te disiplines fiskale si nje mjet qe siguron qe te ardhurat dhe shpenzimet te behen te qendrueshme dhe t' i pergjigjen objektiveve te qeverise per rritje; dhe
- krijimit te nje kuadri per percaktimin e prioriteteve ne shpenzimet publike.

104. Elementet kryesore te Kuadrit te Shpenzimeve Afatmesme perfshijne: (a) zhvillimin e nje kuadri trevjecar makro-ekonomik per te krijuar bazen e projektimit te shpenzimeve; (b) analizen e ceshtjeve te shpenzimeve publike si p.sh. reforma ne paga; (c) zhvillimi i strategjive per shpenzime sektoriale; dhe (d) zhvillimi i planeve tre-vjecare te shpenzimeve ne perputhje me kuadrin makro-fiskal dhe modelet e shpenzimeve sektoriale. Planet e shpenzimeve ofrojne tavanet brenda te cilave, ministrite e linjes planifikojne programet e tyre te detajuara dhe

- 
- Komitetit Drejtues, i cili perbehej nga anetare te Komitetit Nderministerial te Politikave Ekonomike, perfaqesues te komunitetit te donatoreve, si dhe perfaqesue nga shoqeria civile, dhe drejtohej nga Kryeministri, identifikoi objektivat e strategjise dhe lidhjet e saj baze me programe te tjera per zhvillim te Qeverise;
  - Grupit te Punes, i cili u ngrit nga Komiteti Drejtues dhe perbehej nga Zv. Ministrat dhe nje drejtor departamenti nga secila prej ministrive te Financave, Shendetesise, Aresimit, Punes dhe Ceshtjeve Sociale, Bujqesise, Bashkepunimit Ekonomik dhe Tregtise, Transportit dhe Puneve Publike, koordinoi dhe udhehoqi pergatitjen e strategjise; dhe
  - Grupet Teknikte Sektoriale, me nje anetaresi mikse nga Ministrite respektive dhe shoqeria civile, kontribuan per identifikimin e objektiveve dhe treguesve strategjike sektoriale dhe masat perkatese publike.

<sup>29</sup> Pergatitja e ketij studimi ishte planifikuar te koicidonte me pergatitjen e Strategjise per Rritjen Ekonomike dhe Reduktimin e Varferise. U pergatiten draft-dokumenta pune mbi sherbimet bujqesore, probleme qe lidhen me token, financat rurale dhe ekonomine rurale jobuqesore u pergatiten ne konsultim me Ministrine e Bujqesise dhe Ushqimit, dhe u vune ne dispozicion te grupit rural te punes. Draftet e fillimit te strategjise bujqesore dhe rurale te qeverise u diskutuan me Banken, dhe procesi rezultoi ne nje konsensus te gjere per fushat prioritare brenda kesaj strategjie, si dhe ato qe identifikohen ne kete studim.

buxhetet. Programi i Buxhetit Afatmesem është një kuader trevjeçar i ndryshueshem dhe rishikohet çdo vit.

105. Momentalisht, qeveria është duke ndermarre ciklin e dytë të planifikimit të Kuadrit të Shpenzimeve Afatmesme. Kuadri i parë mbulonte periudhën 2001-2003 dhe përfshinte analiza sektoriale për pesë ministritë, referuar shëndetësisë, arsimi, punëve publike nëpër bashki, transportin dhe mbrojtjen sociale. Rezultati i përpjekjes së parë u gjykua si shumë pozitiv me një fokus shumë më të hollë analitik në buxhetin e 2001, dhe një artikullim të fushave prioritare në shpenzime si arsimit, transporti dhe mirëmbajtja e infrastrukurës. Raundi i dytë 2002-2004 i Kuadrit të Shpenzimeve Afatmesme është aprovuar këto kohë të fundit. Ai përfshin një analizë më të detajuar të çësjeve të mëprehta, veçanërisht reformat në pagë, dhe mërr në analizë rekomandimet buxhetore në iniciativën për decentralizim. Themeloret për sektorin rural është fakti që analiza e shpenzimeve sektoriale është bërë edhe nga MBU.

106. **Decentralizimi.** Qeveria inicioi një Strategji Kombëtare Decentralizimi në janar 2000. Strategjia për decentralizim në zonat rurale mbulon bujqësinë dhe ushqimin, burimet natyrore, aktivitetet jashtë fermes dhe shërbimet rurale në infrastrukture. Strategjia ofron një kuader të funksioneve ekskluzive për njesitë e qeverisjeve vendore, grupet me bazë komuniteti dhe shoqatat, dhe funksioneve të ndara ndërmjet MBU dhe bashkive e komunave (Aneksi III, Tabela 11). Qëllimi i kësaj strategjie është të kalojë përgjegjësitë për funksionet qeverisë tek niveli lokal dhe t'i japë komuniteteve lokale një përfaqësim më të madh dhe angazhim në sigurimin e shërbimeve publike dhe në shpërndarjen dhe shfrytëzimin e burimeve të vogla buxhetore. Në tetor 2000, u miratua një ligj "Për Organizimin dhe Funksionimin e Njesive të Qeverisjes Vendore", i cili siguron bazën ligjore për programin e decentralizimit. Reformat decentralizuese janë planifikuar që të implementohen gjatë tre viteve të ardhshme dhe do të kryhen nëpërmjet një procesi përfshirës, duke angazhuar autoritetet e pushtetit vendor, shoqëri civile dhe komunitetet lokale, si dhe përfaqësues të organeve të qeverisjes qendrore. Një Komitet Kombëtar për Decentralizimin, i cili përbehet nga përfaqësues si të qeverisjes lokale ashtu edhe të asaj qendrore, dhe një Grup Ekspertësh ka miratuar një plan veprimi trevjeçar për zbatimin e strategjisë.

107. Ligji përcakton gjerësisht funksionet që do t'i kalojnë njesive të qeverisjes vendore, si dhe funksionet e përbashkëta për të cilat do të ketë përgjegjësi të ndara, si psh. arsimi, shëndeti publik dhe mbështetja sociale. Për funksionet e përbashkëta, fokusi do të jetë në përcaktimin e ndarjes së përgjegjësisë ndërmjet organeve qendrore të qeverisjes dhe atyre lokale dhe marrëdhëniet ndërmjet të dyjave. Në planin e përgjithshëm, vëmendja do të përqendrohet në rritjen e përgjegjësisë të organeve lokale në vendim-marrje, përcaktim prioritetesh, shpërndarjen e burimeve, dhe sigurimin e shërbimeve. Vëmendje do t'i kushtohet gjithashtu edhe zhvillimit të administratës fiskale në mënyrë që të aftësohen organet lokale për të përmbushur funksionet e tyre të shtuara. Do të kërkojë një rritje kapaciteti për sigurimin e të ardhurave në nivel lokal, në kuader të një shpërndarjeje me efektive të burimeve kombëtare financiare. Një propozim për financimin e administratave të sapoformuara lokale është nëpërmjet futjes së takses së tokës. Legjislacioni ekzistues parashikon një taksë për token, por në fakt toka bujqësore prej vitesh ka qenë e përjashtuar nga kjo lloj takse.

108. Sfidat për MBU do të jetë që të bashkërendojë strukturën e saj të decentralizuar me strukturat lokale të qeverisjes ku 36 rrethet janë rigrupuar në 12 rajone. Aktualisht, brenda secilës prej 36 rretheve, Drejtori i Bujqësisë së Rrethit ka përgjegjësinë totale për administrimin dhe shpërndarjen e buxheteve për sektore dhe shërbime të ndryshme në rreth. Psh., buxheti për aktivitetet e ekstensionit në nivel rrethi dhe komune është pjesë e buxhetit të përgjithshëm të Departamentit të Bujqësisë së Rrethit, dhe planifikimi i ekstensionit realizohet në nivel lokal, nën drejtimin e Shefit të Ekstensionit të Rrethit, i cili raporton nga pikepamja administrative tek Drejtori i Bujqësisë së Rrethit. Drejtorite Teknike të MBU janë tani së pari përgjegjës për zhvillimin e politikave dhe rregullave të përgjithshme dhe për sigurimin e mbështetjes teknike. Në disa raste, ekzistojnë edhe fonde shtesë në dispozicion për programe speciale të siguruar drejtpërdrejt nga MBU, shpesh të financuara nga projekte të donatoreve si psh. grantet për

aktivitete kërkimi në ferme, të financuara nga Projekti Kombëtar i Ekstensionit, me mbështetje Hollandeze. E ndërsa kontrolli buxhetor dhe planifikimi i programeve në nivelin lokal duhen vazhduar dhe madje zgjeruar ku të jete e mundur, ka një mundësi për përmirësimin e informacionit dhe të sistemit monitorues në mënyrë që Drejtorite Teknike të MBU të mund të jene në korent të pozicionit buxhetor dhe shpenzimeve. Planifikimi sesi struktura ekzistuese me baze rrethi do të koordinojë, momentalisht është në proces.

109. **Reforma në Administratën Publike** është një fushë tjetër kyçe me ndikime të rëndësishme për MBU dhe strategjinë rurale. Reforma prek të gjithë qeverisjen dhe u iniciua me kalimin e Ligjit për Statusin e Nepunësimit Civil në janar 2000. Elementet kryesore të reformës përfshijnë përvijimin e saktë të përgjegjësive dhe struktureve të organeve publike, kontrolle dhe audite të brendshme të përmirësuar, implementimi i reformës së shërbimit civil, dhe përmirësimi i aksesit publik në informacion. Reforma e shërbimit civil do të kufizojë ndjeshëm numrin e posteve me emerim politik, dhe do të përcaktojë qartë dallimin ndërmjet punonjësve të shërbimit civil dhe funksioneve politike.

110. Vlerësohet se MBU është në pararojë të procesit të kësaj reforme. Një Sekretar i Përgjithshëm u emërua në mars 2001 për zbatimin e reformave të shërbimit civil në MBU dhe për të vepruar si administrator i përgjithshëm i MBU. Sekretari i Përgjithshëm është në fakt nepunësi i parë civil në ministri. Sekretari i Përgjithshëm ka filluar një proces reforme dyvjeçarë në Ministri, i cili përfshin (a) përcaktimin e përgjegjësive dhe funksioneve të Ministrisë; (b) krijimin e një strukture organizative në Ministri, e cila t'i përgjigjet përgjegjësive dhe funksioneve të reja; (c) përpunimin e përkrahjeve të vendeve të punës dhe termave të referencës për stafin në përbushjen e funksioneve të identifikuar; dhe (d) vlerësimin e kapaciteteve dhe nevojave për trajnim për punonjësit në Ministri si një pararendes i konvertimit të statusit të tyre në punonjës civilë. Aty ku personeli konstatohet i papërshtatshëm për përbushjen e kriterëve të reja të punës, parashikohet që ata të ri-trajnohen, ripozicionohen, apo lirohen nga detyra. Synohet që punonjësit të arrijnë të gëzojnë statusin civil brenda dy vjeteve. Në zbatim të këtyre reformave, vetëm Ministri dhe Zv. Ministri mund të zevendesohen me ndryshimin e qeverisë.

111. Megjithatë nuk ekziston ndonjë lidhje formale ndërmjet nivelit të pagave dhe statusit civil, është e mundur që rritjet në paga, dyfishimi i tyre me reduktimin e stafit, të aprovohen në të ardhmen e afërt, në mënyrë që të thithet apo mbahet personeli me cilësi të lartë. Gjithashtu, është e mundur që të fillojnë ndryshimet në sistemin buxhetor, në vijim të fazës fillestare të reformave. Në përgjithësi, parashikohet që këto reforma të sigurojnë stabilitet, rrisin efikasitetin dhe kufizojnë influencën politike në MBU, si dhe të mundësojnë monitorim me të mirë, koordinim dhe vlerësim të punës së drejtorive teknike. Gjithsesi, mbetet të shihet shpejtësia e implementimit të këtyre reformave. Ekziston një rrezik i konsiderueshëm që ndërsa nga njëra anë do të rritet siguria e vendit të punës për punonjësit shtetërorë, ristrukturimi i institucioneve dhe, në vecanti ndryshimet në personelin do të jene të vështira dhe do të kërkojnë kohë.

### **Klima e biznesit- Zhvillimi i sektorit privat**

112. Vlerësohet që rreth 75% e GDP në Shqipëri sigurohet nga sektori privat. Pjesa më e madhe e firmave janë të vogla, me vetëm 2% të tyre që punësojnë më shumë se 10 punëtorë. Sipërmarresit kanë synuar që të kalojnë në biznese të vogla me punë intensive si rezultat i struktureve të ulët të pagave në Shqipëri. Aktivitete të vogla në berjen e mobiljeve, prodhimin e kepuceve dhe të veshmbathjeve kanë rezultuar fitimprurëse kryesisht për kompanitë e vogla që nënkontraktajnë përpunimin për firmat e huaja. Megjithatë, shërbimet financiare si bankat dhe sigurimet, si dhe shërbimet mbi informacionet për biznesin, ende janë të pamjaftueshme për një ekonomi të zhvilluar. Në total, rreth 52% e bizneseve në Shqipëri janë me pakice; 18% janë në sektorin e shërbimeve si hotelet, restorante dhe bare; 14% janë në transport; 10% në prodhim; 3% në ndërtim; dhe vetëm 2% në përpunim bujqësor.

113. Industria e ndertimit po zgjerohet me shpejtesi, me ritme rritjeje te vleresuara ne 15% ne 1999 dhe 17% ne 2000. Kerkesa per ndertime eshte ngritur nga (a) shperberja e fermave kolektive ne ekonomi individuale; (b) lindja e ndermarrjeve te vogla dhe te mesme, perfshire dyqanet dhe restorantet; (c) nje mungese serioze per strehim e cila ka cuar ne ndertime te reja, vecanerisht ne zonat me flukse te medha urbane; (d) hyrja e financimeve humanitare dhe ushtarake ne 1999 gjate krizes kosovare; dhe (e) implementimi i projekteve te medha ne infrastrukture si permiresimet ne rrjetin rrugor me mbeshtetje te huaja dhe ndertime hotelesh. Edhe turizmi po zgjerohet, me 1.2 milione vizitore qe priten ne 2001 krahasuar me rreth 900,000 te regjistruar ne 2000 dhe 227,000 ne 1996. Pavaresisht ketyre treguesve, turizmi ndodhet ende ne nje faze fillestare, ndersa ekzistojne shume mundesi te pashfrytezuara, madje edhe ne zonat rurale. Edhe tregtia me pakice ka pesuar zhvillime, me shume dyqane te reja ne Tirane, dhe ne nje mase me te vogel ne qytete te tjera te medha, pavaresisht se ky zhvillim nuk eshte shtrire tek qytetet dhe fshatrat e larget.

114. Investimet e huaja ne Shqiperi jane relativisht ne nje nivel te ulet, megjithese jane shfaqur shenja te nje interesi ne rritje qe prej rikthimit te stabilitetit pas vitit 1997. Ne 1999, vlere neto e investimeve te huaja ishte 43 milione USD, por kjo shifer arriti me shume se trefishi ne vitin 2000, duke regjistruar 143 milione USD. Gjithsesi, shume pak investime te huaja drejtohen ne sektorin bujqesor. Ekzistojne rreth 2,422 ndermarrje te perbashketa dhe te huaja qe zhvillojne bizneset e tyre ne Shqiperi, dhe vetem 33 prej tyre te angazhuara ne bujqesi. Pothuajse 2/3 e ketyre bizneseve operojne ne sferen e tregtise, perfshire edhe pak tregeti ne inpute bujqesore dhe mallra te perpunuara; 17% ne industri; 6% ne sherbime; 5% ne ndertim dhe 5% ne transport.

115. Bizneset e vogla jane zhvilluar me shpejt ne dhe perreth zonave te uleta urbane ku ekzistojne kompensime me te mira dhe te shpejta te investimeve sesa ne zonat rurale. Vetem rreth 20% e ndermarrjeve ndodhen ne zonat rurale, megjithe faktin qe rreth 55% e popullates banon ne to. Nje numer arsyes shpjegojne kete tendence: (a) te ardhurat nga ferma jane te uleta, kerkesa per mallra dhe sherbime lokale eshte e kufizuar, dhe shume pak teprica prodhimi mbeten per investim; (b) dergesat shfrytezohen ne rradhe te pare per te plotesuar nevojat per konsum, por shpesh jane te crregullta dhe te pamjaftueshme per qellime investimi; dhe (c) largim i konsiderueshem nga zonat rurale, shpesh i anetareve me aktive te forces rurale te punes, i cili ngushton bazen e burimeve njerezore per zhvillim te ndermarrjeve rurale. Pavec kesaj, zhvillimi i biznesit te vogel pengohet nga: mungesa e aftesive teknike dhe te biznesit; sherbime te kufizuara financiare, zhvillim i dobet i tregut; dhe kufizime ne dekretimin, perhapjen dhe zbatimin e ligjeve te pershtatshme tregtare.

116. **Grupet dhe shoqatat me baze komuniteti.** Pavec MBU dhe institucioneve qeveritare, sektori rural ne Shqiperi eshte duke filluar te njohe domosdoshmerine e grupeve dhe shoqatave private me baze komuniteti. Shume prej tyre kane perfituar asistencen teknike dhe financiare prej programeve qeveritare apo me financim te donatoreve gjate procesit te formimit te tyre. P.sh., sot ekzistojne me shume se 500 shoqata te regjistruara te Perdoruesve te Ujit ne vend, te cilat pergjigjen per menaxhimin e infrastruktures ujtesore te rehabilituar, megjithese jo te gjitha jane funksionale<sup>30</sup>. Funksionojne dhe Shoqata per Menaxhimin e Burimeve Natyrore ne 34 komuna, te cilat jane pergjegjese per menaxhimin dhe permiresimin e burimeve te kullotore dhe atyre pyjore ne komunitetet e tyre<sup>31</sup>. Formimi i grupeve te kredise eshte ne proces qe prej vitit 1992.

<sup>30</sup> P.sh., Projekti i BB per Rehabilitimin e Rrjetit Ujtes ka mbeshtetur zhvillimin e rreth 208 Shoqatave te Perdoruesve te Ujit ne shtate rrethe te ultesires bregdetare, ndersa Projekti per Rehabilitimin e Pjesshem te Rrjetit Ujtes, i financuar nga IFAD ka kompletuar rehabilitimin e rreth 7,332 ha dhe ka regjistruar 147 Sh.P.U., kryesisht ne zonat malore te Shqiperise Veriore. Prej zonave te mbeshtetura nga IFAD, rreth 33% konsiderohen qe funksionojne sic duhet, 53% konsiderohen ne nivelin mesatar dhe 14% konsiderohen te varfera.

<sup>31</sup> I mbeshtetur nga Projekti i Pyjeve me financim nga BB. Kjo mbeshtetje perfshin transferimin e te drejtave te perdoruesit tek komuniteti nga ana e Drejtorise se Pyjeve dhe Kullotave ne Rreth, asistencen per formimin e shoqatave te perdoruesve te kullotave dhe pyjeve me baze komuniteti, dhe pergatitjen dhe implementimin e nje plani menaxhues trevjecar.

Rreth 225 Fonde te Kredise se Fshatit jane formuar me mbeshtetjen e projekteve te financuara nga BB dhe IFAD, perfshire 64 ne zonat malore<sup>32</sup>. Pavec kesaj, jane ngritur nje numer Unionesh te Kredise dhe Shoqatash te Kursim Kredise, te parat te formuara qe ne 1997 me mbeshtetjen e Projektit te Permiresimit te Bulmetit Land O'Lakes dhe Lidhjes Irlandeze te Unioneve te Kredise. Sipas Projektit te Mikro-Kredise se BB, rreth 145 Fonde te Kredise se Fshatit ne zonat jo-malore do te transformohen ne Sh.K.K. dhe rreth 240 Sh.K.K. te tjera do te krijohen ne pese rrethe te tjera te ultesires bregedetare pergjate kater viteve te ardhshem.

117. **Organizatave e tregtise dhe prodhuesve.** Zhvillimi i organizatave te ndryshme te tregtise dhe prodhimit ka fituar ritem. Pavec Shoqates se Tregtareve te Plehrave dhe Agro-biznesit, ekzistojne organizata te tjera prodhuesish, si Shoqata Kombetare e Fares se Patates, e cila permbledh 200 prodhues se fares se patates te organizuar ne 14 nenshoqata ne pese grupime rajonale<sup>33</sup>. Kjo shoqate, se bashku me Shoqaten e Hortikultures dhe ate te Vajrave Ushqimore, ka filluar te implementoje aktivitetet ekstensionit per anetaret e saj. Se fundmi, eshte krijuar edhe nje keshill i larte; Keshilli i Agro-biznesit Shqiptar, i cili perbehet nga 17 shoqata anetare. Ekzistojne edhe shume grupe dhe shoqata me baze komuniteti, te regjistruara zyrtarisht apo edhe informale. Keto shoqata perfshijne Shoqaten e Bleterritesve ne Korce, Shoqata e Mbareshtuesve te Races Taranteze, e cila funksionon ne Korce, shoqata te ndryshme te prodhuesve te frutave dhe perimeve, dhe shoqatat e bulmetit shpesh te ndodhura prane pikave te grumbullimit. Shume prej ketyre shoqatave te vogla perbehen nga fermere te orientuar drejt tregut me synime te perbashketa ne aspekte te ndryshme te prodhimit, sigurimit te inputeve dhe marketingut, dhe pjese dermuese e tyre ndodhen prane aktiviteteve perpunuese, me shume perpunues te vegjel te bulmetit te anetaresuar ne Shoqaten Kombetare te Sipermarresve te Bulmetit. Ekziston edhe nje Shoqate e Nderzimit Artificial e perbere nga teknike ne fushen e blegtorise, te cilet kane ngritur ndermarrje te vogla te Nderzimit Artificial.

118. **Rrjetet sociale.** Mbyllja e ndermarrjeve bujqesore dhe industriale si dhe e kooperativave, rrjeteve te furnizimit dhe kanaleve shperndarese, jane faktoret kryesore te papunesise rurale dhe te nivelit te ulet te te ardhurave. Shoqatat e komunitetit dhe ato formale, si ajo fetare, grupet e bamiresise, organizatat vetendihmuese dhe grupet e interesit publik, nuk jane zhvilluar sa duhet per te ndihmuar familjet dhe komunitetet qe te perballojne veshtiresite. Si pasoje, shume shqiptare kane ngritur institucione informale per t'i bere balle veshtiresive te tyre ekonomike dhe sociale. Dy institucionet me te rendesishme informale jane aleancat informale te kredise dhe rrjetet e migracionit qe sigurojne dergesat.

119. Ne zonat rurale te Shqiperise veriore dhe verilindore, institucione tradicionale si Fisi dhe Kanuni po rishfaqen per te sjelle pak rend dhe stabilitet ne mungese te kapaciteve qeverisese. Megjithate, keto institucione, te cilat bazohen ne familje/klane te zgjeruara, jane te kufizuara ne aftesite e tyre per te permbushur gamen e gjere te nevojave. Pavec kesaj, konfrontimi i shqiptareve me grupe te tjera, si familjet/klanet e tjera, grupet etnike dhe fetare, tenton ta copezoje shoqerine civile dhe mund te imponoje zgjidhje joqeveritare neper xhepa gjeografike.

### **Procesi i privatizimit te tokes**

120. Elementet kyc te reformes se tokes perfshijne: (a) zhvillimin e nje kuadri te plote ligjor dhe rregullues per administrimin e tokes dhe zhvillimin e tregjeve te tokes; (b) krijimi i nje Sistemi te Regjistrimit te Pasurise se Paluajtshme; dhe (c) nje program te plote me mbeshtetjen e donatoreve, per te bere regjistrimin rishtazi te pronareve te rinj te tokes. Rreth 29 ligje dhe rregullore qe kane te bejne me administrimin e pasurise se patundshme jane miratuar ne Shqiperi. Ky kuader legjislativ trajton:

<sup>32</sup> Te formuara nga Fondi i Financimit Rural me mbeshtetje te projekteve te financuara nga BB dhe nga projekte per Zhvillimin Rural te Shqiperise Verilindore me financim te IFAD.

<sup>33</sup> Shoqata e Prodhuessve te Fares se Patates eshte aktualisht duke marre mbeshtetje teknike ne drejtim te organizimit dhe menaxhimit nga Projekti i GTZ per Promovimin e Organizatave Vetendihmuese ne Bujqesine Private.

- token bujqesore te zene nga kulturat e fushes, frutat dhe ullinjte dhe vreshtat;
- tokat e zena nga pyjet, kullotat dhe lendinat;
- toke jobujqesore e zene nga ndertesa ekonomike dhe social kulturore dhe njesi ushtarake, si dhe zonen perreth tyre; dhe
- tokat per perdorim te pergjithshem si psh. rruget dhe aeroportet.

121. Legjislacioni ekzistues parashikon nje kuader te mjaftueshem ligjor dhe rregullues per te mbeshtetur funksionimin e tregut te tokes. Nuk ekzistojne me pengesa themelore ligjore qe te parandalojne transaksionet e tokes si psh. blerja, shitja, qiradhenia, dhurimi apo trashegimi. Duket se po shfaqet nje treg i pasurive te patundshme. Ai eshte me shume aktiv ne zonat urbane dhe per shtepite dhe apartamentet. Transaksionet me token rurale ende jane shume te rralla. Aty ku kryhen transaksione me token, ato ne te shumten e rasteve jane qiradhenie, shpesh qiradhenie me afat njevjecar, te paregjistruara dhe ku pagesa behet zakonisht ne natyre.

122. Zyra e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme funksionon me 36 zyra neper te gjithe vendin. Ajo siguron sherbime regjistrimi gratis, perfshire regjistrimin rishtazi te tokes se privatizuar dhe regjistrimin e transaksioneve dhe garancive qe lidhen me te. Nje proces sistematik i regjistrimit rishtazi po zhvillohet sipas nje programi te caktuar. Rreth 55% e tokes bujqesore te shperndare ose rreth 1.6 milione parcela rurale jane studiuar, futur ne harte, titulluar dhe regjistruar. Procesit i regjistrimit rishtazi pritet te perfundoje ne 2004. Per sherbimet e bazuara ne pagesa, zyrat e regjistrimit lejohen qe te mbajne 60% te pagesave te mbledhura, ndersa pjesa tjeter kalon ne Thesar. Gjashte zyra te tjera po ngrihen, kryesisht ne qendrat urbane ku numri i transaksioneve eshte shume i larte.

123. Sipas ligjit sShqiptar, toka i eshte dhene pronareve ne baze familje. Ajo regjistrohet ne emrin e kreut te familjes dhe te gjithe personat e tjere jane te listuar ne titull. Per cfaredolloj transaksioni me token, duhet te nenshkruajne te gjithe anetaret e familjes, duke deshmuar te qenit dakort. Shpesh, eshte e veshtire te marresh firmat e te gjithe anetareve te familjes, pasi njeri prej anetareve mund te mos jete dakort me transaksionin apo sepse ndonjeri nga anetaret mund te kete emigruar.

124. Toka i eshte shperndare qytetareve dhe jane leshuar, shperndare dhe regjistruar titujt e tokes per rreth 60% te te gjithe tokes ne Shqiperi dhe per afersisht 80% te te gjithe tokes rurale. Ende pjesa me e madhe e qytetareve nuk jane te ndergjegjshem cfare do te thote pronesi private mbi pasurite e paluajtshme. Ata nuk jane te ndergjegjshem per te drejtat e tyre mbi token apo pergjegjesite qe shoqerojne mbajtjen e ketyre te drejtave. Psh., disa te drejta, si te drejtat minerale apo e drejta e shpronasimit per te miren publike, i mbeten shtetit. Ne te njejten kohe, qytetaret jane pergjegjes per ceshtje si p.sh. ruajtja e kufijve te pronesise, duke siguruar qe cdo veprim qe ndodh ne pronen e tyre, nuk ndikon negativisht ne pronen e te tjereve, dhe per ndjekjen e procedurave te duhura ligjore ne rastin e transferimit te te drejtave te pronesise tek te tjeret, si rezultat i trashegimise, dhurimit, marteses, divorcit, emigracionit, etj. Duke qene qe koncepti i prones private eshte i ri per shume nga qytetaret, duhen bere perpjekje per t'i edukuar ata per te drejtat dhe pergjegjesite qe shoqerojne titullin e pronesise. Per qytetaret, eshte e veshtire madje te gjejne keshillim ligjor per probleme qe lidhen me pasurite e paluajtshme. Noteret kane eksperience minimale dhe pak ose aspak trainim rreth ligjit mbi pasurite e paluajtshme. Megjithese paraqiten shume raste te lidhen me pasurite e paluajtshme neper gjykata, pak prej tyre kane arritur te zgjidhen, dhe ato pak qe jane zgjidhur nuk behen publike dhe nuk vihen ne dispozicion si informacion per komunitetin ligjor.

125. Per me teper, ne disa zona te Shqiperise, iniciativat lokale te privatizimit i kane paraprire procesit te privatizimit te tokes dhe toka ju shpernda individeve dhe familjeve pa sanksione formale te qeverise. Se fundmi, vendimi per te mos lejuar rikthimin e tokes rurale nuk eshte i aplikueshem per token urbane, dhe mijera pretendime te kunderta ne zonat urbane ende qendrojne per shqyrtim neper gjykata, duke e ngadalesuar keshtu procesin e dhenies dhe regjistrimit te titujve urbane. Ky trajtim i ndryshem per token rurale dhe ate urbane perfaqeson nje problem per

garancine e titujve ne zonat rurale qe rrethojne qendrat kryesore urbane, ku toka po ri-klasifikohet me shpejtesi si urbane. Keto ceshtje po cojne ne nje pasiguri te konsiderueshme rreth pronesise mbi token dhe po rrisin rreziqet e investimit ne toke apo te perdorimit te tokes per te siguruar transakcione financiare.

126. Ceshtje te tjera shqetesuese jane dimensionet e vogla te fermes dhe shkalla e larte e copezimit, me ferma qe pergjithesisht perbehen nga kater apo me shume parcela te shperndara ne distanca te konsiderueshme nga njera tjetra. Dhenia e tokes ne kete menyre ishte nje metode shume e ndjeshme ne pergjigje te deshires se fuqishme per nje shperndarje te barabarte te tokes. Ajo kenaqi deshiren e mbare popullates qe secila familje te marre nje parcele nga secili lloj i tokes, perfshire token e punueshme, vreshtat, dhe kopshte pemesh, si nje menyre per te siguruar barazi ne drejtim te kapacitetit prodhues te tokes. Sot, mbizoteron opinionin qe sistemi i fermes qe doli nga kjo shperndarje nuk eshte eficient. Midis shqetesimeve, mbizoterojne ato qe dimensionet e pergjithshme te fermes jane shume te vogla per te prodhuar per tregeti, qe shume prej parcelave ekzistuese jane te bllokuara me kufij dhe rrugekalime, dhe se ato jane shume te vogla per kultivim te mekanizuar. Gjithashtu, vleresohet qe parcelat e shperndara shtojne koston e fuqise punetore, pasi fermeret i terheqin mjetet e tyre te punes sa nga njera parcele tek tjetra. Ekzistojne shembuj te shumte te fermereve te cilet kerkojne te konsolidojne apo zmadhojne feramat e tyre nepermjet mekanizmave te ndryshem, me shpesh nepermjet shkembimeve apo qiradhenieve informale te tokes. Megjithate, ekziston nje opinion i perseritur tek disa nga perfaqesuesit e qeverise qe duhet marre parasysh nje metode me proaktive qe t'i pergjigjet nevojave ne rritje. Nje inisiativ e qe eshte duke u pilotuar sot, eshte perdorimi i transakcioneve te tregut dhe nje fushate informimi per te angazhuar komunitetet ne nje dialog mbi perfitimet e bashkimeve te tokes. Gjithsesi, ekziston rreziku qe te propozohen metoda me te drejtperdrejta dhe intervencioniste. Programe te tilla te konsolidimit te tokes jane eksperimentuar edhe gjetke ne Europe dhe kane provuar te jene shume te kushtueshme per t'u implementuar dhe te kufizuara ne impakt.

### 2.3 SITUATA DHE ZHVILLIMI AKTUAL-SHERBIMET RURALE

#### Infrastruktura rurale

127. Ekzistenca e nje infrastrukture rurale te pershtatshme mund te konsiderohet si nje nga faktoret me te rendesishem per rritje rurale ne Shqiperi. Ajo i sherben shume qellimeve, si permiresimit te kushteve te jeteses, sigurimit te aksesit ne tregje, permiresimit te prodhimit bujqesor, dhe thithjes se investimeve. Ekzistenca e rruges, ujit, elektricitetit, dhe ne disa zona, e sistemit ujites, do te siguroje bazen per rritje rurale dhe zhvillim. Banoret e zonave rurale te largeta shpesh permendin mungesen e ketyre elementeve themelore te infrastruktures si faktoret me pengues. Nevoja te tjera infrastrukturore, si p.sh. sherbimet shendetesore dhe ato arsimore, jane gjithashtu te rendesishme, por qe nuk do te diskutohen ne kete dokument.

128. **Uji dhe higjiena.** Sistemi i furnizimit me uje ne zonat rurale ka degraduar gjate dekadete se fundit, kryesisht per arsye te mungeses se kapaciteteve mirembajtese dhe te menaxhimit te dobet. Numri i personave qe kane akses ne rrjetin e ujesjellesit ra ne 50% ne vitin 2001, kundrejt 75% qe ishte ne 1989. Madje edhe per ato familje qe kane akses, furnizimi me uje eshte i kufizuar ne pak ore ne dite, dhe ne stinen e veres, shume familje nuk furnizohen fare me uje. Arsyet kryesore per kete situat e jane: (a) degradimi i rrjetit fizik si pasoje e mungeses se burimeve; (b) mbikonsumimi si rezultat i shperberjes se sistemit ujites qe furnizon me uje bujqesine dhe blegtorine; (c) mungesa e kontrollit mbi konsumin, per arsye te mungeses se matesve, numri i madh i lidhjeve te paligjshme dhe mungesa e detyrimit; (d) cmimet nen kosto te ujit dhe niveli i ulet i arketimeve; (e) kushtet e dobeta financiare te ndermarrjeve te ujit; (f) kapaciteti i dobet drejtues dhe funksionues i ndermarrjeve te ujit; dhe (g) mungesa e nje strategjie per permiresimin e ketij sherbimi vecanerisht per fshataret e varfer. Kohet e fundit, Ministria e



Puneve Publike dhe Turizmit ka përgatitur një Strategji Rurale dhe të Higjienës, me asistencën e Bankës, e cila pritet të aprovohet nga Këshilli i Ministrave. Sipas kësaj strategjie, “Investimi që nevojitet për të pajisur zonat rurale të Shqipërisë në lidhje me rrjetin e furnizimit me ujë, vlerësohet ndërmjet 150 milionë USD dhe 300 milionë USD. Shërbimet baze të higjienës do të kërkonin investime edhe më të mëdha.

129. Rreth 2,600 nga 2,900 fshatra kanë sisteme të furnizimit me ujë. Mënyerisht, ekzistojnë 28 kompani të transformuara rishtazi nga 58 ish-ndërmarrje uji, dhe të tjera janë në proces transformimi. Komunitat dhe bashkitë kanë të drejtën të krijojnë ndërmarrje ujësjellesi në nivel komune dhe bashkie apo të kontrahojnë shërbimin me një subjekt privat apo tregtar. Deri në 1998, përdoruesit paguanin një tarifë uji të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Në 1998, tarifën e ujit u liberalizuan, dhe sot bazohen në kushtet që ka qyteti dhe rrethi, të propozuara nga bashkitë dhe të aprovuara nga Enti Rregullator i Ujit, si një organizim autonom. Propozimi për tarifën e reja uji për bashkitë/komunitat vjen nga ndërmarrjet e ujësjellesit. Struktura e tarifave të ujit ka evoluuar nga rreth shtatë në tre tarifa. Sot aplikohen tre tarifa për sektorin e shërbimeve, organizatat publike dhe sektorin privat. Tarifën për popullatën e qytetit dhe atë rurale përcaktohen me pëlqimin e këshillit bashkiak apo komunal. Tarifën janë në nivelin e kufizimit të kostos për të gjitha shërbimet. Nivelet e arketimit janë ndërmjet 50-60% në pjesën dermuese të rrethëve dhe më tej edhe me të ulet për zonat rurale. P.sh., Njësia e Ujësjellesit të Fshatrave të Tiranës nuk e paguan Kompaninë e Ujësjellesit të Tiranës, e cila është furnizuesja kryesore e ujit, si pasojë e nivelit shumë të ulet të arketimeve.

### **Kutia 3. Lidhja ndërmjet shërbimeve të dobëta të ujit dhe varfërisë rurale**

*Ne fund të vitit 2000, Plan International, kreu një studim që matë impaktin e projekteve të furnizimit me ujë në 9 fshatra rurale. Studimi përmban të dhëna mbi lidhjet ndërmjet (mungesës së) ujit dhe shërbimeve të higjienës si dhe të varfërisë që i korrespondon kësaj situatë përpara implementimit të projekteve të tyre. Megjithatë të 9 fshatrat në studim, nuk janë zgjedhur specifikisht si përfaqësues të zonave rurale të Shqipërisë, rezultatet janë referues për zonat me të varfëra rurale të Shqipërisë. Gjetjet kryesore si dhe ato nga burime të tjera janë:*

*Pabarazite gjinore: Në 98% të familjeve të pyetura, gratë përgjigjeshin për mbajtjen e ujit. Vetëm 5% të burrave ndihmonin apo e mbanin vetë përgjegjësinë për të sjellë ujë.*

*Zhvillimi i femijeve: Në 52% të familjeve, femijet ndihmonin nënën e tyre rregullisht. Sot, nuk ekzistojnë të dhëna që sugjerojnë se puna e përditshme e femijeve për mbajtjen e ujit, ndikon në frekuencën e shkolles, por që gjithsesi ndikon në kohën e tyre të lojës dhe të detyrave të shtëpisë.*

*Reduktimi i potencialeve të të ardhurave: Distanca mesatare nga burimi me i afërt i ujit brenda zonës së studimit, ishte 410 metra me një mesatare prej 4.4 udhëtuesh në ditë të bera për t’u furnizuar me ujë. Kështu, gratë u duhej të ecnin mesatarisht 3.6 km çdo ditë, gjysmën e kohës duke mbajtur nënë të renda plot me ujë. Me shumë domethënëse se distanca, ishte edhe koha e shpenzuar duke pritur tek burimi i ujit. Kur u pyeten, 53% e gratë vlerësonin që ato shpenzonin një minimum prej 4 orësh në ditë për të marrë ujë. Mesatarisht, gratë shpenzonin afërsisht 3.5 orë në ditë për t’u furnizuar me ujë, dhe koha e harxhuar për mbajtjen e ujit ul potencialet e sigurimit të të ardhurave prej aktiviteteve të tjera.*

*Konsumi i ujit dhe higjienës.: Aksesit i dobët për furnizim me ujë, kufizon konsumin mesatar ditë për ditë në një sasi të vlerësuar në 15 litra në ditë për frymë. Ky konsum i ulet ka një impakt në higjienën personale: fshataret laheshin një herë “në disa ditë”. Mungesa e ujit gjithashtu kufizon edhe praktikën e larjes së plote me dorë. Përveç higjienës personale, aksesit i dobët për furnizim me ujë ndikon negativisht edhe në pastërtinë e shtëpisë.*

*Shendetit publik: Si rezultat i mungeses se te dhenave baze per shendetin publik, nuk eshte e mundur te vleresohet impakti i mungeses se ujit dhe sherbimeve te higjenes ne shendetin publik te fshatareve ne zonen e studiuar. Megjithate, duke gene se aksesit i dobet ne furnizimin me uje ka nje ndikim te madh ne praktikate e pastrimit ne fshatrat qe jane pjese e studimit, ka shume te ngjare qe cilesia e dobet e sherbimeve te furnizimit me uje dhe higjenes, te ndikojte negativisht ne shendetin publik. Ne pergjithesi, statistikat mbi shendetin te Qeverise se Shqiperise, bejne lidhje ndermjet sherbimeve te dobeta te furnizimit me uje dhe higjenes dhe shfaqjes se shpeshte te semundjes se diarese dhe rritjes se shkalles se larte te vdekshmerise tek femijet.*

130. Gjate regjimit socialist, Qeveria nuk investoi ne sistemin e kanalizimeve ne zonat rurale, me perjashtim te disa fshatrave me dendesi te madhe popullsie dhe te konsideruara si pjese te qyteteve qe kishin prane. Keshtu, ne pergjithesi, fshatrat shqiptare nuk kane sistem kanalizimesh per te shkarkuar ujerat e zeza. Higjiena ne zonat rurale karakterizohet nga gropa dhe nevojtore. Familjet fshatare e shkarkojne ujin ne gropa/ puse te ujerave te zeza. Ujerat qe vijne si pasoje e stuhise apo permbytjeve shkarkojne nepermjet kanaleve te kullimit dhe/ose ujitjes.

131. Komunat dhe bashkite jane pergjegjese per sherbimin e ujerave te zeza, si dhe per ceshtjet administrative, investuese dhe rregullatore qe lidhen me to. Megjithate, sipas politikese se qeverise, te gjitha ndermarrjet e ujerave te zeza duhet te bashkohen me ato te ujesjellesit, nen nje menaxhim. Procesi i bashkimit ka filluar dhe eshte ne vazhdim. Deri vone, sherbimet e ujerave te zeza ishin te financuara totalisht nga buxheti i qeverise qendrore. Tashme, politika e qeverise konsiston ne ate qe kostoja e sherbimit duhet t'i ngarkohet klienteve. Ndermarrjet e sapokrijuara te ujesjellesit dhe ujerave te zeza kane filluar te aplikojne tarifat e ujit te pijshem dhe atyre te zeza ne vitin 2000.

132. **Mbetjet e ngurta.** Grumbullimi i mbetjeve te ngurta dhe sherbimi i heqjes se mbeturinave nuk ekziston ne zonat rurale. Familjet fshatare i hedhin mbeturinat e ngurta ne ambiente te hapura, sistemet e kullimit, kanalet e ujitjes, apo i djegin. Grumbullimi i mbeturinave te ngurta ne zonat urbane, realizohet nga ndermarrjet komunale nen varesine e bashkise. Ne shume qytete, bashkite e kane kontraktuar kete sherbim me sektorin privat sipas kontratave te sherbimit. Nje sherbim i tille financohet pothuajse ne masen 100% nga buxheti i qeverisjes qendrore. Bashkite aplikojne nje kuote te vogel vjetore per pastrimin e qytetit, e cila varion nga qyteti ne qytet.

133. **Rruget rurale.** Ekzistojne 4,126 km rruge ne sherbim te 1.7 milione banoreve te zonave rurale, dhe 7,653 km rruge te vecanta bujqesore/ujitese, pyje/kullota, minerale dhe ushtarake<sup>34</sup>. Keto rruge jane ne kushte te keqija me rreth 50% e tyre te pakalueshme<sup>35</sup>, duke i lene shume fshatra dhe komuna te izoluara, vecanerisht gjate dimrit. Riparimi dhe mirembajtja jane neglizhuar gjate dekadese fundit, si pasoje e burimeve te kufizuara te nje ekonomie shume te dobet. Veshtiresite ne komunikacion po behen nje pengese e madhe per zhvillimin e ekonomive lokale dhe per realizimin e sherbimeve shendetesore dhe aresimore. Per pasoje, fshataret e varfer jane te privuar nga shume prej sherbimeve baze. Qeveria eshte duke permiresuar rreth 1,000 km prej ketyre rrugeve me asistencen e financimeve te donatoreve<sup>36</sup>. Permiresimet ne rrjetin e rrugeve rurale do te jene vendimtare gjate viteve te ardhshme.

134. Menaxhimi dhe mirembajtja e rrugeve rurale ka perparuar gjate dhjete viteve te fundit. Ligji per Qeverisjen Lokale i dekretuar ne 1992 decentralizoi riparimin dhe mirembajtjen e rrugeve rurale tek 36 keshillat e rretheve. Per fat te keq, as rrethet dhe as komunat nuk kane patur buxhetet e mjaftueshme, madje dhe as kapacitetet teknike per te permbushur pergjegjesite e tyre. Procesi i ri i decentralizimit parashikon qe komunat dhe bashkite jane plotesisht pergjegjese per

<sup>34</sup> ICR i Projektit te Rrugeve Rurale, 8 qershor, 2001.

<sup>35</sup> Studimi i O&M per Projektin e Rrugeve Rurale, janar 1999.

<sup>36</sup> Projekti per Rruget Rurale i financuar nga IDA rikonstruktoi 690 km te rrugeve rurale.

ndertimin, rehabilitimin dhe mirembajtjen e rrugëve lokale, trotuareve dhe shesheve publike<sup>37</sup>. Në kuadrin e decentralizimit, përgjegjësia për mirembajtjen e rrugëve rurale ndahet ndërmjet Ministrisë së Qeverisjes Vendore dhe Ministrive të tjera. Bashkitë dhe Komunitat marrin fondet nga Ministria e Qeverisjes Vendore nëpërmjet keshillave të 12 rajoneve. Mirembajtja e rrugëve rurale dhe investimet financohen në masën 100% nga buxheti i qeverisë qendrore. Mënyerisht, nuk aplikohen kuota apo taksa për shfrytëzimin e rrugëve rurale.

135. **Elektriciteti.** Problemet në furnizimin me energji vazhdojnë të kufizojnë ritmet e rritjes, përfshirë zhvillimin e agro-perpunimit dhe bizneseve të tjera në zonat rurale. Grila energjitike i mbulon të gjitha fshatrat, por pjesa më e madhe e familjeve rurale marrin energji vetëm për pak orë në ditë, si pasojë e ndërprerjeve të rregullta të energjisë dhe problemeve të furnizimit që ekzistojnë nëpër të gjithë vendin. Burimet e energjisë brenda Shqipërisë përfshijnë hidrocentralet në Lumenjtë Drin dhe Mat dhe termocentralin e Fierit. Prodhimi i hidroenergjisë nga tre digat në Lumin Drin siguron më shumë se 90% të prodhimit të përgjithshëm vendas dhe përben burimin më të rëndësishëm. Megjithatë, thatësitat e vitit 1999 dhe 2000 i ulen nivelet e ujit në kuotat më të ulëta në harkun kohor të 30 viteve. Prodhimi i përgjithshëm i energjisë në gusht 2000, ra vetëm në 88% të nivelit të vitit 1993, duke rezultuar në ndërprerje të shpeshta dhe të gjata në furnizimin me energji.

136. Mirembajtja, shtrirja dhe përmirësimi i rrjetit energjistik nuk po realizohen. Kooperata Energjetike Shqiptare (KESH) nuk është në gjendje të paguajë për më shumë se një sasi të vogël importi të energjisë, e nevojshme për të plotësuar burimet e saj, si rezultat i vështirësive financiare të shkaktuara nga përdorimi i paligjshëm në shkallë të gjere të energjisë, niveli i dobët i arketimeve, dhe cmimet më pakice të energjisë nën koston e energjisë së importuar. Në 1999, psh., vlerësohej që vetëm 58% e faturave të energjisë paguheshin. Asistenca në drejtim të menaxhimit për KESH, dhe sigurimi i burimeve qeveritare për të importuar energji, kanë arritur ta përmirësojnë disi situatën. Megjithatë, ndërprerjet mbeten të shpeshta dhe zonat rurale furnizohen me më pak energji se ato urbane. Qeveria ka akorduar rreth 21 milionë USD për importimin e energjisë në vitin 2001, kryesisht nga Greqia dhe Kroacia. Si rrjedhojë, vihet re njëfarë përmirësimi në furnizimin me energji, megjithatë ndërprerjet janë ende evidente. Nivelet e arketimit të faturave të energjisë janë përmirësuar në 94% gjatë tremujorit të parë të vitit 2001, kundrejt një mase të pritshme prej 70%, ndërsa humbjet u reduktuan në 43%, kundrejt një parashikimi prej 46%.

137. Është shumë e rëndësishme që të bëhet përmirësimi i furnizimit me energji në zonat rurale. Mungesa e energjisë shpesh përmendet si një nga pengesat më kryesore për zhvillimin e biznesit. Ajo gjithashtu vështireson edhe funksionimin apo shtrirjen e shërbimeve sociale. Për ta përmirësuar gjendjen, në prioritet duhet të përfshihen përmirësimet në aspektin e furnizimit me energji nëpërmjet investimeve në hidrocentrale, rritjes së sasisë së importeve, funksionimit më eficient dhe më pak kosto të shpërndarësve të energjisë, përmirësimin e nivelit të arketimit të faturave, dhe zvogëlimin e lidhjeve të paligjshme të energjisë.

138. **Dallimet rajonale në aksesin për shërbimet.** Mungesat në infrastrukture janë të mëdha në zonat rurale. Ekzistojnë dallime thelbësore në drejtim të aksesit, midis zonave malore, kodrinore dhe ato fushore. Infrastruktura rurale është më e zhvilluar në zonat e ulëta, më pak e zhvilluar në ato kodrinore dhe shumë e varfer në zonat malore. Kushtet shumë të keqja të jetesës dhe të shërbimeve infrastrukturore në fshatrat malore kanë imponuar një lëvizje masive drejt ultësirës bregdetare dhe qendrave të mëdha urbane. Kjo lëvizje demografike ka rritur presionin për shërbime në infrastrukture në zonat bregdetare dhe qendrat urbane, duke i bërë ato edhe më pak prioritare në zonat rurale. Ky rreth vicioz e bën të vështirë që të vendoset një ekuilibër ndërmjet kërkesës së lartë për shërbime rurale infrastrukturore në zonat e ulëta me të populluara, dhe nevojën për të investuar në infrastrukturen e rajoneve më të largëta dhe më të dendura me të

<sup>37</sup> Ligji "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", No. 8652, 31 korrik 2000, Neni 72, paragrafi 4/I/a).

vogel, për t'i dhënë atyre mundësi për t'u zhvilluar, rritur, hapur vende pune me të ardhura të mjaftueshme. Rruget rurale dhe furnizimi me ujë përfshihen rreth 80% të investimeve të kërkuara nga fshatari dhe autoritetet e komunave në kuadrin e nderhyrjeve të FZSH. (Aneksi III, Tabela 11). Gjetja e këtij ekuilibri do të jetë vendimtare për zhvillimin e Shqipërisë gjatë viteve të ardhshme. Përfshirja dhe pjesëmarrja e vazhdueshme e komuniteteve në ndërtimin e infrastrukurës dhe programet e rehabilitimit në nivel komune, do të jenë shumë të rëndësishme në kuadrin e këtij procesi.

### **Sherbimet mbështetëse rurale**

#### ***Prodhimi bujqësor***

139. **Ujitja dhe kullimi.** Shoqatat e Përdoruesve të Ujit (SHPU) mund të shërbejnë si instrumenta të mira për të menaxhuar infrastrukurën ujëtare dhe shpërndarjen e ujit në nivel lokal. Përgjegjësitë për shpërndarjen dhe mirëmbajtjen e ujit për vaditje janë duke i kaluar në mënyrë graduale SHPU dhe Federatës së SHPU. Në fund të vitit 1998, ekzistonte 537 SHPU të cilat mbulonin një sipërfaqe të ujit prej 117,000 ha ose 28% të sipërfaqes së ujitshme në vend, dhe 11 Federata të SHPU, përgjegjëse për të gjitha skemat e ujitjes përfshirë kanalet kryesore dhe nderhyrjet kryesore. Këto Federata pritet të mbulojnë shpenzimet nepermjet anetareve të tyre dhe të funksionojnë dhe mirëmbajnë infrastrukurën ujëtare në mënyrën e duhur. Progresi i Federatave të SH.P.U. është i dukshëm. Me shumë se 60% e sipërfaqes së mbuluar nga SH.P.U., rezultojnë të jete të mbuluar me ujë dhe fermeret janë të kënaqur me shërbimet e ofruara. Kontributet e anetareve janë rritur dhe kapaciteti për të mirëmbajtur sic duhet kanalet është përmirësuar. Tarifat e ujitjes mbledhen dhe perdoren për funksionimin dhe mirëmbajtjen e skemave. Brenda skemave të ujitjes, fermeret prodhojnë kulturë me cilësi me të mirë dhe janë në gjendje të arrijnë fitime me të mëdha me token e tyre. SHPU janë ngritur edhe në zonat me kodrinore ku burimet ujore ekzistojnë, dhe ku prodhimi pa ujitje do të kufizohej në masë të konsiderueshme.

140. Ekzistojnë 38 Ndermarrje Uji në nivel rrethi, përgjegjëse për: (a) mbledhjen dhe shpërndarjen e ujit përfshirë funksionimin dhe mirëmbajtjen e rezervuarëve dhe stacioneve të pompimit; (b) funksionimin e skemave të ujitjes në nivelin e parë dhe të dytë; (c) funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve kryesore të kullimit; (d) mbledhjen e faturave të ujit; (e) rehabilitimin e skemave ekzistuese të ujitjes dhe kullimit dhe ndërtimin e atyre të reja; dhe (f) kontrollin mbi përmbajtjen dhe mbrojtjen nga erozioni. Në fillim, ndermarrjet financoheshin nepermjet buxhetit kombëtar. Në fund, niveli i mbështetjes ka rënë, dhe secila ndermarrje duhet të vendosë tarifën ujëtare të pershtatshme për rrethet e tyre, t'i mbledhë ato për të financuar funksionimin dhe mirëmbajtjen, si dhe të kompensojë të gjitha shpenzimet për funksionimin dhe mirëmbajtjen nepermjet të ardhurave. Megjithatë, Ndermarrjet e Ujit neper rrethet kanë kaluar probleme financiare serioze si rezultat i paafesise së tyre për të bërë furnizimin me ujë si dhe për të mbledhur tarifën e ujit. Infrastruktura ujëtare e përkeqësuar, pompat jofunksionuese dhe të shtrenjta për t'u riparuar, mungesa e personelit, dhe praktikat e dobëta të menaxhimit, të gjitha këto ndikojnë në krijimin e një rrethi vicioz të furnizimit të dobët me ujë dhe nivelit të ulët të mbledhjes së tarifave. Ligji ekzistues për Ujitjen dhe Kullimin parashikon që ndermarrjet e ujit duhet të transformohen në borde përfituese-pjesëmarrëse kullimi. Për fat të keq, shumë pak progres është bërë në këtë drejtim.

141. **Pleherat.** Rritja e sasisë së pleherave gjatë viteve të fundit është rezultat i importeve të sektorit privat, kryesisht nepermjet tregtarëve private të organizuar në një rrjet të njohur si Shoqatat e Tregtarëve Shqiptarë të Plehrave dhe Agro-biznesit (AFADA), e cila u krijua në 1993 dhe tani numëron 120 anetare. AFADA ka zbatuar një program ekstensional që përfshin trajnim, publikim materiale, dhe krijim të parcelave demonstruese të cilat përmbajnë pleh potasiumi. Gjithashtu është ndërtuar edhe një program kreditimi, dhe shumë tregtarë tashmë janë në gjendje

që të marrin kredi nepermjet sistemit bankar. Sistemi shperndares i sektorit privat ka bere te mundur që plehurat të jene prezente ne të gjitha rrethet, megjithese ne zonat e uleta me të favorshme perdoret me shume pleh sesa ne zonat malore te cilat jane me të varfera. Rrjeti i pamjaftueshem dhe i pamirembajtur i rrugeve, rrit kostot e shperndarjes dhe kufizon nxitesat per te operuar ne zonat e izoluar, te njejten gje shkakton edhe natyra shume e copezuar e fermave.

142. Roli kryesor i sektorit publik eshte te rrise transparencen e marketingut dhe te zhvilloje rregulla per marketingun dhe perdorimin e plehrave, me synim sigurimin e mbrojtjes ligjore te perdoruesve, furnizuesve, dhe ambientit. Per kete qellim, eshte miratuar legjislacioni që percakton standartet minale te cilesise. Aktivitetet e ekstensionit te cilat perfshijne procedurat e duhura te perdorimit te plehurat referuar sasise, kohes, llojit dhe vendosjes, kane rendesine e tyre. Nga kjo pikepamje, eshte e rendesishme që sherbimi publik i ekstensionit te mbaje lidhje me sherbimet private ne rritje, te ofruara nga AFADA dhe ofrues te tjere nepermjet ndarjes se informacionit dhe aktiviteteve te perbashketa.

143. **Mbrojtja e bimeve.** Sot, ekzistojne shume tregtare private serioze dhe magazina te vogla ne nivel rrethi, te cilat ofrojne materiale te mbrojtjes se bimeve, megjithese kimikatet bujqesore ende perdoren ne sasi te vogla. Anetareve te AFADA, u eshte ofruar mbeshtetje per importimin e produkteve te ndryshme, ne aspektin e trainimit dhe licencimit per te shperndare keto produkte, dhe per te demonstruar efektivitetin e tyre nepermjet eksperimentimeve ne fushe. Perpjekjet ekstensive jane fokusuar ne metodologjine e kontrollin e barerave te keqija dhe te demtuesve, perfshire kontrollin e kimikateve, ndersa perpjekje po behen per te promovuar menaxhimin e integruar te demtuesve tek ullinjte. Shoqata Kombetare e Fermereve Organike nxit bujqesine organike.

144. Funkcionet rregulluese dhe kontrolluese ne mbrojtjen e bimeve, venia ne karantine e bimes dhe regjistrimi i pesticideve jane pergjegjesi e Sherbimit te Mbrojtjes se Bimeve. Ky rol perfshin identifikimin dhe regjistrimin e kimikateve te pranueshme per import dhe perdorim, licencim te subjekteve shites, ofrim trainimi per agjente te licencuar te marketingut, dhe inspektim te ambienteve te shitjes, per te monitoruar kushtet e ruajtjes dhe datat e skadences. Gjithsesi, ekzistojne shqetesime që lidhen me cilesine e keshillimit te ofruar nga tregtaret e pakices, ruajtja jo ne kushtet e pershtatshme, shitja e produkteve te skaduara, si dhe rreziqet që kercenojne ambientin dhe shendetin publik me perdorimin e pesticideve. Per pasoje, eshte e nevojshme që te permiresohet implementimi i rregullave dhe te behet kontroll i nje cilesie me te larte per te mbrojtur perdoruesit dhe konsumatorët. Ne vitet e ardhshme, do te jete ne epiqender shtrirja e informacionit dhe promovimi i alternativave per llojet e ndryshme te pesticideve, ne menyre që te parandalohen fermeret nga perdorimi i nje mase te vetme prodhimi, e cila mund te mos jete edhe aq efciente dhe me kosto te larte ne perdorim.

145. Sherbimi i Mbrojtjes se Bimeve perfshin gjithashtu inspektoret kufitare, pergjegjes per inspektimin e materialeve mbjellese (fidanave) që hyjne ne Shqiperi, kontrollin fito-sanitar te certifikatave, dhe kontrolli i problemeve potenciale nga importi i materialeve te infektuara. Megjithate, mungesa e mjeteve te komunikimit dhe transportit, dhe aksesit i kufizuar ne informacion, e ul efektivitetin e ketyre inspektoreve, vecanerisht te atyre që ndodhen ne zonat e largeta kufitare.

146. Eshte evidente që Sherbimi i Mbrojtjes se Bimeve ka nevojte te fuqizohet dhe te behet me dinamik, per te permbushur rolin e tij te rendesishem te mbrojtjes se konsumatoreve dhe te ambientit nga demtuesit dhe efektet negative te pesticideve. Kjo do te kerkonte:

- nje sistem te shendoshe dhe te pavarur kontrolli te cilesise, per te monitoruar produktet që i jane nenshtuar kontrollit te demtuesve dhe rregullimi i shperndarjes, perfshire edhe kapacitetet e duhura laboratorike per te testuar dhe kontrolluar cilesine e produkteve te importuara apo te prodhuara ne vend, dhe permiresim i kapacitetit rregullues dhe inspektues per te siguruar nje magazinim dhe shperndarje te sigurt;

- rritja e kapacitetit per te testuar dhe analizuar produktet, token dhe ujin per mbetjet nga pesticidet apo ilacet;
- perfundimi i manualit per inspektoret kufitare dhe sigurimi i mjeteve te komunikimit dhe transportit; dhe
- dhenia e keshillave mbi metodat e pershtatshme te kontrollit me prioritet parandalimin dhe kontrollin jokimik.

147. **Mekanizimi bujqesor.** Ne pergjithesi, fermat jane shume te vogla per te justifikuar blerjen e traktoreve dhe te pajisjeve te tjera, dhe kontraktoret e sektorit privat sot ofrojne pjesen me te madhe te sherbimeve te makinerive. Por, ende ekzistenca e makinerive bujqesore te pershtatshme perben nje problem, megjithese perdorimi i kafsheve te punes ka zvendesuar pjeserisht traktoret ne disa zona kodrinore dhe malore. Ky problem mund te zgjidhet me marketingun e pajisjeve te vogla bujqesore te pershtatura kushteve lokale si p.sh. traktoret me dy rrota dhe pajisje qe terhiqen nga kuajt, dhe me tej duke promovuar ngritjen e sherbimeve private te qiradhenies se makinerive neper fshatra. Perfitimet teknike te mekanizimit perfshijne: pergatitje me eficente dhe ne kohen e duhur te tokes; saktesi me te madhe dhe perpikmeri kohore ne mbjellje; hedhjen e plehut dhe mbrojtjen e bimes; dhe nje vjelje shume me te perpikte ne kohe. Si kembim, keto perfitime mund te rezultojne ne nje rritje te rendimentit te prodhimit (rendimenti rritet rreth 10 deri ne 20%) si dhe permiresim te cilesise se kultures bujqesore.

148. Ne pergjithesi, qeveria nuk duhet te perfshihet ne ceshtje qe lidhen me funksionimin dhe mirembajtjen e makinerive bujqesore, ngritjen e parqeve te makinerive, kryerjen e sherbimeve te mekanizimit apo kontrollin e struktures se cmimeve per sherbimet e mekanizimit. Sipermarresit lokale, te cileat jane me te afte per te vleresuar nevojat dhe kerkesat e nje numri te madh fermeresh te vegjel neper rrethet e tyre, mund ta kryejne kete sherbim shume me mire. Sektori publik duhet per rrjedhoje, te kufizohet ne nje rol mundesues, megjithese ka hapesire per te testuar, demonstruar dhe perhapur teknologjite si p.sh. pajisjet e vogla te mekanizuara dhe ato qe vihen ne pune nepermjet kafsheve.

149. **Farerat.** Perpara reformes, zhvillimi i te gjitha varieteteve dhe shumezimi i farerave ne Shqiperi kryheshin nga institutet kerkimore bujqesore dhe fermat e farerave, te cilat ishin ne pronesi te shtetit, me objektivin paresor te prodhimit te farerave per varietete te pershtatshme per perdorim nga fermat e medha shteterore dhe kooperativat. Por sistemi i prodhimit te farerave u shkaterrua gjate fillimit te tranzicionit, dhe fermeret duhej te mbeshteteshin ne farerat e prodhuara vete, te cilat shpesh ishin te nje cilesie te dobet, me shkalle te ulet mbirjeje si dhe me probleme te demtimit nga barerat e keqija dhe semundjet. Ndermarrjeve shteterore te farerave ne secilin rreth u mbeti pergjegjesia per te shumezuar dhe prodhuar farera, duke perdorur farera me aftesi te larte prodhuese, te prodhuara nga institutet e kerkimeve. Por ky system provoi te mos ishte i suksesshem. Pjesa me e madhe e ndermarrjeve shteterore te farerave tashme jane privatizuar, megjithese ende ekzistojne dy ndermarrje, ajo e Tiranës dhe e Korces, te cilat thuhet se jane ne prag ose te privatizimit, ose te mbylljes.

150. Keto vitet e fundit, ka patur nje rritje te konsiderueshme sasore dhe cilesore te industrise se farerave ne Shqiperi, si rezultat i aktivitetit te sektorit privat, perfshire shtrirjen e prodhimit te farerave per kultura te cilesise se larte si p.sh., vreshtat dhe pemet frutore, importimi i hibrideve te cilesise se larte per farerat e perimeve, dhe rritja ne prodhimin a fares se grurit, misrit, jonxhes dhe patates. P.sh., importi dhe shitja e farerave te perimeve pothuajse u dyfishua ne vlere nga viti 1999 deri ne 2000, duke regjistruar 3 milion USD. Numri i prodhuesve private te farerave ne Shqiperi po rritet dita dites, dhe jane krijuar edhe disa shoqata te fermereve private, me qellim prodhimin e farerave. Keto shoqata perfshijne Shoqaten e Rritesve te Fares se Misrit e vendosur ne Shkoder, e cila prodhon fara hibride te misrit, dhe Shoqata e Prodhuesve te Farerave ne Korce, e cila prodhon farera te certifikuara per grurin, jonxhen dhe kulturat e tjera. Prodhimi i farerave per qellime tregtimi nga rritesit private te farerave pritet te rritet persa i perket rendesise gjate viteve ne vijim, si rezultat i vellimit dhe sasise se farerave te kerkuara nga fermeret shqiptare,

megjithese importet duket se do te mbeten te rendesishme per farerat e perimeve dhe ne nje fare mase, per hibridet e misrit.

151. Prodhuesit e farerave komerciale kerkojne burime te farerave me potencial te larte prodhues si p.sh. linjat prinderore ose shumezuesit super-elite dhe farerat elite (formuese). Shume pak mundesi ka qe kjo fare te jete gjeresisht prezente ne sektorin privat ne te ardhmen e afert, ne mungese te kompanive private te shumezimit te farerave ne Shqiperi. Per pasoje, ndersa qeveria nuk duhet te perfshihet drejtperdrejt ne aktivitetet prodhuese te farerave, institutet e kerkimeve bujqesore kane rolin e rendesishem te prodhimit te farerave me potencial prodhues te larte, per t'iu shitur prodhuesve te farerave. Gjithashtu, ka ende arsye per keto institute te vazhdojne zgjedhjen, testimin dhe zhvillimin e varieteteve te reja. Programet ne pergjithesi, nuk duhet te permbajne gjenetiken baze te bimes dhe aspektin shumezues, i cili shpesh eshte i kushtueshem dhe qe kerkon kohe te jape rezultate. Ne te kundert, tashme po zhvillohet nje sistem i mire per futjen dhe testimin e linjave dhe varieteteve te rritura per tejet detit. Shumezimi i farerave i cdonjerit prej varieteteve te pershtatshme mund te kryhet me pas ne Shqiperi brenda rregullave dhe rregulloreve te Ligjit per Mbrojtjen e Varieteteve te Bimeve<sup>38</sup>.

152. Ndersa prodhimi i farerave i ka kaluar sektorit privat, sektori publik vazhdon te kete nje rol ne certifikimin e farerave, dhe ne grumbullimin, vleresimin dhe ruajtjen e germplazmes. Aktivitetet per certifikimin e farerave perfshijne inspektimin ne fushe, testimin e fares, dhe certifikimin e kryer nga deget rajonale te Institutit Kombetar te Farerave. Megjithate, ne perspektiven afat-gjate, pritet qe prodhuesit e farerave te marrin mbi vete pergjegjesine per inspektimin ne fushe dhe testimin e farerave qofte drejtperdrejt apo nepermjet kontraktimit me agjenci te pershtatshme dhe /ose labororet. Roli publik me pas do te kufizohet ne vendosjen e rregullave dhe monitorimit te respektimit te tyre.

#### ***Ekstensionit dhe Puna Kerkimore***

153. **Sherbimet e ekstensionit.** Progres i konsiderueshem eshte bere ne drejtim te ngritjes se nje sherbimi ekstensionit efektiv dhe eshte vene ne funksionim nje strukture dhe metodologji e mire organizative. Sherbimi sot perfshin rreth 250 veta personel ne nivel komune me ekspertize ne agronomi dhe prodhim blegtoral. Personeli i ekstensionit eshte pergjithesisht i mireinformuar per detyrat e tij, dhe zoteron nje koncept te qarte mbi metodologjine e ekstensionit qe aplikohet sot. Ai mban kontakte te mira me fermeret, dhe ka nje program demonstrimesh, takimesh, dhe sesionesh trainimi si ne baze grupi ashtu edhe individuale te mireplanifikuar. Nje numer i konsiderueshem fletepalosjesh eshte pergatitur dhe shperndare. Programi i trainimit ne pergjithesi ka qene i mire dhe ka perfshire disa elemente te buxhetit te fermes, menaxhimit financiar, dhe marketingut me njoftime. Dhe ne fund, programet kerkimore ne ferme, perbejne nje perpjekje te dobishme per te permiresuar lidhjet ndermjet punonjesve kerkimore, atyre te ekstensionit dhe fermereve, ndersa demonstrimet shpesh trajtojne probleme me te cilat fermeri ndeshet ne fushe.

154. Megjithate, ka ende hapësire per nderhyrje suplementare, vecanerisht ne zonat me lidhje te kenaqshme me drejtorite teknike te MBU; permiresim te lidhjeve ndermjet strukturave kerkimore dhe atyre te ekstensionit; ndarje te metejshme te kriterave rregulluese (perfshire mbledhjen e te dhenave statistikore) nga sherbimet keshillimore; permiresim i shkalles se pergjigjes nga sherbimet e ekstensionit ndaj kerkeses dhe perfshirja e informacionit mbi tregun dhe atij bujqesor ekonomik ne mesazhet e ekstensionit. Te permbledhura, dobesite mund te paraqiten si me poshte:

- Pas punes me grupe te vecanta te interesuara fermeresh, shume pak vijimesi realizohet me grupe jashte objektivit, te cilat rezultojne me impakt te kufizuar.

<sup>38</sup> Projekti i Sherbimeve Bujqesore i financiar nga Banka, mbeshtet krijimin e nje kuadri ligjor te pershtatshem, si dhe prodhimin e farerave me prodhimitari te larte neper institutet e farerave.

- Nuk ka lidhje formale te mjaftueshme me Qendren e Informacionit Bujqesor dhe me drejtorite teknike, vecanerisht ne nivel qendror.
- Informacioni per tregun ne dispozicion te fermerëve është i paket.
- Lidhjet ndermjet strukturave kerkimore dhe atyre te ekstensionit jane te dobëta, megjithë futjen e programeve kerkimore ne ferme.
- Pjesëmarrja nga fermerët ne hartimin dhe kryerjen e disa demonstrimeve ne ferme dhe kerkimeve, është e kufizuar, duke cuar ne interes te kufizuar.
- Programi i ekstensionit nuk është ne sintoni te mjaftueshme me kerkesen, dhe ka shume pak pergjegjshmeri nga ana e punonjesve te ekstensionit per cilesine e tyre te punes.
- Sherbimi i ekstensionit ka nje buxhet te kufizuar per aktivitetet e tij, dhe i mungon nje sistem informacioni per monitorimin e shpenzimeve dhe kostove.
- Pagat per specialistet e ekstensionit jane te uleta, duke e bere te veshtire motivimin e personelit te afte dhe thithjen atij te ri.
- Mungesa e zyrave dhe e pajisjeve te komunikacionit ne nivel komune, veshtireson per fermerët dhe personelin e rrethit kontaktimin me specialistet e ekstensionit.

155. Nje dokument<sup>39</sup> mbi politiken kombetare te ekstensionit, paraqet transferimin gradual te pergjegjesise per sherbimin e ekstensionit, aty ku është e pershtatshme, nga sektori publik tek ai privat. Kjo strategji do te zbatohet nepermjet ngritjes se Qendrave Rajonale te Keshillimit Bujqesor per t'i sherbyer 13 rrethëve ne zonat kryesore bujqesore. Keto qendra do te ofrojne sherbime si teknike ashtu edhe per zhvillimin e biznesit, ne rradhe te pare per fermerët e medhenj te orientuar drejt tregut, duke vendosur tarifa per sherbimet. Sherbimi publik i ekstensionit brenda MBU, per pasoje do te fokusohet tek fermerët e mesem dhe te vegjel, duke perdorur masmedian dhe grupet e interesuara te fermerëve, por nga ana tjetër do te vijë duke u transformuar ne sherbim me baze rikuperimin e pjesshem te kostos.

156. Organizata te ndryshme tregtaresh dhe prodhuesish kane filluar aktivite ekstensionit, perfshire AFADA. Ne vijim te trainimit mbi metodologjine e ekstensionit, i financuar nga USAID, ne kuadrin e Projektit AAATA, AFADA tashme ka filluar aktivitetet teknike te ekstensionit, perfshire publikimin e fletpalosjeve dhe broshurave mbi perdorimin e plehrave, krijimin e parcelave demonstruese, dhe prezantimeve ne masmedia. Organizata te tjera si Shoqata Kombetare e Prodhuesve te Fares se Patates, Shoqata e Hortikultures, dhe Shoqata e Prodhuesve te Vajrave Ushqimore, kane filluar edhe ato aktivite private te ekstensionit me asistencen e projektit AAATA.

157. **Vepimtaria kerkimore ne bujqesi.** Perpara reformes, sistemi i kerkimit bujqesor siguronte informacion i cili kalonte tek punonjesit e punesuar ne fermat shteterore dhe kooperativa. Ne vitin 1991, ekzistonin 18 institute kerkimore pervec stacioneve rajonale me rreth 342 studiues kerkimore dhe 4,654 personel. Megjithate, ky sistem u shkaterrua shume shpejt si pasoje e financimeve te kufizuara, rrjedhjes se personelit, laboratorët dhe pajisjet e vjeteruara, mungesa e transportit dhe sherbimeve, dhe degradimi i godinave.

158. Ne 1994, si rezultat i nje veshtrimi te thelle ne kete aspekt, Projekti SARA (Mbeshtetje per Ristrukturim ne Shqiperi), projekt i financuar nga USAID, pergatiti nje plan te plote ristrukturimi. Plani perfshinte rekomandimet ne vijim: (a) krijimi i nje Bordi te Kerkimit Bujqesor, i cili do te percaktonte prioritetet e punes kerkimore, aprovonte projekte dhe buxhete, dhe orientonte dhe mbikqyrte implementimin e planeve ristrukturuese; (b) uljen e numrit te instituteve dhe konsolidimin e atyre ekzistuese ne nje Qender Kombetare te Kerkimit Bujqesor dhe Ekstensionit dhe kater Qendra Rajonale te Kerkimit dhe Ekstensionit ne zona te ndryshme agro-ekologjike; (c) ndarjen e aktiviteve te sherbimit si prodhimi i spermes, fares dhe vaksinave dhe aktiviteve te tjera potencialisht per qellime komerciale nga programi i kerkimit; (d) nderprerja e punes kerkimore per kultura relativisht te parendesishme si orizi, pambuku,

<sup>39</sup> I titulluar "Ristrukturimi i Platfomes se Sherbimit te Ekstensionit". Aprovuar nga Keshilli i Ministrave me Vendimin No. 522 te 22 gushtit 1998.



luledielli, panxhar sheqeri dhe krimbi i mendafshit; dhe (e) kalimi i aktivitetit kerkimor per duhanin dhe bletet tek sektori privat.

159. Ne zbatim te ketyre propozimeve, u be njefare pune ristrukturuese. Numri i instituteve u ul nga 18 ne 14. U ngrit nje Bord, i cili u mblodh tre apo kater here, megjithese u shenua shume pak progres i pergjithshem, pjeserisht si rrjedhoje e ngjarjeve te vitit 1997. Gjate kesaj periudhe, nje pjese e tokave te instituteve kerkimore u zu, godinat u demtuan, materiali gjenetik (kulturat dhe gjeja e gjalle) humben, dhe dokumentacioni kerkimor u shkaterrua. Personeli tashme perfshin rreth 165 shkencetare dhe 762 personel ne total. Ka patur edhe asistence nga donatoret ne drejtim te permiresimeve dhe aktiviteteve specifike, por aktualisht nuk disponohen fonde per ristrukturimin e sistemit ne teresi.

160. Sistemi kerkimor mbetet i dobet, me financime te kufizuara per aktivite kerkimore. Institutet vazhdojne te sigurojne te ardhura prej sherbimeve dhe nga shitja e farerave dhe fidanave, fares per nderzim artificial, vaksina dhe ilace veterinare, dhe mbareshtimit te gjese se gjalle. Aktiviteti kerkimor nuk eshte posacerisht i orientuar drejt zgjidhjes se problemeve ne nivel ferme; ai zakonisht fokusohet me shume ne kerkimet baze si ne permiresimin gjenetik te kulturave bujqesore dhe te gjese se gjalle, sesa ne kerkimin e aplikuar dhe futjen e teknologjive te reja. Megjithate, programi i aktivitetit kerkimor brenda Projektit Kombetar te Ekstensionit ne Shqiperi dhe Programi i Granteve Konkruese ne kuadrin e Projektit te Sherbimeve Bujqesore, mund te nxisin nje kalim tek kerkimi i aplikuar ne fushe.

#### ***Prodhimi blegtoral dhe sherbimet veterinare***

161. **Prodhimi blegtoral.** Megjithe mbizoterimin e sistemeve te vogla te prodhimit blegtoral, ka filluar te gjallerohet prodhimi per qellime tregtimi dhe perpunimi. (Tabela 8). Kjo tendence bazohet ne radhe te pare ne krijimin e fabrikave te vogla te perpunimit, te drejtuara nga biznese private familjare dhe shoqata, duke iu larguar keshtu tradites te se shkuares te operacioneve te medha perpunuese. Perpjekjet pilote me mbeshtetjen e donatoreve, kane provuar dobine e permiresimeve ne mbledhjen dhe cilesine e produkteve te qumeshtit, dhe nxitesit qeveritare ne mbeshtetje te perpjekjeve te tilla do te zgjerohen. Nxitesa te tille mund te permiresonin eficencen, shendetin e kafsheve dhe higjienen neper thertore.

**Tabela 8. Prodhimi agro-industrial i produkteve te perpunuara blegtorale**

	1993	1997	1999	2000	2001
Qumesht (hl)	--	9,282	36,572	33,196	46,500
Gjalpe (ton)	16	229	315	440	334
Djathe (ton)	582	6,288	6,743	8,404	8,056
Kos (ton)	525	4,652	4,351	5,310	4,223
Sallam dhe Proshute (ton)	166	3,238	3,821	4,055	4,395

Burimi: *Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit.*

162. Pavaresisht tendencave te permendura me lart, vetem nje sasi e vogel e prodhimit perpunohet dhe zona e tregut shpesh kufizohet kryesisht ne zona te prodhimit per konsum. Kostot per mbledhjen dhe shperndarjen e produkteve te bulmetit jane te larta, si rezultat i rrugeve te keqija, numrit te konsiderueshem te prodhuesve te vegjel, dhe sasite e vogla per shitje. Produktet blegtorale shqiptare jane te nje cilesie me te ulet sesa ato te importit, ne drejtim te prezantimit, klasifikimit dhe paketimit. Ky problem i ve produktet shqiptare ne disavantazh, ne nje kohe kur shpenzimet nga ambalazhi njeperdorimesh po rriten dhe konsumatoret shqiptare po behen gjithnje e meshume te ndergjegjeshem. Cilesia e ulet e produkteve dhe paaftesia per te arritur standartet, gjithashtu i kufizon eksportet.

163. Perpunimi i mishit eshte i papershtatshem dhe ka degraduar seriozisht kete dekadene e fundit. Thertoret e medha dhe jorentabel jane mbyllur dhe zevendesuar me therrje ne oborrin e

shtepise, ne kushtet e nje higjiene te dobet dhe pa asnje lloj kontrolli. Lipsen urgjentisht permiresime, megjithese nuk behet me fjale per rikthimin e thertoreve te medha. Rritja e mundesive per kreditim dhe nje strukture nxitese, mund te conte ne krijimin e ambienteve me te mira nga sektori privat. Bashkete apo pushteti vendor mund te mbështesin ndertimin e ambienteve te thjeshta duke i dhene ato me qira per kasapet lokale, mbi bazen e mbulimit te kostos. Investime te tilla ne sektorin publik, mund te rrisin higjiene, reduktonin humbjet, dhe ulnin rrezikun e semundjeve te shkaktuara nga ushqimi, nese kombinohen me vendosjen e rregullave transparente dhe shtrenguese (pas konsultimeve te gjera me aktoret) dhe mbiqyrjen nga afer te aktiviteteteve perpunuese.

#### **Kutia 4. Marketingu i qumeshtit per te varferit**

*Marketingu i qumeshtit ne Shqiperi dominohet nga (a) shitja direkte e qumeshtit nga prodhuesit apo rishitesit (dora e dyte), dhe (b) shitjen e qumeshtit te pasterizuar nepermjet baxhove dhe dyqaneve. Konsumatori Shqiptar eshte shume i ndergjegjshem per rrezikun e perdorimit te seciles nga keto hapësira tregtimi. Dyqani eshte i shtrenjte, dhe jo gjithmone mund te jete i besueshem. Shitesit e qumeshtit ne ane te rruges apo ne tregje, shesin qumesht te papasterizuar, por qe kane krijuar nje klientele te rregullt, "kontrolli i te ciles per cilesine" konsiston ne blerjen e qumeshtit nga shites te besuar dhe zierja e tij ne shtepi. Cmimi i ketij qumeshti eshte shume i ulet ne krahasim me ate te pasterizuar, duke e bere te perballueshem nga ana e te varferve urbane dhe rurale. Shume e shohin kete lloj sistemi marketingu per qumeshtin si te prapambetur, dhe nuk pranojne rendesine e moskuptimit te cilesise informale nga konsumatorët dhe te mundesise se perballimit te cmimit nga ana e te varferve urbane dhe rurale.*

164. **Furnizimi me ushqim per blegtorine dhe kullotja.** Sektori ne rritje i blegtorise po shton kerkesen per furnizim me ushqim. Duke qene qe mundesite per zgjerimin e kullotave natyrore jane te kufizuara, kerkesa e larte per ushqim duhet te permbushet kryesisht nga prodhimi i permiresuar i tagjise si jonxha, misri dhe barera te tjera, dhe shfrytezimi me i mire i nenprodukteve industriale si p.sh. sapun, ulliri, krundet dhe sojen. Bimet foragjere sot rriten ne nje siperfaqe prej 165,000 ha, ose 40% e tokes se punueshme te mbjelle, me jonxhen e cila ze rreth 2/3 e kesaj siperfaqeje. Pjesa me e madhe e prodhimit vilet me dore, dhe ekzistojne probleme me barerat e keqija dhe ruajtjen ne kushte te keqija te barit te thate. Me shume theks duhet vene tek masat per permiresimin e cilesise se foragjereve, menaxhimin e intensifikuar dhe praktikate ushqyese, dhe rritjen e prezences se fares se paster.

165. Burimet e ushqimit per gjene e gjalle, perfshijne kullotat, pyjet dhe nje pjese te tokes bujqesore. Rendesia e ketij burimi pasqyrohet ne faktin qe rreth 60% e popullsise shqiptare eshte e angazhuar ne nje menyre a nje tjetër, ne kullotje sezonale, kryesisht te deleve dhe dhive. Shume kullota dhe pyje kane degraduar ne menyre te ndjeshme gjate pese apo dhjete viteve te fundit, vecanerisht ne zonat prane komuniteteve, ku mbishfrytezimi dhe prerja iracionale e drurit kane cuar ne uljen e produktivitetit dhe erozionin e tokes.

166. Drejtoria e Pergjithshme e Pyjeve dhe Kullotave ne MBU eshte pergjegjese per menaxhimin e kullotave dhe per mbledhjen e tarifave te kullotjes, por kjo metode e centralizuar rralle eshte pranuar nga perdoruesit lokale. Legjislacioni i fundit lejon transferimin e te drejtave te perdoruesve dhe menaxhimin e pyjeve dhe kullotave te komunitetet<sup>40</sup>. Rreth 250,000 ha toke

<sup>40</sup> Ligji per "Pyjet dhe Sherbimin e Policise Pyjore" (No. 7223 i 13 tetorit 1992) eshte ligji i pare shqiptar per pylltarine. Ligji percakton pasurine pyjore te vendit ("fondi i pyjeve") i cili perfshin Shtetin, pyjet komunale dhe private. Menaxhimi i pyjeve shteterore eshte pergjegjesi e administrates se pyjeve, megjithese ligji nuk i specifikon metodat. Menaxhimi i pyjeve private nuk mbulohet nga ky ligj. Pyjet komunale jane nje kategori e re, e cila ndersa toka eshte ende ne pronesi te shtetit, mund te menaxhohet bashkerisht nga komunat dhe Drejtoria e Pergjithshme e Pyjeve dhe Kullotave. Kane dale tekste te ndryshme plotesuese per ligjin e pylltarise, perfshire edhe rregulloret per shfrytezimin e pyjeve, vendimet mbi percaktimin e pagesave apo tarifave te tjera te pyjeve, udhezime per anekandet per drurin e vjeter, instruksione per mbrojtjen kunder zjarreve ne pyje, parimet per zgjedhjen dhe krijimin e zonave ne mbrojtje, dhe shfrytezimin e pyjeve per qellime rikrijuese.

kullote dhe 200,000 ha pyje në 250 nga 315 komunat shqiptare, është identifikuar si toke që mund të transferohet. Kjo nuk përfshin kullotat alpine, të cilat mbeten toke në mbrojtje nën kontrollin e Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave. Projekti i Pylletarisë<sup>41</sup> i financuar nga IDA përmban një komponent të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave komunale, i cili synon (a) rehabilitimin dhe rritjen e prodhimit të kullotave pranë fshatrave, në mënyrë që të përmbushen kërkesat për dru zjarri dhe ushqim për blegtorinë; dhe (b) asistencë në transferimin e tokës të komunitetit, fillimi i një menaxhimi përfshirës të këtyre sipërfaqeve me një shpërndarje transparente të burimeve për përfituesit lokalë, dhe arritjen e një menaxhimi të qendrueshem nëpërmjet një sistemi të tarifave të përdorimit, në funksion të mirëmbajtjes së burimeve dhe investimeve të metejshme. Megjithatë, ky numer përfaqëson vetëm një sasi të vogël të numrit total të komunave, dhe ekziston hapësirë e konsiderueshme për të përfshirë edhe komuna të tjera.

167. **Sherbimet veterinarë.** Në planin e përgjithshëm, shëndeti i kafsheve është i dobët, në pjesën më të madhe për arsye të kequshqimit, aftësive të dobëta të fermerëve në drejtim të kujdesit për shëndetin e kafsheve, dhe prezencës apo aftësive të blerësve të kufizuar për medikamente veterinarë. Ekzistojnë rreth 800 veterinarë publikë dhe privatë që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri. Prekshmeria e lartë nga semundjet e kafsheve, të transmetueshme tek njerëzit, përfshirë brucelozën (prekshmeri prej 1.3 % tek njerëzit), antraksi (prekshmeri prej 0.28% tek kafshet) dhe tuberkulozi (0.8% tek kafshet) është shkak për të kushtuar vëmendje të posaçme. Gjithashtu, trajtimi dhe kontrolli i parazitëve dhe semundjeve të tjera të kafsheve është i kufizuar.

168. Legjislacioni më i fundit mbi shëndetin e kafsheve e ka ndarë tashmë sistemin e kujdesit veterinar në dy aspekte të vecanta. I pari që përfshin kontrollin dhe zhdukjen e semundjeve epidemike dhe zoonotike që përbejnë një rrezik për shëndetin e qenieve humane, si antraksi dhe tuberkulozi. Kjo pjesë e sistemit është ruajtur si një program i MBU, megjithatë mund të kontraktohen edhe veterinarë privatë për të kryer shërbimin. Momentalisht, fushata kundër këtyre semundjeve janë në proces, por që gjithsesi nuk janë sistematike, meqenëse fondet nuk janë të mjaftueshme për të përballuar kostot e reagentëve dhe vaksinave si dhe ekzekutimin e fushatave. Në përgjithësi, vetëm 30% e kafsheve testohen. Ky program është i rëndësishëm si për arsye të shëndetit publik dhe për prodhimin e produkteve blegtorale që mund të eksportohen në vendet e BE. Megjithatë, kosto-efekshmëria dhe prioriteti i këtij programi duhen rishikuar<sup>42</sup>.

169. Fusha e dytë e kujdesit veterinar trajton semundjet dhe crregullimet joepidemike, përfshirë parazitët e brendshëm dhe të jashtëm që nuk përbejnë problem për shëndetin e publikut. Trajtimi dhe kontrolli i këtyre problemeve që lidhen me shëndetin e kafsheve, janë përgjegjësi e zotëruesve të gjëse së gjalle dhe veterinarëve privatë. Veterinarët privatë vendosin tarifa për shërbimet e tyre dhe për ilaçet dhe preparatet, dhe shumë prej tyre madje zotërojnë depo të vogla ku shesin medikamente veterinarë. Disa veterinarë privatë mund të kontraktohen për të kryer fushata kontrolli të semundjeve, duke siguruar kështu të ardhura shtese.

170. Projekte të asistuar nga donatorët po tentojnë të rifillojnë dhe të vazhdojnë Programin e Nderzimit Artificial, kryesisht për gjedhet. Këto programe mund të reduktojnë shkallën e

---

Ligji për “Kullotat dhe Token Kullote” (No. 7917 i 13 prillit, 1995) është për token e mbuluar me bar dhe shkurre të përdorshme për kullota dhe kositje, që nuk i takon as fondit të tokës bujqësore dhe as fondit të pyjeve. Ai i ndan kullotat dhe livadhet në (a) toke kullote në pronësi të shtetit e administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave; (b) toke kullote në pronësi të shtetit për përdorim të përgjithshëm, e administruar nga bashkia apo komuna respektive; dhe (c) toke private, përfshirë pronësi në grup. Ky ligj shkon edhe më tej se ligji për pyjet, duke decentralizuar të drejtat e përdoruesve tek institucionet e qeverisjes vendore dhe duke lejuar pjesëmarrjen e popullsisë së prekur. Komunitet janë plotësisht përgjegjëse për menaxhimin teknik dhe financiar të kullotave komunale. Komunitet gjithashtu mund të realizojnë edhe kontrata të qiradhenies me njerëzit e interesuar në përdorimin e kullotave komunale. Roli i Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave është të aprovojë ndryshimet në shfrytëzimin e kullotave komunale dhe ato private, të sigurojë asistencë teknike (shërbime ekstensionale) kundrejt pageses, dhe të mbrojë kullotat dhe livadhet nga demtimi.

<sup>41</sup> Financim është ofruar gjithashtu nga Italia dhe Zvicra.

<sup>42</sup> P.sh., kosto e trajtimit mjekësor të semundjeve zoonotike duhet krahasuar me koston e parandalimit. Një studim i tillë mund të perfundohet bashkërisht me agjencitë e bujqësisë dhe të shëndetit.

prekshmerise nga semundjet riprodhuese, permiresojne materialin gjenetik, dhe mund te rezultojne me shume ekonomike sesa mbareshtimi natyral. Fermeret i japin prioritet te larte shendetit te kafsheve te tyre, dhe ne pergjithesi ata deshirojne te paguajne per sherbimet veterinare dhe medikamentet kur ata kane akses tek nje veteriner privat i respektuar. Kjo u provua nga nje program i implementuar nga Fondacioni per Blegtorine, i cili si fillim ishte pjese e mbështetjes se Bankes Boterore per FZSH. Te gjitha kafshet ne nje fshat trajtoheshin kunder nje game semundjesh per nje periudhe dy-vjecare, ndersa fermeret paguanin 50% te kostos ne vitin e pare dhe 70% ne vitin e dyte. Ne vitet ne vazhdim, fermeret duhet te paguanin koston totale te trajtimeve te ndryshme. Nga nje vezhgim i pjesemarresve, numri i fermereve qe trajtojne kafshet e tyre u rrit nga 20% ne 60% ne kuader te programit<sup>43</sup>. Prodhimi qumeshtit u rrit nga 100 ne 180litra/koke lope dhe nga 12 ne 18 litra/koke tek te imetat, ndersa pjelloria u rrit nga 5 ne 8% tek ripertypet dhe nga 10 ne 20% tek ripertypet. Ky program eshte zbatuar ne disa rrethe malore, dhe ka aresye te shendosha per zgjerimin e aktiviteteve neper rrethe te tjera. Pervец rritjes se prodhimit dhe ndergjegjesimit per dobine e trajtimit, perfitimet perfshijne dhe zhvillimin e nje sistemit privat veterinar qe mund te trajtoje semundje joepidemike dhe probleme te tjera te shendetit te kafsheve. Inisiativa te ngjashme mund te fillojne per perdorimin e sherbimeve dhe keshillimit mbi mbareshtimin.

### Marketingu dhe agro-perpunimi

171. Infrastruktura e kufizuar e tregut shpesh permendet si nje nga pengesat kryesore per prodhimin bujqesor. Ajo perbehet nga nje informacion shume i paket per tregun, mosperputhje me standartet, dhe paketim dhe etiketim i papershtatshem. Keto pengesa jane prezente si ne tregjet e inputeve ashtu dhe ne ato te outputeve.

172. **Tregjet e eksportit dhe importit.** Eksportet kryesore shqiptare perfaqesohen nga duhani dhe produktet e peshkut. Produkti kryesor i importit eshte gruri. Partneret kryesore tregtare jane vendet fqinje te BE, perfshire Italine, Greqine, Gjermanine, Turqine dhe Bullgarine (Tabela 9). Kontributi i eksporteve ne GDP ne vitin 1999, ishte 10%, perqindje relativisht e ulet krahasuar me vendet fqinje ne tranzicion. Struktura e tregtise ka ndryshuar ne menyre te dukshme. Eksportet kane kaluar nga prodhim baze ne produkte me te perpunuara dhe sofistikuara. Ne vitin 1999, 60% e eksporteve perbeheshin nga tekstilet dhe kepuçet. Ndersa struktura e importeve kaloi tek produktet baze. Kontributi i importeve u rrit nga rreth 22% qe ishte ne 1993, ne 27% ne vitin 1999. Keto te dhena flasin per nje tendence gjate dekadës se fundit, e cila i largohet prodhimit per treg, drejt bujqesise per konsum dhe nje varesi ne rritje tek importet bujqesore.

**Tabela 9. Eksportet dhe importet kryesore dhe destinacioni kryesor (% , 2001)**

<b>Eksportet kryesore</b>	<b>% ne total</b>	<b>Importet kryesore</b>	<b>% ne total</b>
<i>Tekstilet dhe kepuçet</i>	69.4	Makineri dhe pajisje elektrike	13.7
<i>Produktet minerale</i>	2.9	Produkte minerale	13.1
<i>Metalet baze</i>	8.4	Tekstile	11.9
Produkte ushqimore, pije alkoolike dhe duhan	5.3	Ushqimore, pije alkoolike dhe duhan	9.0
<i>Produkte perimesh</i>	4.7	Produkte perimesh	8.4
Lekure (lende e pare) dhe produkte lekure	3.2	Metale baze	7.8
<b>Destinacioni kryesor i eksporteve</b>	<b>% ne total</b>	<b>Destinacioni kryesor i importeve</b>	<b>% ne total</b>

<sup>43</sup> Informacioni i siguruar nga Departamenti i Mbeshtetjes Veterinare ne FZSH, nga nje vezhgim i bere ne Puke, Gramsh dhe Tirane.

Italia	71.2	Italia	36.2
Greqia	12.1	Greqia	27.6
Gjermania	6.7	Gjermania	5.5
Jugosllavia	2.8	Turqia	5.4
Danimarka	1.1	Bullgaria	2.4

*Burimi:* Raporti per Shqiperine, EIU, Mars 2002

173. **Aksesi ne treg.** Ne fillim vitet '90, kushtet ishin shume te pafavorshme per te krijuar sisteme marketingu te bazuara ne nje sektor privat konkurues. Agjencite e meparshme shtetore te shitjes, ose u mbyllen plotesisht, duke lene nje boshlllek te madh te cilin sektori privat nuk mund t'a mbushte per arsye se i mungonin mjetet, ose shteti iu permbajt rolit te tij te vjeter duke kufizuar keshtu aktivitetin e sektorit privat. Gjithsesi, sektori privat filloi te dominonte dhe tashme zoteron shtijen e outputeve dhe inputeve dermuese bujqesore. Por, ende shume prodhues nuk kane akses ne hapesirat e tregjeve per prodhimet e tyre.

174. Zakonisht, prodhimi i tregtueshem kalon nga prodhuesi tek tregjet me te aferta. Fermeret, ose i shesin produktet e tyre drejtperdrejt ne qendrat urbane ose tregtaret blejne produkte direkt nga fermeret apo ne pikat e grumbullimit. Prodhuesit shpesh organizohen ne grupe per te permiresuar furnizimin e tyre me inpute dhe aktivitetet e shitjes. Nje sasi e konsiderueshme e prodhimit nuk arrin ne treg, pasi fermeret prodhojne ne rradhe te pare per te permbushur nevojat e familjeve te tyre per konsum. Arsyet per mostregtimin e produkteve jane nga me te ndryshmet. Ato perfshijne madhesine e vogel te fermes, largesia e madhe nga tregjet, mungesen e kapitalit investues, dhe mungesen e aksesit tek tregtaret. Nje vezhgim i bere kohet e fundit nga GTZ, tregon qe fermeret e konsiderojne mungesen e aksesit tek tregtaret dhe tregjet si nje problem shume serioz. Pjesa dermuese e fermereve te intervistuar theksuan qe nuk ekzistojne fare lehtesira tregtare ne fshatrat e tyre. Keshtu, prodhuesit duhet t'i tregtojne mallrat e tyre vete, shpesh pa asnje akses ne informacion te besueshem mbi tregun. Ankesat kryesore te bleresve ne tregje ne lidhje me prodhuesit, i referohen peshe jo te sakte, paketimit dhe etiketimit te dobet, furnizimit jo te rregullt, dhe cilesise e ulet. (Studim i DAI).

#### **Kutia 5. Vendndodhja e shitjeve dhe blerjeve te produkteve**

Rreth 50% e prodhimit te kulturave shitet ne ose perreth fshatit te fermerit. I gjithe duhani dhe rreth 2/3 e frutave te tregtuara nga fermere shitet ne tregje lokale. Mallra qe jane me pak delikate, si p.sh. gruri, patatja dhe fasulet jane me te predispozuar per t'u shitur ne qendrat e rretheve. Rreth gjysma e sasise se gjese se gjalle shitet brenda lokalitetit, ndersa gjysma tjeter ne fshatra apo rrethe te tjera, apo ne ndermarrje dhe bleres shtetore. Derrat dhe delet jane me te mundshem per t'u shitur brenda lokalitetit, ndersa dhite dhe shpendet ne tregjet e rretheve apo ndermarrje shtetore.

#### **Vendndodhja e shitjeve te kulturave bujqesore (%)**

Lloji i kultures	Tregu lokal	Buzet e rrugave	Fshat	Fshatra te tjere	Qendra e rrethit	Rrethe te tjera	Nderm. shtetore	Bleres te drejtperd
Fruta	27	28	8	0	30	1	1	5
Duhan	18	76	6	0	0	0	0	0
Perime	20	14	12	2	45	4	0	3
Drithe	20	0	23	8	46	1	1	1
Total	21	15	14	3	41	2	1	3
Blegtori	21	14	17	1	0	35	10	1
Mishi i perpunuar	73	3	11	0	1	7	2	3

Nenprodukte	33	1	22	1	0	21	12	9
-------------	----	---	----	---	---	----	----	---

Shenim: Blegtoria përfshin gjedhet, delet, dhite, derrat, pulat, gjelin e detit, patat, roast, kuajt dhe mushkat. Mishi i përpunuar përfshin gjedhin, delet, derrat dhe pulat. Nenprodukte bujqësore përfshijnë qumështin, gjalpin, djathin, gjizen, leshin, vezet dhe mjaltin.

#### Blerësit e kulturave

	Me shumicë/pakice	Perpunues private	Perpunues shtetërore	Koop. tregtare	Koop. konsumi	Tregu Tiranë	Greqi/Itali
Fruta	60.8	9.8	0	0	0	29.3	0
Drithe	48.5	29	0	0	0	22.5	0
Perime	86	0.4	0	0	0	9.8	4
Duhan	80	20	0	0	0	0	0
Gje gjalle	53.1	0.7	0	0	0	31.2	3.9
Nenprodukte blegtorale	603	7.8	0	0	0	31.7	0.2

Shenim: Frutat përfshijnë shalqion, pjeprin dhe rrushin. Drithi përfshin misrin dhe grurin. Perimet përfshijnë qepet, ullinjte, specat, domatet, patatet dhe fasulet. Blegtoria përfshin gjedhin, delet, dhite, derrat, pulat, gjelin e detit, patat, rosat, kuajt dhe mushkat. Nenproduktet blegtorale përfshijnë qumështin, gjalpin, djathin, gjizen, leshin, vezet dhe mjaltin.

*Burimi: Vlerësim në aspektin cilësor i Verferisë, Shqipëri, 2001.*

175. Tregjet ditore bujqësore sot janë funksionale në qendrat urbane, ndërsa tregjet javore në zonat rurale. Shitesit janë një konglomerat prodhuesish, të cilët shesin produktet e tyre, grumbullues dhe importues të vegjël. Konkurenca është me e fuqishme aty ku ka një furnizim me të qendrueshem me produkte, i garantuar nga një kombinim i prodhimit lokal, prodhimit të ardhur nga rajone të tjera dhe importeve. Përndryshe, tregjet paraqiten të vegjël dhe cmimet të pastabilizuara. Tregjet javore apo mujore të gjese se gjalle funksionojnë në shumë zona. Përvëc sigurimit të një hapësire tregtimi të domosdoshme, këto tregje e lidhin prodhimin blegtoral në zonat malore me ato të uleta, duke sjelle kafshë të njoma nga zonat malore në ato të uleta. Perderisa tregjet e gjese se gjalle kanë nevojë për transport me kosto të ulët, në mënyrë që t'i shërbejnë një zone relativisht të gjere, sistemi rrugor joadekuat dhe i keqmbajtur, është ndoshta pengesa kryesore për rritjen e aktivitetit të tregjeve të gjese se gjalle.

176. Me shumë mund të bëhet në drejtim të përmirësimit të ambienteve fizike të tregjeve, gjë që do të shtonte me shumë motivimin si për prodhuesit ashtu edhe për konsumatorët për t'i përdorur ato. Shumë tregje nuk janë gjë tjetër veçse një hapësire boshe, me asnjë mbrojtje nga moti, pa tezgja shitjeje, dhe akses të dobët si për blerësit ashtu edhe për shitesit. Edhe ambientet me të organizuara si p.sh. në Tiranë, janë shumë të vogla për të mbuluar fluksin ekzistues të prodhimit, dhe tregtia ka shpërthyer neper rruget që i rrethojnë këto tregje. Autoritetet e qeverisjes vendore mund të rrisin komoditetin si të prodhuesve ashtu edhe të konsumatorëve duke siguruar tezgja të mbuluara, akses me të mire për automjetet dhe kembësoret, dhe pastrim efektiv dhe mirembajtje të këtyre ambienteve. Tarifat kundrejt përdorimit të tezgave, mund të mbulonin kostot e funksionimit dhe mirembajtjes. Një infrastrukturë e përmirësuar do të ndihmonte vecanerisht në përmirësimin e kushteve të higjienës dhe reduktimin e mbeturinave.

177. Tregjet e eksporteve janë edhe me pak të konsoliduara si pasoje e (a) mungesës së ambienteve të tregtimit, (b) standardeve të uleta në kontrollin e cilësive të ushqimit dhe atij veterinar, (c) mungesa e integritetit vertikal të organizatave të prodhuesve; dhe (d) numri i vogël i

hapësirave perpunuese dhe paketuese. Nepermjet marreveshjeve preferenciale të tregtise me BE, eksporti mund të bëhet një mundësi potenciale tregtimi; gjithsesi duhet të plotësohen sasitë dhe cilësitë.

178. Tregtarët punojnë në mënyrë të pavarur për të mbuluar distancat e largëta për blerjen e produkteve të tyre. Komunikacioni i dobët, distancat e largëta, dhe vizitat në fermë individuale, e rrisin kohën dhe koston e shitjes. Megjithatë, për fermerët individuale, tregtari përfaqëson një situatë monopolistike. Shpesh, tregtari është e vetmja mundësi që fermeri të shesë produktin e tij, gjë që le shume pak hapësirë për të negociuar për çmimin apo për të bërë krahasime. Mungesa e ambienteve lokale dhe qendrore të magazinimit krijon në disa raste luhajtje të konsiderueshme të çmimeve gjatë vitit, siç ndodh me qepet, fasulet dhe specat. Tregtarët më të mëdhenj fokusohen në produkte të vecanta gjatë aktivitetëve të tyre të shitjes, dhe shpesh i shesin produktet tek tregtarët e vegjël apo dyqanet. Tregtarët më të mëdhenj zakonisht kanë fermere kontakti në fshatra.

179. Një proces aktiv grumbullimi nga ana e sektorit privat, megjithatë shume i kufizuar, është në funksionim. Pjesa më e madhe e grumbulluesve ose janë shitës, të cilët shesin në treg në mënyrë permanente ose prodhues të mëdhenj, të cilët blejnë sasi të vogla nga prodhuesit fqinjë, për t'i rishitur me prodhimet e tyre. Ekziston edhe një treg shumicë, me shitës, të cilët blejnë nga tregjet e Korçës, Shkodrës dhe zonave të tjera me prodhimtari të lartë, për t'i transportuar dhe shitur në Tiranë. Një grup tjetër i shitësve në treg, në afërsi të kufijve jugorë dhe lindorë, e shes me të lehtësisht që t'i marrë produktet nga Greqia, Maqedonia, sesa të mbështetet në një grumbullim të produkteve nga fermerët lokalë.

180. Volumi i tregtise lokale është shume i vështirë për t'u përcaktuar. Nuk ka informacion të saktë rreth sasive dhe strukturave tregtare. Tregtare lokale tregtojnë sasi shume me të vogla sesa shitësit e mëdhenj të shumicës apo importuesit. Ata, ose blejnë direkt nga fermerët, ose nepermjet niveleve të ndryshme të ndërmjetësuesve, ose janë prodhues dhe tregtare në të njëjtën kohë. Keshtu, kanali i tregut nuk është shume eficient. Shpesh, prodhuesit dhe tregtarët e vegjël, si dhe tregtarët e shumicës perpiqen të shesin produktet e tyre në të njëjtat tregje urbane. Tregtarët nuk preferojnë të shohin fermerët të shesin mallrat e tyre me çmime shumicë, pasi prodhuesit bujqësorë përjashtohen nga TVSH, ndërsa tregtarët jo. Keshtu, fermerët i ofrojnë produktet e tyre në treg, me çmime më të ulëta sesa tregtarët.

181. **Informacioni për tregun.** Prodhuesit, perpunuesit dhe tregtarët bujqësorë pengohen nga një mungesë e njohurive dhe aksesit në informacionin e nevojshëm, për të marrë vendime mbi prodhimin dhe shitjet, si dhe vendime mbi investimet, eksportet ose zhvillimin e tregjeve të reja. Duket që funksionimi i tregjeve nuk është i kuptuar siç duhet, edhe informacioni në dispozicion, nuk i lejon njerezit të ndjekin konceptet e marketingut. Shume prodhues dhe perpunues vazhdojnë të marrin vendime për mbjelljen dhe perpunimin e produktit bazuar në supozimin që do të shitet lehtësisht në treg. Faktore si kërkesa, çmimet e tregut dhe vecanerisht cilësia e produkteve, shpesh nuk vlerësohen sa duhet. Keshtu, prodhuesit dhe perpunuesit lokalë shpesh e gjejnë veten përballë konkurrencës me importues me të mirë-informuar dhe të orientuar drejt tregut. Kjo mungesë përgatitje rreth tregut, sjell rritjen e importeve bujqësore që shiten në Shqipëri.

182. Informacioni i pamjaftueshëm për çmimet dhe tregjet potenciale, është një pengesë kryesore për rritjen e eksporteve bujqësore. Kesaj i shtohet edhe vështiresia në prodhimin dhe perpunimin e vazhdueshëm të produkteve me cilësi të lartë dhe në sasitë e dëshiruara. Grupet dhe shoqatat e prodhuesve janë pjesërisht të suksesshme në mbushjen e ketij boshllëku. Megjithatë, pjesa dërrmuese e fermereve të vegjël, ende nuk merr pjesë apo përfiton nga keto organizata.

183. Informacioni dhe çmimet e tregut u grumbulluan dhe publikuan nga një projekt i USAID në mesin e viteve '90. Pas mbylljes së projektit, departamenti i statistikave në MBU, i cili grumbullon informacion për çmimet në bazë javore, e vazhdoi këto detyra. Megjithatë, ky informacion nuk është lehtësisht i arritshëm dhe nuk arrin tek objektivi kryesor. Përveç kesaj, duket që informacioni në dispozicion, nuk është aq bashkëkohor për të qenë i dobishëm në

marrjen e vendimeve në treg. Do të ishte e preferueshme që të lejohej sektori privat të fokusohet në grumbullimin e të dhënave planifikuese dhe strukturale dhe informacionin për tregun. Shoqata Kombëtare e Fermereve dhe një qendër agro-biznesi, janë duke planifikuar aktivitete për përmirësimin e sistemit të informacionit për tregun. Projekti i Shërbimeve Bujqësore, i financuar nga Banka, do të mbështesë përmirësimin e procesit të grumbullimit të të dhënave për tregun dhe të disponueshmërisë së tyre në nivelin rajonal të tregtisë me shumicë si dhe në atë të grupit të prodhuesve. Programe të tjera po fokusohen në krijimin e organizatave të fermereve (GTZ, Land o'Lakes), duke përmirësuar kështu futjen e informacionit dhe pranimin e rregullave të tregut.

184. **Agro-perpunimi.** Vetëm një pjesë e vogël e prodhimit vendas përpunohet në Shqipëri. Industria bujqësore zë rreth 5-8% të GDP dhe pëneson vetëm 5% të fuqisë kombëtare të punës. Investimet në industri në vitin 1999, kapnin vlerën prej rreth 2.5 miliardë Lek, pjesa më e madhe e realizuar në vitin 1998. Të gjitha ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të agro-perpunimit janë tashmë të privatizuara. Investimet më të mëdha janë bërë në pijet freskuese, vajin e ullirit dhe përpunimin e qumështit dhe mishit. (Tabela 10).

185. Agro-perpunimi është i rëndësishëm për përmirësimin dhe zgjerimin e kanaleve të marketingut. Pjesa më e madhe e fabrikave të përpunimit janë të vogla, dhe impakti i tyre në marketing shpesh është shumë i lokalizuar. Zgjerimi pengohet nga mungesa e kapitalit për investime, mungesa e ekspertizës teknike dhe menaxheriale, kostot e larta për grumbullimin e prodhimit, pasi shpesh fermat janë të vogla dhe në distanca shumë të largëta, dhe infrastruktura është e varfër. Zhvillimi i mëtejshëm i agro-perpunimit do të rrisë opsionet e marketingut për fermeret, si dhe mundësitë për të prodhuar produkte me vlerë të shtuar. Megjithatë, ky zhvillim duhet të priret me shumë nga sektori privat sesa nga ai publik.

**Tabela 10. Zhvillimi i agro-perpunimit (në ton)**

<b>Produkti</b>	<b>1994</b>	<b>1997</b>	<b>1998</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>
Pije të buta	132,274	262,129	299,798	297,234	420,448
Ujë mineral	3,656	61,115	364,065	326,744	425,509
Miell	180,000	98,149	74,016	61,685	101,645
Qumësht		9,282	36,685	36,572	102,420
Birre	85170	151572	92583	87328	85,837
Buke	211,391	90,513	61,151	65,033	66,200
Pije alkoolike	40,819	39,943	22,029	27,009	30,184
Djathe	2052	6288	5798	6743	8,404
Vere	9,640	16,777	10,503	12,708	7,413
Kos	525	4,652	4,713	4,351	5,310
Sallam dhe proshute	1,405	3,238	2,349	3,821	4,055
Duhan	1,865	3,613	4,313	8,677	3,800
Perime të konservuara	285	667	836	318	105
Recel	608	182	377	209	218

*Burimi:* MBU, Shqipëri, 2000

186. Një industri moderne dhe konkurruese do të jetë çelësi për një zhvillim të mëtejshëm bujqësor dhe rural. Ajo do të sigurojë një hapësirë për produktet bujqësore, duke i lejuar fermeret të kalojnë nga të prodhuarit për konsum familjar, në të prodhuarit për treg, në kushtet pak a shumë të njohura dhe të sigurta. Ajo do të ofrojë me tej mundësi punësimit në zonat rurale, duke ndihmuar në parandalimin e largimeve të tepërta nga zonat rurale. Pa rritje në industrinë përpunuese, prodhimi bujqësor do të kufizohet në kërkesën lokale për prodhime të freskëta, dhe avantazhi relativ i Shqipërisë në punën intensive, prodhimi me vlerë të lartë, do të mbetet i pashfrytëzuar.



## Financat Rurale

187. Zhvillimi i kufizuar i shërbimeve financiare në zonat rurale ka qenë faktori kryesor që ka penguar zhvillimin e sektoreve bujqësore dhe rurale. Realizimi i këtyre shërbimeve në zonat rurale, përballë sfidave të vecanta të cilat shpesh intensifikohen nga:

- Kosto e lartë e transaksioneve si rezultat i dendësisë së ulët të popullatës, kushtet e veshitura të rrjetit rrugor, telekomunikacioni i dobët, dhe shërbimet mbështetëse qeveritare të dobëta;
- Rreziku i lartë si pasojë e niveleve të larta të çmimeve dhe rrezikut të prodhimit dhe të ardhurave sezonale, si dhe mungesa e sigurancës dhe instrumentave mbrojtëse për të zbutur këto rreziqe;
- Periudhat e gjata të konceptimit të ideve, të cilat rezultojnë në një xhiro të ngadalte të kapitalit në ndërmarrjet bujqësore, që do të thotë se ekziston një kërkesë e lartë për kapital afatmesëm dhe afatgjatë;
- Informacioni jo i mjaftueshëm për klientin, në përgjithësi i renduar nga nivelet e ulëta të arsimimit në zonat rurale;
- Tregjet e dobëta të tokës, inputeve bujqësore (kimikate, makineri, ushqim);
- Bashkimi informal i tokës midis fermerëve të lidhur me titujt, të cilët i leshohen familjes së njësi, duke bërë kështu të vështirë për të përdorur tokën si kolateral, pasi pjesa më e madhe e familjeve kanë anëtarë që jetojnë jashtë në mënyrë të përhershme apo të angazhuar me migracion sezonal.

188. Pjesërisht si rezultat i këtyre sfidave, strukturat për dënimin e kredive dhe mobilizimin e kursimeve dhe shërbimet financiare dhe ato të asistencës teknike për ndërmarrjet bujqësore dhe rurale janë të pamjaftueshme. Ekzistojnë shumë pak institucione të përshtatshme që funksionojnë në fshat dhe në nivel komune, dhe lidhjet ndërmjet institucioneve ekzistuese dhe sektorit financiar formal janë të dobëta.

189. Pavarësisht sa thame, ekziston një kërkesë e konsiderueshme për shërbime financiare në zonat rurale, që reflektohet edhe në numrin e lartë të anëtarëve në Fondet e Kredive të Fshatit dhe në rëndësinë e kredive informale. Për shembull, nga një vëzhgim i kryer nga Federata e Financimit të Ndermarrjeve dhe Zhvillimit (FEFAD Bank), rezultojnë që, ndërsa vetëm 6.7% e fermerëve kanë në dorë kredi, pjesa më e madhe nga burime informale si miq dhe familja, një mesatare prej 43% e të intervistuarve kanë arritur një burim kreditimi në të shkuarën. Vëzhgimi provoi gjithashtu një rentabilitet të lartë e për rrjedhojë, një treg potencialisht të mirë për kredite. Nga 150 fermerë, raporti mesatar i të ardhurave neto kundrejt asetëve kapitale të investuara ishte 42%, me të ardhura nga ferma që kapin vlerën prej 330,000 lek për hektarë. Midis ndërmarrjeve bujqësore rentabel, spikat prodhimi i perimeve në sera, prodhimi i rrushit dhe bulmetrat.

190. **Sektori bankar.** Përgjithësisht, huadhënia rurale është jeterheqese për një sektor financiar formal me shkallë të lartë rrisht. Në një masë të konsiderueshme, bankat preferojnë të investojnë në Bonot dhe Thesarit, të cilat kanë rrisht të ulët dhe të japin hua për pak kompani të mëdha, të cilat në përgjithësi kanë kosto më të ulët të transaksioneve dhe forma më të pranueshme të kolateralit. Zgjerimi i aktiviteteve bankare në zonat rurale bëhet se pari në aspektet e transferimit të fondeve, aktivitetit të kembimit dhe shërbimeve të kursimit. Në fakt, sic provohet nga eksperiencat e Bankes Shtetërore të Kursimeve, ekzistojnë sasi të mëdha fondesh që mund të mobilizohen nga zonat rurale. Megjithatë, është e kuptueshme që burimet financiare do të vazhdojnë me shumë të thithen nga zonat rurale sesa të kontribuojnë në zhvillimin rural, deri të mos ketë ndryshime të rëndësishme në praktikën e biznesit të bankave në zonat rurale.

191. Është bërë një lloj progresi në drejtim të privatizimit dhe ristrukturimit të sektorit të meparsheh bankar, i cili zotërohet nga shteti, me 60% të Bankes Kombëtare Tregtare të bashkuara të privatizuara si dhe privatizimin e planifikuar të Bankes Shtetërore të Kursimeve. Këto dy banka kanë rrjetet më të mëdha midis të gjitha bankave në Shqipëri, me BKT e cila ka 7 degë dhe një

agjenci jashtë Tiranës dhe BK, e cila ka 23 dege dhe 14 agjenci jashtë Tiranës. Megjithatë, këto banka kanë ofruar shumë pak kredi në vitet e fundit dhe nuk duket që do të japin hua të konsiderueshme për fermerët dhe ndermarrjet rurale, për atë kohë sa nuk do të kenë përfunduar procesin e tyre të ristrukturimit, zhvillojnë metodologji të reja kreditimi, dhe personel kredie të rikualifikuar.

192. Përveç BKT dhe BK, në Shqipëri ekzistojnë edhe 11 banka private, të cilat funksionojnë nën një kontroll të rregullt nga banka qendrore, Banka e Shqipërisë. Këto banka kanë rritur sasine neto të kredive në mbi 100% nga 1999 në 2000, kundrejt një rënie prej 6.3% të shënuar tek bankat shtetërore. Nga një vëzhgim informal mbi bankat tregtare, rezultoi që ato janë duke dhënë disa kredi për agro-biznesin, përfshirë inputet bujqësore, serat, fermat industriale të shpendarise dhe përpunimin e produkteve ushqimore. Shumat variojnë nga rreth 12% në 28% të portofoleve totale. Megjithatë, bankat tregtare janë shumë me pak të prirura për të financuar prodhimin bujqësor, duke patur parasysh rreziqet që mbarten, dhe megjithatë nuk janë prezente në zonat rurale.

193. Banka FEFAD është e vetmja bankë që po përpunon aktivisht t'i shërbejë ndermarrjeve bujqësore dhe rurale ekzistuese. Kjo bankë ka aktualisht një rrjet prej 5 degesh dhe 1 agjencie, por ndërkohe që ka për të ardhmen edhe plane shtrirjeje në të gjitha qytetet me një popullsi mbi 20,000 banorë. Banka FEFAD ishte institucioni financiar privat me aktiv, i përfshirë në Projektin e Zhvillimit të Agro-përpunimit, të financuar nga Banka Botërore, i cili siguroi kredi në sasine prej 2.3 milion USD për 300 kliente, me një shkallë ripagimi prej 97%. Mëqenëse data e mbylljes së projektit është 30 qershori, 2000, FEFAD-i ka mbetur aktiv dhe ka realizuar edhe 125 nenkredi nga fondet e saj. Në pjesën më të madhe kanë qenë afat-shkurtra (3 deri në 6 muaj) dhe afat-mesme (12 deri në 18 muaj) në sektorët kryesorë të prodhimit të bukës, (13%), shitjen me shumicë dhe pakicë të produkteve bujqësore (22%), pijeve të lehta alkoolike (12%), përpunimit të perimeve dhe frutave (11%), dhe përpunimit të qumështit (8%). Banka FEFAD është gjithashtu duke implementuar një program pilot në huadhenien në sektorin bujqësor. Kushtet për kredite bujqësore janë të njëjta me ato të kredive të tjera, me përjashtimin që ekziston një tarifë më e lartë e drejtperdrejtë prej 3% , kundrejt 2%. Nëse ky program pilot gjykohej i suksesshem, në mesvitin 2001, FEFAD-i planifikon të shtrijë aktivitetin në dege të tjera në të gjithë vendin.

194. Në fillimin e vitit 1999, Zyra Postare (ALBAPOST) u transformua në një kompani aksionere, 100% e zotëruar nga qeveria, e cila ka aplikuar për një licencë funksionimi si institucion bankar. Qeveria ka menduar që ALBAPOST mund të marrë përsiper disa funksione të BK në disa prej zonave rurale të largëta, ku nuk është fare rentabel funksionimi i degës dhe që mund të mbyllet si pasojë e privatizimit. Zyra postare ka një rrjet ekzistues prej 450 degesh. Megjithatë, rifutja e një institucioni të kontrolluar dhe zotëruar nga qeveria, në sektorin e sapoprivatizuar bankar nuk është e keshillueshme. Një Bankë e re e Zyres Postare do të përballëj me sfidën kryesore të futjes së funksioneve bankare, të cilat do të kërkonin një riaktivizim të kapitalit, një përmirësim të ndjeshëm në aftësitë e personelit dhe të pagave, rekrutim personeli shtesë, instalim të sistemit të menaxhimit të informacionit dhe sistemeve të komunikimit, dhe sigurim të asistencës teknike lokale dhe të huaj. Ky proces do të ishte i vështirë dhe i gjatë, pa një sukses të sigurt. Në këtë fazë të zhvillimit të sektorit financiar në Shqipëri, nuk është e keshillueshme të futemi në këtë proces dhe të leme të lirë rrugën e një sektori të mirefillte financiar privat. Kjo do të kushtojë më pak dhe do t'i shërbente më mirë klienteles, nëse qeveria paguan BK që t'i mbajë në funksionim deget e saj jorentabel dhe të largohet nga një sistem bankar i sponsorizuar nga shteti.

195. **Sektori jobankar.** Rrymat më të përhapura në shërbimet financiare rurale priren drejt një numri iniciativash të ndryshme në sektorin jobankar. Këto iniciativa përfshijnë formimin e Fondeve të Kredive së Fshatit, dhe Unionet e Kredive si ato të mbështetura nga Lidhja Irlandeze e Unioneve të Kredive, Fondi i Financimit Rural, dhe Fondi i Financimit të Zonave Malore; dhe sigurimi i shërbimeve financiare jobankare si ato të ofruara nga Fondacioni Besa, Opportunities International, Western Union, dhe nepermjet OJQ-ve si Land o'Lakes dhe IFDC.

196. Formimi i Fondeve të Kredive të Fshatit filloi në vitin 1992 me një projekt pilot të financuar nga B.B. Fondi i Zhvillimit Shqiptar (FZSH) u krijua për të mbështetur zhvillimin e metejshëm të FKF-ve, me financim shtesë të siguruar nga projektet e B.B. dhe Projektit për Zhvillimin Rural të Shqipërisë Verilindore, të financuar nga IFAD. Në 1999, departamenti i kredive rurale në FZSH kaloi në një fondacion të pavarur, Fondi i Financimit Rural (FFR). Në total, u krijuan rreth 225 FKF në kuadër të ketij programi, me një portofol total të FFR në vlerën prej 417 miliona Leke në fundin e vitit 1999. FKF-te u konceptuan që t'i pajisnin fshataret me kredi të vogla individuale për aktivitete që gjenerojnë të ardhura, me presionin e grupit në funksion të garantimit të ripagimit. Në fillim u levrua një transh prej 30,000 USD për FKF-te, dhe me pas shuma u rrit në 20,000 USD deri në 30,000 USD, në varesi të numrit të anetareve dhe të shkallës së ripagimit. Komiteti i Kredive të Fshatit ishte përgjegjës për aprovimin e kredive, të cilat arrinin një shumë maksimale prej 1,000 USD. Kredite për blektorine ishin në mënyrë të vecantë të përhapura, me pothuaj 70% të kredive për t'u përdorur për aktivitete blektorale në këto rrethë malore në zonën verilindore të Shqipërisë. Në përgjithësi, funksionimi i FKF-ve ishte i kënaqshëm, me një shkallë të mirë ripagimi dhe shkallë mospagimi me të ulet se 5%.

197. Për ta bërë programin më të qendrueshëm, FFR është duke ndihmuar 145 FKF të zonave jomalore për t'u transformuar në Shoqata të Kursim Kredive (SHKK), me mbështetjen e Projektit të Mikrokredive të financuar nga IDA. Rreth 240 SHKK të tjera janë planifikuar të formohen në pesë rrethë të tjera të ultësirës bregdetare gjatë këtyre viteve të ardhshme. Portofoli i 64 FKF në zonat malore, tashmë është transferuar nga FFR tek Fondi i Financimit të Zonave Malore (MAFF), me mbështetjen e IFAD, i cili filloi të funksiononte në vitin 2000 dhe disbursoi rreth 15,600 USD gjatë tremujorit të parë të 2001. 16 FKF me pak të suksesshme janë mbyllur.

198. Në dhjetor 2001, figuronin 75 SHKK të regjistruara zyrtarisht, dhe disa të tjera për t'u formuar në vitin 2002. SHKK-te e para u formuan në 1997 me mbështetjen nga Projekti për Permiresimin e Bulmetit i Land o'Lakes dhe Lidhja Irlandeze e Unioneve të Kredive. Lidhja Irlandeze ka krijuar një fondacion të quajtur Fondacioni i Levizjes për Zhvillimin e Shoqatave të Kursim Kredive (F.L.Zh.Sh.K.K.), i cili përgjigjet për zhvillimet e metejshme. 16 nga 37 SHKK që u formuan me asistencën nga Lidhja Irlandeze /F.L.Zh.Sh.K.K., koeporojnë me Land o'Lakes dhe IFDC. Ato kanë një anetaresim total prej 1,291 vetash, me një mesatare prej 81 anetaresh/SH.K.K.<sup>44</sup>. 59 SHKK e tjera u formuan nën patronazhin e FFR, dhe kanë 2,159 anetare. Portofoli outstanding i kredive për këto SHKK shenonte 3.6 miliona USD në dhjetor 2001, dhe portofoli në rrezik (30 ditë) 2.4%. Gjendja aktuale e programit të SHKK paraqitet në mënyrë të përmbledhur në Tabelën 11.

199. Në 3 maj 2001, Parlamenti kaloi ligjin e ri për Shoqatat e Kursim Kredive. Ky ligj, i cili është produkt i diskutimeve të gjera ndërmjet qeverisë, Bankës së Shqipërisë, institucioneve të prekura nga ky ligj dhe B.B., lejon që SHKK të rregullohen dhe mbikeqyren në një mënyrë që garanton siguri dhe qendrueshmeri, e ndërsa merr në konsideratë karakteristikat e vecanta dhe natyrën reciproke të SHKK. Ligji mundeson një terren transparence dhe përgjegjshmeri. Banka e Shqipërisë aktualisht po perfundon rregullat prudenciale dhe procedurat e mbikeqyrjes së SHKK, dhe do t'i nënshtrohet një trainimi intensiv për të fuqizuar aftësinë e saj në drejtim të mbikeqyrjes së funksionimit të SHKK në Shqipëri.

**Tabela 11. Pozicioni i Shoqatave të Kursim Kredive (dhjetor 2001)**

Projekti	Nr. i SHKK (Dhjet)	Anetare ne total	Anetaresi m mesatar/	Kursime (USD)	Kursimet mesatare/ SHKK	Kursime t mesatar	Kredi (USD)

<sup>44</sup> Si Land o'Lakes dhe IFDC po japin asistencë teknike dhe financiare për shoqatat e bulmetit dhe furnizuesit e inputeve bujqësore, dhe janë duke krijuar lidhje ndërmjet këtyre grupeve dhe bankave, shoqatave të kursim kredive, dhe institucioneve financiare jobankare. Si rezultat i përpjekjeve të IFDC, furnizuesit kryesorë të inputeve bujqësore janë tashmë në gjendje të përfitojnë miliona dollare kredish komerciale nga bankat. Në total, këto OJQ kanë ndihmuar për realizimin e aksesit të klienteve në sektorin bankar, në shumën 19 miliona USD.

	2001)		SHKK		(USD)	e/anetar	
Lidhja Irlandeze e Unionit te Kredive	16	1,291	81	62,999	3,937	49	33,740 b/
FFR a/	59	2,159	36	0	Na	na	306,57 2
Totali	75	3,450	53	62,999	49	49	340,31 2

\* Përfshirë numrat e Land 'o Lakes dhe IFDC

a/ Ende asnje kursim; b/ Kapitali ne zoterim 17,996 USD; Shenim: Kursi i kembimit i dhjetorit 2001. 1 USD = 147 Leke

200. Konstatohet me interes roli pionier i Western Union, nje institucion financiar jobankar, i cili ofron sherbime financiare te kufizuara per zonat rurale te Shqiperise. Kjo kompani ka ndertuar nje rrjet prej 84 degesh neper te gjithë Shqiperine, qe eshte me i madh sesa rrjeti i kombinuar i degeve te te gjithë sektorit bankar, dhe momentalisht ka 90 dege. Western Union po krijon lidhje si me bankat tregtare ashtu dhe me kompanite qe synojne qe te shtrijne biznesin e tyre ne zonat rurale. Per shembull, nepermjet partneritetit me Banken Amerikane te Shqiperise, Western Union do te veproje si nje agjent per shitjen e Certifikatave te Depozitimit. Rrjete degesh te tilla mund te hapin dyert per aleanca strategjike ndermjet sektorit formal bankar, sektorit te biznesit, Zyres se Postes, dhe institucioneve te ndermarrjeve te vogla. Per shembull, nje dege mund te sherbente si nje pike pagese dhe leshimi e Certifikatave te Depozitimit nga ana e nje banke tregtare apo per shitje te Bonove te Thesarit drejtperdrejt tek klientet. E njejtja dege mund t'i sherbente kompanive dhe institucioneve te tilla si fondet e kredise per ndermarrjet e vogla, si nje menyre per te shtrire rrjetet e tyre dhe per t'i bere ato me eficente nepermjet perdorimit te sherbimeve te transferimit te parave jashte per pagesa dhe rimbursime. Ne vleresim te pergjithshem, Western Union po demonstroi qe sherbimet e kufizuara financiare mund te ofrohen me nje kosto te ulet nepermjet nje zyre shume te vogel apo qofte edhe nepermjet zyrave te shumta neper qytete me personel te kualifikuar dhe me nje linje te mire telefonike.

Nje pershkrim i Strategjise Rurale - Elementet esenciale qe mbeshtesin rritjen dhe zhvillimin e qendrueshem

201. Nje strategji e plote rurale per Shqiperine duhet domosdoshmerisht te perfshije veprime te bashkerenduara ne nje numer sektoresh te ndryshem dhe angazhimin e agjencive te ndryshme qeveritare ne nivele te ndryshme. Bazuar ne analiza, jane identifikuar elementet themelore qe mbeshtesin rritjen dhe zhvillimin e sektorit rural, elemente te cilet duhet te formojne bazen e nje strategjie rurale. Keto elemente jane trajtuar ne paragrafet e meposhtem dhe perfshijne: (a) stabilitet i qendrueshem makro-ekonomik; (b) decentralizim i metejshe dhe roli ne rritje i organizatave me baze komuniteti; (c) klime e permiresuar biznesi; (d) infrastrukture e permiresuar rurale; (e) tregjet funksionale te tokes; (f) sherbimet rurale mbeshtetese te afta per te ofruar asistencë per fermeret e vegjel; (g) zhvillimi intensiv rural jobujqesor; (h) integrimi ne rritje i burimeve mjedisore dhe natyrore ne zhvillimin rural. Mesimet e nxjerra nga ekonomite e tjera ne tranzicion dhe projektet ne Shqiperi, duhen marre ne konsiderate.

202. Rritja ne inpute dhe te ardhura qe prej 1990, ka qene rezultat i menaxhimit te shendoshe makro-ekonomik dhe reformave themelore politike dhe institucionale, te cilat mundesuan transformimin e nje sektori rural jorentabel, te zoteruar nga ferma te medha shteterore dhe kooperativa e ndermarrje bujqesore, ne nje sektor rural te karakterizuar nga mijera ferma te vogla me baze familje. Megjithese feramat jane jashtezakonisht te vogla dhe te copezuara, ato kane regjistruar nje rritje te qendrueshme te prodhimit, pasi pronaret e rinj te fermave punojne intensivisht per te permiresuar prodhimin. Reforma te medha, përfshirë privatizimin dhe

shpërndarjen e tokës, liberalizimin e tregut dhe të cmimeve, ndihmuan për rritjen e prodhimit rural. Investime themelore në rehabilitimin e infrastruktures, vecanerisht në ato ujëse, ndihmuan gjithashtu në intensifikimin e rritjes.

203. Qeveria sot përballë me sfida të nxitjes së rritjes rurale duke u mbështetur në sukseset e fillimit, dhe të sigurimit të ritmeve të qëndrueshme dhe madje të shpejta të rritjes. Duke u ballafaquar me këto sfida, qeveria pranon që duhet të vazhdojë të zbatojë shumë prej politikave ekzistuese, paralel me intensifikimin e përpjekjeve për rehabilitimin e infrastruktures rurale, nxitjes së investimeve private rurale me ritme të shpejta dhe sigurimin e shërbimeve publike me efektive. Kështu, pjesëmarrja e komunitetit dhe kapacitetet e konsoliduara të qeverisjes lokale nëpërmjet decentralizimit, janë elemente të rëndësishme të strategjive të qeverisë.

#### **Kutia 6. Mesimet e nxjerra- Eksperiencat nga vendet e Europës Juglindore**

Gjatë dekadës që Banka ka qenë e angazhuar në ekonomitë në tranzicion, kanë dalë një seri mesimesh themelore, të cilat duhet të merren në konsideratë. Ndermjet me shumë të rëndësishmeve për Shqipërinë, do të vecoheshin si më poshtë:

- Reformat themelore kërkojnë kohë, vazhdimësi e tyre është shumë e rëndësishme, dhe privatizimi pa kuadrin mbështetës institucional dhe rregullator nuk çon në zhvillim të ekonomisë së tregut dhe mirëqenie. Shqipëria ka qenë me fat, në ato që vazhdimësi e reformave ka qenë shumë e mirë dhe është shfaqur një sektor privat fleksibel. Megjithatë, procesi i reformës ka çuar në shkatërrimin e industrisë tradicionale të përpunimit në zonat rurale dhe boshllëku i lenë nga ky shkatërrim duhet të mbushet. Gjithashtu, megjithë ekzistencën e një kuadri të mirë ligjor dhe administrativ, tregjet funksionale të tokës dhe shërbimeve rurale financiare kanë lindur ngadalë.
- Projektet e thjeshta zakonisht funksionojnë me mirë. Projektet e suksesshme duhet të fokusohen gjeografikisht në ato mbështesin një program kompleks, për shembull, ato që përfshijnë rehabilitimin e kurrizëve ujëdarese me baze komuniteti, infrastrukturen rurale, reformën e tokës dhe ristrukturimin e fermës me rikonceptim të sistemeve të ujitjes në fushë. Projektet duhet të mbështesin vetëm një zonë nderhyrjeje nëse përqendrohen në planin kombëtar, si për shembull, në mikrokredinë e bazuar në komunitet. Aspekti gjeografik është vecanerisht i rëndësishëm për Shqipërinë, duke patur parasysh diversitetin gjeografik.
- Një vëmendje në prodhimtarinë bujqësore është e nevojshme për zhvillimin rural, por nuk mjafton. Duhet një metode me baze më të gjera për sektorin rural, e cila ekuilibron investimet në përmirësimin e prodhimtarisë bujqësore me investimet në aspektin jobujqësor të ekonomisë rurale. Kjo metode me baze të gjera përfshin si mbështetjen për zhvillimin e ndermarrjeve rurale jobujqësore ashtu dhe mundësitë për punësim dhe mbështetje për një infrastrukturë sociale dhe fizike rurale të përmirësuar.
- Dimensioni më i dobët i projekteve në të shkuarën, ka qenë zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe qëndrueshmërisë së aktiviteteve pas tërheqjes së financimeve nga donatorët. Përmirësimet në këto zona mund të vijne nga puna e ngushtë me institucione lokale dhe nëpërmjet mbështetjes së metodave “poshtë-lart” si identifikimi dhe implementimi i projekteve të orientuara nga komuniteti. Shqipëria ka marrë një rol drejtues në rajon, përse i takon metodave të orientuara nga komuniteti.
- Masat për të përmirësuar kapacitetet e qeverisë nëpërmjet reformës së decentralizimit dhe asaj të shërbimit publik janë të vështira për t’u formuluar dhe implementuar. Shqipëria ka filluar inisiativa ambicioze si për reformën e decentralizimit ashtu dhe ato të shërbimit civil, dhe sfida do të jetë që të ruhen ritmet e rritjes, ndërsa këto reforma ambicioze vijojnë.
- Nuk ka modele të mira për mbështetjen ndaj sektorit privat, qoftë kur përfshin zhvillimin e ndermarrjeve të vogla dhe të mesme në përgjithësi, apo qoftë edhe kur synojnë ri-vitalizimin

apo krijimin e ndermarrjeve të rendesishme që i shërbejnë sektorit rural, kryesisht agrobizneset dhe kompanitë e marketingut për shpërndarjen e inputeve dhe mbledhjen e prodhimit. Ende, kjo mundësi perceptohet si një barriere e rendesishme për zhvillimin bujqësor në të gjithë rajonin dhe përben interes të vecantë për politika-bërësit në Shqipëri.

### **Mesimet nga Programi i BB në Shqipëri**

Mesimet nga Shqipëria tregojnë atë çka BB ka mesuar rreth metodave të orientuara nga komuniteti. Këto mesime vijnë nga eksperiencia të fituara në investime me mbështetjen e Bankës në rehabilitimin e rrjetit ujëtar, mikrokredi dhe iniciativat pyjore me baze komuniteti. Banka ka mesuar se investimet nga lart-poshtë shpesh janë themelore për të tërhequr interesin e komunitetit, dhe për të siguruar funksionimin dhe mirëmbajtjen e duhur. Përveç kësaj, eksperiencia e Bankës me procesin e privatizimit të tokës, zbulon qartë që reforma aktuale e marrëdhënieve të pronësive dhe zhvillimit të strukturave mbështetëse institucionale, është një proces afat-gjatë dhe i komplikuar. Në fund, eksperiencia e hershme në Shqipëri me linjat e kreditimit të financuara nga Banka për agro-perpunimin, nxjerrin në pah vështirësitë e zhvillimit të ndërhyrjeve të qëndrueshme dhe me impakt të lartë për agrobiznesin.

204. Një strategji rurale për Shqipërinë nuk duhet të kishte si synim ndalimin e flukseve të migrantëve nga zonat rurale. Eksperiencia të tera të pasuksesshme dhe të ngjashme me programe dhe politika të zbatuara gjetke, që kanë synuar në ndalimin me vendosmëri të migrimit nga zonat rurale, sugjerojnë që politika të tilla nuk duhet të jenë pjesë e një strategjie rurale. Në të kundërt, vëmendja duhet të përqendrohet në përmirësimin e shërbimeve dhe mundësive rurale për ata që zgjedhin të qëndrojnë, ndërsa garantohej për ata që zgjedhin të largohen në nivelin e duhur të shëndetit dhe shkollimit, të kënaqësive të mira për të udhëtuar; të lënë vendin pa minimumin e shqetësimit, dhe që të mund të dërgojnë lehtësisht paratë e tyre mbrapsht. Kjo, natyrisht kërkon dialog politik me vendet fqinje me Shqipërinë, i cili mund të lehtësojë nepermjet përfshirjes me të shpeshtë të Shqipërisë në marrëveshje rajonale si dhe ato me BE.

### **3.1 NJE KUADER MAKRO-EKONOMIK I STABILIZUAR**

205. Masat për stabilizimin e një Kuadri Makro-ekonomik kanë qenë çelësi i procesit të rimekëmbjes në Shqipëri, e ndërsa është e nevojshme një vëmendje e vazhdueshme në ruajtjen e stabilitetit, në mënyrë që të sigurohet vijimesia e rritjes dhe zhvillimit në sektorin rural. Qeveria është e angazhuar të menaxhojë politikën e saj monetare, fiskale dhe tregtare, për të siguruar stabilitet makro-ekonomik. Nivelet e synuara të inflacionit do të jenë nga 2 në 4% nepermjet kontrollit të parave nga Banka e Shqipërisë, menaxhimit të kurseve të këmbimit, dhe kontrollit mbi deficitin buxhetor, si dhe nepermjet përdorimit të përmirësuar të instrumenteve të tregut gjatë zbatimit të politikës monetare. Menaxhimi fiskal do të fokusohet në reduktimin e deficitit buxhetor nepermjet: (a) rritjes së të ardhurave nga administrimi fiskal i përmirësuar dhe zgjerimi i bazës së taksimit; (b) përmirësimi i kontrollit mbi shpenzimet; dhe (c) planifikimi dhe parashikimi me i mirë buxhetor.

206. Përmirësimet në pozicionin e jashtëm të ekonomisë duhet të fokusohen në një reduktim gradual të deficitit financiar dhe ruajtje të rezervave në valute për kater muaj importe. Masat për të inkurajuar rritjen e eksportit dhe zëvendësimin e importit do të kombinohen me përpjekje të vazhdueshme për të perfunduar si marrëveshjet dypalëshe ashtu edhe ato shumëpalëshe të tregtisë brenda rajonit dhe me gjere<sup>45</sup>. Do të jete shumë vendimtare të ruhet dhe të fuqizohet me tej kuadri duke ruajtur stabilitetin e monedhës vendase, mbajtur inflacionin nën kontroll, duke vazhduar të reduktohen deficitet buxhetore, dhe rritur të ardhurat qeveritare nepermjet

<sup>45</sup> Në 2001, ekonomia qëndronte në kuotat e inflacionit prej 3.5% në dhjetor dhe të një GDP reale të rritur në 7.3%. Të ardhurat fiskale zinin pothuajse 24% të GDP dhe shpenzimet totale të buxhetit ishin 33% të GDP. Po këtë vit, Shqipëria kishte një deficit buxhetor prej 9%. Marrëveshja e parë për tregtinë e lirë, është nënshkruar me Maqedoninë, në kuadër të iniciativave të Paktit të Stabilitetit.

permiresimit ne mbledhjen e taksave. Ka filluar nje thellim i reformave institucionale (perفشire reformen ne sherbimin civil, decentralizimin, permiresimin e mbrojtjes ligjore per aktivitetet private, ulje te korrupsionit, dhe privatizimi, proces, i cili duhet te zbatohet seriozisht gjate viteve te ardhshme.

### 3.2 DECENTRALIZIMI DHE ROLI I ZHVILLIMIT ME BAZE KOMUNITETI

207. Funksionet dhe kompetencat e reja te njesive te qeverisjes vendore, duhet te shoqerohen me autoritet vendim-marres dhe pergjegjeshmeri. Ligji "Per Organizimin dhe Funksionimin e Njesive te Qeverisjes Lokale" ende nuk parashikon kompetencat e secilit nivel per sherbime te caktuara. Sfida qendron ne zbatimin e ketij ligji ambicioz dhe identifikimin ne detaje te strukturave organizative qe sigurojne burimet e tyre te financimit dhe pergjegjshmeri.

208. Shume ministri jane perfshire ne procesin e decentralizimit, si Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit, Ministria e Puneve Publike dhe Transportit, Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Transporteve dhe te tjera. Deri sot, jo te gjitha ministrite kane perfunduar planet e tyre per decentralizimin e funksioneve ne sektoret e tyre respektive. Planet e veprimit ekzistojne, por gjithsesi implementimi i tyre po zvarritet. Autoriteti vendim-marres dhe pergjegjshmeria e niveleve te ndryshme qeveritare duhet te percaktohen qarte.

209. Ministria e Puneve Publike dhe Transportit ka hartuar nje strategji. Enti Rregullator i Ujit nevojitet qe te punoje me tej per ndarjen e kompetencave dhe pergjegjesive rregulluese ndermjet komunave. Per rruget rurale, Ministria e Pushtetit Lokal ndodhet ne procesin e ripershtatjes se pergjegjesive te 36 ish-rretheve per rruget interkomunale me nje shtrirje prej rreth 7,000km, per 12 **Rajone**.

210. Ne aspektin e ujitjes dhe kullimit, funksionimi dhe menaxhimi i kanaleve ujtese, po transferohet gradualisht tek Shoqatat e Perdoriesve te Ujit (Sh.P.U). MBU duhet te beje decentralizimin e mbikeqyrjes se fondeve te funksionimit dhe mirembajtjes se sistemeve ujtese nga ana e Sh.P.U. Financimet e kombinuara nga Sh.P.U dhe MBU per rehabilitimin dhe mirembajtjen, duhet te vazhdojne derisa te behet mbulimi i koston nepermjet tarifave te perdorimit. Gjithashtu, eshte shume e domosdoshme qe te ristrukturohen ndermarrjet e ujit duke kaluar ne borde kullimi, te cilat te jene pergjegjese vetem per funksionimin dhe menaxhimin e stacioneve te pompimit dhe te digave. Duhet krijuar nje grup pune brenda Departamentit te Ujitjes, ne menyre qe te diskutohet per konceptin e bordeve kulluese dhe te pergatitet nje draft-propozim per Keshillin e Ministrave. Dy ndermarrje te ujit (ne Kavaje dhe Lushnje) do te jene te parat qe do te transformohen ne borde te kullimit, borde te cilat duhet te ngrihen nga mesi i vitit 2002.

211. MBU nevojitet te vijojte me tej me decentralizimin e sherbimit veterinar, i cili hyri ne fuqi ne fillim te vitit 2001. Kontrolli efektiv mbi semundjet epizotike neper te gjitha vendin, duhet te mbetet pergjegjese e qeverise qendrore, ndersa monitorimi dhe kontrolli i semundjeve te gjese se gjalle, duhet te transferohet ne nivelin lokal dhe shkembimet e informacionit ndermjet nivelit lokal dhe atij qendror duhen detajuar. MBU duhet te vazhdoje me tej me procesin e decentralizimit per rregullat e sigurise ushqimore dhe mbrojtjes se konsumatorit. Bashkia duhet te lejohet qe te percaktoje rregullat dhe standartet e higjenes per vendndodhjet e tregjeve dhe te thertoreve, ndersa monitorimi dhe kontrolli i tregtareve, perpunuesve te mishit, dhe rregullat e pergjithshme te sigurise ushqimore duhet te mbeten ne nivelin kombetar.

212. Eshte e rendesishme qe veprimet per decentralizimin e funksioneve dhe kompetencave, te marrin domosdoshmerisht ne konsiderate nivelin e pershtatshem per sherbimet kryesore dhe qe rolet dhe pergjegjesite percaktohen ne nje kuader ligjor te qarte. Ne kete kuptim, do te jete shume e domosdoshme qe te percaktohen pergjegjesite e qeverisjes rajonale dhe qendrore ne koordinimin e projekteve per infrastrukturen dhe zhvillimin ekonomik, per planifikimin dhe menaxhimin e shfrytezimit te tokes qe i kalon kufijte e komunave dhe bashkive.

213. **Te garantohet që financimet të pershtaten me përgjegjësitë.** Dihet mirë prej eksperiencave në vendet e tjera, që krijimi i një baze të gjere taksimi dhe kalimi nga burimi qendror në atë lokal të të ardhurave kërkon kohe. Për rrjedhojë, mund të pritet që në vitet para të decentralizimit në Shqipëri, buxhetet e pjesës dermuese të njesive të qeverisjes vendore, të vazhdojnë të varen nga burimet qendrore, gjë që do ta bëjë të rëndësishme sigurimin e lidhjeve të fuqishme ndërmjet shërbimeve të ofruara në nivelin lokal dhe fondeve të nevojshme për t'i realizuar këto shërbime.

214. Ligji "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Pushtetit Lokal" specifikon burimet e financimit të funksioneve të qeverisjes lokale, sic janë taksat dhe tatimet, një taksë e re për token bujqësore, ndarja e taksave kombëtare, grantet e pakushtezuara nga qeverisja qendrore, grante të kushtezuara nga qeverisja qendrore, dhe huamarrja. Ligji i ri për Marrëdhëniet Nderqeveritare, aktualisht në fazë përgatitjeje, do të përcaktojë ndarjen e taksave kombëtare, kriteret e reja dhe rregullimet për përcaktimin e granteve të pakushtezuara, dhe rolin e granteve të kushtezuara. Planifikimi i shpenzimeve afat-mesme përcakton një kuader për financimin e funksioneve ekskluzive, të ndara dhe të deleguara tek qeverisja vendore. Sipas atij: (a) funksionet ekskluzive do të financohen nga taksat dhe tatimet lokale, taksat kombëtare të ndara dhe grantet e pakushtezuara nga buxheti i qeverisë qendrore; (b) funksionet e ndara do të financohen nga grantet e kushtezuara nga buxheti i qeverisë qendrore, dhe (c) funksionet e deleguara do të financohen plotësisht nga transferata të kushtezuara nga buxheti i qeverisë qendrore.

215. Shpërndarja e granteve të pakushtezuara periodike për qeverisjen vendore në drejtim të shërbimeve në infrastrukturë si rrugët rurale, furnizimin me ujë të pijshëm, kanalizimet e ujerave të zeza, kanalet për sistemin e ujerave të shiut, janë në kompetencë të qeverisjes vendore. Prandaj, funksionimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve të ujerave rurale dhe higjienës, mbështeten në të ardhurat nga tarifata e përdorimit dhe grantet periodike të pakushtezuara<sup>46</sup>. Financimi i parashikuar për këto aktivitete është shumë më i ulët sesa nevojat, sipas vlerësimeve të strategjisë së ujit dhe higjienës rurale. Transferimi i planifikuar nga Ministria e Pushtetit Lokal në funksione ekskluzive të pushtetit lokal për vitin 2002, vlerësohet 2.8 miliardë Leke, që përfshin administrimin dhe ndërtimin lokal publik, kostot e rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve rurale. Duke patur parasysh kushtet e keqja të rrugëve rurale, kostot e vlerësuara për rehabilitimin, riparimin dhe mirëmbajtjen, kapin vlerën e rreth 15 miliardëve<sup>47</sup>.

216. **Rritja e të ardhurave.** Është e nevojshme që të krijohet një ekuilibër i ri ndërmjet niveleve të larta të taksave kombëtare që aktualisht i demotivojnë njesitë e qeverisjes vendore, dhe atyre të rritura lokale. Përveç kësaj, njesitë e qeverisjes vendore duhet që të ndihmohen në krijimin e kapaciteteve efektive administrative për mbledhjen e taksave dhe tatimeve. Përfundimi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme, dhe fillimi i aplikimit të taksës së pronës mbi bazën e vlerës së tregut, do të jenë burime të rëndësishme të sigurimit të të ardhurave për njesitë e qeverisjes vendore. Futja e taksës për token bujqësore do të jetë gjithashtu, një baze e rëndësishme të ardhurash për qeverisjen vendore. Autonomia në rritje e të ardhurave do të varet nga një politikë e mirëkoordinuar, krijimi i një sistemi efektiv të menaxhimit financiar, dhe aprovimi i financimeve sipas prioritetëve të vecanta. Me rritjen e kapaciteteve administrative dhe të shkallës së përgjegjshmërisë, njesitë lokale do të kërkojnë të ndërmarrin hapa më të përparuar drejt autonomisë së të ardhurave.

217. Projektimi i Ministrisë së Financave për financimin e pushtetit lokal gjatë periudhës 2002-2004, tregon një tendencë pozitive në drejtim të rritjes së autonomisë të të ardhurave për pushtetin lokal. Në 2001, varesia nga grantet e kushtezuara ishte 78%, dhe në 2004 parashikohet

<sup>46</sup> Riparimi dhe mirëmbajtja vjetore dhe një pjesë e kostos së rehabilitimit për sistemin rural të ujit dhe higjienës, vlerësohen nga 21-42 miliona Leke, duke marrë në konsideratë një kosto të riparimit dhe mirëmbajtjes vjetore prej 1% të kostos kapitale.

<sup>47</sup> ICR, Projekti i Rrugëve Rurale në Shqipëri, 2001.



te jete 63%. Kjo tendence bazohet kryesisht ne rritjen e menjehershme te parashikuar per taksat dhe tatimet lokale dhe transferimin e granteve te pakushtezuara.

218. Pjesemarrja e komuniteteve lokale ne Shqiperi ka provuar te jete efektive ne ndertimin e nje baze te shendoshe per permiresimin e sherbimeve. Megjithate, per aq kohe sa nuk do te kete permiresime te metejshme ne pjesemarrjen e komunitetit, vecanerisht ne kushtet e nje vendi me insitucione te dobeta dhe me mungese besimi kundrejt qeverise se Shqiperise, organizatat dhe institucionet lokale do te mbeten te dobeta dhe te paperfillshme, dhe besimi midis komuniteteve dhe autoriteteve te qeverisjes vendore do te mbetet i brishte. Nje menyre per te rritur pjesemarrjen eshte per te perfshire autoritetet e komunes ne monitorimin e mbledhjes dhe perdorimit te fondeve te Sh.P.U dhe asistuar keto te fundit per te mbuluar kostot dhe permiresuar menaxhimin e burimeve ujore.

### 3.3 PERMIRESIMI I KLIMES SE BIZNESIT

219. Qeveria pranon rendesine e permiresimit te klimes per zhvillimin e biznesit dhe investimeve, vecanerisht investimet e huaja te drejtperdrejta. Duhet te ndermerren nje seri hapash: (a) te fuqizohet kuadri ligjor dhe rregullator; (b) mbeshtetet zhvillimi i ndermarrjeve te vogla dhe te mesme; (c) inkurajohen investimet e drejtperdrejta te huaja; dhe (d) te nxiten eksportet.

220. Zhvillimi i nje Kuadri Ligjor dhe Rregullues ka qene ne vemendje te vecante te qeverise, si dhe eshte pergatitur nje pjese e konsiderueshme e kuadrit baze te nevojshem legjislativ dhe rregullator per nje ekonomi te orientuar drejt tregut. Shqiperia ka nje Kod Tregtar te zhvilluar brenda kontekstit te kodit civil, me nje kuader te gjere ligjesh dhe rregullash ne aspektin bankar, administrimin e prones se patundshme, administrimin e taksave, doganave, privatizimin dhe investimet e huaja. Ne te shumtat e rasteve, ligjet konsiderohen te jene ne perputhje me standartet nderkombetare, dhe puna e mbetur per pergatitjen e legjislacionit ne aspekte si falimentimi, ka perparuar mire. Megjithate, problemi mbetet te mungesa e kapacitetit imponues , qe con ne implementimin e dobet te kuadrit ligjor dhe rregullues. Moszbatimi i rregullt i ligjeve dhe rregullave ekzistuese, shpesh sjell trajtime arbitrare dhe te padrejta. Per me shume, zbatimi i kontratave eshte i veshtire dhe sistemi gjyqesor eshte ne vecanti i dobet ne aspektin e zbatimit te kontratave dhe zgjidhjes se mosmarreshjeve. Keto ceshtje lipsen te trajtohen per zgjidhje nga qeveria ne vitet qe vijojne. Ligji per falimentin ka nevojte te ratifikohet, dhe duhet siguruar nje zbatim me transparent i ligjeve. Korrupsioni duhet te trajtohet ne menyre me rigoroze nga qeveria, duke e bere hyrjen ne biznes apo proceset e tregtise me transparente.

221. Zhvillimi i ndermarrjeve te vogla dhe te mesme, shihet si nje burim i rendesishem i rritjes se ekonomise dhe ne vecanti te asaj rurale. Qeveria duhet te perfundoje ligjin per Ndermarrjet e Vogla dhe te Mesme (SME) si dhe te krijojte nje agjenci te Ndermarrjeve te Vogla dhe te Mesme, si nje pike fokale per inisiativat e SME. Nxitja e investimeve te huaja duhet lehtesuar me ngritjen e dyqaneve me nje ndalesa per ofrimin e sherbimeve per investitoret e huaj dhe duke i ndihmuar ata per te marre licencat dhe lejet e nevojshme. Iniciativa te tjera jane ne progress, per pergatitjen dhe publikimin e vezhgimeve gjashte-mujore mbi klimen e biznesit dhe per analizimin a pengesave administrative per hyrjen e investitoreve. MBU duhet te zhvilloje inisiativa te nxitjes se eksportit qe perfshijne hartimin e nje strategjie per nxitjen e eksporteve te prodhimeve bujqesore, rishikimin e legjislacionit qe prek eksportet, dhe zhvillimin e programeve te nxitjes se eksporteve.

222. Qeveria duhet te vazhdoje implementimin e masave kryesore te reformes si : (a) perfundimin e privatizimit dhe ristrukturimit te ndermarrjeve, (b) privatizimin e bankave, (c) permiresimin e kuadrit rregullator per sektorin financiar, (d) permiresimin e qeverisjes dhe transparences, dhe (e) fuqizimin e sistemit ligjor dhe juridik. Qeveria duhet te perqendrohet me te gjitha energjite e saj ne permiresimin e efektivitetit te shpenzimeve publike nepermjet zgjidhjes se pengesave kryesore gjate viteve ne vazhdim. Reformat institucionale duhet te luajne nje rol

dominues per kapercimin si te kapaciteteve te dobeta institucionale ashtu edhe te mungeses se pergjegjshmerise dhe transparences ne administraten publike. Ceshtjet kryesore qe ndikojne ne klimen aktuale te biznesit jane paraqitur te permbledhura ne Kutine 7. Shqiperia ka potenciale per te rritur nivelin shume here me teper, nese keto ceshje themelore zgjidhen.

#### **Kutia 7. Ceshtjet themelore qe lidhen me klimen e investimeve te huaja te drejtperdrejta**

Problemi primar qe pengon eshte qeverisja e dobet. Pengesat qe permenden me poshte jane te nje rendesie te vecante:

- Mungesa e zbatimit te rregullt dhe transparent te ligjeve, qe perben edhe pengesen e vetme me e rendesishme per nje me te larte.
- Korrupsioni, i cili ngre koston e zhvillimit te biznesit.
- Zbatimi i dobet i ligjit dhe kontratave, qe vjen si pasoje e mungeses se besimit tek sistemi gjyqesor.
- Zbatimi jo i rregullt i ligjeve te taksave dhe procedurave te doganave, s dhe mekanizmat jo-efektive te rimbursimit te taksave dhe tatimeve.
- Infrastruktura jo e plote, vecanerisht mungesa e sasise se duhur te energjise, ujit, dhe transporti, i cili sjell per pasoje struktura me kosto te larte.
- Aksesit i veshtire ne lejet e tokes dhe ato te ndertimit.
- Procedurat e gjata te rregullave e biznesit.

*Burimi:* FIAS, 2001

### **3.4 INFRASTRUKTURA RURALE**

223. **Furnizimi me uje dhe higjiena.** Decentralizimi i pergjegjessive per furnizimin me uje dhe higjienen tek komunat dhe bashkite, erdhi ne nje kohe kur furnizimi me uje nepermjet sektorit publik ne zonat rurale ishte i paqendrueshem dhe nuk i sherbente sic duhet nevojave te komuniteteve. Per rrjedhoje, e ardhmja e zhvillimit te sektorit kerkonte reforma politike, si e vetmja rruge per te permiresuar sherbimet, ne menyre qe cdokush qe jeton ne fshat, te kete mundesi te furnizohet mjaftueshem me uje te pijshem dhe higjiene, dhe qe nevojat baze te permbushen ne menyre te drejte, eficente dhe te qendrueshme.

224. Ne pergjigje te kesaj sfide, Ministria e Puneve Publike dhe Transportit pergatiti ne vitin 2001, nje Strategji te Furnizimit me Uje dhe Higjienes ne Zonat Rurale, me asistencen e B.B. Strategjia synon te ndryshoje menyren e furnizimit me uje te implementuar nga Qeveria. Ne kete kuptim, ajo propozon tre opsione te shperndarjes: (a) sherbim te shperndarjes nga sektori privat; (b) sherbim te shperndarjes nga pushteti lokal (autoritetet e komunes); dhe (c) sherbim te shperndarjes nga vete komuniteti<sup>48</sup>.

225. Eshte e rendesishme qe te nxitet konkurrenca ndermjet opsioneve te shperndarjes, dhe qe te futen modele te ndryshme te furnizimit me uje. Modelet e furnizimit me uje nga komuna, nga komuniteti dhe nga sektori provat, mund te bashkeekzistojne ne te njejten kohe dhe brenda te njejtaj rajon. Strategjia e propozuar e Furnizimit me Uje dhe Higjienes ne Zonat Rurale, do t'i jape ketyre modeleve, te njejtat mundesi per financim te investimeve.

226. Me aprovimin e kesaj strategjie nga Keshilli i Ministrave, duhet te hartohet nje plan veprimi, i cili duhet te permbaje:

<sup>48</sup> Parimet udheheqese jane: (a) implementimi i nje metode te orientuar nga kerkesa dhe i nje procesi pjese-marres ne krytjen e sherbimit; (b) pergjegjessia e perdoruesve per funksionimin dhe mirembajtjen e sistemit; (c) kalimi i rolit te qeverise nga sherbim i drejtperdrejte i shperndarjes, ne thjesht planifikim dhe formulim politikash; (d) monitorimi dhe vleresimi i sistemit dhe dhenia e mbeshtetjes financiare te pjesshme per nevoja te investimeve kapitale; (e) menaxhimi i ujit si nje e mire ekonomike dhe jo si nje sherbim gratis; dhe (f) krijimi i nje sistemi financiar te qendrueshem.

- mbështetje për organizatat me baze komuniteti për të marrë pjesë në menaxhimin e procesit të furnizimit me ujë të pijshëm, nepermjet kalimit të autoritetit të vendim-marrjes në nivel komuniteti;
- angazhimi në rritje i OJQ-ve si ndermjetësues sociale dhe trainere në pjesëmarrjen e komunitetit;
- inkurajimi i sektorit privat për të asistuar komunitetet në ngritjen e Shoqatave të Komunitare të Ujit (Sh.K.U.), për të vlerësuar mundshmerinë e aplikimit të skemes së furnizimit me ujë, për të ofruar trainim në drejtim të menaxhimit, administrimit, funksionimit dhe mirembajtjes, dhe për të siguruar asistencë teknike të vazhdueshme, menjëherë kur sistemi të jete i ngritur dhe të vihet në funksionim;
- ndryshimi i rolit të qeverisë, në mënyrë që në vend të shërbimeve të drejtëpërdrejta, ajo (a) të krijojë Agjencitë Rurale të Ujit dhe Higjienës nën ombrellën e Drejtorisë së Ujit dhe Kanalizimeve në Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit; (b) lehtësojë emerimin e bordit; (c) sigurojë buxhetin operacional të agjencive; (d) përcaktojë politikën në sektorin e furnizimit me ujë dhe atë të higjienës në zonat rurale; dhe (e) detyrojë për zbatim një legjislacion rregullator të burimeve ujore, ambientit dhe shëndetit;
- garantimi i qëndrueshmerisë financiare nepermjet implementimit të projekteve me kompensim të pjesshëm të kostos;
- krijimi i një klime të përshtatshme që nxit transparencën, dhe fuqizon partneritetin e vertete ndermjet organizatave qeveritare, OJQ-ve dhe komuniteteve;
- zhvillimi dhe implementimi, me pjesëmarrjen e komunitetit i planeve për menaxhim të qëndrueshëm të burimeve ujore, në varesi të qëllimit të përdorimit.

227. Sistemet e vogla të furnizimit me ujë të administruara nga komunitetet dhe/ose sektori privat. Një model i furnizimit me ujë me baze fshati, është i rekomandueshëm për komunitetet rurale periferike. Sistemet e vogla të furnizimit me ujë të menaxhuara nga komunitetet kanë provuar të jenë të suksesshme në drejtim të kostos së ulet të shërbimit, mbulimit të kostos, organizimit me eficient dhe teknologjisë modeste që kërkojnë. Në rastin e fshatrave të largëta, me shumë pak mundësi të ardhurash, realizimi i shërbimeve infrastrukturore duhet të lidhet direkt me projekte që nxisin aktivitete që prodhojnë të ardhura. Menaxhimi i burimeve lokale në interes të komunitetit, sic janë pyjet dhe kullotat komunale, është një burim i rëndësishëm të ardhurash, në vecanti për zonat e largëta malore. Përtej mirembajtjes së sistemit, këto të ardhura mund të përdoren për investime prioritare në infrastrukturën e komunes. Niveli i qeverisjes vendore dhe komunitetet duhet të jenë në pararojë të përcaktimit të prioriteteve për aspekte të vecanta. Në rastet kur burimet natyrore, si Liqeni i Ohrit, janë të një rëndësie përtej nivelit lokal, procesi i vendim-marrjes duhet të zgjerohet duke përfshirë institucione që mbrojnë interesat me të gjera. Një shembull i menaxhimit të kurrizeve ujendarese me pjesëmarrjen e fshatrave që ndodhen përgjate liqenit, është Projekti për Ruajtjen e Liqenit të Ohrit, i financuar nga Njësia Globale e Mjedisit.

228. **Zhvillimi i zonave urbane periferike.** Si pasoje e levizshmerisë së madhe të popullsisë, nga zonat e verifera rurale në ato urbane, kufijte ekzistues administrative nuk pasqyrojnë zhvillimin e zonave periferike urbane. Mijera fshatare janë vendosur në periferi të qyteteve kryesore, si dhe në qytete përgjate bregut të Detit Adriatik. Kështu, dallimet ndermjet urbanes dhe rurale shpesh behen të paqarta. Kjo vlen për ato rrethe, fshatrat e të cilave janë në kufi me qytetet. Punesimi jashtë fermes, prodhimi i vogël, dhe shërbimet po mbizoterojnë në këto zona. Ende, në zonat e sapo urbanizuara, ish zonat rurale, bujqësia mbetet një burim i mirë të ardhurash për jetesë. Kjo situatë ka krijuar një lloj boshllëku të përgjegjesive institucionale në sigurimin e ujit të pijshëm. Përveç kësaj, këto zona janë shpesh të zaptuara në mënyrë informale ose ilegale, duke cuar në pak shërbime infrastrukturore, si psh., ai i ujerave të zeza, kanaleve kulluese dhe tubave të ujit. Aspekti institucional i këtij problemi duhet të trajtohet në kuadrin e decentralizimit, për të rritur rolin e rajonit në koordinimin nepermjet juridiksionit të komunave

dhe bashkive dhe rritjes se bashkepunimit midis komunave. Zhvillimi i infrastruktures urbane nevojitet te marre ne konsiderate keto zona peri-urbane ne zhvillimin e planeve te infrastruktures.

229. **Rruget rurale.** Sic eshte permendur ne kapitullin e meparshem, ndertimi, rehabilitimi dhe mirembajtja e rrugeve rurale, iu transferua gradualisht komunave qe prej vitit 1992, deri ne finalizimin e tij ne janar 2001. Megjithate, menaxhimi lokal ka pasur pak ndikim ne kushtet e rrugeve. Nje nga veshtiresite kryesore mbetet kapaciteti i dobet per realizuar mirembajtje efektive te rrugeve, si pasoje kryesisht e burimeve te kufizuara te financimit.

230. Ne vitin 1999, qeveria hartoi nje Strategji per Mirembajtjen e Rrugeve. Strategjia perfshin te gjitha rritjet e rrugeve, dhe ve ne dukje parimin kryesor te ruajtjes se nje niveli te pershtatshem te sherbimeve, per secilen pjese te rritjet te rrugeve, nepermjet programeve afatmesme dhe afat-gjata te investimit per rehabilitim dhe reforme sektoriale, strukturim institucional dhe privatizim gradual te sherbimeve te mirembajtjes se rrugeve. Strategjia i referohet kater fushave te rendesishme per permiresime: (a) krijimin e nje strukture efektive organizative, (b) krijimin e nje sistemi qe siguron nje nivel te mjaftueshem financimi, (c) zbatimimi i procedurave te plota operative, dhe (d) aplikimi i politikave te mire per rekrutimin e personelit.

231. Strategjite dhe veprimet e ndermarra nga qeveria, ne kompleksitetin e tyre po cojne ne drejtimin e duhur menaxhimit te rrugeve rurale dhe permiresimet ne nje mjedis te bazuar ne tregun, me nje pergjegjesi te konsoliduar te qeverisjes lokale. Zhvillimet e ardhshme duhet te sigurojne qe:

- keshillat rajonale te marrin funksionet e nder-komunave, dhe nderrethet, te cilave u eshte deleguar menaxhimi i rrugeve rurale i deleguar nga Ministria e Pushtetit Lokal, marrin persiper inventarin perfundimtar, dhe marrin edhe buxhetin per mirembajtjen (grante te pakushtezuara);
- keshillat rajonale perpilojne kritere per akordimin e buxhetit per rruget rurale primare, sekondare dhe terciare, bazuar ne standarte te aprovuara per secilin lloj te rruges, kushtet e rruges dhe burimet ekzistuese;
- keshillat rajonale mbikeqyrin projektet e rrugeve dhe sigurojne qe ato te perfshijne te gjitha kriteret qe lidhen me kullimin, llojin e trafikut, gjeresine e rrugeve, materialet dhe kritere te tjera;
- te aplikohet mirembajtja me baze kontraktimi per rruget rurale;
- prokurimi per mirembajtjen e rrugeve rurale behet pergjegjesi e rrugeve rurale.

232. **Ujitja dhe kullimi.** Rehabilitimi i sistemeve te ujitjes dhe kullimit, duhet te vazhdoje edhe ne vitet ne vijim. Progres i kenaqshem eshte bere me krijimin e organizatave me baze komuniteti dhe shoqatat e perdoruesve te ujit kane provuar ne shume raste, te jene instrumenta te mire per te menaxhuar infrastrukturen ujtese dhe shperndarjen e ujit ne nivelin lokal. Keto perpjekje duhet te vazhdojne, Sh.P.U. qe nuk funksionojne sic duhet, duhet te mbeshteten si dhe do te inkurajohet krijimi i Sh.P.U-ve te tjera. Der tani, kerkesa per ujitje nuk mund te permbushet plotesisht. Sh.P.U duhet te kene nje person kontakti ne MBU, i cili te mund te koordinoje aktivitetet te ndryshme ne implementim ne aspektin e ujitjes. Aktualisht, ujitja ne zonat kodrinore mbeshtetet nga projekti per zhvillimin e zonave malore per financimin e IFAD-it, ndersa ujitja e zonave te uleta mbeshtetet nga Projekti i Ujitjes i BB. Te dyja keto aktivitetet duhet te koordinohen per te lejuar nje metode te perbashket ne drejtim te organizimit te Sh.P.U dhe ujitjes. Ne te ardhmen, vemendja do te perqendrohet ne: (a) ndertimin e kapaciteteve te autoriteteve qe koordinojne dhe lehtesojne funksionimin e kanaleve te medha, paralel me ruajtjen e konceptit te nje sistemi menaxhimit nga ana e perdoruesve; (b) keshillimin e fermereve per perdorimin efcient te ujit per vadije dhe menaxhimit e permiresuar te burimeve si dhe nje trajtim te qendrueshem; (c) menaxhimi e burimeve ujore; (d) riparimin e stacioneve te pompimit dhe digave. Pervec kesaj, Keshilli Kombetar i Ujit duhet te operacionalizohet dhe duhen marre masa per ta bere me efektive. Keshilli Kombetar i Ujit aktualisht funksionon administrativisht, nen ombrellen e Presidentit, ndersa do te ishte me mire qe te vendosej ne MBU, aty ku mund te behet

nje pike fokale per te gjitha aktivitetet qe lidhen me ujitjen dhe menaxhimin e burimeve ujore. Eshte shume themelore qe ne vitet e ardhshme, te hartohet nje plan i detajuar i menaxhimit te burimeve ujore.

### 3.5 TREGJET E TOKES

233. Zhvillimi i tregjeve te tokes bujqesore eshte nje element i rendesishem i strategjise rurale ne Shqiperi. Tregjet mirefunksionuese te tokes jane shume te rendesishme per rritjen afat-gjate te sektorit, pasi ato ndihmojne te sigurohet qe burimet e tokes orientohen drejt perdorimeve me te mira te mundshme. Ato jane gjithashtu te rendesishme per lehtesimin e ndermjetesimit financiar dhe promovimin e investimeve ne permiresime kapitale. Hapa te metejshem te domosdoshem per t'u ndermarre:

- Perfundimi i procesit te regjistrimit te pare sa me shpejt qe te jete e mundur. Sigurimi i financimeve shtese te donatoreve, nese vazhdon te ekzistoj boshlleku financiar.
- Rishikimi i legjislacionit dhe rregullave ekzistuese per regjistrimin e pasurive te patundshme, me qellim qe te reduktohet koha dhe kostot e kryerjes se transakcioneve.
- Rishikimi dhe amendimi i legjislacionit dhe procedurave qe lidhen me njoftimin e familjes, me qellim thjeshtesimin e procedurave dhe kufizimin e llojeve te transakcioneve ne rastet kur kerkohet njoftimi i familjes.
- Ngritja dhe zbatimi i mekanizmave per kompensimin e qytetareve me pretendime te ligjshme dhe largimi i pasigurise se titujve si pasoje e pretendimeve te pazgjidhura.
- Kryerja e nje fushate te ndergjegjesimit publik, per te edukuar qytetaret mbi te drejtat dhe pergjegjesite qe shoqerojne pronesine mbi pronen private.
- Pergatitja per zbatimin e nje sistemi te taksimit per pronen, me tarifa te moderuara taksimi, te cilat te behen efektive sapo qe te mbaroje regjistrimi i pare. Pergatitjet duhet te perfshijne zhvillimin e kapacitetit per te bere vleresimin e prones.

234. **Berja funksionale e tregjeve te tokes.** Pavaresisht progresit te kenaqshem te bere nga qeveria ne intensifikimin e nje reforme te rendesishme dhe largpamese te tokes, ekzistojne nje numer ceshtjesh qe rrezikojne ngadalesimin e zhvillimit te tregjeve te tokes. Per pjesen me te madhe te pronareve te tokes, eshte hera e pare qe ata zoterojne toke apo ndonje forme tjeter prone te patundshme, dhe per rrjedhoje ata nuk jane shume te predispozuar per ta shitur ate. Per me teper, ata e kane fituar token gratis, dhe perderisa nuk ekziston sistem taksimi per token, ka pak presion per t'a perdorur, shitur apo dhene me qira ate. Ceshtje te tjera qe mund te pengojne zhvillimin e tregjeve te tokes jane: (a) procesi i paperfunduar i regjistrimit; (b) proceset e biznesit ne zyrat e regjistrimit; (c) struktura e tarifave (p.sh. tarifat e noterise dhe ato te regjistrimit); (d) kriteret per njoftimin e familjes; (e) mungesa e njohurive dhe te kuptimit te konceptit te te drejtave dhe pergjegjesive te prones private; dhe (f) pretendimet e meparshme.

235. **Perfundimi i procesit te regjistrimit.** Regjistrimi jo i plote i pasurive te patundshme, pengon zhvillimin e tregjeve te tokes, si rezultat i pasigurise qe shoqeron transakcionet qe nuk mbështeten nga tituj te regjistruar. E ndersa eshte bere progres i kenaqshem ne regjistrimin e pare, nje numer i konsiderueshem parcelash mbeten ende te paregjistruara, dhe do te duhen me shume se dy vjet, sipas kalendarit ekzistues, qe te perfundoje regjistrimi. Mundesia e respektimit te ketij kalendarit eshte gjithashtu ne pikepyetje, pasi potencialisht ekzistojne 25% me shume parcela qe duhet te regjistrohen, kundrejt atyre te parashikuara (4 milione ne vend te 3 milioneve). Per me shume, pronat e pazgjidhura qe duhet te regjistrohen, jane kryesisht periurbane dhe urbane, ku paqartesia ne kthimin e tokes dhe politiken e kompensimit, po shkaktojne vonesa ne vendosjen e titujve te qarte mbi token. Megjithate, asgje nuk i pengon pronat me tituj te pasigurt nga futja ne sistemin e regjistrimit, dhe keshtu regjistrimi per here te pare mund te

perfundohet pavaresisht ketyre paqartesive. Ne raste te tilla, duhet vendosur nje njoftim mbi titull, qe te thote se titulli nuk eshte i qarte, dhe se nuk duhet te behen transaksione me pronen, derisa te sqarohet titulli. Megjithate, administrimi i Sistemit te Regjistrimit te Pasurive te Patundshme kundershon futjen e ketyre pronave ne sistem, derisa titujt te qartesohen. Ekziston gjithashtu edhe nje boshllek financiar ne kete proces te financuar nga donatorete, qe mund te coje ne nje vonese te konsiderueshme ne perfundimin e tij, nese boshlleku nuk do te mbyllet.

236. Permiresimi i proceseve te biznesit ne zyrat e regjistrimit te pasurive te patundshme. Cilesia e sherbimeve te bazuara ne tarifa, te ofruara nga zyra e regjistrimit eshte e ndryshme. Ne zyra te vogla rajonale, standartet e sherbimit jane te pranueshme ne nje shkalle te madhe, pasi niveli i aktivitetit eshte i kufizuar. Krejt ndryshe, cilesia e sherbimit ne zyrat urbane, vecanerisht ne regjistrin qendror te Tiranes, eshte alarmuese. Dhomat e pritjes jane te mbipopulluara, koncepti i rrades duket i huaj dhe mbreteron kaosi. Ky ambient eshte demoralizues per ata qe nuk jane te familjarizuar me procedurat dhe con ne nje shtate ku zyrtaret e korruptuar qe lehtesojne procesin, perceptohen si nje fenomen i perhapur. Zyrtaret e regjistrimit duhet te ndermarrin veprime per ta kundershuar kete perceptim dhe t'i demonstrojne perdoruesve se te gjitha tarifat jane te ligjshme dhe qe nuk ekziston korupsion ne sistemin e regjistrimit. Ekziston gjithashtu edhe nje nevojte emergjente dhe e qarte per te zgjidhur ceshtje te lidhen me procedurat e zyles dhe kontrollin e fluksit te qytetareve, ne menyre qe te mbahet rregull dhe te permiresohet eficaenca e transaksioneve.

237. Hartimi dhe zbatimi i nje plani biznesi praktik per Zyren e regjistrimit te pasurive, do te zgjidhte problemet operacionale. Plani i biznesit do te percaktonte qarte proceset e bizneseve, identifikonte burimet e nevojshme njerezore, teknike dhe financiare, dhe percaktonte strukturen organizative per te siguruar operacione eficaente dhe efektive te kesaj zyre.

238. **Ulja e strukture se tarifimit.** Tarifat dhe taksat qe shoqerojne transaksionet me pronen e patundshme jane te larta po te krahasohen me vendet fqinje dhe perbejne nje pengese reale per transaksione te ligjshme. Per shembull, tarifat dhe taksat per pullat per nje blerje/shitje jane rreth 65 USD, te cilave u shtohet nje takse transferimi e cila luhetet nga 0.5% ne 3% te vleres se tokes. Tarifat ne keto nivele, jane shume te larta krahasuar me te ardhurat rurale dhe madhesine e parcelave qe blihen apo shiten. Te nje rendesie te vecante jane taksat e transferimit, tarifat per pushtetin lokal per dhenien e certifikatave te gjendjes civile, qe verifikojne anetaret e familjes qe duhet te bejne pjese ne transaksion, dhe tarifat e noterise, te cilat u rriten shume kohet e fundit. Te dyja palet ne nje marreveshje shitje/blerje duhet te pajtojne notere per te realizuar transaksionin. Meqenese noteret kane monopolin e transaksioneve me pronen, tarifat e tyre caktohen dhe rregullohen nga shteti. Megjithate, shteti ka lejuar qe tarifat e notereve te rriten ne menyre te crregullt gjate viteve te fundit, duke arritur ne nje pike qe ato raportohen si frenuese per transaksionet me pronen. Eshte e nevojshme qe te ristrukturohen tarifat, per t'i bere ato me te uleta dhe me te drejta. Per me tej, tarifat mund te rriten gradualisht (nese do te jete e nevojshme), duke qene se perdoruesit ndergjegjesohen mbi perfitimet e sistemit dhe binden per sigurine qe ofron sistemi.

239. Aktualisht, nuk ekziston asnje taksim mbi pronen rurale ne Shqiperi. Ne pjesen me te madhe te juridiksioneve ne mbare boten, taksat mbi pronen i furnizojne qeverite lokale me nje burim te ardhurash per te mbeshtetur administrimin e sistemit te menaxhimit te pasurise. Zbatimi i nje takse te moderuar mbi pasurine per te gjitha llojet, do ta lejonte shtetin te ulte ne menyre te ndjeshme taksen e transferimit te pasurise dhe per ta bere ate me te arsyeshme ne kryerjen e transaksioneve mbi pronen.

240. **Zgjidhja e pretendimeve te hershme.** Procesi i privatizimit i miratuar per token bujqesore sipas Ligjit No. 7501, i miratuar ne 1991, nuk lejon rikthimin e tokes tek ata, te cilet e zoteronin perpara shtetezimit te saj ne 1945. Krejt ndryshe, ai lejon kompensimin ne lek fizik per njerezit qe vertetojne me prova pretendime te ligjshme mbi token qe nga epoka parakomuniste. Kjo metode shihet gjeresisht si menyra me pragmatiste per te trajtuar pretendimet e hershme dhe bazuar ne kete parim, u ndertua edhe nje Plan veprimi per tregun e tokes. Megjithate, per arsyte

ndryshme (politike dhe ekonomike), Plani i veprimit për tregun e tokës, nuk mundi të zbatohet ashtu siç u konceptua. Shumë programe privatizimi u vonuan dhe të tjera e shtrinë me tej, ndërsa disa nuk arritën madje as të fillonin. Për fat të keq, qeveria ende nuk ka zbatuar procedurat për kompensimin në lek fizik për njëzëzit me pretendime të hershme ndaj tokës bujqësore, si dhe numër i konsiderueshëm pretendimesh janë të pazgjidhura në sistemin gjyqësor. Përfshirja e gjykatave e ka komplikuar me tej procesin, duke kthyer apo modifikuar vendime privatizimi, duke shkaktuar me shumë konflikte midis njëzëzve nëpër fshatra ku ka ende konflikte të pazgjidhura.

### 3.6 SHERBIMET MBESHTETËSE RURALE

241. Sherbimi i ekstensionit në të ardhmen- Një metode e orientuar me shumë drejt klientit. Sherbimi aktual i ekstensionit në Shqipëri kryhet nga Ministria e Bujqësisë. Programe të ndryshme kanë mbështetur sherbimin gjatë dekadës së fundit, duke u përqendruar në trainim, asistencë teknike, rregullime transporti dhe aktivitete demonstruese. Një dokument politik, i cili hedh veshtrimin nga ristrukturimi i sherbimit të ekstensionit, u aprovua së fundmi nga qeveria. Ai do të synojë të rrisë lidhjet ndërmjet sherbimit të ekstensionit dhe sektorit privat, dhe krijojë qendrat e keshillimit që do të funksionojnë privatisht, me qëllimin për t'u bërë të vetë-qëndrueshme.

242. Objektivi kryesor i MBU do të jetë vazhdimi i mbështetjes për krijimin e një sistemi shumëplanësh informacioni. Sherbimet keshillimore për fermat e mëdha tregtare, duhet t'i kalojnë gradualisht sektorit privat, përfshirë shtrirjen e shoqatave të fermerëve/prodhuesve, tregtareve, furnizuesit e inputeve dhe burime të tjera informacioni. MBU duhet të mbështesë plotësisht këto zhvillime nëpërmjet trainimeve të përbashkëta dhe ndarjes së materialeve përfshirë informacionin e përftuar nga kërkimet dhe demonstrimet në fermë.

243. Veprimtaria e Qendrave rajonale të keshillimit bujqësor, të cilat janë pionere të sektorit publik, të synuara për t'u privatizuar totalisht për një periudhë pesëvjeçare, duhet të monitorohet dhe vlerësohet me kujdes, me një shtrirje në të ardhmen në zona e tjera, në varesi të performancës së tyre dhe të efektivitetit. Sherbimi publik i ekstensionit në MBU duhet të fokusohet në një masë të konsiderueshme tek fermerët e vegjël dhe mesëm, vecanërisht ata me një fokus orientimi në treg. Kjo metode do të kërkonte: (a) një vëmendje në rritje tek zhvillimi i materialeve cilësore të ekstensionit përfshirë masmedian dhe produksionet me video; (b) përmirësimin e kapaciteteve të keshilluesve lokalë; (c) një vëmendje e vazhdueshme në grupet e interesuara të fermerëve, përfshirë grupet ekzistuese dhe shoqatat private të fermerëve; (d) përmirësimin e lidhjeve midis sherbimeve të ekstensionit dhe atyre të kërkimeve, nëpërmjet programeve kërkimore në fermë dhe pjesëmarrjes në programet me baze komuniteti; (e) vazhdimin e programeve të trainimit në teknologji të nevojshme për fermerët e vegjël përfshirë edhe parashikimin e buxhetit për fermën; dhe (f) sigurimin e informacionit për tregun.

244. Në fundin, sistemi i ekstensionit duhet të orientohet në një shkallë të gjërë, drejt kërkesës për operacione private dhe duhet të jetë financiarisht i qëndrueshëm, duke lejuar qeverinë që të fokusohet në lidhjet ndërmjet kërkimit dhe ekstensionit. Mundësi të mëtejshme qëndrojnë në avancimin e teknologjisë së informacionit, e lidhur me bujqësinë dhe zhvillimin ruralë, dhe për t'i sjellë zonat rurale pranë informacionit që ato kanë nevojë. Për të arritur këtë, teleqendrat rurale janë nxitur në vende të tjera, duke përbërë një portë kalimi drejt ekonomisë së dijes.

245. Brenda sherbimit publik të ekstensionit në MBU, duhet të merren parasysh dhe të pajisen me buxhetin e mjaftueshëm për përbushjen e programit, sa më poshtë:

- Mund të zhvillohen lidhje me të mira formale ndërmjet stafit të drejtorive teknike dhe sherbimit të ekstensionit, vecanërisht në nivelin e MBU. Emerimet ekzistuese në MBU sipas Ligjit të sherbimit civil, që përfaqësojnë një rishikim të plote të pozicioneve dhe të përshkrimeve të vendit të punës, janë një mundësi e shkelqyer për t'i zhvilluar këto lidhje.

- Duke pasur parasysh që shkurtime të metejshme në staf janë të mundshme, duhet të ketë me shumë shpërndarje të përgjegjësive dhe detyrave në nivelin e rrethit dhe komunes, ndoshta duke e përfshirë stafin e mbrojtjes së bimeve dhe të blegtorisë plotësisht në shërbimet e ekstensionit.
- Duhet marrë në konsideratë edhe koncepti i zhvillimit të zyrave zonale që mbulojnë me shumë se një komunë, të pajisura me shërbimet e duhura dhe mjetet e komunikimit. Këto zyra mund të akomodojnë stafin lokal të ekstensionit, atë të kujdesit veterinar dhe të mbrojtjes së bimeve.
- Staf i ekstensionit duhet të përqendrohet me shumë në aktivitetet e ekstensionit sesa në funksionet rregulluese dhe kontrolluese apo mbledhjes së të dhënave, të cilat janë përgjegjësi e qeverisë.
- Duhet të vazhdohet të fokusohen shërbimet e ekstensionit në sigurimin e informacionit financiar dhe atij për tregun, si dhe të vazhdohen programet e trainimit të cilat janë të nevojshme për fermeret e vegjël përfshirë parashikimin e buxhetit të fermes dhe analizën financiare. Të eksplorojnë mundësitë për teleqendrat rurale.
- Të vazhdohet puna me grupet e interesuara të fermerëve, vecanërisht ato që janë formuar me qëllime të përbashkëta në prodhim dhe marketing, dhe ato të formuara nën kujdesin e projekteve dhe programeve të tjera.
- Zgjerimi i programeve të kerkimit në ferme, aty ku është e mundur, duke patur parasysh nevojën për t'iu përgjigjur ideve të prodhuara nga fermeret. Në këtë kuptim, pjesëmarrja në Programin Konkurrues për Grante, pjesë e projektit të Shërbimeve Bujqësore, i financuar nga BB, duhet nxitet me tej.
- Përmirësimi i prodhimit të medias, vecanërisht videot dhe spotet televizive, nëpërmjet koordinimit me të mirë ndërmjet Shërbimit të Ekstensionit dhe Departamentit të Informacionit Bujqësor.

246. **Reforma e shërbimit kerkimor.** Ka një hapësirë të konsiderueshme për të patur një efikasitet më të madh në operacionet kerkimore, një program kerkimi me adaptiv, bashkëpunim të përmirësuar midis instituteve të mbetura si dhe një përcaktim të qartë të prioritetëve të kerkimit që reflektojnë nevojat për zhvillim të Shqipërisë. Qëveria duhet të marrë në konsideratë sistemet e financimit të veprimtarisë kerkimore të orientuara nga kërkesa, përfshirë edhe sistemet konkurruese. Ekziston një nevojë e qartë për të reduktuar numrin e instituteve dhe për të konsoliduar ato që mbeten në një qendër kombëtare me një numër të kufizuar stacionesh. Në perspektivën afat-gjate, prodhimi i farës riprodhuese, farëve të bimeve dhe faksinave, duhet të kalojë tek sektori privat. Fokusi kryesor i punës kerkimore duhet të jetë pranimit dhe zbatimi i teknologjive që sigurojnë kosto të ulët dhe zgjidhje efektive për problemet e fermerëve.

247. Sot ekziston një mirekuptim i gjërë mbi nevojën për konsolidimin e instituteve të kerkimit dhe për përqendrimin e përpjekjeve për kerkime në kerkimin e aplikuar dhe jo atë baze. Për më shumë, pas dhjetë vitesh reforme, struktura e sektorit ka ndryshuar, dhe është e evidente që kerkimi duhet të rifokusohet në sfidat e reja, si p.sh. bujqësia e ekonomive të vogla, prodhimi blegtoral, dhe hibridet e kulturave të ndryshme. Për rrjedhojë, propozimet për ristrukturim duhet të rishqyrtohen dhe të hartohen një Master Plan i plotë. Rekomandohet që të emërohet një Task Force, për të analizuar gjendjen ekzistuese dhe për të bërë rekomandime specifike për ndryshime, me financimet e duhura të parashikuara për këto punë.

248. Në një masë të konsiderueshme, rekomandimet e Projektit SARA mbeten të vlefshme vecanërisht rekomandimi që kerkimi bujqësor të menaxhohet dhe bazohet në prioritetet e përcaktuara qartë të cilat pasqyrojnë nevojat e fermerëve (referohu tek paragrafi 158). Ristrukturimi i sistemit të kerkimit bujqësor, përfshirë infrastrukturën, duhet gjithashtu që të



plotesoje prioritetet e percaktuara ne nivelin lokal. Zgjidhjet e veshtira duhen bere duke marre parasysh veshtiresite qe ka qeveria ne drejtim te financimit, pasi sistemi ekzistues i sigurimit te shumave te vogla per nje numer programesh dhe institutesh kerkimi, nuk ka cuar ne zgjidhje teknike per problemet ne nivelin e fermes. Qeveria duhet te diskutoje seriozisht sisteme financimi alternative, te orientuara nga kerkesa, perfshire nje sistem konkurues ku kerkuesit pergatisin propozime per fonde per akvite kerkimore ne fusha te vecanta prioritare, te percaktuara nepermjet konsultimeve me fermeret dhe konsumatoret.

249. Ende eshte prezente nevoja per te shkurtuar numrin e instituteve dhe per te konsoliduar ato qe mbeten ne nje qender kombetare me nje numer te kufizuar stacionesh rajonale ne zona te ndryshme agro-ekologjike. Me tej, disa institute qe luajne nje rol plotesisht sherbimi dhe rregullues, si p.sh. Instituti i Kerkimeve Ushqimore, duhet te pozicionohen brenda drejtorise perkatese ne MBU, si laboratore sherbimi.

250. Aktivitetet e sherbimit si prodhimi i fares riprodhuese dhe vaksinat dhe aktivite te tjera te mundshme komerciale, duhet te ndahen nga programi i kerkimit. Ne perspektiven afat-gjate, keto aktivite duhet te transferohen ne sektorin privat, dhe task forca e propozuar duhet te zbulojte mundesi te rikuperimit te menjehershem te kostos dhe privatizimin ne te ardhmen. Mbeshtetja e metejshme nga ana e shtetit, eshte e kushtueshme, krijon konkurrence te padrejte me sektorin privat, dhe eshte demotivuese per zhvillimin privat agro-industrial. Ne planin e pergjithshem, ekziston nje hapësire e konsiderueshme per: (a) nje eficence me te madhe te aktiviteve kerkimore, perfshire administrimin dhe menaxhimin financiar; (b) koordinim me te mire te aktivitetit kerkimore, duke shmangur perseritjen apo mbivendosjen; (c) bashkepunimi i permiresuar ndermjet punonjesve kerkimore dhe shfrytezimit te perbashket te laboratoreve dhe pajisjeve; dhe (d) percaktimi me i mire i prioriteteve me investime te perqendruara ne aspekte prioritare. Keshtu, rekomandohet qe MBU te filloje procesin dhe kerkoje mbeshtetjen e donatoreve per ristrukturim, sa me shpejt qe te jete e mundur.

251. **Prodhimi blegtoral dhe sherbimet veterinare.** Zgjerimi i numrit te gjese se gjalle dhe ndarja e pronesise, kane pasoja serioze per kryerjen e sherbimeve, per qendrueshmerine e ambientit dhe per aksesin e tregut. Pengesat kryesore per nje sektor prodhimi blegtoral konkurues, jane (a) gjendja e foragjereve dhe ushqimit ne pergjithesi si dhe ushqimi i varfer i blegtorise; (b) kosto e larte e kryerjes se sherbimeve ne shendetin e kafsheve, mbareshtim dhe zgjerim drejt nje popullsie me ekonomi te vogla; dhe (c) mungesa e kerkeses efektive e lidhur ne nje mase te konsiderueshme, me koston e larte te transportit dhe mungesen e perpunimit te mire dhe mjeteve mbrojtese.

252. Sherbimet veterinare jane ndare ne dy kategori. E para qe trajton kontrollin dhe zhdukjen e semundjeve qe rrezikojne shendetin publik. Keto sherbime ende qendrojne brenda nje programi te MBU, megjithese mund te kontraktohen edhe veterinare private per te kryer sherbimet. Kategoria e dyte merret me trajtimin e semundjeve te tjera, qe nuk perbejne rrezik per shendetin publik aty ku nje trajtim i tille kryhet nen kujdesin e pronarit te gjese se gjalle. Edhe keto sherbime kryhen nga veterinare private. Sherbimet e mbareshtimit sigurohen ne rradhe te pare nga sektori privat, me faren riprodhuese te marre nga institutet e kerkimit dhe nga materiali mbareshtues i aplikuar ne kuadrin e projekteve te ndryshme. Ne perspektiven afat-gjate, rolet kryesore te qeverise duhet te behen rregullimi dhe monitorimi, dhe jo mirembajtja e demave per prodhimin e fares riprodhuese.

253. **Per pajoje, theksi duhet vene ne masat e meposhtme:**

- Permiresimi i menaxhimit te kullotave, dhe disponueshmeria e cilesia e ushqimit dhe foragjereve, te cilat ndikojne ne prodhimin blegtoral, ritmet e rritjes, pjellorine dhe performancen riprodhuese. Masa duhen marre per te permiresuar prodhimin e foragjereve dhe teknologjine mbrojtese, menaxhimin dhe praktikaten e ushqyerjes, dhe disponueshmeria e fares se paster dhe jonxhes dhe bimeve te tjera foragjere te mbjella ne toke te punueshme. Kjo perpjekje duhet te jete nje aktivitet ekstensional, i mbeshtetur nga komunitetet rurale te

cilat së bashku mund të kryejnë aktivitete që lidhen me përmirësimin e ushqimit. Programi i Menaxhimit Komunal të Pyjeve dhe Kullotave, pjesë e Projektit të Pyjeve, duhet shtrirë duke përfshirë komuna të tjera. Kufizimi i burimeve kullotore të paqëndrueshme si pasoje e shtrirjes së numrit të gjeshë të gjallë dhe kullotjes së pakontrolluar, duke lejuar burimet të kontrollohen në nivelin lokal.

- Sigurimi i shërbimeve me kosto-efektshmeri, përfshirë shëndetin e kafshëve dhe mbarëshkrimin, si për fermeret e vegjel ashtu edhe për prodhuesit e medhenj tregtare, dhe përmirësimi i shëndetit të kafshëve nepermjet uljes së shkallës së lartë të shfaqjes së semundjeve që përbejnë rrezik për shëndetin publik, siç janë bruceloza dhe tuberkulozi, dhe duke përmirësuar kujdesin shëndetësor për parazitët e brendshëm dhe të jashtëm dhe semundjet e tjera. Kjo mund të arrihet nepermjet privatizimit perzgjedhës, me disa nxitës që kanë mbështetjen e shtetit, aty ku është e nevojshme. Shërbimet veterinarë duhet të vazhdojnë të orientohen drejt kërkesës, dhe në masën më të madhe të siguruar nga privati, por gjithsesi me rolin e sektorit privat në kontrollimin e semundjeve epidemike dhe zoonotike. Por, zbatimi i programeve të kontrollit si vaksinimi, duhet bërë nepermjet kontraktimit nga e shtetit me specialiste private. Shërbimet e mbarëshkrimit janë gjithashtu, me të mirëmenaxhuara nga sektori privat.
- Zhvillimi i metejshëm i agro-perpunimit, i cili do të rrisë mundësitë e hapësirave tregtare për produktet e fermës, si dhe mundësitë për transformimin e produktit dhe shtimin e vlerës. Përmirësimi i aksesit në treg, gjë që aktualisht pengohet nga kërkesa e kufizuar dhe prezencë e kufizuar e ambienteve të përshtatshme për perpunim dhe hapësira të tjera për produktet blegtorale.
- Investimi i metejshëm në sigurinë ushqimore është i garantuar, por duhet të konceptohet me kujdes dhe nuk duhet të përjashtojë marrjen në konsideratë të aksesit të dobët rural dhe urban në produktet blegtorale. Zhvillimi i një sistemi kontrolli të sigurisë së produkteve blegtorale i përballueshëm nga ana financiare, i cili nuk i veçmimet për produktet e domosdoshme jashtë mundësisë së përballimit nga të varferit.

254. **Tregjet dhe agro-perpunimi.** Është e rëndësishme të përmirësohet infrastruktura e tregut, për të funksionuar në mënyrë më efektive si dhe për të siguruar mirëmbajtjen e tregjeve. Shqipëria ka një mundësi për eksplorimin e disa tregjeve të mira bujqësore, si bimët medicinale, kermijtë, produktet e ullirit, mjaltin dhe produkte të tjera të bletës. Megjithatë, keto tregje duhet të arrihen në një mënyrë të qëndrueshme. Vecanerisht me bimët medicinale, zhvillimi duhet të lehtësojë me shumë drejt kultivimin të këtyre barerave, sesa mbledhjes së tyre të egra, gjë që rrezikon shkrimin e burimeve të natyrës. Qeveria mund të mbështesë kuadrin rregullues dhe mundësitë eksportuese për keto produkte si dhe përmirësojë shtrirjen gjeografike të shërbimeve të ekstensionit. Megjithatë, funksionimi vetë duhet të jetë realisht privat dhe do të përbejë një treg të mirë dhe të leverdisshëm vetëm për një numër të vogël fermerësh.

255. Roli kryesor i qeverisë do të jetë krijimi i rregullave transparente dhe të zbatueshme pas një serie konsultimesh të gjera me aktorët. Në disa raste, si psh. në zonat rurale, bashkia apo pushteti lokal mund të investojnë në ndërtimin e thertoreve dhe ambienteve frigoriferike, duke i dhënë ato me qira mbi bazën e mbulimit të kostos. Investime të tilla në sektorin publik do të rrisin higjienën, ulnin humbjet dhe reduktonin rrezikun e semundjeve të transmetueshme nepermjet ushqimit. Investime të tjera në sigurinë ushqimore janë të garantuara, por ato duhet të konceptohen me kujdes, në mënyrë që të mos lihet pas dore fakti i aksesit të dobët rural dhe urban në produktet bujqësore.

256. Zhvillimi i një industrie konkurruese agro-perpunuese është esenciale për rritjen rurale. Pa një industri të tillë, rritja bujqësore do të kufizohet në rradhë të parë në drejtim të përmbushjes së kërkesës lokale dhe shitjes së produkteve të fresketa, dhe përfitimet nga prodhimi nepermjet punës intensive, produktet e cilësive së lartë, do të mbeten të pashfrytëzuara. Zhvillimi i

kapaciteteve agro-perpunuese do te ndikohet nga shume faktore, perfshire krijimin e nje klime te stabilizuar dhe te pakorruptuar biznesi, aksesit per financime afat-gjata, dhe permiresimin e infrastruktures se transportit dhe komunikacionit ne zonat rurale. Shtrirja pengohet nga teknologjia e vjeteruar ne fabrikat ekzistuese, mungesa e kapitalit per ambiente te reja, mungesa e ekspertizes teknike dhe menaxheriale, kosto e larte e grumbullimit te prodhimit ne rastet kur fermeret jane te vegjel dhe rruget ne kushte shume te keqija, si dhe njohurite e cinguara mbi shitjet moderne dhe sistemet e shperndarjes. Ndersa zhvillimi i metejshe i agro-perpunimit do te rrise gamen e hapesirave tregtare per produktet e fermes, si dhe mundesite per transformimin e produktit dhe shtimin e vleres, ai duhet te orientohet me shume drejt investimeve ne sektorin privat sesa ne ate publik.

257. Ndersa projektet ne vazhdimesi te financuara nga BB, mbeshtetin zhvillimin e kanaleve te tregut, informacionin per tregun dhe investimet ne sektorin e marketingut, vemendje e metejshe do t'i kushtohet permiresimit te aksesit drejt financimeve afat-gjata per sektorin, mbeshtetjes per aktivitetet e fermereve ne aspektin e marketingut, dhe permiresimit te standarteve dhe cilesise. Roli i qeverise duhet te kufizohet ne : (a) sigurimin e nje klime biznesi te pershtatshme per investime ne sektorin e perpunimit; (b) sigurimi dhe kontrolli i standarteve te produkteve ushqimore, dhe (c) permiresime te vazhdueshme ne infrastrukturen rurale dhe ate te tregut. Pjesa tjeter dermuee e pengesave duhet te zgjidhen nepermjet sektorit privat. Permiresimet ne sektorin e marketingut dhe agro-perpunimit duhet te shihen te kombinuara me permiresimet e pergjithshme te sherbimeve mbeshtetese bujqesore.

### 3.7 ZHVILLIMI RURAL JOBUIQESOR

258. Mungesa e zhvillimit rural jobuiqesor ka kontribuar ne situaten e keqe qe mbizoteron sot ne zonat rurale. Mungesa e mundesive per punesim jashte sektorit bujqesor, eshte nje pengese per nje racionalizim te metejshe te prodhimit bujqesor dhe per perfitim nga ekonomite e shkallezuar. Te marra se bashku keto faktore, kane prodhuar nje situatë te qendrueshme te papunesise strukturale ne fshat. Shembuj te mundesive per zhvillimin e ekonomise jobuiqesore dhe kushtet e nevojshme per implementimin e tyre jane pasqyruar ne Aneksin III, Tabela 13.

259. Qeveria synon te shfrytetoje potencialet per zhvillimin e ekonomise rurale jobuiqesore, si pjese e Strategjise se Rritjes Ekonomike dhe Reduktimit te Varferise. Nje program ndersektorial i ndertuar me kujdes, per mbeshtetje ndaj investimeve ne drejtim te zhvillimit te ekonomise rurale jobuiqesore, e bashkerenduar edhe me potencialet ekonomike lokale, do te ndihmonte ne permiresimin e imbalancave strukturore ekzistuese. Ai do te zbuste streset sociale, ekonomike dhe mjedisore, qe shoqerojne keto imbalanca dhe do te hidhte bazat ne menyre te efektshme per nje rritje te qendrueshme dhe permiresim ne jetesen rurale. Cdo program duhet te adresojë ceshtjet themelore te diskutuara me pare ne lidhje me zhvillimin e ndermarrjeve te vogla dhe mesme dhe hyrjet ne tregjet (paragrafi 3.3). Ekzistojne potenciale per zhvillimin e turizmit ne disa zona rurale bregdetare, por qe pengohet nga ceshtje te pazgjidhura te pronesise. Zgjidhja e problemeve te mbetura qe lidhen me kthimin dhe kompensimin e tokes, do te jene te nevojshme, ne menyre qe te keto zona te lejohen te zhvillojne potencialet e tyre. Ekzistojne te dhena qe bankat, qendrat e sherbimeve te marketingut dhe biznesit, qendrat e trainimit dhe sherbime te tjera mbeshtetese, synojne te vendosen ne zona ku infrastruktura eshte e pershtatshme. Keshtu, nje lidhje tjeter mund te vendoset ndermjet permiresimeve ne sherbimet e infrastruktures rurale dhe objektivave per reduktimin e varferise. Pervec kesaj, decentralizimi i aktiviteteve ne pergjithesi ka nje influence pozitive ne zhvillimin e bizneseve.

260. Aspektet themelore te nje programi te zhvillimit te ekonomise rurale jobuiqesore do te ishin:

- ndertimi i kapaciteteve dhe mbeshtetja e sipermarresve ne prodhimin e tyre te identifikuar dhe mundesite per punesim;

- arsimimi dhe trainimi në aftësi teknike dhe ato të biznesit dhe hapësirat e tregut në zonat rurale;
- ndërtimi i kapaciteteve institucionale në fushat e qeverisjes lokale, organizatat e shoqërisë civile, dhe shërbimeve financiare rurale;
- përmirësimi në normalizimin e klimës së pronës, atë institucionale dhe komerciale, që pengon zhvillimin e biznesit; dhe
- sigurimi i nxjessave siç janë përfitimet nga taksat apo aranzhimet preferenciale për kreditim ndaj zhvillimit të biznesit në zonat rurale.

261. Organizatat e shoqërisë civile aktualisht janë të pakonsoliduara, pjesërisht si pasoje e trashëgimit të epokës para 1991, dhe pjesërisht prej mungesës së qartësisë rreth statusit të tyre ligjor. Rritja dhe përfitimet e ekonomisë rurale jobujqësore do të amplifikoheshin nga zhvillimi i organizatave të shoqërisë civile, për shembull, në aspektin e shkëmbimit të informacionit, furnizimit me inpute, ndërmarrjen e prodhimit, përdorimit të përbashkët të infrastrukurës teknike dhe të tjera, organizimin e marketingut, sigurimit të shërbimeve financiare, dhe përfaqësimin e interesave të zhvillimit lokal. Ekziston një nevojë e vecantë në këtë kontekst, për të mbështetur rregullime të pranueshme institucionale, të cilat do të lejonin gratë rurale të marrin pjesë në zhvillimin e ekonomisë rurale jobujqësore dhe të kenë akses në përfitimet e saj në një mënyrë që pasqyron plotësisht rëndësinë e tyre në ekonominë dhe shoqërinë rurale.

262. E një rëndësi themelore për zhvillimin e ekonomisë rurale jobujqësore, është krijimi i shërbimeve rurale financiare të përshtatshme, kompetente dhe të besueshme. Në këtë aspekt, rezultate të rëndësishme janë arritur nëpërmjet Fondëve të Kredive të Fshatit, Shoqatave të Kursimit të Kredive, Fondit të Financimit Rural, dhe Fondit të Financimit të Zonave Malore. Në të njëjtën kohë, programet qeveritare dhe kredite bankare mbulojnë vetëm 9% të kapitalit fillestar për ndërmarrjet private të vogla dhe të mesme. Rreth 80% e sipërmarrësve të pyetur shprehën që ata kanë nevojë për kredi.

263. Në fundi dhe më e rëndësishmja, cdo politikë dhe strategji për zhvillimin e ekonomisë rurale jobujqësore duhet të bazohet tek tregu. Mbështetja për faktore të prodhimit do të shkonte dem nëse prodhimi nuk do të shitej. Për pasoje, hapësira dhe shkalla e investimeve në aspektet njerezore, teknike dhe institucionale të ekonomisë rurale jobujqësore, duhet në mënyrë absolute të përshtaten me krijimin e mundësive për sipërmarrësit që të identifikojnë dhe zhvillojnë tregje të qëndrueshme.

264. Siguria dhe cilësia ushqimore. Siguria ushqimore është dukshëm një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit të shëndetit publik dhe mirëqenies së konsumatorit. Përmirësimi i standarteve të sigurisë ushqimore, megjithatë shkon përtej miratimit të disa rregullave. Ajo kërkon gjithashtu, investime në nivelet e prodhuesve dhe përpunuesve, që përktëhet në kosto me të lartë të produktit. Kostoja e rritur e produktit, duhet të përballohet nga konsumatorët, shumë prej të cilëve mund të gjenden nën një presion të ashpër financiar. Në fundi, rregullat për rritjen e sigurisë ushqimore kërkojnë zbatimin e publikut. Zhvillimi i rregullave të reja të sigurisë ushqimore do të kërkojë gjithashtu hartimin e një strategjie tranzitore, drejt niveleve të standarteve të sigurisë ushqimore.

265. Produktet bujqësore shqiptare vazhdojnë të kenë cilësi të ulët në krahasim me ato të importuara, në drejtim të paraqitjes, kategorizimit dhe paketimit. Kjo i vendos ato në disavantazh, në një kohë kur shpenzimet nga ambalazhi një-përdorimesh po rriten dhe konsumatorët shqiptarë po behen me shumë të mprehte. Cilësia e ulët e produkteve dhe paaftësia për të respektuar standartet e eksportit, kufizojnë aksesin në tregjet e eksportit. Përmirësimet në cilësinë ushqimore janë një kerkese që vjen si nga konsumatori i brendshëm ashtu dhe nga ai i jashtëm, të mbështetura nga rregullat e duhura dhe të zbatueshme. Zakonisht, është sektori privat i cili përmirëson cilësinë ushqimore bazuar në kërkesën e perceptuar, por gjithsesi është e

nevojshme qe te percaktohen standarte te cilesise ushqimore edhe nga publiku, kryesisht per produktet blegtorale dhe mallrat bujqesore.

266. Nxitja e tregjeve te favorshme bujqesore. Shume produkte bujqesore te favorshme, perfshire por jo vetem bimet dhe barerat medicinale, kermijte, produktet e ullirit, mjaltin dhe produktet e bletes, djatherat dhe mishi i tymosur, kane potenciale te konsiderueshme per eksport, vecanerisht ne vendet e BE. Qeveria duhet te eksploroje masat per mbeshtetjen e ketyre potencialeve eksportuese ne bashkepunim te ngushte me sektorin privat. Rekomandimet perfshijne: (a) politika publike, perfshire (por jo kufizuar me) legjislacionin dhe rregullat mbi sigurine dhe cilesine e produkteve ushqimore, dhe marreveshjet preferenciale per akses ne tregje; (b) investime publike themelore, per shembull ne infrastrukture; dhe (c) investime ne sektorin privat. Megjithate, keto tregje duhet te zhvillohen ne nje menyre qe te evitohen shfrytezimi i burimeve dhe te mirave te perbashketa. Ne vend te prodhimit te bazuar krejtesisht ne grumbullimin e produkteve ne natyre, duhen bere kerkime te metejshme dhe zbatuar teknologji te reja, te cilat lejojne prodhimin e ketyre produkteve te favorshme ne kushtet e fermes. Zhvillimi i tregjeve te favorshme, me siguri do te ndihmoje ne rritjen e vleres se shtuar per produktet bujqesore ne disa rajone, por qe gjithsesi nuk mund te konsiderohet si nje zgjidhje e plote per nje rritje te produkteve te tregtueshme dhe atyre te eksportit. Prodhimi i ketyre produkteve kerkon specializimin e prodhuesit. Vetem nje numer i kufizuar prodhuesish do te kene mundesine e shtrirjes neper keto tregje.

### **3.8 MENAXHIMI I QENDRUESHEM I BURIMEVE**

267. Hapat e marra per te mbrojtur burimet natyrore, do te jene vendimtare per zhvillimet e ardhshme te sektorit bujqesor dhe rural. Ne kushtet qe eshte, Shqiperia ka pak toke bujqesore ne total dhe per fryme, keshtu qe cdo humbje e kesaj toke, ka rendesi te madhe. Per te mbrojtur qendrueshmerine e prodhimit bujqesor, Qeveria duhet te: (a) vazhdoje te zhvilloje dhe zbatoje politika qe synojne permiresimin e menaxhimit te pellgjeve ujore, ne vecanti duke lehtesuar menaxhimin ne nivelin komunal dhe ate te fshatit te kullotave malore dhe pyjet; (b) siguroje disponueshmeri afat-gjate te burimeve ujore per perdoruesit rivale; dhe (c) zhvilloje dhe zbatoje politika ne lidhje me monitorimin dhe survejimin e burimeve detare.

268. Menaxhimi i permiresuar i pyjeve duhet te fokusohet ne tre objektivat qe vijojne: (a) rehabilitimi i zonave pyjore dhe kullotave te degraduara ne ish-pronesi te shtetit dhe nxitja e perdorimit te tyre te qendrueshem; (b) ruajtja e eko-sistemeve te pyjore natyrore; (c) perparimi ne kalimin e sektorit te pyjeve/ kullotave drejt ekonomise se tregut, ne vecanti nepermjet ndarjes se funksioneve tregtare nga ato rregullatore; dhe (d) krijimi i mekanizmave per vetefinancim te aktiviteteve tregtare. Keto hapa do te kerkojne reforma institucionale ne administraten e pyjeve/kullotave, perfshire krijimin e njesise se menaxhimit te pyjeve/ ambientit; dhe reforma politike per kontrollin e prerjeve ilegale neper pyje, si dhe reformat ne marketing dhe cmime. Rendesi e vecante duhet t'i kushtohet nje metode me pjesemarrje, ne menaxhimin e pyjeve dhe kullotave te zoteruara nga shteti, duke u dhene komunave lokale dhe fshatrave, te drejta afat-gjate perdorimi. Qeveria ka pranuar impaktin e mundshem te demshem qe mund te sjelle degradimi i metejshem i bazes se burimeve natyrore te vendit, per synimet e saj per zhvillim, dhe per kete qellim ka kerkuar edhe asistencen e B.B. ne pergatitjen e nje Projekti te Menaxhimit te Varferise, Burimeve Natyrore, dhe Kontrollit te Erozionit, i cili te perfshije komunitetet lokale si dhe konsideratat perkatese social-ekonomike, financiare, institucionale dhe teknike.

269. Menaxhimi i pellgjeve ujore duhet te permiresohet duke bere transferimin gradual te te drejtave te perdoruesve per pyjet dhe kullotat ne pronesi te shtetit, tek komunat dhe fshatrat me baze afat-gjate (qiradhenie per 20 vjet e lart), me synim qe te mbeshtetet jetesa e banoreve te ketyre komuniteteve. Duke siguruar te drejta afat-gjata perdorimi, komunitetet lokale do te jene me te interesuara ne menaxhimin e qendrueshem te ketyre pyjeve dhe kullotave, dhe ne kete menyre do te kontribuojne ne uljen e erozionit. Menaxhimi komunal i pyjeve eshte duke u pilotuar

nga Projekti i Pyjeve, i mbeshtetur nga B.B., ne rreth 30 komunitete. Shtrirja e kesaj metode komunale edhe per kullotat, duhet te kete nje prioritet te larte.

270. Nje sere masash duhen marre per te zgjidhur problemet ekzistuese me burimet ujore: (a) struktura institucionale duhet te menaxhoje me mire ne planin sasior dhe cilesor, burimet ujore; (b) sistemi monitorues per ujerat siperfaqesore dhe nentokesore duhet te permiresohet; (c) masa ligjore duhet te zgjidhin problemin e shfrytezimit te burimeve ujore dhe ndotjes se tyre; (d) duhet te pergatitet nje plan i burimeve ujore, qe te mbroje ne menyre eficente te gjitha perdorimet e ujit dhe ndermjeteson konfliktet.

271. Burimet e konsiderueshme te ujerave te embla ne Shqiperi, jane subjekt i kerkesave konkurrese ne rritje, si konsumi familjar, perdorimi industrial, prodhim te energjise, ujitje dhe se fundmi koha e lire dhe turizmi. Per te siguruar perdorimin racional te ujerave te embla te vendit, duhet pergatitur nje Master Plan Kombetar per Ujin. Ky plan duhet te marre ne konsiderate burimet ekzistuese dhe kerkesen ne evolim, dhe te propozoje menyra apo metoda te mbushjes se nje boshlleku te mundshem furnizimi me uje. Po keshtu, nuk ekziston asnje metode koherente per te siguruar perdorimin e qendrueshem te burimeve shqiptare te peshkimit detar dhe ne ujerat e embla. Deri me sot, nuk eshte hartuar as nje metodologji menaxhimi qe te percaktoje dhe implementoje nje politike te qendrueshme peshkimi. Nje Master Plan Kombetar i Burimeve te Ujerave te Kripura duhet te pergatitet, me fokus ne rolin e institucioneve publike ne percaktimin dhe respektimin e niveleve te qendrueshme te peshkimit.

272. Pershtatje perfundimtare e kuadrit ligjor, te politikave dhe atij institucional. Ligji per pyjet ka nevojte per nje pershtatje perfundimtare, ne menyre qe te sqaroje si objektivat e prodhimit dhe konservimit ne procesin e menaxhimit te pyjeve, te drejtat e perdoruesve dhe te pronesise, ne vecanti transferimin e synuar te pyjeve drejt menaxhimit komunal, dhe perdorimin e qendrueshem dhe te shumefishte te pyjeve ne toke private. Vendit i mungon gjithashtu nje percaktim i qarte i parimeve te politikave se tij ne lidhje me pyjet dhe kullotat, qe te specifikojte objektivat e tij afat-gjata, parimet dhe direktivat operacionale. Permiresime te konsiderueshme ne reformen institucionale dhe zhvillimin, jane bere ne kontekstin e Projektit te Pyjeve. Megjithate, administrata e pyjeve dhe kullotave mbetet e dobet dhe joeficente, duke patur nje numer te kufizuar stafi te specializuar qe asiston ne menaxhimin komunal te pyjeve dhe kullotave, gje qe con ne nje vzhgim minimal mbi perdorimin e kullotave ne shume rajone.

273. Duke patur parasysh kushtet aktuale te sektorit te pyjeve, shpenzimet fiskale per pyjet do te vazhdojne te kapercenje te ardhurat fiskale, duke e bere sektorin te ndervaret nga burimet qendrore te financimit edhe per shume vite te tjera. Investimet e bera ne kuadrin e Projektit te Pyjeve ne operacionet e pylltarise si psh. pyllzimi, mbjelljet plotesuese, punet kulturore dhe pastrimet permiresuese, kane patur nje impakt te rendesishem ne sektor. Megjithate, vazhdimi i aplikimit te cmimeve te administruara, mosperputhja ndermjet volumit te drurit te prere me ate te shitur, dhe prerja ne rritje e drurit jashte kontrollit te Drejtorise se Pergjithshme te Pyjeve dhe Kullotave, vazhdojne te ndikojne negativisht ne situaten e te ardhurave. Institucionet e perfshira, si Drejtoria e Pergjithshme e Pyjeve dhe Kullotave dhe Ministria e Mjedisit, si dhe Inspektorati i Pyjeve dhe Kullotave, duhet te konsolidohen me tej per te ndaluar prerjet e paligjshme dhe rritur te ardhurat nga sherbimet.

274. **Permiresimi i tregtise, marketingut dhe cmimeve te produkteve pyjore.** Megjithese pyjet zene rreth 36% te siperfaqes tokesore te vendit dhe perbejne nje baze burimesh natyrore jashtezakonisht te rendesishme, kontributi i pyjeve dhe kullotave ne ekonomine e vendit ka mbetur i paperfillshem. Potencialet ekzistojne per te rigjeneruar kapacitetet prodhuese te sektorit. Sektori jo vetem qe mund te behet i vete-qendrueshem, por edhe nje kontribues i dobishem per Qeverine, duke rritur punesimin rural, nxitur zhvillimin industrial, dhe siguruar perfitime ambientaliste. Eksportet shqiptare te produkteve pyjore u ndikuan negativisht nga politikat spontane dhe jo te rregullta te viteve te shkuara. Ne 1999, kufizimet ne eksport u hoqen dhe tregtia u liberalizua. Megjithate, vetem nje sasi e vogel e drurit te mbledhur dhe te shkukur apo

produkteve jodrusore prodhohen dhe tregtohen ne menyre ligjore, duke cuar ne deformime serioze te tregut dhe te ardhura vazhdimisht te uleta te qeverise.

275. Te luftuarit e problemit te vazhdueshem te prerjeve te paligjshme, do te kete rendesi vendimtare ne menaxhimin e qendrueshem te burimeve, por edhe per zbulimin e mundesive per zhvillimin e biznesit ne zonat rurale. Perfshirja e qeverise lokale dhe komuniteteve ne menaxhimin e burimeve pyjore dhe te kullotave, eshte nje hap i pare i rendesishem drejt ndalimit te praktikave te prerjeve te paligjshme. Megjithate, duke qene se jane nje seri aktorësh dhe problemesh qe e rrethojne fenomenin e prerjeve te paligjshme, do te nevojiteshin veprime te koordinuara ne nivele te ndryshme.

276. **Mbrojtja e biodiversitetit.** Shqipëria ka nje llojshmeri biologjike dhe te relievit qe ruan nje game te gjere speciesh bimore dhe kafshesh. Vleresohen 3,200 specie te bimeve vaskulare dhe 756 specie vertebrorë ne vend. Rreth 30% e te gjithë flores europiane eshte prezente edhe ne Shqipëri, dhe pyjet e larta jane shtepia e komuniteteve te gjitareve te medhenj si ujqrin, arinjte, rregebujt, rosat e egra dhe komunitete zogjsh karakteristike per pyje te virgjër. Shqipëria eshte gjithashtu nje rruge kalimi e rendesishme per zogjte, lakuriqet dhe insektet. Ekzistojne rreth 91 specie te rrezikuara ne te gjithë vendin. Ekosistemet ekzistuese dhe mjediset perfshijne dunat ranore, deltat lumore, pyjet aluvionale, lagunat, kullotat alpine dhe livadhet, liqenet kontinentale dhe te ngrira dhe pyjet gjethegjere dhe halore.

277. Praktika intensive bujqesore te te shkuars si dhe aktivitetet ekzistuese te nje ekonomie ne tranzicion, kane kontribuar ne demtimin e biodiversitetit dhe llojshmerise se relievit. Disa prej impakteve kryesore te padeshirueshme jane (a) humbja e mjediseve dhe copezimi; (b) demtimi dhe degradimi i mjediseve dhe ekosistemeve, shqetesimi dhe keqtrajtimi i kafsheve te egra; (c) zhdukja e specieve; dhe (d) demtimi dhe erozioni i burimeve gjenetike. Ekziston nje nevojë urgjente per te ndertuar kapacitetet e nevojshme per monitorimin dhe kontrollin ne zbatimin e ligjit, dhe c'është e me rendesishme per krijimin e ndergjegjesimit dhe sjelljeve ambientaliste.

278. Shqipëria ka nenshkruar Konventen per Diversitetin Biologjik ne vitin 1994 dhe eshte perpjekur per te permbushur detyrimet e saj, pavaresisht veshtiresive qe shoqeruan tranzicionin. Ne 1998, Qeveria kerkoi pergatitjen e Nje Strategjie te Biodiversitetit dhe nje Plani Veprimi si nje hap drejt implementimit te Konventes. Per mbrojtjen e biodiversitetit shqiptar ne te ardhmen, Strategjia e Biodiversitetit dhe Plani i Veprimit perkates duhet te reflektohen ne politikat kombetare dhe lokale dhe roli i komuniteteve ne ruajtjen e biodiversitetit duhet te konsolidohet me tej. Kryesisht ne zonat me te largeta, permiresimet ne infrastrukturen e sherbimeve mund te lidheshin me masat e permiresuara per mbrojtjen e burimeve natyrore.

#### **Korniza e nje strategjie rurale - Fushat prioritare te nderhyrjeve te B.B.**

279. Strategjia rurale per Shqipërine duhet te kete si objektivin e saj themelor, nje vemendje te vazhdueshme ne rritjen e prodhimit dhe te ardhurave; sigurimin e sherbimeve rurale baze; luften ndaj varferise rurale; dhe nje vemendje ne menaxhimin e qendrueshem te burimeve natyrore. Analiza e mesiperme sugjeron qe strategjia rurale duhet te ndertohet se pari mbi bazen e nje themeli te forte te stabilitetit te qendrueshem makro-ekonomik, i karakterizuar nga inflacioni i ulet, monedha vendase e stabilizuar, renie te deficitit buxhetor dhe fuqizimi i bilanceve te jashtme. Nderhyrjet e BB propozohet te perqendrohen ne tete fusha kryesore:

- Vazhdimi i mbeshtetjes per reformat e politikave, ne menyre qe te krijohet nje klime politikash qe ndihmon rritjen ne zonat rurale;
- Rritja e vemendjes ne ndertimin e kapaciteteve gjate dhe pas procesit te decentralizimit (a) ne nivelin lokal per te fuqizuar strukturat e sapo krijuara zyrtare dhe (b) ne nivelin kombetar, per te fuqizuar ministrite qendrore;
- Vazhdimi i venies se theksit tek zhvillimi i tregjeve te tokes;

- Rritja e perfshirjes ne iniciativat e infrastruktures rurale, me baze komuniteti, perfshire ujitjen, furnizimin me uje te zonave rurale, menaxhimin e tokes per kullotje dhe rruget rurale;
- Vazhdimi i fuqizimit te sherbimeve rurale mbeshtetese me vemendjen kryesore ne sherbimet mbeshtetese bujqesore dhe sigurine ushqimore, por duke perfshire edhe aktivite qe anojne nga aktivitetet jobujqesore, si keshillim biznesi, mbeshtetje ligjore dhe menaxhim te njohurive;
- Vazhdimi i ndertimit te sukseseve ne sektorin e finances rurale, shtrirja e sherbimit si dhe zgjerimi i iniciativave ekzistuese te mikro-kredise, dhe intensifikimi i shtrirjes se rrjetit bankar ne zonat rurale;
- Perpilimi i opcioneve qe mbeshtetin zhvillimin rural me karakter jobujqesor, ne funksion te krijimit te mundesive per punesim dhe te sigurimit te te ardhurave ne zonat rurale, por edhe per te bere te mundur qe njerezit te jene me te mire pergatitur per te mbeshtetur vetveten gjatke;
- Konsolidimi i perfshirjes ne menaxhimin e burimeve natyrore ne nivelin e politikave dhe nepermjet aktiviteteve te projekteve me objektive te drejtperdrejte.
- Te vazhdoje theksi mbi reformat ne aspektin e politikave dhe programet specifike per mbeshtetjen e zhvillimit te sektorit privat

280. Qeveria ka identifikuar nje game te gjere aktivitetesh per te stimuluar investimet ne sektorin privat te te gjithe ekonomise. Nje pjese e mire prej kuadrit legjislativ te nevojshem per nje mjedis qe ndihmon zhvillimin e sektorit privat, eshte ne funksionim. Iniciativa e mbetur per t'u perfunduar ne aspektin e legjislacionit, eshte ligji per falimentin. Duke qene qe kuadri legjislativ eshte drejt kompletimit, vemendja e qeverise duhet te kaloje drejt zbatimit te permiresuar, duke arritur nje zbatim me konsistent te ligjeve dhe rregullave ekzistuese dhe perfundimin e programit legjislativ. Theksi mbi fuqizimin e sistemit gjyqesor, eshte vecanerisht i rendesishem ne kete drejtim. Pavec permiresimit te klimes ligjore, qeveria eshte fokusuar seriozisht ne iniciativa qe synojne zhvillimin e ndermarrjeve te vogla dhe te mesme, nxitjen e investimeve te huaja dhe rritjen e eksporteve.

281. Pengesat kryesore per nje zhvillimin e nje biznesi me te permiresuar si dhe mundesite perkatese, jane identifikuar gjeresisht ne paragrafet e meparshem. Banka do te vazhdoje dialogun e saj me qeverine, per te trajtuar keto pengesa dhe per te nxitur shanset ne zonat rurale. Diskutimet brenda Strategjise se Rritjes Ekonomike dhe Reduktimit te Varferise dhe kredite per reduktimin e varferise, mund te sherbejne si nje mjet i mire per te identifikuar treguesit qe mund te monitoronin progresin qe eshte bere ne lidhje me kapercimin e ketyre pengesave. Kredite e dhena ne kuader te strategjise per reduktimin e varferise mund te sherbejne si nje mjet per te vendosur bazen e zhvillimit te sektorit privat.

- Rritja e kapaciteteve institucionale ne kushtet e nje klime decentralizimi ne te gjitha nivelet

282. Roli themelor i MBU eshte krijimi dhe rregullimi i nje kuadri politikash dhe ligjor qe e lejon bujqesine te funksionojne ne menyre eficente dhe te suksesshme dhe qe siguron kryerjen e sherbimeve per fermeret e rinj, te ekonomive te vogla. Ndersa kerkesat per sherbimin publik kane ndryshuar, stafi i tij ka mbetur i pandryshuar, i mberthyer midis strukturave dhe vjetra dhe te reja, me pergjegjesi qe nuk jane te percaktuara qarte. Do te jete shume e rendesishme qe te thithet fuqi punetore me e kualifikuar ne sherbimin Qeveritar, si dhe te miratohen fushat e pergjegjesise, ne perputhje edhe me kerkesat ne ndryshim te nje sektori privat ne funksionim.

283. Pergjegjesite e MBU duhet te rishikohen, vecanerisht ato qe i perkasin procesit te decentralizimit. Deri tani, rolet e niveleve te ndryshme qeveritare nuk jane te percaktuara mire, kryesisht ato qe lidhen me burimin e fondeve dhe pergjegjesite e shpenzimit. Nje numer pergjegjesish duhet te vazhdojne te mbeten ne nivelin qendror, si politikatat, legjislacioni,



rregullimet tregtare, aprovimet e gjera të buxhetit, grumbullimi i të dhenave, shërbimet publike veterinarë dhe kontrolli i standarteve të cilësive. Nivelet bashkiake dhe komunale duhet gjithashtu të kenë role dhe përgjegjësi të përcaktuara qarte. Bazuar në ndarjen e qarte të përgjegjësisë, duhet ofruar trajnim në drejtim të lehtësimit të kuptimit nga ana e të gjithë aktoreve, të roleve të tyre. Ndërsa shumë prej këtyre kapaciteteve në nivelin lokal mund të duhet të mbulojnë nepermjet projekteve në zbatim apo atyre që do të vijne, për zhvillimin me baze komuniteti, theksi duhet vënë edhe mbi rritjen e kapaciteteve të qeverisë qendrore. Një projekt i ri për zhvillimin rural duhet të përfshijë aktivitete në këto drejtim. Aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve duhet të lidhen qartësisht me aktivitete implementuese.

284. Zhvillimi i tregjeve të tokës bujqësore do të vazhdojë të jetë i rëndësishëm. Janë një sërë hapash që duhet të ndërmerren në vitet në vijim.

- *Permirësimi në Sistemin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për të siguruar saktësinë e të drejtave dhe interesit mbi tokën, të regjistruar në sistem.* Regjistrimi i parë është në proces dhe informacioni mbi regjistrimin mbahet në formë dixhitale si dhe në hard copy. Megjithatë, zyrat e rretheve dhe ato rajonale nuk kanë kompjutera për të mbajtur të dhëna dixhitale, dhe nëse nuk do të behen përpjekje për t'i pasuruar dhe ruajtur regjistrat, shumë shpejt të dhënat dixhitale do të vjeterohen dhe nuk do të pasqyrojnë gjendjen reale. Sistemit i titullit të pronës së patundshme, kërkohet të sigurojë regjistrat publike që pasqyrojnë gjendjen faktike në terren dhe kështu, të garantojnë sigurimin e të drejtave për poseduesit e pronës. Zyrrat e rretheve dhe ato rajonale të regjistrimit të pasurive të patundshme, u mungon teknologjia baze për të krijuar bazen e të dhënave dixhitale dhe mbajtur regjistrat ekzistues të të drejtave të pronësive, për rrjedhojë ato kanë nevojë që të kompjuterizohen dhe të pajisen për ta përballuar këtë sfidë. Gjithashtu, do të jetë e rëndësishme për të trajnuar stafin e zyres në përdorimin e teknologjisë.
- *Rishikimi i legjislacionit ekzistues për të përcaktuar procedurën me të thjeshtë dhe me më të ulët kushte për regjistrimin e pasurisë së patundshme. Përdoruesit aktualisht përpiqen t'i shmangin sistemit, për shkak të proceseve komplekse, të gjata në kohë dhe kostos së lartë të transaksioneve.* Legjislacioni është hartuar në përpjekje për të krijuar sa më shpejt një sistem të regjistrimit të pasurive të patundshme, në mënyrë që të regjistrohen të drejtat dhe interesat në pronat e privatizuara rishtazi në Tiranë. Që prej krijimit të legjislacionit, janë nxjerre shumë mesime, dhe është pikërisht koha për t'i reflektuar ato në një legjislacion të përmirësuar. Do të jetë e rëndësishme për të siguruar asistencë ligjore për Zyrrat e Regjistrimit të Pasurive të Patundshme në drejtim të rishikimit të legjislacionit, të bëjë se propozimeve rreth amendamenteve të nevojshme dhe të ndihmohet për kalimin e tyre në Parlament.
- *Asistencë në drejtim të përfundimit të Regjistrimit të Parë të pasurive në Zyrrat e Regjistrimit të Pasurive të Patundshme, si një mjet lehtësues për rritjen e produktivitetit të sistemit të pronësive mbi tokë të copezuar në Shqipëri.* Regjistrimi i parë i pasurive të privatizuara po zgjatet me shumë sësë parashikimet. Shumë prona nuk do të regjistrohen, si pasoje e një numri të madh ceshtjesh të pazgjidhura në gjykatë dhe që provokohen nga konflikte pronësie si pasoje e pretendimeve për rikthim apo kompensim. Duhet të behen përpjekje për të zgjidhur kaosin në ceshtjet gjyqësore dhe për t'i futur këto prona në regjister (e për rrjedhojë edhe në tregun e tokës). Shqipëria duhet të krijojë një mekanizëm të zgjidhjes së konflikteve, në mënyrë që të mund të zgjidhen mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me pasurinë e patundshme. Kjo do t'i zhvendoste pjesën më të madhe të ceshtjeve nga gjykatat, për t'i zgjidhur nepermjet një procesi negociimi. Shqipëria do t'i ofrohet asistencë ligjore për të konceptuar dhe implementuar një mekanizëm funksional të zgjidhjes së konflikteve. Mekanizmi duhet të testohet nepermjet zgjidhjes së një zone pilot të përshtatshme dhe duke u përpjekur për të zgjidhur një model të mosmarrëveshjeve me pronën. Mëqenëse regjistrimi i parë është duke u bërë me mbështetjen e donatoreve të tjerë, Banka do t'a përqendrojë vëmendjen

ne rishikimin e legjislacionit, permiresimin e funksionimit te zyrave te regjistrimit te pasurive te patundshme, dhe pilotimin e transaksioneve.

- *Ndjekja e aktiviteteve ne tregun e tokes per te percaktuar nevojën per nderhyrje te forcave te jashtme, me qellim nxitjen e tregut.* Toka private eshte nje koncept relativisht i ri ne Shqiperi. Prandaj, tregu eshte ende i pakonsoliduar dhe ekzistojne te dhena minimale per numrin dhe llojin e transaksioneve qe ndodhin. Per te percaktuar aktivitetet e tregut, duhet krijuar nje baze te dhenash per transaksionet, me tregues per llojet e tyre (qiradhenie, blerje, trashegimi), numrin e transaksioneve per lloje te ndryshme pronesish, vleren e transaksioneve dhe vendndodhjen gjeografike. Transaksionet me pronen ne rajone te zgjedhura te Shqiperise, mund te studiohen per te percaktuar aktivitetet e tregut dhe identifikuar ndonje pengese ne treg. Nese veshtiresite ne treg jane duke penguar transaksionet eficente te pronave, duhet te dalin rekomandime ne lidhje me metoden, kufijte kohore dhe nivelin e perpjekjeve per t'i shmanguar ato.
  - *Kryerja e nje fushate te ndergjegjesimit publik, per t'i edukuar qytetaret mbi te drejtat dhe pergjegjesite qe shoqerrojne pronesine mbi pronen private.* Pjesa derrmuese e qytetareve qe kane marre toke ne pronesi gjate pese viteve te fundit, nuk kane patur kurre me pare ne pronesi toke. Pjesen me te madhe te jetes se tyre ata e kane jetuar ne nje sistem ku shteti gezonte te gjitha te drejtat mbi token dhe u jepte qytetareve vetem „te drejten e perdorimit”. Qytetaret nuk jane plotesisht te informuar se cfare do te thote ne te vertete pronesi private mbi token, duke qene qe ajo lidhet me te drejtat dhe pergjegjesite qe shoqerrojne titullin e pronesise mbi pasurine e patundshme. Duhet te behen perpjekje per te siguruar informacion per qytetaret rreth te drejtave dhe pergjegjesive qe shoqerrojne pronesine private mbi token.
  - *Pergatitja per implementim e nje sistemi taksimi per pronen, me nivele taksimi te moderuara, te cilat te behen efektive sapo qe te perfundoje procesi i regjistrimit te pare.* Pergatitjet duhet te perfshijne zhvillimin e kapaciteteve per te bere vleresimin e prones. Meqenese, nuk ekziston asnje lloj taksimi per token bujqesore, nuk ka asnje kosto qe te rendoje mbi fermerin nese ai e le token te pashfrytezuar per prodhim, per nje periudhe te pacaktuar kohe. Taksimi eshte nje shtyese e rendesishme per t'i detyruar individet per te bere dicka me token e tyre, si shitje apo qiradhenie tek dikush tjetër i cili mund t'a perdoroje ne menyre produktive. Pushteti lokal ose Shteti duhet te implementojne nje takse modeste mbi token, per te gjithë token bujqesore ne Shqiperi. Megjithate, taksa duhet te implementohet vetem pasi te kemi nje sistem funksional te vleresimit te tokes dhe pasi te jete lene nje periudhe e aresyeshme kohe per njoftim (sugjeron 3 vjet) per qytetaret. Kjo do t'i jepte kohe te mjaftueshme qytetareve per te shmangur barren e takses nepermjet shitjes, qiradhenies apo venies se tokes ne shfrytezim per prodhim bujqesor.
  - *Fuqizimi i sherbimeve rurale, perfshire kerkimin dhe ekstensionin, sherbimet veterinare dhe ato te mbareshtimit, dhe marketingun e agro-perpunimin*
285. *Kerkimi bujqesor.* Objektivi kryesor ne kerkimin bujqesor eshte ristrukturimi dhe modernizimi i sistemit, ne menyre qe te behet i qendrueshëm dhe t'i pergjigjet nevojave te fermerëve te ekonomive te vogla. Sot, ekziston nje marreveshje e gjere mbi nevojën e konsolidimit te instituteve te kerkimit, dhe ekziston nje hapësire e konsiderueshme per : (a) nje rritje te madhe ne eficencen e operacioneve kerkimore perfshire administrimin dhe menaxhimin financiar; (b) rritja e rendesise se kerkimit, dhe reduktimi i perseritjeve dhe mbivendosjeve; (c) bashkepunimi i permiresuar midis punonjesve kerkimore dhe perdorimi i perbashket i laboratoreve dhe ambienteve te tjera; dhe (d) percaktimi me i mire i prioriteteve. Vemendja kryesore duhet te perqendrohet ne futjen dhe aplikimin e teknologjive qe mund te sjellin zgjidhje me kosto-efektshmeri per problemet e fermes, ne vend te aplikimit te kerkimit baze. Gjithashtu, duhet menduar edhe per nje sistem konkurues per financimin e aktivitetit kerkimor, ku studiuesit pergatisin propozime per kerkime ne fusha te vecanta prioritare, te percaktuara nepermjet

konsultimeve me fermeret dhe konsumatorët. Rekomandohet që propozimet për ristrukturim të parashtruara si pjesë e projektit SARA, të financuar nga USAID, të rishikohen. Ato përfshijnë: (a) krijimin e një Bordi të Kerkimit Bujqësor, i cili do të përcaktonte prioritetet në sferën e kerkimit, aprovonte projekte dhe buxhete, dhe orientonte apo mbikqyrte planin e ristrukturimit; (b) shkurtrim i numrit të institutivëve dhe konsolidimi i atyre të mbetura për të mbuluar zonat e ndryshme agro-ekologjike; (c) ndarja nga programi i kerkimit dhe privatizimi i punëve të ndryshme të shërbimeve me potenciale tregtare, si prodhimi i farës riprodhuese, farerat dhe vaksinat. Duhet të krijohet një Task Force, për të rishikuar situatën ekzistuese dhe bërë rekomandime specifike për ndryshime.

286. Ekstensionit. Në vendet e tjera, fermeret përfitojnë njohuri dhe informacion nga një sërë burimesh, përfshirë shërbimet publike të ekstensionit, por edhe prej shërbimit privat të ekstensionit si dhe ofruesit e informacionit. Kështu, objektivi kryesor i MBU, duhet të jetë vazhdimi i mbështetjes për zhvillimin e një sistemi informacioni shumë-planësh. Shërbimet e keshillimit për fermeret e mëdhenj tregtare, duhet të kalojnë të sektori privat, përfshirë njesitë në zhvillim të ekstensionit, të shoqatave të fermerëve/prodhuesve, tregtarëve, furnizuesve të inputeve dhe burime të tjera informacioni. MBU duhet të mbështesë plotësisht këto zhvillime nëpërmjet trainimeve të përbashkëta dhe përdorimit të përbashkët të materialeve, përfshirë informacionin që merret nëpërmjet aktivitetit kerkimor në ferme dhe demonstrimeve. Shërbimi i ekstensionit të MBU duhet të fokusohet në një shkallë të gjërë në fermeret e vegjël dhe të mesëm, veçanërisht ata me orientim drejt tregut. Kjo do të kërkonte: (a) një theks në rritje në zhvillimin e materialeve cilësore të ekstensionit, përfshirë masmedian dhe video-produksionet; (b) një vëmendje e vazhdueshme në grupet e interesuara të fermerëve, përfshirë ato ekzistuese dhe shoqatat private të fermerëve; (c) përmirësim i lidhjeve ekstension-kerkim, nëpërmjet programeve të kerkimit në ferme dhe pjesëmarrjes në CGP; (d) vazhdimi i programeve të trainimit për teknologjinë, të dobishme për fermeret, siç është parashikimi buxhetor i fermes; (e) sigurimi i informacionit për tregun.

287. Një metode që implementohet aktualisht nëpërmjet Projektit të Shërbimeve Bujqësore, është prodhimi rural me baze komuniteti dhe mundësitë e marketingut mbi baza të konkurrencës. Bazuar në konceptin e skemave konkurruese të grantit, grupet e fermerëve kanë mundësinë e marrjes së financimeve për të implementuar aktivitetet që (a) përmirësojnë aktivitetet ekzistuese, (b) ofrojnë mundësi të reja për sigurim të ardhurash, dhe (c) janë të përshtatshme në zona të tjera. Koncepti funksionon si një metodologji ekstensionit të përshtatur, sipas se cilës fermeret shprehin interesin dhe kërkesën e tyre për aktivitetet të vecanta, dhe të cilëve u ofrohet orientim përgjatë procesit të implementimit. Aktualisht, koncepti është në një fazë të hershme në Shqipëri, dhe mbetet të shihet se sa i suksesshem është dhe në çfarë mase ndikon në ekonomitë rurale. Nëse provon të jetë i suksesshem, ky instrument mund të aplikohet përtej sektorit të bujqësisë të ekonomisë rurale.

288. Shërbimet e farërave. Farerat tregtare dhe prodhimi i fidanave në Shqipëri, ka tendencë të rritet gjatë viteve të ardhshme, megjithatë importet duket që do të vazhdojnë të mbeten të rëndësishme për kulturën si perimet, dhe deri në njëfarë mase, hibridet e misrit. Qeveria nuk duhet të përfshihet direkt në prodhimin e farërave, dhe mbyllja finale dhe privatizimi i ndermarrjeve të mbetura të farërave në Tiranë dhe Korce, do të ndihmonte në këtë proces. Në perspektivën afat-mesme, roli i sektorit publik do të ishte mbështetja e zhvillimit të prodhuesve private të farërave nëpërmjet (a) shërbimeve të përmirësuara të certifikimit të farërave, përfshirë inspektimet në fushë dhe testimin e certifikimit të farërave; (b) prodhimi i farërave me shkallë të lartë prodhimi për shitje tek prodhuesit e farërave; (c) zgjedhja dhe regjistrimi i varieteteve të reja, veçanërisht atyre që kultivohen jashtë shtetit; dhe (d) grumbullimi, vlerësimi dhe ruajtja e materialit riprodhues. Në perspektivën afat-gjatë, pritet që prodhuesit e farërave të marrin pjesë përgjegjësinë për inspektimin në fushë dhe testimin e farës, ose direkt ose nëpërmjet kontraktimit me agjenci dhe/ose laboratore të përshtatshme. Po kështu, në kushtet e mungesës së kompanive private të riprodhimit të bimeve në Shqipëri, kërkohet një rol i rëndësishëm i institutivëve të

kerkimit bujqesor, per te prodhuar farera me shkalle te larte prodhimi, megjithese ka tendence qe prodhuesit e sektorit privat te marrin gjithnje e me shume kete rol, si dhe ate te futjes, testimi dhe shumezimit te varieteteve te pershtatshme. Roli i sektorit publik do te kufizohet keshtu, ne vendosjen e rregullave dhe monitorimin e respektimit te rregullave te certifikimit te fares, Ligjit per Mbrojtjen e Varieteve te Bimeve dhe rregulla te tjera.

289. Sherbimet veterinar dhe ato te mbareshtimit. Trajtimi i semundjeve dhe crregullimeve joepidemike, perfshire parazitet e brendshem dhe te jashtem, gjithnje e me shume po realizohet nga sektori privat. Keto trajtime kryhen nen kujdesin e pronarit te gjese se gjalle. Veterineret private caktojne nje tarife per fermerin per sherbimet e tyre si dhe per ilacet dhe preparatet, dhe ne shume raste, ato disponojne magazina te vogla per shitjen e medikamenteve dhe pajisjeve te tjera veterinar. Per te inkurajuar zhvillimin e metejshem te sistemit privat veterinar, ekzistojne aresye per ta shtrire metoden e perdorur nga Fondacioni per Blegtorine, i cili si fillim ishte pjese e FZSH, i mbeshtetur nga BB. Megjithate, eshte e nevojshme qe MBU te ruaje pergjegjesine per kontrollin dhe zhdukjen e semundjeve epidemike si ajo e gjedheve dhe ethet e derrit, dhe semundjeve zoonotike qe perbejne rrezik per shendetin publik, sic jane tuberkulozi, bruceloza dhe antraksi. Eshte shume e mundshme qe veterineret private te kontraktohen gjithnje e me shume per te kryer fushatat e MBU per kontrollin e semundjeve, megjithese MBU do te vazhdoje te mbaje rolin e rendesishem ne monitorimin e diagnostikimit te semundjeve te kafsheve. Sherbimet e mbareshtimit kryhen ne rradhe te pare nga mbareshtues te sektorit privat, me fare te marre nga institutet e kerkimit dhe nga materiale riprodhuese te aplikuar ne kuader te projekteve te ndryshme. Ne perspektiven afat-gjate, pritet qe sektori privat te fuse material riprodhues te permiresuar, e ndersa roli kryesor i qeverise do te jete me shume rregullues dhe monitorues, sesa kujdesi per demat per prodhim te fares riprodhuese.

290. Sherbimet e mbrojtjes se bimeve. Pjesa me e madhe e materialeve te mbrojtjes se bimeve sigurohen nga sektori privat, kryesisht nepermjet nje numri te konsiderueshem dyqanesh te vogla te furnizimit me inpute, te vendosura ne rrethe. Roli i qeverise perfshin identifikimin dhe regjistrimin e kimikateve te pranueshme per import dhe perdorim, licencimi i aktiviteve te shitjes, dhe sigurimi i trainimit per agjentet e licencuar te marketingut. Megjithate, ekzistojne shqetesime ne lidhje me keshillimin qe behet nga shitesit me pakice, materialet e skaduar dhe rreziqet e shendetit publik si pasoje e perdorimit jo te rregull te pesticideve. Per pasoje, eshte e nevojshme per te permiresuar kontrollin dhe sistemin rregullues, per te mbrojtur perdoruesit dhe konsumatorët mbi bazen e shtimit te kapaciteteve: (a) per te testuar dhe verifikuar cilesine e kontrollit te demtuesve per produktet e importuara dhe ato te prodhuara ne vend; (b) per te inspektuar ambientet e ruajtjes dhe te shperndarjes; (c) per te analizuar produktet bujqesore dhe ujin, per pesticidet dhe mbetje te tjera. Role te tjera te rendesishme te sektorit publik perfshijne inspektimin ne pikat kufitare dhe ruajtja e bimeve me qellim per te bere kontrollin e importit te materialeve te infektuara, monitorimin dhe diagnostikimin e demtuesve dhe semundjeve, dhe keshilla rreth metodave te pershtatshme te kontrollit perfshire parandalimin dhe menaxhimin e integruar te demtuesve. Krijimi i laboratoreve diagnostikues rajonale me moderne, ne vend te nje numri te konsiderueshem laboratoresh joefektive te rretheve, zhvillimi i sherbimeve te permiresuara perfshire mjetet e komunikimit ne pikat kufitare, si dhe percaktim i qarte dhe ndarje e roleve te ekstensionit dhe atyre rregulluese te stafit te Mbrojtjes se Bimeve, do te conin ne permiresimin e kapaciteteve te Sherbimit te Mbrojtjes se Bimeve ne permbushjen e ketij roli te rendesishem.

291. Marketingu dhe agro-perpunimi. Roli themelor i qeverise do te jete krijimi i rregullave transparente dhe te zbatueshme per ndermarrjet tregtare dhe ato agro-perpunuese. Siguria ushqimore duhet diskutuar me tutje, por duhet edhe te konceptohet me me kujdes, ne menyre qe te mos i nxjerre fermeret e vegjel jashte tregut. Me shume theks do te vihet ne lidhjen e fermereve me nje ambient dijes, i cili eshte gjithnje e me shume lehtesisht i arritshem nepermjet aksesit ne teknologjite e informacionit ne hapesirat tregtare.

- Mbeshtetja per rritjen e disponueshmerise se sherbimeve financiare ne zonat rurale

292. Një mundësi e vazhdueshme e financave për investime në sektorin rural, përben dhe pengesën kryesore për zhvillim rural në Shqipëri. Një rrugë e gjatë faktorësh, janë identifikuar si frenues për zhvillimin e tregjeve financiare rurale, përfshirë kostot e larta të transaksioneve dhe rreziqet e larta të financës rurale, informacioni jo i saktë mbi klientët potencialë dhe mundësitë e huadhenies në zonat rurale, dhe një kuadër ligjor dhe rregullues i dobët për transaksione të sigurta. Këto frenime i kanë mbajtur bankat tregtare të fiksuara në qendrat urbane, të kënaqura për t'u përqendruar në financën urbane, dhe kanë ngadalësuar zhvillimin e shërbimeve ndërmjetesuese financiare me baze rurale.

293. Pavarësisht progresit të ngadalshëm në zhvillimin e shërbimeve financiare rurale, kanë filluar të shfaqen disa tendenca inkurajuese. Shumë iniciativat të BB, IFAD dhe IFC, dhe shumë OJQ kanë hedhur bazat për shtrirjen e një sistemi të qëndrueshëm financiar rural. Iniciativat e hershme të huadhenies për fermerët dhe sipërmarrës të tjerë rurale, nëpërmjet fondëve të kredise së fshatit, janë duke u plotësuar me përpjekje të koordinuara për zhvillimin e një sistemi kombëtar të shoqatave të kursim-kredise, të cilat hapin depozita si dhe ofrojnë shërbimi huadhenie. SH.K.K. janë institucione financiare formale, që rregullohen sipas legjislatcionit të kursim-kredise, i miratuar së fundi dhe janë subjekt i mbikqyrjes nga Banka e Shqipërisë. Shtrirja e rrjetit të SH.K.K. në të gjithë vendin, gjatë tre viteve të ardhshme, pritet të ngrerë numrin total në më shumë se 400 SH.K.K. Megjithatë, ndërsa mbulimi i popullsisë rurale me këto shërbime do të rritet në mënyrë të konsiderueshme përgjatë tre viteve që do të vijne, numri i fermave të vogla rurale me akses në kredi, do të vazhdojë të jete me pak se 10% e totalit.

294. Kujdes i duhet kushtuar shtrirjes së shëndoshe të këtyre programeve. Një fenomen i përhapur dhe i perseritur me iniciativat financiare rurale nëpërmjet të gjithë botën në zhvillim, është nevojë për të shtrirë shumë shpejt programe të vogla të suksesshme, përpara se të zhvillohen kapacitetet institucionale dhe njerezore për të menaxhuar këto programe.

295. Paralel me zhvillimin e një sistemi mbarekombëtar të institucioneve të mikro-kredise, janë shfaqur edhe shenja inkurajuese, megjithatë të vogla që tregojnë se sektori bankar tregtar po fillon të shtrihet përtej bazës ekzistuese urbane. Kjo shtrirje ka ardhur në përgjigje ndaj zhvillimit të përgjithshëm të tregjeve financiare shqiptare. Deget e bankave po fillojnë të vendosen në qytetet rurale. Kjo shtrirje sjell shërbime të reja financiare për popullsinë rurale, i ndihmon bankat të familjarizohen me mundësitë e huadhenies në zonat rurale, dhe ndihmon komunitetin e fermerëve, nëse jo drejtpërdrejt me hua, të pakten në mënyrë të tertortë nëpërmjet ndërmjetësimeve të përmirësuar financiare.

296. Banka do të vazhdojë të jete e angazhuar në zhvillimin e tregjeve financiare në Shqipëri, dhe do të vazhdojë të vere theksin në tregjet financiare rurale. Një numër hapash mbeten për të bërë për të intensifikuar zhvillimin e metejshëm të sektorit financiar:

- përfundimi i kuadrit ligjor dhe rregullues është shumë esencial, përfshirë edhe aprovimin e ligjit për falimentin;
- finalizimi i procedurave rregulluese dhe mbikqyrëse për shoqatat e kursim-kredise;
- fuqizimi i kapaciteteve zbatuese dhe detyruese, vecanërisht në Bankën e Shqipërisë;
- vazhdimi i mbështetjes për iniciativat e mikro-kredise në proces, me fokus në shtrirjen e mundshme të programeve të mikro-kredise;
- transformimi i suksesshëm i FFR në një union kombëtar të kredise, duke siguruar qëndrueshmërinë e institucioneve të mikro-kredise menjëherë sapo të mbarojnë financimet e donatoreve;
- thellimi i tregut nëpërmjet mbështetjes për ngritjen e degeve të bankave në zonat rurale, ndoshta nëpërmjet subvencioneve për kostot e larta administrative, dhe mbështetjes për shtrirjen e transaksioneve të sigurta, përfshirë procedura të përmirësuar regjistrimi për transaksione të sigurta.

- Rritja e investimeve në rehabilitimin e infrastruktures dhe permiresimi i menaxhimit të infrastruktures rurale

297. **Furnizimi me uje dhe higjiena.** E ardhmja e zhvillimit të sektorit kërkon një reforme në aspektin e politikave, si e vetmja mënyrë për të permiresuar shërbimet e furnizimit me ujë dhe ato të higjienës në zonat rurale. Synimi i reformës në sektor duhet të jetë që të cdokush të ketë akses në furnizimin me ujë të pijshëm dhe higjienë të një standarti të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat baze në mënyrë të drejtë, eficiente dhe të qendrueshme. Si një përgjigje për këtë sfidë, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit ka përgatitur në vitin 2001, një Strategji për Furnizimin me Ujë dhe Higjienën në Zonat Rurale, me asistencën e B.B., e cila synon të ndryshojë mënyrën sesi shpërndahet uji nga Qeveria. Propozohen tre opsione të shpërndarjes: (a) shërbimi i shpërndarjes nga sektori privat; (b) shërbimi i shpërndarjes nga pushteti lokal (autoritetet e komunes); dhe (c) shërbimi i shpërndarjes nga vete komuniteti. Projekti Ujërave dhe Kanalizimeve të bashkive, do të bëjë testimin e pjesëmarrjes së sektorit privat në shërbimin e furnizimit me ujë nëpërmjet një kontrate menaxhimi për katër qytete- Durrësin, Fierin, Lezhën dhe Sarandën.

298. Pjesëmarrja e organizatave me baze komuniteti në menaxhimin e furnizimit me ujë të pijshëm, duhet të mbështetet nga zhvendosja e vendim-marrjes tek niveli i komunitetit, duke rritur pjesëmarrjen e grave dhe grupeve të disavantazuara në menaxhimin e shërbimit të shpërndarjes, investimet dhe pronesinë mbi asetet. Aktivizimi në rritje i OJQ-ve si ndërmjetësuese sociale që trajnojnë komunitetet për të marrë pjesë në planifikim, hartim dhe implementim, do të ishte e dobishme. Roli i qeverisë duhet të kufizohet në lehtësimin e kuadrit të ri institucional dhe implementimin e strategjise duke (a) krijuar Agjencinë Rurale të Ujit dhe Higjienës nën varesinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujërave dhe Kanalizimeve në Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit; (b) lehtësimi i procesit të emerimeve brenda bordit; (c) sigurimi i buxhetit për Agjencinë Rurale të Ujit dhe Higjienës; (d) sigurimi i fondeve për investime, së bashku me donatorët e interesuar, për të ndihmuar në financimin e opsioneve direkte të shërbimit të shpërndarjes së ujit; (e) përcaktimi i politikave për sektorin rural të furnizimit me ujë; (f) bërija e auditëve vjetore të Agjencive Rurale të Ujit dhe Higjienës; dhe (g) venia në zbatim e legjislacionit rregullues, të burimeve ujore, mjedisit dhe shëndetit. Qendrueshmëria nëpërmjet implementimit të projekteve me mbulim të pjesshëm të kostos, do të ishte shumë e rëndësishme.

299. Rruget rurale. Aksesimi më i mirë në rruget rurale, do të permiresonte kapacitetin e njerezve për të levizuar drejt tregjeve, por edhe do t'i levizte njerezit drejt mundësive që ofrojnë të ardhura, aty ku ato ekzistojnë. Do të ishte e rëndësishme që të ruhej një nivel shërbimi i përshtatshëm për secilin pjesë të rrjetit rrugor, nëpërmjet programeve afat-mesme dhe afat-gjata të investimit për rehabilitim dhe reforme të sektorit, strukturim institucional dhe privatizim gradual të shërbimeve të mirembajtjes së rrugëve si dhe shtrirje të rrjetit në zonat të cilat e gëzojnë të cunguar këto lloj shërbimi. Kater fusha të rëndësishme për permiresim do të sugjeroheshin për rruget rurale: (a) krijimi i një strukture efektive organizative; (b) krijimi i një sistemi që siguron një nivel të mjaftueshëm financimesh; (c) venia në zbatim e procedurave të shëndosha operative; dhe (d) miratimi i politikave të mira të personelit. Kjo duhet të bazohet në parimet që përdoruesit e sektorit privat duhet të paguajnë për shfrytëzimin e rrugëve, duhet garantuar financimi adekuat për nevojat e mirembajtjes, dhe fondet për mirembajtjen e rrugëve duhet të jenë të barabarta çdo vit. Pjesëmarrja në rritje e komuniteteve në ndërtimin dhe mirembajtjen e rrugëve të fshatrave, duhet të bëhet edhe me prioritet për portofolin e B.B. Modele të sukseshme nga vende të tjera duhet të studiohen për t'u aplikuar në Shqipëri.

300. **Energjia rurale.** Deri tani, Banka ka mbështetur sektorin e energjise nëpërmjet tre projekteve që fokusohen në riparime urgjente të sistemit të furnizimit me energji, rehabilitimin e rrjetit dhe blerjen e matësve të energjise. Një Projekt i planifikuar për Rehabilitimin dhe Ristrukturimin e Sektorit të Energjise po financon: (a) rehabilitimin e pjesëve të rrjeteve transmetuese dhe shpërndarëse në rajonet e Durrësit, Elbasanit dhe Kucovës; (b) prokurimin dhe instalimin e kutive matëse; dhe (c) asistencë teknike. Një projekt i mëvonshëm do të mbështete

perpjekjet e qeverise per te rritur kapacitetet e prodhimit te energjise me burime termale. Banka ka mbeshtetur gjithashtu, veprime per te permiresuar mbulimin e kostove ne sektorin e energjise, fuqizuar institucionet e sektorit, ristrukturuar sektorin dhe pergatitur per konkurrencen dhe privatizimin perfundimtar. Aktualisht, eshte ne proces nje studim i madh per sektorin e energjise, me financim nga nje projekt ekzistues i Bankes Boterore, per vleresimin e kerkeses per energji ne te ardhmen, konceptimin e programeve me sa me pak kosto, percaktimin e politikave te pershtatshme te cmimeve dhe masa rregulluese, si dhe per propozimin e masave te reformes. Pritet qe ky studim te hedhe bazat per asistencen e ardhshme te donatoreve per sektorin. Duke patur parasysh natyren e krizes se sektorit, e cila prek shume si konsumtoret rurale ashtu dhe ato urbane, kendveshtrimi i nderhyrjeve te Bankes ne favor te sektorit te energjise, deritanime nuk ka perfshire masa te vecanta per konsumtoret rurale, pasi perpjekjet jane ne proces (investime dhe masa ne sektorin e politikave), prej te cilave do te perfitojne keto konsumtore, po ashtu dhe ato urbane. Zgjidhje per zonat rurale do te dalin gjithashtu, edhe prej mesimeve te nxjerra ne rajone te tjera si Amerika Latine, ku burimet alternative te energjise dhe mikro-skemat e vena ne funksionim nga sektori privat jane testuar dhe kane provuar te kene qene te suksesshme. Ne shume zona te Shqiperise, e kryesisht ne ato malore, potencialet e prodhimit te energjise me hidrocentrale te vogla, duhen studiuar per te ardhmen.

301. **Ujitja dhe kullimi.** Eshte e rendesishme te vazhdohet procesi i rehabilitimit te sistemeve te ujitjes dhe kullimit pergjate viteve te ardhshme. Banka do te vazhdoje mbeshtetjen e saj per shoqatat e perdoruesve te ujit dhe shtrije aktivitetet e saj ne rajone te tjera per te permbushur nevojat per ujitje. Megjithate, asistenca per te ardhmen do te perqendrohet me shume ne: (a) asistencen per sektorin publik ne lidhje me ristrukturimin e sherbimeve; (b) ndertimi i kapaciteteve te strukturave qe menaxhojne kanalet e medha te ujitjes; (c) venie theksit ne menaxhimin e burimeve ujore duke trainuar fermeret per nje perdorim me eficient te ujit; (d) mbeshtetja e qeverise ne hartimin e nje plani kombetar te burimeve ujore; (e) asistencen per rehabilitimin e stacioneve te pompimit dhe digave aty ku do te kerkohet; dhe (f) mbeshtetje ne vazhdimesi per Shoqatat e Perdoruesve te Ujit. Duke qene qe koncepti i Sh.P.U. po funksionon ne pjesen me te madhe, dhe shume mesime jane nxjerre te cilat mund te perkthehen ne programe te reja, me shume vemendje duhet kushtuar per pergatitjen e autoriteteve respektive ne drejtim te menaxhimit te sistemeve te medha dhe atyre te bazuara ne komunitet. Gjithashtu, vemendje me e kujdesshme i duhet dhene menaxhimit ne kushtet e fermes, se ujitjes. Qe sistemet te behen te qendrueshme dhe efektive, duhet te rritet kapaciteti i fermereve per te menaxhuar ujitjen ne baza afat-gjata, si dhe duhen bere permiresime ne drejtim te mirembajtjes se skemes.

- Hartimi i programeve specifike qe synojne zhvillimin e ekonomise rurale jobujqesore, me nje focus ne zonat rurale, ku potencialet bujqesore jane te kufizuara

302. Mungojne projekt-ide te mira per zhvillimin e ekonomise rurale jobujqesore. Shume parakushte per zhvillim te suksesshem te sektorit jobujqesor, vijne ne pergjithesi nga pengesa te zhvillimit. Keshtu, eshte e veshtire te skalitet nje program qe te fokusohet ne menyre direkte ne ekonomine rurale jobujqesore. Ne fakt, do te ishte e domosdoshme qe se pari te pergatiteshin kushtet dhe kuadri ne te cilin mund te kultivohet zhvillimi rural jobujqesor. Banka do t'i perfshije keto konsiderata ne dialogun e saj me qeverine. Nderhyrje te vogla te synuara per te nxitur disa aktivitete rurale jobujqesore, duhet te bazohen tek komuniteti dhe te orientohen nga kerkesa.

303. Aksesi ne burimet financiare do te jete themelor per zhvillimin e ekonomise rurale jobujqesore. Aktivitete te metejshe trainimi sugjerohen ne drejtim te menaxhimit te biznesit dhe formimit profesional, per t'i pajisur njerezit ne zonat rurale me kapacitete me te fuqishme per te gjetur pune. E ndersa kjo mund te coje si fillim ne zhvendosjen e metejshe te njerezve nga zonat rurale, ne fakt do te kontribuojte per nje reforme strukturale me te shendoshe ne zonat rurale. Megjithate, procesi do te jete i gjate dhe nuk do te jete ne gjendje qe te ndaloje levizjet e popullsisve apo te sheroje deshperimin ne zonat e largeta. Disa zona te Shqiperise mund te jene te

favorshme per te perfituar nga nxitja e turizmit. Shume pak eshte bere deri tani per te zbuluar keto mundesi. Megjithate, zhvillimi i turizmit duhet te ndodhe sipas ritmeve te kontrolluara, ne menyre qe planet per zhvillim te mjedisit dhe ato per zhvillim afatgjate per keto zona, te mos ndikohen negativisht.

304. Vitet e fundit kane pare nje shperthim iniciativash, si p.sh. rruget e taksueshme, prodhimi privat i energjise dhe rrjetet e telefonave celulare, ne te cilat sektori privat eshte bere aktiv ne nje fushe e cila tradicionalisht ka qene e sektorit publik. Ndersa keto iniciativa mund te kene me siguri, nje impakt te madh ne infrastrukture, mundesi te metejsme duhet te zbulohen. Metodot me baze komuniteti qe identifikojne ne menyren me te mire, kerkesen dhe potencialet e fushave te caktuara, mund te sherbejne si mjete per promovimin e angazhimit ne rritje te sektorit privat ne zonat rurale. Metoda te tilla si ato te zaturara me sukses me fonde sociale apo skema te granteve konkruese, mund te shtrihen me tej per te mbuluar nje hapesire me te madhe te aktiviteteve ekonomike ne zonat rurale. Perparesia e dhenies eksluzive te kredive, qendron ne orientimin qe mund te jepet gjate fazes fillestare te aktiviteteve. Nese kombinohen me trainim dhe aktivite promovuese, keto iniciativa mund te sherbejne si nje burim keshillimi per zhvillues te tjere potenciale te biznesit.

- Rritja e vemendjes ne menaxhimin e qendrueshem te burimeve

305. Gjate viteve te fundit, Shqiperia ka arritur rezultate te spikatura ne reformen sektoriale te pyjeve dhe kullotave, kryesisht nepermjet decentralizimit te menaxhimit te burimeve natyrore tek strukturat komunale. Asistenca e jashtme eshte realizuar prej B.B., Qeverise Italiane, FAO, USAID dhe GTZ. Vitet e para te procesit te tranzicionit u karakterizuan nga nevoja per ndertimin e kapaciteteve te brendshme dhe pranimin e ideve pergjate tranzicionit drejt ekonomise se tregut, administrates se decentralizuar dhe sistemeve te menaxhimit. Duke marre parasysh arrijtet e se shkuars nga ana e qeverise shqiptare dhe strategjite per zhvillim te BB si dhe risqet e medha ende prezente per zhvillim te qendrueshem, asistenca e ardhshme e BB do te ndertohet perreth prioriteteve te meposhtme:

- Krijimi i mundesive te reja per sigurim te ardhurash dhe akses ne treg per komunitetet e varfera rurale brenda kuadrit te menaxhimit te qendrueshem te pyjeve, kullotave dhe kurrizeve ujdendarese, ne aspektin ekologjik, ekonomik dhe social, perfshire aksesin ne teknologjite e informacionit. Aspektet kyce do te perfshinin:
  - *krijimin e mundesive per punesim ne menaxhimin shteteror te pyjeve (mbledhja e druve, operacionet krasitese, ripyllzimi, rehabilitimi i rrugeve etj.);*
  - *zhvillimi i aftesive per prodhimin e produkteve jodrusore (bimet farmaceutike, aromatike, kerpudhat, punimet me dore, etj.) dhe permiresimi i aksesit ne tregje;*
  - *masat per kontrollin e erozionit per "tokat e refuzuara";*
  - *permiresimi i aksesit ne teknologjite moderne te informacionit dhe komunikimit ne zona pilote. Ky aktivitet duhet te siguroje pajisje per qendrat e informimit dhe komunikimit te komunitetit, trainim, mbeshtetje per krijimin e kanaleve te marketingut ne internet etj., dhe asistence teknike.*
- Rehabilitimi i integruar i pyjeve te degraduara dhe te eroduara, kullotave dhe tokes se punueshme nepermjet menaxhimit te mikrozonave me prita ne toke komunale. Aspektet kyce do te perfshinin:
  - Mbeshtetje per perfundimin e programit per transferimin e tokes shteterore te zene me pyje dhe kullota tek komunitat, dhe mundesit me vone tek familjet apo personat private;
  - Zhvillim i vazhdueshem i planeve per zhvillimin e pyjeve dhe kullotave komunale;
  - Ripyllzimi i tokave te degraduara dhe djerre ne zonat e permbytura;
  - Investime per kontrollin e erozionit, vecanerisht ne tokat e ashtuquajtura te refuzuara;




- Permiresimi i ruajtjes së tokës në prodhimin e kulturave bujqësore, përfshirë prodhimin e foragjereve të kultivuara;
  - Permiresimi i menaxhimit të kullotave;
  - Vazhdimi i rehabilitimit të pyjeve të larta të zotëruara nga shteti, përfshirë krasitjen komerciale, rigjenerim natyral të pyjeve; dhe
  - Vazhdimi i rehabilitimit të rrugëve pyjore dhe linjave hyrese.
- 
- Normalizimi i biodiversitetit dhe mbrojtjes së mjedisit nëpërmjet ruajtjes së biodiversitetit, kryesisht në zonat e mbrojtura, dhe mbrojtjes së mjedisit. Aspekte kyçe do të përfshinin:
  - Rregullimi i aspekteve të biodiversitetit në politikat kombëtare, rajonale dhe lokale;
  - Mbeshtetje për planifikimin dhe kryerjen e menaxhimit të zonave të mbrojtura të perzgjedhura;
  - Ndergjegjesimi rreth zjarrit të pyjeve, masa që lidhen me parandalimin dhe menaxhimin;
  - Mbeshtetje për ngritjen e kapaciteteve të luftës kundër zjarrit; dhe
  - Permiresimi i politikave dhe menaxhimit të kontrollit të erozionit.
- 
- Fuqizimi i kapaciteteve institucionale të agjencive të menaxhimit të burimeve natyrore dhe mjedisit, në nivelet qendrore, rajonale dhe lokale, dhe sigurimi i mbështetjes për krijimin e një kuadri ligjor, politikash dhe ekonomik për menaxhimin e decentralizuar dhe komunal të pyjeve dhe kullotave. Aspektet kyçe do të përfshinin:
  - Përfundimi i procesit të ristrukturimit dhe decentralizimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave;
  - Fuqizimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit;
  - Fuqizimi i shërbimeve të inspektimit të pyjeve dhe kullotave dhe rritja e mbështetjes ndaj luftës kundër prerjeve të paligjshme;
  - Krijimi i kapaciteteve të planifikimit komunal dhe vetëmenaxhimit;
  - Mbeshtetje për përgatitjen e planeve shtetërore dhe komunale për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave;
  - Sqarimi i çështjeve që lidhen me pronësinë dhe regjistrimin e tokës; dhe
  - Mbeshtetje për trajnim, pajisje teknike dhe asistencë teknike.

## Aneks I. Baza e burimeve natyrore – Zonat Agro-ekologjike te Shqiperise

Shqiperia ze nje siperfaqe totale prej 28,750 km, nga te cilat 699,000 ha klasifikohen si toke bujqesore (24 % e siperfaqes totale), 1,027,000 ha klasifikohen si pyje (36%) dhe 446,000 ha klasifikohen si kullota (15%). Pjesa e mbetur, e cila ze 25%, klasifikohet ne kategorine *te tjera*, duke perfshire zonat urbane, rreth 135,000 ha liqene dhe perrenj si dhe siperfaqe toke te paperdorura shkembore dhe malore. Siperfaqja mesatare e tokes bujqesore per fryme eshte mjaft e vogel, ne nivelin 0,2 ha, e konsideruar si me e vogla ne Europe, pavaresisht se toka bujqesore u rrit me teper se dyfishi nga viti 1950 ne vitin 1990, per arsye te kullimit te ujerave nentokesore, krijimit te tarracave dhe kultivimit te pyjeve dhe kullotave, si dhe krijimit te skemave te reja te ujitjes.

Vendi eshte mjaft malor me lartesi qe variojne nga niveli i detit pergjate Detit Adriatik ne perendim, deri ne 2,751 m ne malin e Korabit ne rrethin e Dibres ne veri-lindje te vendit. Vetem 16% e tokes shtrihet poshte 100 m, 55% bie midis 100 dhe 1,000 m dhe 29% ndodhet siper 1000 m. Per kete arsye, toka qe perdoret ne bujqesi eshte shume shpesh mjaft e pjerrtet, ku vetem 44% e siperfaqes bujqesore ka pjerrtesi me pak se 5 %.



**Burimi: Pamje e Bujqesise Shqiptare nga Shkelqim Agolli, Tirana, 2000.**

Shqiperia mund te ndahet ne 3 zona kryesore agro-ekologjike bazuar ne kushtet klimatike dhe topografine:

- *Ultesirat* perbehen nga fusha bregdetare pergjate Detit Adriatik, me lartesi qe variojne nga niveli i detit ne 200m. Rreth 80% e rreshjeve vjetore ndodhin nga tetori ne mars, duke sjelle nevojën per ujitje per prodhimin e kulturave bujqesore te veres. Ne pergjithesi, keto kushte lejojne prodhimin e nje game te gjere kulturash bujqesore si dritherat, foragjeret, perimet, pjergullat, si dhe agrumet ne pjesen me jugore te zones.
- *Zona kodrinore* (nen-malore) varion nga 100 ne 900 m, e perbere kryesisht nga kodra qe shtrihen nga veriu ne jug midis fushave bregdetare dhe maleve. Ketu rriten: ullinjte, pjergullat, pemet frutore, misri dhe gruri dhe ka zona te gjera me pyje te uleta dhe shkurre. Zona kodrinore perfshin pellgun e rendesishem bujqesor te Korces, ne jug-lindje te Shqiperise, e vendosur ne mbi 800 m mbi nivelin e detit ne pjesen me te thate te vendit (rreshjet mesatare vjetore arrijne ne 790 mm).
- *Zona malore* perbehet nga livadhe ndermalore dhe maja shume te larta malore, me vere te bute dhe dimer mjaft te ftohte me ngrirje te medha dhe rreshje debore te konsiderueshme (rreshjet vjetore mesatare variojne nga 900 mm ne jug ne 1500 mm ne veri dhe deri ne 3000 mm ne lartesi e maleve veriore). Kulturat bujqesore si misri, foragjeret, perimet e veres dhe gruri i stines se dimrit mund te rriten ne lendina, kurse elbi dhe patatja ne lartesi me te larta. Gjithashtu, kultivohen frutore si mollet dhe kumbullat. Ne lartesi, zona perfshin kryesisht pyje dhe kullota per kafshe te gjalla.

Tokat aluvionale dominojne fushat bregdetare me hapësira te vogla te toke te kripura te gjetura pergjate bregut, pjese-pjese te perziera me pjese te dala shkembore dhe duna rere. Pavaresisht se tokat mund te jene te ndryshme, ato ne pergjithesi jane te thella, te kulluara mire dhe pjellore. Zonat ekstensive jane bonifikuar nga mocalet ne rreth 280,000 ha te rehabilituara gjate regjimit te meparshem, duke zene keshtu me teper se 66% te zonave te ujitura te vendit. Jashte fushave bregdetare, tokat me te rendesishme bujqesore jane ato mesdhetare me ngjyre te kuqe/kafe, tokat me ngjyre kanelle dhe toka te ndryshme me ngjyre kafe. Daljet ne siperfaqe te gureve gelqerore dhe tokave gelqerore jane dominuese ne malet veriore, veri-lindje te Tiranës dhe lindje te Sarandes. Megjithese keto toka mund te perdoren per prodhimin e dritherave, nje pjese e mire e tyre jane te uleta, te gurezuara, acide nese nuk jane formuar nga gure gelqerore, me pjellori relativisht te ulet dhe behen subjekt i erozionit ne pjeset me te dala ne siperfaqe. Rreth 100,000 ha e tokes ne zonat me kodrinore dhe malore jane terracuar gjate regjimit te meparshem, kryesisht per rritjen e grurit dhe kulturave drusore.

Burimet e ujit perfshijne: reniet e shiut, ujerat siperfaqesore dhe ato nentokesore. Burimet e ujrave siperfaqesore rrjedhin ne 8 pellgje kryesore lumenjsh, me nje prurje mesatare 25.7 bilion m<sup>3</sup>. Ekzistojne me teper se 650 rezervuare te vegjel te ndertuar per qellime ujitjeje, me nje kapacitet grumbullimi prej rreth 560 milion m<sup>3</sup>. Pervet kesaj, 450 milion m<sup>3</sup> jane shmangur nga drejtimi i rrjedhjes se lumit. Kjo perfaqeson 3.3% te burimeve totale, nga te cilat 75% eshte perdorur ne bujqesi. Rreth 60% apo 425,000 ha te tokes bujqesore u klasifikua si toke per ujitje ne 1990, megjithese pas kolapsit te fermave shtetore dhe sistemit te kolektivizimit dhe demit e shkaterrimit qe u pasua, vetem 80,000 ha u ujitën ne 1993. Gjithashtu, ka disa diga te medha qe perdoren kryesisht per prodhimin e energjise elektrike me kapacitet 3.25 bilion m<sup>3</sup>. Ujerat nentokesore nuk perdoren zakonisht per ujitje, pavaresisht se pjese me e madhe e ujrave lokale perftohët nga ky burim.

Shqiperia ka pyje te konsiderueshme me mbi 1 milion ha apo 36% e siperfaqes se pergjithshme (Tabela 1). Pyjet luajne nje rol te rendesishem ne mbrojtjen e tokes dhe sigurojne burime per lende druri, lende drusore djegese, dhe tagji. Pyjet me te uleta jane shpesh te perdorshme per rritjen e bleteve. Rreth 47% e pyjeve klasifikohen si pyje te larta ahu, pishe te zeze, dhe specie te tjera gjethegjera dhe pyje shkurresh (25%) duke perfshire specie si shkoza, dhe te tjera gjethegjera. Shumica e pyjeve jane natyrore, por gjate periudhes se regjimit te meparshem jane bere disa mbjellje, kryesisht me drure halore ne mbi 100,000 ha deri ne fund te vitit 1991. Pyjet me te larta jane ne pergjithesi ne kushte te mira, por koriet dhe

pyjet shkurre shpesh jane mbishfrytezuar per tagjira dhe lende drusore djegese, vecanerisht prane zonave te populluara, duke cuar ne probleme te gjera shpyllezimi dhe erozioni. Per shembull, rreth 50% e pyjeve me ah jane konsideruar si te degraduara. Kjo situatë është renduar pas nje reforme per rritjen e popullimit me kafshe te gjalla, me teper kullota te pakontrolluar dhe rritja e grumbullimit te lendeve drusore djegese. Pervec kesaj, pjesa me e madhe e pemeve buze rruges u prene gjate trazirave politike. Druret e fermes, te cilat perbehen kryesisht nga plepa ne zonat e uleta dhe jane shperndara ne ngastra te vogla ne token bujqesore dhe perreth vendbanimeve, mbulojne nje siperfaqe prej rreth 11,000 ha.

#### STRUKTURA E ZONES SE PYJEVE

	Siperfaqe	Vellimi (x1000m)	Vellimi tregetar (x1000m)				Lende drusore djegese
			Total	E madhe	Mesatar e	E vogel	
Totali i pyjeve me produktivitet te larte ah, pishe e zeze, lis)	859,566 84%	65,966 80%	40,901 62%	19,487 48%	8,888 22%	12,526 30%	25,065 38%
Total korrie (lis, te tjera)	266,606 31%	8,157 12%	2,966 36%	829	650	1,487	5,191 64%
Shkurre (shkoze, arbutus)	221,217 26%	6,885 11%	0	0	0	0	6,885
Pyje te mbrojtur	165,445 16%	16,452 20%	10,036 61%	5,144 51%	2,355 24%	2,537 25%	6,416 39%
Total	1,025,011	82,418	50,937	24,631	11,243	15,063	31,481

Burimi: Drejtoria e Pergjithshme e Pyjeve dhe Kullotave, 1999.

Rreth 1 milion ha apo me teper se 30% e vendit perdoret per kullota duke perfshire token e klasifikuar per kullota, pyje dhe toke bujqesore (tabela 2). Rendesia e e ketij burimi kullotash eshte reflektuar ne faktin se rreth 60% e popullsise jane perfshire ne nje fare menyre ne rritjen e kafsheve, kryesisht per dele dhe dhi. Kthimi i kullotave ne toke marzhinale bujqesore per qellime prodhimi te dritherave gjate regjimit te meparshem rezultoi ne nje reduktim te siperfaqeve te kullotave nga rreth 700,000 ha ne vitin 1960 ne 420,000 ha ne 1990. Zona e kullotave perfshin lendina natyrore dhe bimesi malore pertej kufijte e pyjeve natyrore ne male, dhe kullotave te bera nga njeriu brenda brezit te pyjeve dhe rreth fshatrave. Rreth 60% eshte klasifikuar si kullota dimerore ne lartesi me te uleta nderkohe qe pjesa e mbetur eshte klasifikuar si kullora verore ne lartesi te medha. Megjithate, kufijte midis kullotave dhe tokes se paperdorur dhe ndermjet kullotave pyjeve nuk eshte gjithmone e percaktuar qarte dhe ka shume forma te perkohshme. Mbi te gjitha, cilesia e kullotave dhe produktiviteti i tyre eshte i ulet dhe supershfrytezimi i kullotave eshte i zakonshem, gje qe i atribohet rritjes se popullimit me kafshe te imta dhe nje shkalle me e larte e kullotjeve te pakontrolluara ne zbatim te reformave.

#### VLERESIM PERAFERT I VLERES DHE SASISE SE TAGJISE

	HA (x1000)	Mesatare Kg DM/HA	Prodhimi		Vlera e tagjise \$ x 1000**
			total	Dele	
			vjetor MT	x 1000*	
Dimer	241	800	192,800	385,600	20,250

Vere/ Pranvere	162	250	405,000	81,000	7,500
Te tjera	600	250	150,000	300,000	<u>37,390</u>
			747,800	1,495,600	65,140

\*=supozohet nje nevoje per tagji prej .5 MT/vit; \*\*=supozohet nje vlere prej \$50/MT/dM

## *Aneks II. Pakti i Stabilitetit per Europen Juglindore*

Pakti i Stabilitetit eshte nje iniciative per te koordinuar perpjekjet ekzistuese ne ndihme te integritimit politik, ekonomik dhe ne fushen e sigurise te Europes Juglindore ne Europe. Pakti nuk i implementon projektet nen pergjegjesine e tij. Ai eshte nje instrument per te bere te mundur koordinimin dhe pershpjtimin e projekteve te te gjitha organizatave partnere, si Bashkimi Europian dhe shtetet anetare te tij, NATO, OSBE, institucionet nderkombetare financiare dhe disa vende individuale se bashku me te gjitha vendet e Europes Juglindore.

Pakti i Stabilitetit u miratua ne nje takim te vecante te Ministrave te Jashtem dhe perfaqesuesve te Organizatave dhe Institucioneve Nderkombetare dhe iniciativave rajonale ne Qershor te vitit 1999. Pakti vendosi nje marreveshje politike per arritjen e mirekuptimit, koordinimit dhe zhvillimit strategjik ne rajon dhe krijoi nje forum ne te cilin, anetaret mund te identifikojne masat dhe projektet qe mund te kontribuojne ne vendosjen e stabilitetit dhe zhvillimin ne rajon. Ne Paktin e Stabilitetit ka 29 pjesemarres, si dhe 11 lehtesues dhe 4 iniciativa rajonale.

### ***Anetaret e Paktit te Stabilitetit***

- *Shtetet anetare te Bashkimit Europian dhe Komisioni Europian*
- *Vendet e rajonit dhe fqinjet e tjere: Shqiperia, Bosnje-Hercegovina, Maqedonia, Hungaria, Rumania, Slovenia, Jugosllavia dhe Turqia*
- *Anetaret e G8: Sh.B.A. , Kananda, Japoni dhe Rusi.*
- *Vende te tjera: Norvegji, Zvicer.*
- *Organizatrat nderkombetare: UN, OSBE, Keshilli i Europes, UNHCR, NATO, OECD, WEU*
- *Institucione nderkombetare financiare: Banka Boterore, IMF, EBRD, EIB*
- *Iniciativat rajonale: Bashkepunimi Ekonomik ne Detin e Zi, Inisiativa e Europes Qendrore, Inisiativa e Bashkepunimit me Europen Juglindore, dhe Procesi i Bashkepunimit me Europen Juglindore.*

Nje Tavoline Rajonale e Europes Juglindore eshte krijuar si nje organ gjithepershires i Paktit, i cili perbehet nga perfaqesues te qeverive, organizatave nderkombetare, dhe institucioneve. Kjo tavoline vlereson progresin dhe siguron ndjekjen dhe drejtimin ne arritjen e objektivave te Paktit te Stabilitetit.

Tavolina perbehet nga tre grupe pune: a) demokratizimi dhe te drejtat e njeriut  
b) bashkepunimi, zhvillimi dhe ristrukturim ekonomik dhe c) ceshtjet e sigurise.

**Pakti i Stabilitetit ne Shqiperi.** Pakti i Stabilitetit ne Shqiperi aktualisht perfshin 32 projekte nen mbikqyrjen e Grupit te Pare te Punes (me rreth 18 milion \$), 16 projekte nen mbikeqyrjen e Grupit te Dyte te Punes (me rreth 150 milion \$) dhe 4 projekte ne mbikeqyrjen e Grupit te Trete te Punes ( me rreth 2 milion \$). Pakti i Stabilitetit do te kete rendesine kryesore per Shqiperine. Drejtimi i mbeshtetjes nga donantori do te sigurohet nga vendimet e grupeve te punes. Per qeverine shqiptare eshte e nevojshme te zhvilloje nje pozicion te qarte ne mbeshtetjen qe i nevojitet. Kjo do te siguroje qe vizionet e Shqiperise te mund inkorporohen ne drejtimet e pergjithshme brenda Paktit te Stabilitetit.

### ANEKSI III. TABELAT E REFERENCES

Tabela 1. Vlera dhe perqindja e produkteve bujqesore (cmimet e vitit 1994 ne milion lek)

Vitet	Prodhimi bujqesor total	Kafshe te gjalla	%	Kulturat bujqesore	%	Peme frutore	%
1992	71,602	26,693	42%	37,829	53%	4,080	6%
1993	84,927	37,875	45%	42,332	50%	4,720	6%
1994	91,985	45,303	49%	41,452	45%	5,230	6%
1995	104,157	50,581	49%	46,979	45%	6,597	6%
1996	107,224	51,688	48%	49,079	46%	6,457	6%
1997	95,634	46,899	47%	41,851	46%	6,884	7%
1998	9,9027	47,830	48%	43,946	45%	7,251	7%
1999	103,198	51,360	50%	44,835	43%	7,003	7%

Burimi: Botimi vjetor statistikor i vitit 1999, Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit, Qershor 2000, Zyra e Statistikave te Ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit

Tabela 2. Numri i kafsheve te gjalla ('000 koke) dhe prodhimi nga kafshet e gjalla

Emertimi	1989	1992	1995	1998	1999	2000
<i>Numri i kafsheve te gjalla ('000 koke)</i>						
Gjedhe	700	616	840	705	720	728
Lope	288	324	470	423	432	448
Dele a/	1,593	1,796	2,480	1,872	1,941	1,939
Dhi a/	1,153	1,234	1,650	1,051	1,120	1,106
Derra	182	90	100	81	81	103
Kuaj	177	168	230	221	215	204
Shpende	5,590 b/	2,539	3,900	4,862	5,023	5,291
Koshere–Blete ('000 koshere)	87	36	40	57	67	76
<i>Prodhimi blegtoral</i>						
Qumesht ('000 ton)	528	612	968	861	907	948
Mish ('000 ton) b/	84	91	116	106	111	112
Veze (milion)	202	270	285	397	414	530
Mjalte (ton)	83	237	450	805	906	1,076

Burimi i te dhenave: Shifrat nga viti 1992-1999 jane nxjerre nga botimi statistikor i vitit 1999, Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit, qershor 2000; shifrat e 1989 jane marre nga Pamje e pergjithshme e Sektorit Bujqesor, Tetor 1991.

a/ kryesisht te mbajtura per prodhimin e qumeshtit, b/ perfshire 2,95 milion shtresa, c/ pesha e bagetise

**TABELA 3. NUMRI I PEMEVE FRUTORE DHE PRODHIMI I FRUTAVE**

<b>Emertimi</b>	<b>1990 a/</b>	<b>1992</b>	<b>1996</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>
<i>Peme frutore b/</i>					
Numri total i pemeve ('000)	13,032	3,583	5,072	5,160	5,573
Numri ne prodhim ('000)	7,498	2,867	4,012	3,875	4,179
Prodhimi (ton)	75,300	34,000	58,120	54,300	64,900
<i>Ullinj</i>					
Numri total i pemeve ('000)	5,821	3,129	3,405	3,564	3,611
Numri ne prodhim	3,402	2,313	3,084	3,200	3,256
Prodhimi (ton)	25,580	20,200	27,660	42,000	36,200
<i>Agrumet</i>					
Numri total i pemeve ('000)	1,084	364	420	332	391
Numri ne prodhim ('000)	820	305	361	266	305
Prodhim ('000)	12,580	12,900	3,000	2,500	2,600
<i>Pjergulla</i>					
Siperfaqja totale (ha)	17,261	7,285	5,024	5,377	5,824
Siperfaqe ne prodhim (ha)	14,058	6,193	4,345	4,380	4,613
Prodhim (ha)	77,930	37,800	59,100	70,400	79,300

Burimi i te dhenave: Statistika te Ministrise se Bujqese dhe Ushqimit, 2000  
a/Shifrat e prodhimit jane mesatare per 1985-1990; b/shifra per pemet: molla, dardha, pjeshka, kumbulla, qershia etj.

**TABELA 4. PERDORIMI I PLEHRAVE KIMIKE**

<b>Plehra kimike</b>	<b>1990</b>	<b>1995</b>	<b>1997</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>
Ure	93,290	18,607	24,742	27,512	25,939
Nitrat Amoni	93,420	37,564	42,896	4,7709	50,186
Fosfat diamoni	0	3,474	4,934	7,743	12,871
Superfosfat	151,000	31,832	39,780	38,611	40,112
Potas	6,000	0	0	0	0
Total	343,710	91,477	112,352	121,575	129,108

Burimi i te dhenave: Statistika te Ministrise se Bujqese dhe Ushqimit, 2000

**TABELA 5. MAKINERI BUJQESORE**

<b>Makineria</b>	<b>1990</b>	<b>1995</b>	<b>1997</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>
Traktore	6,484	7,498	6,892	7,260	7,187
Traktore me zinxhire	4,081	1,440	1,018	Na	Na
Makine mbjellese	Na	1,462	1,519	1,652	1,772
Makina kositese	Na	132	149	294	504
Autokombajna korrese	1,350	817	783	760	891

Burimi i te dhenave: Statistika te Ministrise se Bujqesese dhe Ushqimit, 2000.

**TABELA 6. TENDENCA E CMIMEVE TE PRODHIMEVE BUJQESORE**

<b>Cmimet nominale te prodhuesit</b>	<b>Korrik 1993</b>	<b>Korrik 1994</b>	<b>Korrik 1995</b>	<b>Korrik 1996</b>	<b>Qershor 1999</b>	<b>Qershor 2000</b>
Gruri	15.9	16.5	14.5	30.0	39.0	34.9
Misri	20.4	22.1	18.2	39.3	40.0	34.3
Qumeshti	22.6	28.4	28.5	29.0	50.9	50.8
Djathe	158.2	178.3	185.9	213.7	341.0	295.8
Patate	18.8	39.5	30.5	38.3	46.7	61.3
Domate	38	23.0	37.6	41.3	49.8	83.4
Mish vici	224.5	222.0	229.1	274.0	573.0	565.8
Mish qengji	234.7	240.1	234.9	295.0	536.3	520.2
Molle	31.8	59.6	65.7	93.9	129.3	104.8
Portokall	37.4	67.7	54.8	91.4	104.5	95.9

Burimi i te dhenave: Dokumenti teknik i Bankes Boterore 431, Ministria e Bujqese dhe Ushqimit.

**TABELA 7. CMIMET MESATARE TE SHITJES ME PAKICE PER PRODHIME BUJQESORE TE ZGJEDHURA**

	<b>1994</b>	<b>1995</b>	<b>1996</b>	<b>1997</b>	<b>1998</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>
Miell gruri	31.4	31.9	46.4	61.8	66.0	60.3	56.2
Fasule	68.5	113.7	93.8	101.4	193.0	167.9	117.5
Qumesht (lope)	30.6	31.1	32.3	39.6	49.0	51.2	52.4
Djathe (feta)	194.1	197.9	222.8	261.0	333.0	331.8	327.0
Patate	35.1	36.5	36.8	50.2	55.0	55.3	50.6
Domate	75.8	75.7	96.8	117.6	142.0	146.2	111.8
Mish vici	228.5	251.7	297.7	384.3	583.0	584.3	560.7
Veze	7.6	7.9	10.7	13.2	14.0	12.8	11.9
Molle	53.6	61.4	71.8	83.0	100.0	112.5	100.0
Portokall	49.5	52.3	74.1	84.2	110.0	113.8	89.9
Rrush	58.9	73.0	146.8	202.6	268.0	237.3	199.8
CPI (Dhjetor 1993=100)	Na	120.1	135.3	180.2	217.4	218.2	na

Burimi i te dhenave: Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit



**TABELA 8. VLERA E EKSPORTEVE PER PRODUKTET KRYESORE BUJQESORE (MILION LEK)**

	1997		1998		1999		2000	
	m Lek	%	m Lek	%	m Lek	%	M Lek	%
Bujqesia - Total	2,313	54.4	2,411	48.7	1,640	42.3	1,818	44.1
Fruta	52.9		9.6		12.1		5.1	
Perime	271		220		44		128	
Kultura bujqesore a/	1,945		1,902		1,403		1312	
Peme	44		9		1.3		100	
Kafshe te gjalla – Total	28	0.7	6	0.1	8.8	0.2	58	1.4
Produkte te perpunuara – Total	1,366	32.1	1,939	39.2	1,825	47.1	2,048	49.7
Vaj Ulliri	4		14		23		6	
Duhan dhe produkte duhani	980		1,346		940		1,024	
Produkte perimesh b/	54		75		71		50	
Peshk i konservuar	303		342		549		577	
Te tjera c/	25		162		932		1,026	
Peshkimi – Total	546	12.8	592	12.0	404	10.4	200	4.9
Peshq	178		418		267		100	
Kerminj dhe molusqe	368		173		137		100	
Total (mije lek)	4,253	100	4,947	100	3,877	100	4,124	100
Kursi mesatar i kembimit	148.93		150.63		137.69		143.71	
Total (US\$ million)	28.6		32.8		28.2		28.7	

Burimi i te dhenave: Statistika te Ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit a/ perfshire bimet mjeksore; b/ perfshire vaj perimesh, perime te konservuara dhe salce domate, c/ perfshire duhanin, cigare, pije alkolike, birra, ushqim kafshesh

**Tabela 9. Vlera e importeve per produktet kryesore bujqesore**

Emertimi	1997		1998		1999		2000	
	m Lek	%	m Lek	%	m Lek	%	m Lek	%
Bujqesia – Total	6,151	21.7	9,438	25.4	7,660	23.5	9,923	30.5
Fruta	2,021		2,488		2,509		3,461	
Perime	729		1,079		872		842	
Grure	2,224		1,598		1,665		2,360	
Drithera te tjera a/	997		1,208		1,088		1,356	
Kultura te tjera b/	107		146		404		867	
Plehera kimike	885				865		757	
Blegtori – Total c/	2,506	8.9	3,769	10.2	4,015	12.1	2,900	8.9
Peshkimi – Total d/	456	1.6	603	1.6	534	1.6	378	1.2
Produkte te perpunuara – Total	19,009	67.1	23,269	62.7	21,006	63.2	19,358	59.5
Produkte blegtorale e/	721		955		604		694	
Produkte duhani	202		826		2,568		2,916	
Perime dhe Produkte perimesh f/	3,580		4,637		3,133		3,719	
Sheqer dhe produkte te tij	4,362		5,041		6,669		3,371	
Miell dhe makarona	7,402				4,171		3,691	
Pije g/	771		1,709		1,929		2,467	
Total (million lek)	28,310	100	37,102	100	33,215	100	32,560	100
Kursi mesatar i kembimit (lek/US\$)	148.93		150.63		137.69		143.71	
Total (million US\$)	190.1		246.3		241.2		226.6	

Burimi i te dhenave: Statistika te Ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit a/ oriz, miser dhe elb; b/ perfshire kulturat bujqesore, fidana, lule, kafe, caj dhe ereza, c/ perfshire kafshet e gjalla, mishi, vezet, dhe mjalti; d/ perfshire peshkun, molusqet dhe kerminjte; e/produktete bulmetit dhe mish i perpunuar; f/ vaj perimesh, vaj ulliri, perime te konservuara dhe fruta, leng frutash dhe salce domate; g/ perfshire uje mineral, birra dhe pije alkolike.

**Tabela 10. Shpenzimet e Ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit 1996-2001(milion lek)**

	1996	1997	1998	1999	2000	2001
Buxheti operaional						
Personeli	440.5	458.0	501.9	499.0	487.7	555.4
Operacionet	594.0	650.5	582.1	711.5	773.5	653.1
Subside per ujitje	0	150.0	169.8	180.0	0	220.0
Nen-total	1,034.5	1,258.5	12,53.8	1,390.5	1,252.2	1,428.5
Buxheti i investimeve						
Financim i brendshem	643.7	679.5	1,175.4	1,296.7	1,492.0	1,324.2
Financim i huaj	3,044.0	3,400.0	3,530.0	3,400.0	3,890.0	2,583.0
Nen-total	3,787.7	4,079.5	4,705.4	4,696.7	5,382.0	3,907.2
Total (milion lek)	4,822.2	5,338.0	5,959.2	6,087.2	6,634.2	5,335.7
Financim i brendshem	1,678.2	1,938.0	2,429.2	2,687.2	2,744.2	2,752.7

Financim i huaj	3,787.7	4,079.5	4705.4	4,696.7	5,382.0	3,907.2
Kursi i kembimit (lek/USD)	104.50	148.93	150.63	137.69	143.71	148
Total (milion lek)						
Financim i brendshem	46.15	35.84	39.56	44.21	46.16	36.05
Financim i huaj	16.06	13.01	16.13	19.52	19.10	18.60

Burimi i te dhenave: Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit

**Tabela 11. Prioritetet ne sherbimet e infrastruktures\***

Rrethi	Kommuna	Fshatra	Popullsia	Total Nenprojekt te kerkuar	Prioritet ne kerkesat e nenprojekteve			
					Rruge dhe ura	Furnizimi me uje	Arsimi shendetsia	Te tjera
<i>Rrethet veriore</i>								
Bulqize	7	62	32,510	59	25	16	15	3
Diber	14	141	72,008	42	42%	27%	25%	5%
Hase	3	30	13,449	9	31%	14%	43%	12%
Kukes	14	90	46,832	43	14%	33%	0%	0%
Kurbin	2	28	35,047	17	51%	14%	28%	7%
Lezhe	9	63	53,723	59	41%	18%	24%	18%
<b>Nen-total</b>	<b>49</b>	<b>414</b>	<b>253,569</b>	<b>229</b>	<b>42%</b>	<b>37%</b>	<b>12%</b>	<b>8%</b>
<i>Rrethet qendrore</i>								
Berat	10	122	75,017	110	69	19	17	5
Elbasan	20	176	115,522	180	63%	17%	15%	5%
Fier	14	117	115,905	110	98	48	13	21
Gramsh	9	95	25,246	94	54%	27%	7%	12%
Kruje	4	43	32,625	31	41	38	20	11
Kavaje	8	65	46,461	60	37%	35%	18%	10%
Librazhd	9	75	53,760	64	58%	22%	11%	5%
Durres	6	61	54,478	49	18	7	6	0
<b>Nen-total</b>	<b>80</b>	<b>754</b>	<b>519014</b>	<b>698</b>	<b>58%</b>	<b>23%</b>	<b>19%</b>	<b>0%</b>
					<b>71%</b>	<b>16%</b>	<b>8%</b>	<b>4%</b>
					<b>39%</b>	<b>8%</b>	<b>6%</b>	<b>6%</b>
					<b>35%</b>	<b>8%</b>	<b>4%</b>	<b>2%</b>
					<b>7%</b>	<b>3%</b>	<b>8%</b>	<b>7%</b>
					<b>31%</b>	<b>25%</b>	<b>4%</b>	<b>4%</b>
					<b>48%</b>	<b>39%</b>	<b>6%</b>	<b>6%</b>
					<b>71%</b>	<b>16%</b>	<b>8%</b>	<b>4%</b>
					<b>57%</b>	<b>24%</b>	<b>11%</b>	<b>7%</b>

<i>Rrethet jugore</i>								
Devoll	4	44	27,971	35	12	13	5	5
Delvine	4	38	4,384	27	11	15	1	0
Korce	14	155	82,718	87	44	27	8	8
Kucove	2	17	17,471	17	6	5	3	3
Gjirokastrer	11	95	33,054	82	49	21	9	3
Kolonje	6	76	7,664	58	35	14	6	3
<b>Nen-total</b>	<b>41</b>	<b>425</b>	<b>173262</b>	<b>306</b>	<b>157</b>	<b>95</b>	<b>32</b>	<b>22</b>
<b>Totali</b>	<b>170</b>	<b>1,593</b>	<b>945,845</b>	<b>1,233</b>	<b>654</b>	<b>319</b>	<b>167</b>	<b>93</b>
					<b>53%</b>	<b>26%</b>	<b>14%</b>	<b>8%</b>

\*Nenprojektet prioritare te kerkuara nga komunitetet dhe komunat ne zonat rurale

TABELA 12. MATRICA E DECENTRALIZIMIT RURAL

Fusha	Sektori	Pergjegjesite e transferuara ne nivel lokal	Pergjegjesite e ndara me Pushtetin lokal	Njesia pergjegjese e Pushtetit lokal	Grupet & Shoqatat mbi baza komuniteti
I. Bujqesia dhe Ushqimi	A) Sistemi i ujitjes	Veprimet, riparimi dhe mirembajtja			Shoqatat dhe Federatat e Perdoruesve te Ujit
	B) Sistemi i Kullimit	Riparimi, mirembajtja dhe mirembajtja e digave e stacioneve te pompimit dhe monitorimi	Bordi i kullimit		
	C) Peshkimi	Menaxhimi i burimeve te peshkimit			Shoqatat e peshkimit
	E) Sherbimet veterinare		Monitorimi dhe kontrolli i semundjeve te gjese se gjalla, te cilat nuk mbulohe nga Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit dhe shkembimi i informacionit	Komuna	
	F) Mbrojtja e bimeve		Monitorimi i semundjeve te bimeve dhe i informacionit	Komuna	
	G) Mbrojtja konsumatore	Vendosja e rregullave dhe regulloreve sigurimi i kushteve higjienike te vendit te tregut; heqja e ushqimit te demtuar nga vendi i tregtimit; aplikimi i gjobave ndaj tregtareve ne rast te thyerjes se rregullores; perpunimi i mishit		Bashkia	
II. Burimet natyrore	A) Pyjet	E drejta e pronesise dhe e shfrytezimit te pyjeve komunale		Komuna	Shoqatat e menaxhimit te burimeve natyrore
	B) Kullotat	Te drejta e pronesise dhe/apo perdorimit te kullotave komunale		Komuna	Shoqatat e menaxhimit te burimeve natyrore

III. Aktivitete jo- bujqesore	A)Marketing		Sistemi i Marketingut&Informacionit; Tregu i shitjes me shumice	Bashkia, shoqatat fermere, tregtaret	
	B) Ekstensioni		Shkembimi i eksperiencës dhe praktikave me të mira, trajnimi, mbështetja për futjen e teknologjive të reja	Bashkia & komuna	
	C) Sherbimet e kreditimit	Sigurimi i mikro-kredive për fermeret			Shoqatat e kursim kredise,kooperativat e kredise
IV. Infrastruktura rurale	A) Uji dhe Higjiena	Sherbime, investime, rregullore, pronesi		Bashkia & komuna	
	B) Transporti Rural	Riparim&Mirembajtje		Bashkia & komuna	

Tabela 13. Ekonomia rurale jobujqesore –mundesite dhe kushtet

Aktivitetet	Male/Fusha	Kerkesa investimi te larta/Te mesme/te ulta	Intensiteti i fuqise punetore: i Larte ose i Ulet	Tregu Lokal, Kombetar, Nderkombetar
<b><i>I. Agro-perpunimi</i></b>				
Vere/ pije	M,F	M	U	L,K
Leng frutash/recel	M,F	M	U	L,K
Perpunim mishi	M,F	M	U	L
Perpunim bulmeti	M,F	M	U	L,K
Perpunim perimesh	F	M	L	L,K
Kafe	M	M	L	L
Ereza	M	U	L	L,K,N
Kerpudha	M	U	L	K,N
Vaj ulliri	F	L	U	L,K
Lule	F	L	L	L
Ferma peshkimi	F,M	U	U	L,K
Ereza	F,M	L	L	L,K
Duhan	F	U	L	L,K,N
<b><i>II. Sherbime</i></b>				
Pjekje buke	F,M	U	L	L
Transporti	M,F	M	U	L
Sherbime mekanike	M,F	L	U	L
Gur gelqeror	M	M	L	L,K
Bare/resorante/Hotele	F,M	L	L	L
Dyqane te shitjes me pakice	M,F	U		L
Firma ndertimi	M,F	L	L	L
Hidraulike	F,M	U		
Karpienteri/gure	M,F	U	L	L
Elektrike	F,M	U	U	L
Pune metalike	F	U	U	L
Prodhimi i instrumentave	M	M	L	L
Turizem/Kohe e lire	F,M	L	U	L,K
<b><i>III. Pyllezimi/pylltaria/kultivimi i drureve frutore</i></b>				
Fidanishte	F	M	L	L,K
Perpunimi i drurit	M,F	L	L	L,K
Lende drusore djegese	M	U	L	L,K
Gjuetia/mbareshtimi/Konservimi	M	M	U	L,K
Rritja e bleteve	M,F		U	L,K
<b><i>IV. Infrastruktura</i></b>				
Punet komunale	M,F	L	L	L,K
Punet publike	F,M	L	L	L,K
<b><i>V. Mjeshteri</i></b>				
Endja (sixhadesh)	M	M	L	L,K
Punime druri	M,F	M	L	L,K
Argjendari	M	M	L	L,K
Veshmbathje	M	M	L	
<b><i>VI. Punesimi ne sektorin shteteror</i></b>				
Administrata	F,M	U	-	L
Shkollat/spitalet	F,M	U	-	L
Policia/ushtria	F,M	U	-	L



<b>VII. Industrite</b>	F,M			
Prodhime te modes se fundit bazuar ne punen me cope	F,M	M	L	K,N
Punime zhavorri/ rere	F,M	L	U	K,L

Aneks IV. Te dhena mbi popullsine – Regjistrim i pergjithshem i popullsise  
(1 prill 2001)

**Popullsia banuese e Shqiperise nga 1 prill 2001 (ne '000)**

	<b>Total</b>	<b>Perqindja</b>	<b>Meshkuj</b>	<b>Femra</b>
Popullsia	3087,2	100,0	1540	1547,0
Urbane	1300,0	42,1	643	658,0
Rurale	1787,2	57,9	898	889,2

**NUMRI I FAMILJEVE DHE SHTEPIVE NE SHQIPERI SIPAS REGJISTRIMIT TE PERGJITHSHEM  
TE**

**1 PRILL 2001**

	<b>Total</b>	<b>Urbane</b>	<b>Rurale</b>
Familje	728,6	331,8	396,8
Anetare/familje	4,2	3,9	4,5
Shtepi	783,7	361,8	421,
Banuar	691,6	313,2	378,4
Jobanuar	92,1	48,6	43,5
Ne perqindje	11,7	13,4	10,3

**Zhvillimi i popullsise, Regjistrimi i vitit 1979, 1989 dhe 2001 (ne '000)**

<b>Popullsia</b>	<b>Total</b>	<b>Meshkuj</b>	<b>Femra</b>
1979	2590,9	1337,4	1253,2
1989	3182,4	1438,9	1545,4
2001	3087,2	1540,0	1547,2
<b>Urbane</b>			
1979	866,2	442,0	424,6
1989	1137,6	577,1	560,5

2001	1300,0	642,0	658,0
<b>Rurale</b>			
1979	1724,0	896,5	827,5
1989	2044,9	1061,0	983,9
2001	1787,2	898,0	889,2

**NDARJA E KOMUNAVE DHE BASHKIVE SIPAS MADHESISE**

<b>Banore nga-ne</b>	<b>Numri i Komunave dhe Bashkive</b>	<i>Perqindja e popullsisë</i>
500-4999	180	17.1
5000-9999	132	29.5
10000-38999	53	24.5
39000-99999	8	17.8
100000-350000	1	11.1

**POPULLSIA BANUESE NE MIJE DHE MADHESIA MESATARE E FAMILJEVE SIPAS REGJISTRIMIT TE 1979, 1989, 2001**

	<b>1979</b>	<b>1989</b>	<b>2001</b>
Popullsia rezidente	2590,6	3182,4	3087,2
- Zona urbane	866,6	1129,8	1299,9
- Zona rurale	1724,0	2052,6	1787,3
Numri i familjeve	463,3	675,4	728,6
- Zona urbane	186,9	289,2	331,8
- Zona rurale	276,4	386,2	396,8
Anetaret e familjes	5,6	4,7	4,2
- Zona urbane	4,6	3,9	3,9
- Zona rurale	6,2	5,3	4,5